

KONFERENCË SHKENCORE NDËRKOMBËTARE
NË PËRVJETORIN E DHJETË TË SHTETËSISË
SË KOSOVËS

KONSOLIDIMI I SHTETIT DHE SFIDAT EUROINTEGRUESE

BOOK OF PROCEEDINGS

15-16 Shkurt, 2018
@ Kolegji AAB

Prishtinë - Republika e Kosovës

<http://konferencat.aab-edu.net/iceich2018/>



Kolegji AAB
CILËSI, LIDERSHIP, SUKSESI



KOLEGJI UNIVERSITAR "PAVARËSIA VLORË"

**KONFERENCË SHKENCORE
NDËRKOMBËTARE NË PËRVJETORIN E
DHJETË TË SHTETËSISË SË KOSOVËS**

**BOOK OF
PROCEEDINGS**

Organizuar nga:



AAB College

Në partneritet me:



KOLEGJI UNIVERSITAR "PAVARËSIA VLORE"



**15 shkurt, 2018, Prishtinë
Republika e Kosovës**

Konferencë shkencore ndërkombëtare në Përvjetorin e dhjetë të Shtetësisë së Kosovës

KONSOLIDIMI I SHTETIT DHE SFIDAT EUROINTEGRUESE

Kosova që nga 17 shkurti i vitit 2008 është shtet i pavarur që ka hyrë në komunitetin botëror të shteteve dhe ka fituar anëtarësimin në organizata të ndryshme ndërkombëtare. Ajo vazhdon me anagzhime për anëtarësim në organizata të tjera botërore dhe rajonale.

Pavarësia e Kosovës është shpallur me përpjekje të koordinuara të institucioneve të saj me institucionet e demokracive kryesore botërore. Kështu Parlamenti i Kosovës e shpalli Pavarësinë e vet me Deklaratën e Pavarësisë dhe që nga ky akt e deri më tani, si shtet është njohur nga 114 shtete të botës.

Por, përveç sukseseve, rrugëtimi për konsolidimin e shtetit të ri, ka pasur edhe sfidat dhe vështirësitë e veta. Këto sfida dhe vështirësi kanë qenë të brendshme dhe të jashtme. Ndërtimi i institucioneve, zhvillimi i proceseve demokratike, sundimi i ligjit, transparenca në qeverisje, lufta kundër korrupsionit, dialogu i brendshëm etj., janë disa nga sfidat që janë prezente në shoqëritë post-komuniste dhe në shoqëritë që kanë dalë nga lufta., si sfida dhe vështirësi të brendshme. Krahës këtyre, Kosova vazhdon të ballafaqohet edhe me sfidat në fushën e bashkëpunimit rajonal, dialogut me Serbinë, zhvillimit të fqinjësisë së mirë, kontributit për stabilitet në rajon etj. Kapërcimi i këtyre sfidave dhe zgjidhja e këtyre problemeve vështrohen dhe vlerësohen nga bashkësia ndërkombëtare, në veçanti nga BE-ja, në rrugëtimin e Kosovës për integritet europian dhe euro-atlantike.

Konferenca shkencore Konsolidimi i shtetit dhe sfidat eurointegruese vë theksin në mënyrë të qartë te çështjet lidhur me sfidat për integritetin e Ballkanit Perëndimor në BE dhe rëndësinë e përshpejtimin të integritetit të Kosovës në këtë proces. Kosova vazhdon të jetë faktor kyç për stabilitetin në Ballkan dhe çështje kruciale në përshpejtimin e proceseve integruese të të gjithë rajonit.

Dhjetëvjetori i Pavarësisë së Kosovës dhe kjo konferencë jubilarë e këtij viti ka për qëllim që të bëjë bashkë akademikë, hulumtues dhe personalitete (vendore dhe ndërkombëtare) të cilët në mënyra të ndryshme kanë qenë të angazhuar në procesin e pavarësimit të Kosovës. Kjo është një mundësi e veçantë ku studiuesit me kërkimet e tyre do të

zhvillojnë debat akademik në njërën anë dhe ata mund të dëgjojnë drejtpërdrejt edhe folësit kryesorë të konferencës, që ishin të përfshirë në aktivitetet për shpalljen e Pavarësisë së Kosovës, në anën tjetër.

Komiteti Shkencor:

- Prof. Ass. Dr. Lulzim Tafa – Kolegji AAB, Prishtinë
- Prof. Asoc. Dr. Muhamet Kelmendi – Kolegji AAB, Prishtinë
- Dr.Sc. Petrit Bushi – Kolegji AAB, Prishtinë
- Prof. Dr. Roland Zisi – Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë
- Prof. Dr. Kseanela Sotirofski – Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës
- Prof. Asst. Dr. Faton Shabani - Universiteti i Tetovës
- Dr.Sc. Myzafer Elezi, Universiteti “Pavarësia”, Vlorë
- Prof. Asst. Dr. Hasan Saliu, Kolegji AAB, Prishtinë
- Prof. Asst. Shaip Bytyqi – Kolegji AAB, Prishtinë

Këshilli organizues:

- Prof. Asst. Dr. Bashkim Rrahmani
- Dr.Sc. Mentor Lecaj
- Prof. Asst. Hajdin Abazi
- Dr.Sc. Ylber Aliu
- Njomza Haziraj
- Albulena Brestovci
- Elsa Zyberaj
- Blerta Neziri

Përmbajtja

PROCEDURA LIGJORE NË KONTESTET E PUNËS NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Afrim Jakupi, PhD Candidate..... 9

NEPOTIZMI DHE KORRUPSIONI NË PUNËSIM SI PENGESË E INTEGRIMIT EUROPIAN TË MAQEDONISË

Agim Beqiri 25

POZICIONI LIGJOR I NOTERISË DHE ROLI I NOTERIT NË PËRPILIMIN E AKTEVE NOTERIALE

Agron Arslani 35

Ali Aliu..... 35

PËRGJEGJËSIA E ORTAKËVE/AKSIONARËVE PËR DETYRIMET E SHOQËRISË TREGTARE NË RAST TË KEQPËRDORIMIT TË SUBJEKTIVITETIT JURIDIK TË SHOQËRISË TREGTARE

Ali Aliu..... 53

Agron Arslani 53

EFEKTET E GLOBALIZIMIT NË PROCESIN E PUNËS

Aljona Laska..... 71

PAVARËSIA E PUSHTETIT GJYQËSOR NË SHQIPËRI

Dr.Arjana Llano..... 85

Dr. Stela Meçaj 85

MBROJTJA KUNDËR DISKRIMINIMIT NË EVROPË

Dr.Aulona Haxhiraj 95

PJESËMARRJA E QYTETARËVE NË PROCESIN VENDIMMARRËS NË NIVEL VENDOR.RASTI I BASHKISË DEVOLL.

M.Sc Enida Haxhi (Shishi)..... 113

ORPHAN WORKS-ALBANIA AND KOSOVO: TWO DIFFERENT LEGAL FRAMEWORKS	
Dr. Ergysa Ikonimi	139
MBROJTJA E DËSHMITARËVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË	
Fatbardha Ismaili	153
GLOBALIZIMI, INOVACIONI DHE KONKURENCA	
Fatime Musliu, PhD student	161
CHALLENGES OF WESTERN BALKANS' ACCESSION TO THE EU, THE SAA	
PhD.Candidate. Fatlume Jaha.....	175
SOCIETAS EUROPAEA - A NEW ENTRY TO THE LAW OF THE REPUBLIC OF MACEDONIA	
Faton Shabani	199
MINORITETET NË KOSOVË DHE NË VENDET E RAJONIT, TRAJTIMI I TYRE PËRKITAZI ME TË DREJTAT E NJERIUT DHE PËRDORIMI POLITIK I TYRE	
Gjenis Haxhimehmeti	207
REALIZMI DHE EKUILIBRI I FUQIVE	
Mr. Hedibe Nesimi; Phd candidate.....	221
ARTIFICIAL REPRODUCTIVE RATIONALITIES IN ALBANIA AND KOSOVO	
Dr. Jonada Zyberaj	239
WOMEN'S PARTICIPATION IN THE DECISION MAKING: COMPARATIVE STUDY BETWEEN VITIA MA FROM KOSOVO AND TEARCE MA FROM MACEDONIA	
Lirie Aliu	251
Gjylten Ademi	251
AKTORET DHE ROLI I PARTNERITETIT PUBLIK-PRIVAT NË MENAXHIMIN E TURIZMIT TË QËNDRUESHËM	
Dr(c). Marinela Selmanaj	265
Dr. Merita Murati	265

SFIDA E BASHKËPUNIMIT RAJONAL TË KOSOVËS NË KUADËR
TË PROCESIT TË INTEGRIMIT EVROPIAN

Stela Meçaj 285

ROLI I ADMINISTRATËS SË TREGUT TË PUNËS NË ZHVILLIMIN
EKONOMIK: RASTI I KOSOVËS

Dr. Ylber Aliu..... 295

PROCEDURA LIGJORE NË KONTESTET E PUNËS NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Afrim Jakupi, PhD Candidate*

Abstrakt

Në jetën e përditëshme, njeriu mund të vijë në situatë që të themelojë marrëdhënie pune në baza të ndryshme, dikush themelon marrëdhënie pune si punëtor i zakonshëm, dikush është në gjendje të kryejë funksion publik, dikush të punojë edhe jashtë marrëdhënies së punës dhe të gjitha këto kanë të drejta të caktuara, të cilat padyshim mund të çenohen ose të lëndohen.

Në këtë punim do të analizohen të drejtat e marrëdhënies së punës, të drejta të cilat, janë të rregulluara dhe të përcaktuara me ligje të veçanta, siç është “Ligji për marrëdhëniet e punës”, ligjet e tjera, marrëveshja kolektive dhe kontrata e punës, të cilat njëkohësisht janë të garantuara me Kushtetutë dhe nëse vjen deri te shkelja e këtyre të drejtave, varësisht nga ajo a bëhet fjalë për të drejta individuale ose kolektive, si mund të zgjidhen të njëjtat, respektivisht cila është mënyra e zgjidhjes së kontestit, mbrojtja para institucioneve kompetente dhe a mund të zbatohet në kontestet e marrëdhënies së punës revizioni si mjet i jashtëzakonshëm juridik.

Fjalët kyç: *mbrojtja e të drejtave, procedura në kontestet e punës, revizioni, në Republikën e Maqedonisë.*

Hyrje

Mirëqenia e çdo individit është e lidhur ngushtë me respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, dhe në këtë aspekt e drejta për punë është një e drejtë themelore. Gjatë marrëdhënies së punës, hasim në situata të ndryshme të pakëndëshme, pavarësisht cilësisë që paraqiten, si punonjës apo si punëdhënës. Kjo temë fokusohet në fushëveprimin e procedurave në zgjidhjen e kontesteve të punës. Nënkontestet e punës nënkuptojmë ose mendojmë për ato konteste që ndodhin midis punëtorit dhe punëdhënësit.

*Afrim Jakupi, PhD Candidate, Gjykatës në Gjykatën e Apelit në Gostivar, R.Maqedonisë.afrim.jakupi71@gmail.com

Ajo që është e rëndësishme të përmendet edhe si varianti më i madh i mundshëm për kontestet në punë, është shkarkimi ose ndërprerja e marrëdhënies së punës(pushimi), që padyshim do të shkaktonte reperkusion të madh ose do të rrezikonte jetën dhe shëndetin e njerëzve, respektivisht të punëtorit.

Është interesante të përmendet se të gjithë nga këndvështrimi i tyre, të udhëhequr nga interesi personal, mendojnë se e drejta është në anën e tyre. Por, megjithatë me ose pa arsye, epilogu është hyrje në kontestin e punës, që në mënyrë të pashmangëshme imponon kërkesën për zgjidhjen e kontestit dhe zgjidhja e kontestit mund të jetë nëpërmjet rrugës paqësore(me marrëveshje), jashtë gjykatës me ndihmën e pajtuesve ose arbitrit, ose zgjidhja e të njëjtit përmes procedurës përkatëse, gjegjësisht procedurës gjyqësore.

Përgjithësisht pranohet mendimi, se në një sistem të suksesshëm juridik, kontesteve, së pari, iu duhet shmangur, ose duhet të zgjidhen shpejt dhe me marrëveshje respektivisht në mënyrë paqësore, por kjo nuk është gjithmonë kështu.

Në Republikën e Maqedonisë, ekzistojnë ligje si mekanizma juridikë për zgjidhjen më efikase të kontesteve, si të atyre kolektive dhe atyre individuale, qoftë përmes zgjidhjes paqësore të kontestit të punës, të njohur si zgjidhje jashtë gjyqësore ose përmes procedurës gjyqësore. Pra, ekzistojnë dy mënyra për të zgjidhur kontestet e punës.

Vlen të potencohet se procedura për zgjidhjen paqësore të kontesteve të punës, e cila në thelb është vullnetare, ka për qëllim të ndihmojë palët e përfshira në kontest, për të arritur kompromis ose për të zgjidhur problemin në mënyrë më të lehtë, më të shpejtë dhe me kosto ekonomiko-financiare më të ulët. Por jo gjithmonë te ne, kontestet e punës kanë zgjidhje nga vetë punëdhënësi. Në një numër të madh rastesh, kontestet e punës marrin epilog të zgjidhjes gjyqësore të kontesteve, të cilat për dallim nga zgjidhjet jashtëgjyqësore-paqësore, mbasin të pazgjidhura më shumë se afati i përcaktuar me Ligjin për procedurën civile të R.Maqedonisë, kjo nga shkaku i strukturës organizative të gjyqësisë në vendin tonë, respektivisht R.M-së, si dhe ngarkesës të një numri të madh të lëndëve nëpër gjykata, ndërsa, nga pikëpamja ekonomiko-financiare, zgjidhjet e këtilla janë të shtrenjta.

Ajo çka është e rëndësishme të potencohet, se ekzistojnë mjete që përdoren si masa mbrojtëse në kontestet e punës. Pra, si mjete mbrojtëse juridike, janë ose i njohim, kundërshtimet dhe paditë.

Kundërshtimet në marrëdhëniet e punës, në fakt, mund të konstatohen se ato përfaqësojnë mjete mbrojtëse kundër një vendimi ose akti të caktuar

të punëdhënësit, me të cilin punonjësi i drejtohet punëdhënësit për të rishikuar vendimin e dhënë, i cili pa dyshim e ndryshon pozitën juridike të punëtorit në marrëdhënien konkrete të punës.

Procedura iniciohet me padi përpara gjykatës kompetente, i cili me vendimin e vet, duhet të zgjidhë kontestin ndërmjet bartësve të të drejtave subjektive. Duhet potencuar se marrëdhëniet e punës, janë marrëdhënie juridike të natyrës specifike. Për shkak të rëndësisë ekzistenciale të marrëdhënieve të punës, procedura në kontestet e punës është urgjente. Parimi i urgjencës ose procedurës së përshpejtuar manifestohet në mënyrë që, pas paraqitjes së padisë në gjykatë, padia menjëherë, në kohën më të shkurtër të mundshme, duhet të procedohet, respektivisht t'i dërgohet palës së kundërt. Pas marrjes së padisë, i padituri duhet të dorëzojë përgjigjen për padinë në afat prej 8 (tetë) ditëve. Që nga fillimi i procedurës, deri në zgjidhjen gjyqësore, nuk duhet të kalojë më shumë se 6 (gjashtë) muaj përpara gjykatës së shkallës së parë, ndërsa procedura para gjykatës së shkallës së dytë, duhet të përfundojë brenda 30(tridhjetë) ditëve nga dita e pranimit të ankesës ose maksimumi brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve, nëse para gjykatës së shkallës së dytë mbahet seancë publike.

Është karakteristikë të përmendet se në kontestet me karakter statusi, me rastin e ndërprerjes së punësimit, revizioni si mjet i jashtëzakonshëm juridik gjithmonë lejohet pa marrë parasysh vlerën e kontestit. Shqyrtimi dorëzohet në gjykatën më të lartë gjegjësisht në gjykatën supreme të R.Maqedonisë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e vendimit të plotfuqishëm të shkallës së dytë, ndërsa gjykata supreme, sipas “Ligjit mbi procedurën kontestimore”, është e detyruar të vendosë brenda 8 (tetë) muajve nga marrja ose pranimi i lëndës.

Kontestet nga marrëdhënia e punës, llojet

Në Republikën e Maqedonisë në veçanti, si dhe në vendet në rajon në përgjithësi, si vende në tranzicion, problemet e punës janë gjithnjë e më shumë të pranishme dhe të cilat, në fakt, datojnë me vite, ose për më tepër me dekada. Në përplasjen e interesave midis më të “fuqishmit” dhe më të “dobët”, në këtë rast punëdhënësit dhe punëtorit, të cilat në mënyrë të pashmangshme çojnë në pakënaqësi latente, si dhe përplasje të hapura midis dy lloj "aktorësh". Pra konteste nga marrëdhëniet e punës janë konteste, të cilët dalin në mes punonjësit dhe punëdhënësit, e si rezultat i

shkeljeve të disa të drejtave, respektivisht mos kryerjen e obligimeve që dalin nga puna.¹

Dallojmë dy lloje të kontesteve të punës:

- kontestet individuale të punës
- kontestet kolektive të punës

Dallimi kryesor midis kontesteve individuale dhe kontesteve kolektive është se në kontestin individual është i përfshirë një individ, ndërsa në kontestin kolektiv përfshihen më shumë individë ose një grup punëtorësh. Kontesti individual, ose kontesti me një person, është kontest që është rezultat i mospajtimit në mes të një punëtori dhe punëdhënësit, karakteristikë e këtij lloji, është se mosmarrëveshja ndodh në rastet e mëposhtme:

- Me rastin e anulimit të kontratës për punësim, respektivisht gjatë themelimit, ekzistimit dhe ndërprerjes së marrëdhënies së punës
- Lidhur me sistemimin dhe risistemimin e punëtorit
- Konteste lidhur me sigurimin social, për mospagesën e rrogës më të ulët².

Si palë në këtë kontest konsiderohen punëtori dhe punëdhënësi.³ Mund të themi se kontesti individual mund të zgjidhet ose nëpërmjet Institutit për zgjidhje të kontestit në mënyrë paqësore, pra zgjidhje jashtëgjyqësore të kontestit, nëpërmjet arbitrit dhe së fundi përmes procedurës gjyqësore⁴. Në vetë “Ligjin mbi zgjidhjen me ujdi ose paqësore të kontesteve të punës” të R.Maqedonisë, është parashikuar që nëse mes palëve, në kontestin individual është në rrjedhë procedura gjyqësore, nga e njëjta bazë faktike dhe ligjore, palët kanë për detyrë që gjykatës, bashkarisht t’i parashtrojnë kërkesë për ndërprerjen e procedurës⁵, që do të thotë se procedura jashtëgjyqësore bëhet primare, kurse procedura gjyqësore sekondare.

Lloji tjetër i mosmarrëveshjes është kontesti kolektiv. Ky kontest ndodh kur rrezikohen ose cënohen disa të drejta ose interesa të të gjithë

¹Herman,B.&Çupurdija, M. (2011).*Osnovi radnog prava*.Osijek, fq. 178.

² A Janevski, T&Kamilovska, Z. (2009). *Gragjansko procesno pravo-kniga prva Parnicno pravo*. Shkup fq. 486.

³Neni 29 i *Ligjit mbi zgjidhjet me ujdi të kontesteve të punës*, Gaz. Zyrtare e RM-së.

⁴Dika, M. &Triva,S. (2004).*Građansko parnično procesno pravo*.Zagreb, fq.793.

⁵Dika, M. & Triva, S. (2004).*Građansko parnično procesno pravo*.Zagreb, fq.793.

kolektivit të punës, ose të një kategorie të caktuar, grupit të punësuarve, respektivisht punëdhënësit. Më shpesh, si palë në këtë kontest, shfaqet sindikata. Vlen të theksohet se ky lloj kontesti nuk është e drejtë individuale, respektivisht interes i punëtorit, punëmarrësit, por është shkelje e të drejtave kolektive, si interes i përgjithshëm i kolektivit apo grupit të punës. Kontesti kolektiv i punës është kontest midis punëdhënësit dhe organizatave të tij nga njëra anë dhe punëtorëve dhe organizatave të tyre në anën tjetër dhe në lidhje me rregullimin kolektiv të marrëdhënieve të punës.⁶ Zgjidhja e këtyre kontesteve dallon nga zgjidhja e kontestit individual.⁷ Kontesti kolektiv i punës i parashikuar në “Ligjin për zgjidhje paqësore-me ujdi të kontesteve të punës”, konsiderohet kontesti, i cili është rezultat i lidhjes, ndryshimit, plotësimit ose zbatimit të marrëveshjes kolektive, ushtrimit të të drejtave të organizatës sindikale dhe grevës⁸. Pra, kontestet kolektive të punës konsiderohen keqkuptimet midis sindikatave dhe punëdhënësve. Definicioni ligjor na jep të drejtën të konkludojmë se, kontesti kolektiv është rezultat i tre rasteve: Me rastin e lidhjes, ndryshimit, plotësimit ose zbatimit të marrëveshjes kolektive në ushtrimin e të drejtave të organizimit sindikal dhe në realizimin e së drejtës për grevë. Kontestet kolektive, në pikëpamje me të drejtën e huaj dallohen si konteste juridike, të cilat karakterizohen në aspektin e interpretimit dhe zbatimit, përkatësisht zbatimit të dispozitave (rregullativave) shtetërore dhe marrëveshjeve kolektive, si dhe kontesteve të zgjidhura ose të përfunduara, të njohura si konflikte interesash ose ekonomike, të cilat kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrimet e palëve në kontest.⁹

Mënyra e zgjidhjes së të drejtave nga marrëdhënia e punës

Duke u nisur nga fakti se të drejtat nga marrëdhënia e punës janë të drejta të përcaktuara dhe të rregulluara me ligjin mbi marrëdhëniet e punës, ligji mbi inspektoriatin e punës, ligji për mbrojtje sociale, ligji për mbrojtje shëndetësore e tjerë, kontratën kolektive dhe kontratën e punës, të njëjtit janë të patjetërsueshëm dhe të pakufizuar dhe njëkohësisht të garantuar me kushtetutë, të cilët shpesh herë dinë të jenë të çenuar ose shkelur dhe

⁶Ibide, fq. 794

⁷Kenoviq, M.&Dedij, S. (1999). *Osnovi radnog prava*. Sarajevë, fq. 444

⁸Neni 2 i *Ligjit mbi zgjidhjet me ujdi të kontesteve të punës*, Gaz. Zyrtare e RM-së.

⁹Kenoviq, M.&Dedij, S. (1999). *Osnovi radnog prava*. Sarajevë, fq. 444

si rrjedhojë lind çështja dhe nevoja për një mekanizëm ligjor për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Nën mbrojtjen e të drejtave nga marrëdhënia e punës, nënkuptojmë të drejtën që bartësi i një të drejte subjektive mund të shfrytëzojë duke iu drejtuar një subjekti tjetër, organit shtetëror ose një organi tjetër të parashikuar me ligj, me qëllim të mbrojtjes të së drejtës së tij.

Mënyra e zgjidhjes së kontesteve të punës ose mbrojtja e të drejtave nga marrëdhënia e punës, duke marrë parasysh kontestet individuale dhe ato kolektive, në ligjin për marrëdhëniet e punës dhe nga njohësit e fushës të së drejtës së punës, parashikohen këto mënyra:

- Zgjidhja paqësore ose zgjidhja jashtëgjyqësore, (zgjidhja përmes arbitrazhit, mbrojtja te punëdhënësi)
- Zgjidhja gjyqësore
- Mbrojtja përmes sindikatës
- Mbrojtja me anë të organeve inspektuese
- Organet e tjera të parapara me ligj.¹⁰

Të përmendim se lënda e këtij shqyrtimi është mbrojtja e të drejtave nga marrëdhënia e punës nëpërmjet zgjidhjes paqësore të kontesteve dhe mbrojtjes gjyqësore. Siç e përmendëm më lart, gjatë periudhës punuese, punëtori shpesh vjen në përfundim se disa nga të drejtat e tij janë të shkelura ose nuk i janë siguruar, në një rast të tillë parashikohet mundësia ligjore, i njëjti t'i drejtohet punëdhënësit me kërkesë për të eliminuar, larguar shkeljen ose cënimin e së drejtës, që nënkuptojmë punëdhënësi t'a përmbushë detyrimin e tij. Domethënë, nëse punëdhënësi, pas kërkesës së paraqitur nga punëtori, vepron në mënyrë pasive në kuptimin e asaj që ai të mos përgjigjet fare në kërkesën e punëtorit, ose po përgjigjet me shkrim në atë mënyrë që edhe me atë vendim (prononcim me shkrim) të punëdhënësit, punëtori konsideron se e drejta e tij edhe më tej është e cënuar(shkelur), ku në një rast të tillë ka të drejtë brenda 8(tetë) ditëve, nga marrja e vendimit me të cilin i shkelet e drejta, të kërkojë nga punëdhënësi t'a eliminojë atë. Nëse punëdhënësi nuk i përmbush detyrimet e tij nga marrëdhënia e punës brenda 8(tetë) ditëve pas dorëzimit të kërkesës me shkrim të punëmarrësit, respektivisht punonjësi, në fakt punëdhënësi nuk e eliminon shkeljen e së drejtës, punëtori brenda 15(pesëmbëdhjetë) ditëve, mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore para

¹⁰Starova,G. (2009). *E drejta e punës*. Shkup, fq. 344..

gjykatës kompetente.¹¹ Për mbrojtjen gjyqësore, në mënyrë të detajuar do të bëhet fjalë në përmbajtjen e këtij punimi në vazhdim.

Në ligjin për marrëdhëniet e punës dhe ligjin për zgjidhjen me marrëveshje ose paqësore të kontesteve të punës, parashihet një Institut për zgjidhjen paqësore të kontesteve të punës, si te kontestet individuale, ashtu edhe në kontestet kolektive të punës, por vlen të përmendet se zgjedhja paqësore e kontesteve si Institut, është më e pranishme në kontestet individuale të punës se sa te ato kolektive. Por, më duhet të konstatoj se nga praktika gjyqësore 10(dhjetë) vjeçare, deri më tani nuk është vërejtur se kontesti është zgjidhur përmes mënyrës së zgjidhjes jashtë gjyqësore të kontestit.

Ligji mbi zgjidhjen me marrëveshje paqësore të kontesteve të punës si, "lex specialis" për çështjen e të ashtuquajturës shqyrtim jashtë gjyqësor, rregullon mënyrën dhe procedurën për zgjidhjen paqësore të kontesteve të punës, pavarësisht nëse ato janë konteste individuale ose kolektive të punës, përzgjedhja, të drejtat dhe detyrimet e pajtuesve, arbitrave, si dhe çështje të tjera, paraqesin rol të rëndësishëm për zgjidhjen paqësore të disa konteksteve.

Duhet theksuar se zgjidhja paqësore ose me marrëveshje, nuk zbatohet për të gjitha llojet e kontesteve, të cilat eventualisht mund të dalin nga kompleksi i marrëdhënieve të punës. Pajtimi është procedurë për zgjidhjen paqësore ose me marrëveshje të kontestit kolektiv të punës, në të cilën, nëpërmjet pjesëmarrjes së personit të tretë neutral, dy palët kundërshtare negociojnë derisa të arrihet marrëveshje reciproke e pranueshme për të dy palët.

Për t'u iniciuar procedura për zgjidhje paqësore të kontesteve të punës, është e nevojshme dhe e pashmangshme të përmbushen disa kushte. Sipas ligjit për zgjidhjen me marrëveshje të kontesteve të punës, procedura për zgjidhjen me marrëveshje fillon vetëm me kusht që të mos vendoset në pajtim me dispozitat e ligjit për marrëdhëniet e punës.¹²

Në pajtim me dispozitat e ligjit për marrëdhëniet e punës, me qëllim të qasjes në zgjidhjen paqësore-me marrëveshje të kontesteve të punës (kontesteve individuale dhe kolektive), është e pashmangëshme që të ketë apo të ekzistojë kontrata ndërmjet punëtorit dhe punëdhënësit dhe në bazë të kontratës t'i besohet zgjidhja e kontestit organit të posaçëm të

¹¹Neni 181 i *Ligjit mbi marrëdhëniet e punës*, Gaz. Zyrtare e RM.

¹²Starova, G.E *drejta e punës*. Shkup, fq. 348.

përcaktuar me ligj¹³ Si organ i posaçëm, shpeshherë mund të përcaktohet arbitrazhi, që do të thotë se paraprakisht dhe është kusht që të ekzistojë kontrata, respektivisht të jetë e përcaktuar ose e normuar në marrëveshjen kolektive organi i posaçëm. Vlen të theksohet se nëqoftëse marrëveshja kolektive parashikon "arbitrazhin" si Institut për zgjidhjen paqësore me marrëveshje të kontesteve, në rast të tillë vendimi i arbitrazhit është përfundimtar dhe i detyrueshëm për palët e involvuara në kontest¹⁴. Përbërja, procedura dhe çështjet e tjera thelbësore për punën e këshillit pajtues, gjegjësisht arbitrazhit, pa dyshim parashihen në marrëveshjen e palëve të përfshira, pra në vetë kontratën kolektive. Përndryshe arbitrazhi si Institucion nga pikëpamja historike, dhe në veçanti si Institucion për zgjidhjen e kontesteve është shfrytëzuar edhe para gjykatave.¹⁵

Për zbatimin e duhur të rregullave për zgjidhjen me marrëveshje të kontesteve të punës, me rëndësi thelbësore janë edhe parimet themelore të tij. Parimet bazë ose parimet që bazohet zgjidhja paqësore e kontesteve të punës, të cilat i propagandon edhe ligji, janë si në vijim:

- Parimet vullnetare
- Neutraliteti
- Paanshmëria dhe tripartizmi (pavarësia)
- Barazia
- Efikasiteti
- Drejtësia ose besueshmëria
- Mosprezenca e publikut.

Specifike për parimin e vullnetit-vullnetar, është fakti që palët, pjesëmarrësit në lidhjen e kontratës kolektive janë të lirë të vendosin vullnetarisht për pjesëmarrjen e pajtuesit në marrëveshjen kolektive dhe janë të lirë që vullnetarisht t'i qasen zgjidhjes me marrëveshje të kontestit, nëse nuk ka ndalim ligjor. Vlen gjithashtu të theksohet se në bazë të parimeve të neutralitetit, paanshmërisë dhe tripartizmit, në zgjidhjen e kontestit të punës janë të përfshirë palët në kontest, si dhe pajtuesi, arbitri, i cili është i detyruar për t'u qasur në mënyrë neutrale dhe të paanshme.¹⁶ Sa i përket procedurës për zgjidhjen paqësore(me marrëveshje) të kontestit të punës, është karakteristikë se ajo inicohet duke parashtruar

¹³Neni 182 i *Ligjit mbi marrëdhëniet e punës*, Gaz. Zyrtare e RM.

¹⁴Neni 183 i *Ligjit mbi marrëdhëniet e punës*, Gaz. Zyrtare e RM.

¹⁵Kenoviq, M.&Dediq, S. (1999).*Osnovi radnog prava*.Sarajevë, fq. 406/407.

¹⁶Neni 5/6 i *Ligjit mbi zgjidhjet me ujd të kontesteve të punës*, Gaz. Zyrtare e RM.

propozim, e jo padi dhe propozimi i parashtrohet organit, i quajtur Këshilli Republikan për zgjidhjen me marrëveshje të kontesteve të punës. Këshilli, pjesëmarrësit ose palët në mosmarrëveshje, mund të paraqesin propozim individual ose të përbashkët.¹⁷

Parimi i efikasitetit manifestohet në atë mënyrë që, pas propozimit, pajtuesi vepron në atë mënyrë që, pas dorëzimit të propozimit te pala tjetër, e fton të njëjtin që të deklarohe brenda 3(tre) ditëve nëse ai pranon zgjidhjen me marrëveshje të kontestit. Ndërsa parimi i mungesës së publikut është që pajtimi të bëhet vetëm në praninë e palëve në kontest pa praninë e palëve të treta ose publikut. Së fundi, vlen të përmendet se në procedurën për zgjidhjen me marrëveshje të kontesteve të punës, parashihen edhe shpenzime në këtë procedurë. Sa u takon shpenzimeve në procedurën për zgjedhjen e kontesteve me marrëveshje, duhet potencuar se ato janë gati të njëjta, si në procedurën gjyqësore, që nënkuptojmë se secila nga pjesëmarrësit, bart shpenzimet e tyre, ndërsa shpenzimet e pajtuesit i mbulon Këshilli si organ i veçantë.¹⁸

Është e rëndësishme të përmendet se procedura para arbitrit është pothuajse identike me procedurat gjyqësore në pikëpamje të mbajtjes së shqyrtimeve, provat e dëshmuara dhe propozimet, tërheqja e propozimit. Epilogu i procedurës para arbitrit është sjellja e aktvendimit, i cili sillet brenda 30(tridhjetë) ditëve nga hapja e seancës dhe kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesa. Aktvendimi bëhet i formës së prerë në të njëjtën ditë kur palët e pranojnë atë.¹⁹

Kompetenca, parimet dhe mbrojtja e të drejtave nga marrëdhënia e punës para gjykatës kompetente.

Lidhur me të drejtat nga marrëdhënia e punës, respektivisht mbrojtja e tyre gjyqësore, është çështje e rregulluar me ligjin për procedurë kontestimore, ku kontestet e punës normohen ose janë të grupuara në grupin e kontesteve të veçanta.

Procedura para gjykatës inicohet me padi. Shumë e rëndësishme dhe thelbësore për fillimin e procedurës, është paditësi ta identifikojë, ta

¹⁷Neni 7/10 i *Ligjit mbi zgjidhjet me ujdi të kontesteve të punës*, Gaz. Zyrtare e RM.

¹⁸Neni 14/15 i *Ligjit mbi zgjidhjet me ujdi të kontesteve të punës*, Gaz. Zyrtare e RM.

¹⁹Neni 35 i *Ligjit mbi zgjidhjet me ujdi të kontesteve të punës*, Gaz. Zyrtare e RM.

drejtojë padinë në gjykatë, e cila është kompetente si në aspekt të kompetencës reale ashtu dhe atë vendore, për të zgjidhur kontestin, përndryshe epilogu me vetëm paraqitjen e padisë do të ishte refuzimi - hedhja e padisë për shkak të moskompetencës reale dhe vendore të gjykatës. Në kontestet e punës, gjykatat kompetente janë gjykatat themelore me juridiksion²⁰ themelor dhe të zgjeruar. Juridiksioni vendor, përcaktohet nga vendbanimi i palës së paditur, respektivisht selia e të paditurit. Sidoqoftë, në kontestet e punës, nëse paditës është punëtori, për shqyrtimin e rastit përveç gjykatës që ka kompetencë vendore të përgjithëshme për të paditurin, kompetente është edhe gjykata në territorin në të cilën kryhet, ose është kryer, ose duhet të kryhet puna, si dhe gjykata në territorin e së cilës është e themeluar marrëdhënia e punës.²¹ Ndërsa, sa i përket përbërjes së gjykatës, vlen të përmendet se në kontestet e statusit para gjykatës së shkallës së parë, gjykon trupi gjykues (kolegji) prej 3(tre) gjyqtarësh, nga të cilët njëri është gjykatësi, i cili është gjykatës profesional dhe dy anëtarë të jurisë, ndërsa në kontestet jo statusore, kërkesa e të cilëve ka të bëjë me një kërkesë civile si për shembull, dëmshpërblim e tjerë, përbërja e gjykatës varet mbi të gjitha nga vlera që ka kontesti.

Ajo që karakterizon procedurën në kontestet e punës janë parimet që kërkojnë nga gjykata që të zgjidhin menjëherë kontestin, kështu që kur përcaktohen afatet dhe seancat, gjykata do t'i kushtojë gjithmonë vëmendje të veçantë nevojës për zgjidhjen urgjente të kontesteve të punës. Vlen të theksohet se në marrëdhëniet e punës, afati i fundit për t'u përgjigjur në padi është 8(tetë) ditë. Dëgjimi për seancën kryesore duhet të mbahet brenda 30(tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes së përgjigjes ndaj padisë, kur kontesti ka të bëjë me ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Gjithashtu, parimi i urgjencës karakterizohet nga fakti se procedura para gjykatës së shkallës së parë, duhet të përfundojë brenda 6(gjashtë) muajve nga pranimi i padisë. Ndërsa para gjykatës së shkallës së dytë(gjykatës së apelit), çështja duhet përfunduar brenda 30(tridhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të ankesës, por në qoftëse para gjykatës së shkallës së dytë(apelit), mbahet seancë dëgjimore-publike, atëherë çështja duhet përfunduar brenda dy muajve.²²

²⁰Neni 30/31 i *Ligjit mbi zgjidhjet me ujdë të kontesteve të punës*, Gaz. Zyrtare e RM.

²¹Neni 58 i *Ligjit mbi procedurën kontestimore*, Gaz. Zyrtare e RM.

²²Janevski, A.& Zoroska, K. T. (2009). *Gragjansko procesno pravo-kniga prva Parnicno pravo*. Shkup, fq. 2009

Siç përmendëm se mbrojtja e të drejtave nga marrëdhënia e punës në gjykatë, inicohet apo fillon me parashtrimin e padisë, e cila është veprim fillestar i procesit gjyqësor, forma dhe përmbajtja e së cilës përcaktohet me ligj. Padia mund të jetë me karakter të ndryshëm, me të mund të kërkohej, të gjykohej pavlefshmëria, përkatësisht anulimi i akteve juridike të punëdhënësit ose të kontratës së punës. Kërkesë-padia mund t'i referohet edhe realizimit të ndonjë kërkesë pa para nga marrëdhënia e punës, ose të referohen në kërkesë para. Kur bëhet fjalë për kërkesë padi në të holla(para), duhet të nënvizojmë një vertikale për të cilat punëtori ka fituar të drejtën me kryerjen e detyrimeve të punës dhe kërkesë të mjeteve(parave) për kompensim të dëmit që punëtori e ka pësuar në punë ose në lidhje me punën, si dhe ajo që i është shkaktuar atij nga punëdhënësi, gjegjësisht kompensimi i dëmit të shkaktuar ndaj punëdhënësit nga ana e punëtorit, por ajo që është e rëndësishme për analizën e këtij punimi është se fokusi do të jetë drejtim në kontestet me karakter statusor, dmth. konteste për ndërprerjen e punësimit.

Me parashtrimin e padisë hapet procedura, e me këtë për gjykatën si organ kompetent, lindin ose rezultojnë obligime, fillimisht të shqyrtojë karakterin, procesin formal të padisë, të shihet se padia a i përmban të gjitha elementet për të qenë në gjendje të veprojë në bazë të padisë, të shqyrtojë çështjen e identifikimit real të palëve, dmth. personat që paraqiten si paditës apo të paditur janë vërtetë ato palë. Kjo çështje është e natyrës materialo-juridike dhe jo e aspektit proceduralo-juridik, pra legjitimiteti del nga ajo se paditësi është me të vërtetë i legjitimuar, respektivisht a është ai bartës i kërkesës së theksuar në padi dhe nëse i padituri është me të vërtetë bartësi i detyrimit që rrjedh nga kërkesë-padia dhe në fund duhet të shqyrtojë bazueshmërinë e kërkesës që gjendet në padi dhe të marrë vendim në formë të aktgjykimit pozitiv ose negativ për paditësin ose të paditurin. Përndryshe, vlen të theksohet se padia në kontestet e punës mund të inicohet nga punëtori dhe punëdhënësi.

Gjatë marrëdhënies së punës, mund të ndodhë që të drejtat nga marrëdhënia e punës të jenë shkelur. Nëse punëtori konstaton se punëdhënësi nuk i siguron të drejtat nga marrëdhënia e punës, ose shkel ndonjë nga të drejtat e tij të marrëdhënies së punës, punëtori ka të drejtë t'i drejtohet me kërkesë me shkrim punëdhënësit për të hequr shkeljet ose për të përmbushur detyrimin e tij. Nëse punëtori vlerëson se vendimi i punëdhënësit ka shkelur të drejtën e tij, ai ka të drejtë brenda 8(tetë) ditëve nga dita e dorëzimit - pranimit të vendimit me të cilin është shkelur e drejta, të kërkojë që punëdhënësi t'a eliminojë shkeljen. Nëse

punëdhënësi brenda afatit të caktuar, prej 8(tetë) ditëve pas dorëzimit të kërkesës me shkrim të punëtorit, nuk i përmbush detyrimet e tij nga marrëdhënia e punës, d.m.th. ai nuk e eliminon shkeljen e së drejtës, në atë rast punëtori, brenda afatit shtesë prej 15 ditëve nga marrja e vendimit nga punëdhënësi, mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore në gjykatën kompetente, dhe kjo vlen edhe kur punëtori është shkarkuar nga vendi i punës, punëtori mund të paraqesë padi në gjykatën kompetente brenda 15(pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e vendimit nga punëdhënësi, kundër vendimit për shkarkim nga puna. Në rastin konkret dhe në ligjin mbi marrëdhëniet e punës, kushtet që duhet të përmbushen për të kërkuar punëtori mbrojtje gjyqësore, më parë duhet të ketë shfrytëzuar mundësinë për të kërkuar së pari mbrojtjen e të drejtave të tij të punës nga punëdhënësi²³, e pastaj të shohë mundësinë e inicimit të kontestit të punës. Por duhet të theksojmë se kemi përjashtime kur kërkesë-padia ka të bëjë me pretendimet në para, në këtë rast afatet dhe seancat dëgjimore prej 8(tetë) apo 15(pesëmbëdhjetë) ditësh janë të karakterit irelevant dhe kjo e drejtë mund të kërkohej drejtpërsëdrejti në gjykatë. Rasti është i njëjtë kur bëhet fjalë për kërkesë-padi me dëmshpërblim, të cilat mund të paraqiten në gjykatën kompetente me padi. I njëjtë do të ishte rasti kur kandidati i pazgjedhur për punësim, i cili konsiston se gjatë përzgjedhjes është shkelur parimi i mos diskriminimit, i njëjti ka obligim në afat prej 15(pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit nga punëdhënësi të iniciojë procedurën konkrete.²⁴

Shpesh herë, në procedurën gjyqësore parashtrohet pyetja e lejueshmërisë dhe afatshmërisë të kërkesë-padisë, domethënë nëse ndodh që punëtorit i ndërpritet marrëdhënia(kontrata e punës) me ose pa periudhë(njoftim) për shkarkim, ose të sistemohet në tjetër vend pune, për punëtorin ekziston obligimi kundër vendimit të tillë të punëdhënësit, të parashtrojë kundërshtim tek organi drejtues ose punëdhënësi.

Kundërshtimi dorëzohet brenda 8(tetë) ditëve nga dita e marrjes së vendimit për anulimin e kontratës së punës dhe pas kundërshtimit të parashtruar, punëdhënësi është i detyruar të marrë vendim ndaj kundërshtimit brenda 8(tetë) ditësh dhe nëse ndodh që të mos ketë epilog pas kundërshtimit të parashtruar, ose punëtori nuk është i kënaqur me vendimin e marrë pas kundërshtimit, ai ka të drejtë të iniciojë kontestim në gjykatën kompetente brenda 15(pesëmbëdhjetë) ditëve.²⁵ Nga kjo që u tha më lart del lejueshmëria, gjegjësisht palejueshmëria, si dhe

²³Starova, G.(2009. *E drejta e punës*. Shkup, fq. 345/346.

²⁴Neni 181 i *Ligjit mbi marrëdhëniet e punës*, Gaz. Zyrtare e RM.

²⁵Neni 91/93 i *Ligjit mbi marrëdhëniet e punës*, Gaz. Zyrtare e RM.

afatshmëria e kërkesë-padisë. Kjo do të thotë se nëse punëtori nuk ka kërkuar më parë mbrojtje para punëdhënësit ose kundërshtimi i paraqitur është parashtruar pas skadimit të afatit prej 8(tetë) ditësh, padia në rast të tillë është e palejueshme, për shkak se mbrojtja paraprake nuk është kërkuar para organit kompetent të shkallës së dytë të punëdhënësit. Në rast të tillë, nëse nuk kemi përmbyshjen e supozimeve procedurale për pranueshmërinë ose afatet kohore të padisë, gjykata pa u lëshuar në vlerësimin e bazës ose pabazës së kërkesë- padisë, e njëjta duhet hedhur si e palejueshme, respektivisht si e paafatëshme dhe këtua forma e vendosjes është me aktvendim. Edhe në kontestet e punës, baza e padisë është e parëndësishme, d.m.th. gjykata do të veprojë edhe kur baza juridike nuk është e theksuar²⁶.

Në fund, të theksojmë kur gjykata ka qasje nga vendimmarrja meritore të kërkesë-padisë, ekziston obligimi ligjor për të përgatitur aktgjykimin brenda 8(tetë) ditëve, i cili do t'u shpërndahet palëve të involvuara, të cilat kanë të drejtë të apelojnë, natyrisht, ajo palë që nuk është e kënaqur dhe afati për paraqitjen e ankesës është 8(tetë) ditë pas pranimit të aktgjykimit.

Revizioni në kontestet e statusit.

Revizioni si mjet i jashtëzakonshëm juridik gjithmonë lejohet në kontestet e statusit, ose kontestet për ndërprerjen e punësimit. Revizioni si mjet i jashtëzakonshëm ka karakter devolutiv, josuspenziv, prekluziv i dyanshëm dhe i kufizuar. Karakteri devolutiv konsiston në faktin se për të njëjtën vendos gjykata më e lartë nga ajo që ka sjellë vendimin, i cili goditet me revizionin. Josuspenziviteti konsiston në faktin se revizioni i dorëzuar nuk e pengon ekzekutimin e vendimit. Prekluziviteti konsiston në afatin kohor për paraqitjen e tij. Dyanshmëria ka të bëjë me faktin se kopje të revizionit gjithmonë i dorëzohet palës së kundërt. Karakteri i kufizuar ka të bëjë me aspektin e lejimit të tij dhe shkaqet për paraqitjen e tij ku vlen të theksojmë se lejimi i revizionit ka të bëjë me dy kritere: ajo e vlerës *ratione valoris* dhe kriteri kauzal *ratione causae*.²⁷

Revizioni dorëzohet kundër aktgjykimit të plotfuqishëm të dhënë nga shkalla e dytë, shkaqet e paraqitjes së revizionit me të cilën goditet vendimi i plotfuqishëm janë për shkak të shkeljes së dispozitave të

²⁶Neni 176 i *Ligjit mbi procedurën kontestimore*, Gaz. Zyrtare e RM.

²⁷Janevski, A. & Zoroska, K. T. *Gragjansko procesno pravo-kniga prva Parnicno pravo*. Shkup, fq. 414.

procedurës kontestimore, e cila është bërë në procedurën e gjykatës së apelit, zbatimi i gabuar të së drejtës materiale dhe për shkak të tejkalimit të kërkesë-padisë, po qe se kjo parregullësi është bërë në procedurën e zhvilluar në gjykatën e shkallës së dytë.

Palët mund të shfrytëzojnë të drejtën për të dorëzuar revizionin në afat prej 30(tridhjetë) ditëve nga data e dorëzimit ose nga pranimi i aktgjykimit të plotfuqishëm. Kusht për dorëzimin e revizionit, është që paraprakisht pala t'a ketë shfrytëzuar të drejtën e mjetit të rregullt juridik - ankesën.

Të theksojmë nga praktika gjyqësore kemi raste të rralla, kur revizioni përpara se të dorëzohet në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë, gjykata më e ulët të ketë vendosur në kuptimin që ai të hedhë me aktvendim si revizion jo i plotë, i lëshuar jashtë kohës së duhur, ose jo i lejuar, por kjo i lihet për të vendosur gjykata më e lartë, respektivisht Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë.

Ligji për procedurën kontestimore e njeh mundësinë, ose parashikon mundësinë që me paraqitjen e revizionit, palët mund të paraqesin fakte të reja dhe të propozojnë prova të reja vetëm nëse i referohen shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore për shkak të të cilave mund të deklarohej revizion.

Pas dorëzimit të revizionit, procedura është në atë mënyrë që revizioni i dorëzohet palës kundërshtare për dhënien e përgjigjes së revizionit, pala kundërshtare mund të paraqesë në gjykatë përgjigje të revizionit brenda 15(pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e dorëzim-pranimit të revizionit. Kur të hiqen të gjitha pengesat formalo-proceduriale, ajo i dorëzohet Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë, përndryshe të sqarojmë se i dorëzohet gjykatës, përmes gjykatës që ka shqiptuar aktgjykimin e shkallës së parë, deri te gjykata e shkallës së tretë²⁸.

Pas revizionit, Gjykata Supreme vendos në Kolegj të përbërë nga pesë gjyqtarë dhe është e detyruar të miratojë vendimin pas revizionit, jo më vonë se 8(tetë) muaj nga dita e marrjes së rastit në shqyrtim dhe për revizionin gjykata e revizionit vendos pa seancë dëgjimore.

Konkluzione

Ajo që u tha më sipër, absolutisht nuk paraqet pasqyrë shteruese të spektrit të plotë të procedurave për zgjidhjen e kontesteve të punës. Ndonëse sipas kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, çdo individ ose

²⁸Dika, M. &Triva, S. (2004).*Građansko parnično procesno pravo*. Zagreb, fq.805/806.

qytetar mund të thirret në gjykatat e Republikës së Maqedonisë për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të përcaktuara me kushtetutë. Por përveç gjykatave, ekzistojnë edhe institucione të tjera që thjeshtë aplikojnë ose rregullojnë procedurat përmes zgjidhjes paqësore të kontesteve të punës në atë mënyrë që brenda organeve të tyre, (pajtuesit ose arbitrat), përpiqen të zgjidhin ato konteste për të cilat nuk ka mundësi ligjore të prerë ose ndalesë për t'u zgjidhur të njëjtit. Edhe pse procedura për zgjidhjen me marrëveshje-paqësore të kontesteve është më efikase dhe ekonomikisht më e kapshme ose e pranueshme, përsëri numër i vogël i rasteve janë, ose ndoshta edhe nuk janë të njohur rastet, të cilat kanë epilog të zgjidhjes paqësore të kontesteve të punës, nëpërmjet Institutit, "zgjidhja me marrëveshje ose paqësore të kontesteve të punës". Në Republikën e Maqedonisë mbizotëron konkludimi se kontestet e punës në përqindje të madhe kanë zgjidhje nëpërmjet procedurës gjyqësore, e cila pa dilema është më e shtrenjtë, më e gjatë dhe kërkon përkushtim të madh.

Të punohet në çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e punës, nuk është vetëm kontribut në realizimin e ligjshëm dhe të qëllimshëm të të drejtave të qytetarëve, punëtorëve nga krijimi i marrëdhënieve të punës, por gjithashtu kjo paraqet dimension human në veprimtarinë e personave nga profesioni juridik. Tradicionalisht, menaxhimi i kontesteve të punës para së gjithash është përgjegjësi njerëzore, civile dhe profesionale.

Edhe pse procedura në kontestet e punës e parashikuar në dispozitat e procedurës civile është urgjente, duke u bazuar në parimet e prioritetit dhe urgjencës, dhe sidomos gjatë përcaktimit të afateve dhe seancave gjyqësore, gjykata gjithmonë duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë nevojës për zgjidhjen urgjente të tyre, megjithatë, në praktikë për fat të keq, kjo nuk është ashtu, kontestet e punës zgjasin për kohë të gjatë, madje edhe stërzgjatën shumë nga ajo që parashikohet në ligjin për proceset kontestuese. Arsyeja për stërzgjatjen e procedurës në kontestet e punës nuk duhet të fokusohet vetëm te gjyqtari dhe ai të konsiderohet si "fajtori kujdestar", përkundrazi, duhet t'i kushtohet vëmendje funksionimit dhe organizimit të gjyqësorit në Republikën e Maqedonisë, sepse një pjesë e gjykatave për shkak të mbingarkesës me lëndë, ato janë të stërmbushura dhe objektivisht nuk mund të veprojnë në afatin ligjor për të zgjidhur kontestet e punës.

Në fund, ajo që më jep të drejtën të konstatoj se nëse është e mundur në procedurën tjetër-paqësore, me pak më shumë përpjekje kontesti të zgjidhet nëpërmjet Institutit për zgjidhjen me marrëveshje-paqësore,

atëherë ia vlen të përdorni mënyrën më të lehtë, më të shpejtë dhe me kosto më të ulët për zgjidhjen e kontesteve të punës!

Bibliografia

Janevski A. Zoroska Kamilovska T. *Gragjansko procesno pravo-kniga prva Parnicno pravo*, Shkup 2009.

Herman V. Çupurdija M. *Osnovi radnog prava* Osijek 2011.

Starova G. *Trudovo pravo*, Shkup 2009.

Çela K. *E drejta e punës*, Tiranë 2005.

Dika M. Triva S. *Građansko parnično procesno pravo*, Zagreb, 2004.

Kenoviq M. Dediq S. *Osnovi radnog prava*, Sarajevë 1999.

Përmbledhja e vendimeve gjyqësore nga 2004-2014.

Revija gjyqësore e RM-së, 2006.

Ligji për procedurën kontestimore, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë.

Ligji për Gjykatat "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë".

Ligji për zgjidhjen me marrëveshje të kontesteve të punës Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë.

Ligji për marrëdhënie pune, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë.

NEPOTIZMI DHE KORRUPSIONI NË PUNËSIM SI PENGESE E INTEGRIMIT EUROPIAN TË MAQEDONISË

Agim Beqiri*

Abstrakt

Papunësia është problem me të cilin ballafaqohen shumica e vendeve të botës. Në përqindjen e lartë të papunësisë ndikojnë shumë faktorë, të cilët mund të jenë faktorët e zhvillimit ekonomik, resurset e një vendi, industrializimi etj. Edhe Maqedonia si vend aspirant për në BE përballet me një përqindje të theksuar të papunësisë. Por, një problem tjetër që shfaqet në këtë vend është edhe mënyra e rekrutimit në punë. Për këtë qëllim punimi është i fokusuar kryesisht në qëndrimet e qytetarëve, në lidhje me mundësitë e punësimit, mënyrën e publikimit të shpalljeve për punësim mënyrën se si realizohen intervistat për punësim, testimet për nënpunësit shtetërorë, ndikimi i shkallës së arsimimit dhe njohja e gjuhëve të huaja. Në këtë kuptim, duke pasur parasysh shkallën e zbatimit të ligjit, dukuritë e nepotizmit, diskriminimit dhe korrupsionit, janë të pranishme, dukuri këto që bëhen pengesë e dukshme në proceset eurointegruese të vendit. Hipoteza që shtrohet këtu është se në këtë vend shkalla e diskriminimit gjatë punësimit është e madhe, duke kërkuar të identifikohen mënyra e shfaqjes së nepotizmit dhe korrupsionit mbi mundësinë e punësimit në sektorin publik. Kjo hipotezë do të testohet në mënyrë kuantitative duke anketuar qytetarë për perceptimet e tyre për këto dukuri të pranishme.

Gjetjet nga ky studim dëshmojnë se shkalla e lartë e papunësisë dhe mënyra diskriminuese e rekrutimit, ndikojnë negativisht, mbi zhvillimin dhe konsolidimin e shumë sektorëve dhe kanë pasoja për të gjithë jetën shoqërore.

Fjalë kyç: *pabarazi, diskriminim, korrupsion, punësim, nepotizëm.*

* Dr. Agim Beqiri, Kolegji AAB, E-mail: agim.beqiri@aab-edu.net

Hyrje

Kriza ekonomike dhe recensionit i kapluan gati të gjitha vendet e afërta dhe të largëta në rajon dhe më gjerë. Ndërprerje të marrëdhënieve të punës, mbyllje të firmave dhe ndërmarrjeve, pavarësisht nëse janë të vogla, të mesme ose të mëdha, të gjitha pësuan dëme të mëdha si në fushën financiare ashtu edhe në tregun e punës. Papunësia në mënyrë rapide filloi të rritet gati në të gjitha vendet e Unionit Europian, të cilat llogariteshin si vende me standard të lartë dhe kushte të mira dhe kualitative për jetesë. Këto kohëra janë të paparashikueshme dhe se nuk dihet se çka mund të na sjellin në një të ardhme të afërt.

Republika e Maqedonisë kaloi ndër 25-vjet tranzicion, 25-vjet të zhvendosjeve në të gjitha sferat e jetës shoqërore. Ato vite ishin përplot me ataqe permanente, ekzistenciale dhe transitore – ndryshimi total i sistemit të vlerave, ndryshimi i raporteve dominuese pronësore, lufta për zbatim të sistemit politik pluralist, organizimi i referendumit për shkëputje nga Federatë e atëherëshme e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe lufta e vazhdueshme për afrim dhe praninë në organizatat ndërkombëtare.

Përqindja e lartë e personave të papunë sot paraqet shenjën më brengosëse të një situate të pafavorëshme sociale dhe ekonomike në vendin tonë. Papunësia, në bazë të shumë indikatorëve: shkaktarët, vëllimi, karakteristikat, trendet, në veçanti implikimet e ndërlikuara e karakterizojnë limitimin e horizonteve të shtetit të Maqedonisë në sigurimin e kushteve elementare ekzistenciale për banorët e vet, respektivisht shfaq pamundësinë e plotë të politikave makroekonomike të Maqedonisë për të ndërtuar një sistem ekonomik, i cili do t'i kyçë në mënyrë efikase banorët e vet në sistemin e tij të funksionimit.

Papunësia e lartë shumëfish e godet dhe e dëmton një shtet. Përkundër rritjes së varfërisë ajo e minon klasën e mesme në shoqëri, papunësia shkakton mosshfrytëzim të pjesshëm ose të plotë të resurseve njerëzore, ikje të “trurit” jashtë shtetit, rritje të punës në të “zezë”, manipulim të forcës punëtore dhe sjellje diskriminuese nga ana e ofruesve të vendeve të punës dhe ndjenja e privimit dhe pakënaqësisë - sidomos tek brezi i ri, i cili për këto arsye e humb motivimin për zhvillim të mëtutjeshëm, riedukim dhe ritrajnim.

Qëllimet e kërkimit

Duke pasur parasysh që ky punim do t'i qaset aspektit sociologjik dhe politik të punësimit, qëllimet e këtij kërkimi do të rezultojnë pikërisht nga

këto qasje. Punësimi ka një ndikim të madh në cilësinë e jetës së personit dhe të familjeve të tyre, ndërkohë që shkalla e ulët e punësimit flet për një shtet që nuk është në gjendje të sigurojë kushtet për një jetë optimale. Arritja e një shkalle të ulët të punësimit është një nga objektivat e pothuajse çdo ekonomie botërore dhe përparësia e këtillë për këtë synim del nga fakti se, papunësia e lartë shkakton një numër të madh problemesh që pastaj transmetohen në shumë fusha të shoqërisë.

Pyetjet kërkimore

Pyetjet kërkimore që do të jenë në fokus të këtij punimi janë si më poshtë:

- Fleksibiliteti i tregut të punës dhe ndikimi i tij në shkallën e papunësisë, sidomos në papunësinë afatgjatë dhe lëvizshmëria e forcës punëtore.
- Cilësia e arsimit dhe shanset e të rinjve për të gjetur punë menjëherë pas diplomimit.

Besojmë se përgjigjet në pyetjet kërkimore të mësipërme, do të hedhin dritë mbi gjëndjen reale në lidhje me punësimin/papunësinë në Maqedoni.

Dallimet rajonale në punësim

Në përgjithësi, zhvillimi ekonomik mund të vështrohet në tre nivele gjeografike, edhe atë: lokal, nacional dhe atë ndërkombëtar appo global. Sigurisht që nuk ekziston as edhe mundësia më e vogël që të arrihet një barazi absolute e zhvillimit në asnjërën nga tre nivelet e përmendura, por edhe pse ekzistojnë mendime se dallimet në zhvillim janë natyrale bile edhe dukuri të dobishme, liberalizimi solli shumë probleme nga fusha e pabarazisë. Jo vetëm që nuk u arrit një ekuilibër, porse dallimet ekzistuese u thelluan edhe më shumë edhe atë në bazë të shumë autorëve, në dëm të të varfërve.

Në nivel global ka një orvatje të grupimit rreth kapitalit ekonomik dhe politik- ushtarak, me çka krijohet një formulim i ri i kufijve nacionalë rreth këtij kapitali. Organizatat e tilla si Bashkimi European dhe pakti i NATO-s, përfaqësojnë një forcë të fuqishme që tenton të diktojë shpërndarjen e fuqisë ekonomike dhe politike - ushtarake në botë dhe që shtrihen pikërisht në pjesët më të zhvilluara të botës. Ajo që është

karakteristike, brenda kufijve të çdo shteti anëtar në këto organizata, është se, ritmi i shpejtë i rritjes së tyre ekonomike shpesh shkon në kurriz të rritjes së pabarazive zhvillimore rajonale.

Çfarë është pabarazia rajonale?

Pabarazia rajonale paraqet divergjencat apo pabarazinë e cilësive, fenomeneve ose proceseve që kanë një shpërndarje të veçantë hapësinore dhe ndodhin në të paktën dy subjekte të strukturës territoriale (*Kutscherauer et al., 2010:8*).

Ato dallime rajonale mund të paraqiten në dy forma, edhe atë:

- Dallime apo pabarazi midis njësive rajonale;
- Pabarazi brenda njësive rajonale.

Arsyet për paraqitjen e pabarazive

Arsyet janë të shumëllojshme. Në vazhdim do të mundohemi t'i përmbledhim të gjitha arsyet që sjellin deri tek një disparitet i këtitë.

- **Natyrale**, siç janë ekzistenca e burimeve natyrore në një territor të caktuar, klima e përshtatshme, qasja në terren, relievi i përshtatshëm, kushtet natyrore për krijimin e një infrastrukture të zhvilluar (sidomos të transportit). Zgjedhja e lokacionit për biznes paraqet kursim sa më të madh, me qëllim të rritjes së konkurrencës në treg.
- **Urbanizimi** – qytetet janë zona të dendura me popullatë dhe më shpejt zhvillohen në krahasim me zonat rurale, rrjedhimisht, të gjitha resurset kanë qasje më të lehtë.
- **Infrastruktura** mirë e zhvilluar, veçanërisht afërsia e njeve transportuese.
- **Afërsia e tregjeve**, që përsëri ndërlidhet me harxhimet më të ulta të transportit.
- Ekzistimi i **stabilitetit institucional**.
- **Kualiteti social, tradicional, kulturor i popullatës** në rajon të caktuar, qëndrimi i tyre ndaj punës dhe shprehitë e tyre.
- **Ndërlidhshmëria e të gjitha subjekteve** nga të cilat mund të varet rrjedhja e papenguar e punës etj.
- **Ndasitë e thella etnike, religjioze, politike ose në baza të tjera në shtet** që shkaktojnë rënie të investimeve dhe zhvillim të ulët ekonomik mbas të cilave fshihen qëndrime diskriminatore.

Sipas Marshall (*Marshallin Fujita, Krugman and Venables, 1999: 18*), tre faktorët kryesorë janë çelësi i përqëndrimit të aktivitetit ekonomik në rajone të caktuara:

1. **Përhapja, derdhja e dijes** – afërsia dhe qasja e lehtësojnë dhe ndikojnë pozitivisht mbi përhapjen e informacionit.
2. Përparësi ka **tregu i hapur i njohurive të specializuara** – Sipërmarrjet lehtë i gjejnë punëtorët me dituritë e specializuara, kurse punëtorët lehtë mund t'a ndërrojnë vendin e punës nëse sipërmarrja punon keq.
3. Ekzistenca e **lidhjeve me furnizuesit dhe blerësit**, të cilat gjithashtu janë rezultat i madhësisë së tregut – koncentrimi krijon treg për distributorë të specializuar lokalë, të cilët distribuojnë prodhimin e lëndëve të para dhe produkteve të ndërmjetme (inputeve).

Stimson, Stoug dhe Nizhkamp (R. Stimson, R. R. Stough and P. Nijkamp) e kanë krijuar të ashtuquajturin **model “Pentagon”** nëpërmes të cilit në mënyrë të qartë tregojnë se si duket renditja e resurseve që garantojnë një zhvillim të qëndrueshëm rajonal (*OPP*).

Më poshtë është treguar **modeli “Pentagon”** dhe pesë elementet e tij kyç, të cilat çdo rajon duhet t'i posedojë për të realizuar një rritje të shpejtë ekonomike:




Foto nr.9: Modeli Pentagon” për zhvillim të qëndrueshëm rajonal
(Marrë nga Stimson, Stough dhe Nijkamp, 2011: 10)

1. **Kapitali prodhues (KP)** – rëndësia e tij është nxjerrë nga teoritë neoklasike të rritjes, në bazë të së cilave prodhimi kryesisht determinohet nga ana e faktorëve tradicionalë të prodhimit, siç është puna dhe kapitali.
2. **Kapitali human (KH)** –i referohet kualitetit të fuqisë punëtore si faktor i prodhimit (niveli formal dhe joformal i arsimimit, shkathhtësi të reja). Potenciali për rritjen e rajoneve të caktuara dhe niveli i pabarazisë rajonale varet nga ajo se si kapitali human është i shpërndarë në mes të individëve brenda në rajon.
3. **Kapitali social (shoqëror)** – paraqet komunikim dhe interaksion ndërmjet aktorëve në rajon, rrjeteve të biznesit (formale dhe joformale) të sipërmarrjeve në nivel të rajonit, marrëdhëniet që bazohen në besim etj.
4. **Kapitali kreativ (KK)** - Ose niveli i aftësisë për t'i zotëruar sfidat e reja dhe shfrytëzimin e mundësive, kjo rrjedh nga ekzistenca e frymës sipërmarrëse dhe kulturës sipërmarrëse, pastaj prezanton mënyra të reja të menduarit dhe të vepruarit,

aftësia që problemet ekzistuese të zgjidhen në mënyrë inovative. Shpesh mund të gjenden në zonat multikulturore.

5. **Kapitali ekologjik (KE)** – thënë shkurt, e përbëjnë kushtet e përshtatshme për jetë dhe punë në ndonjë rajon. Mjedisi i pastër ekologjik, mundësitë për rekreim dhe sport, kulturë, arsimim etj., ndjeshëm e rrisin rëndësinë e rajonit.

Pasojat ekonomike të koncentrimin të kapitalit në hapësirë gjeografike, janë të shumta dhe të shumëllojshme:

- **Nga aspekti demografik** – shpopullim dhe plakje e popullsisë. Për shkak të pamundësisë për të gjetur vend pune, të rinjtë shpesh vendosin që të shkojnë nga rajoni i pazhvilluar dhe të shpërngulen në rajone të tjera, bile edhe jashtë shtetit.
- **Nga aspekti ekonomik** – pasoja më e rëndë me siguri është varfëria por, ka edhe shumë të tjera. Psh. Mosshfrytëzimi i kapaciteteve të shumta, mungesa e efektivitetit të politikës fiskale dhe asaj monetare etj.
- **Nga aspekti social** – thellimi i pabarazisë sociale, rritja e tensionit social, krijimi i kushteve për diskriminim direkt ose indirekt i të ashtuquajturave grupe të rrezikuara në shoqëri.
- **Nga aspekti juridik** – krijimi i klimës në të cilën direkt ose indirekt shkelen të drejtat themelore të njeriut.
- **Nga aspekti politik** – thellimi i dallimeve të botëkuptimeve ndër kundërshtarët politikë, mundësitë e keqpërdorimit të pozitave politike nëpër rajonet ku oferta për punë atraktive është e vogël, pamundësia e zbatimit të reformave të parapara me programet politike etj.

Integrimet në Bashkimin Europian

Siç është përmendur disa herë deri tash, njëri ndër problemet më të hidhura që përcillet bashkë me përqindjen e lartë të papunësisë, është rënia e standardit jetësor, varfëria dhe përjashtimi social, veçanërisht përjashtimi i të ashtuquajturave grupe të rrezikuara, të cilat nuk kanë ose e kanë të kufizuar qasjen në tregun e punës.

Njëri ndër funksionet e shtetit është që të sigurojë mirëqenie për qytetarët e vet. Mbajtja e baraspeshës dhe qetësisë sociale është punë komplekse dhe pikërisht për shkak të tyre, pothuajse çdo shtet derdh resurse të mëdha drejt zgjidhjes së problemit të papunësisë. Siç përmendëm, çdo rritje e përqindjes së papunësisë, drejtpërdrejt reflekton në zvogëlimin e

prodhimit bruto të brendshëm edhe atë për dy herë e gjysmë. Shteti ka shumë instrumente me të cilët duhet të intervenojë në këtë sferë, me qëllim që të integrohet në Bashkimin European.

Bazuar në strategjinë e rishikuar të Lisbonës, e cila ka prioritet rritjen ekonomike dhe punësimin, qëllimet e saja janë që Europa të transformohet në një vend më atraktiv për investime dhe punë, zgjerimi dhe thellimi i tregut të brendshëm, sigurimi i tregjeve të hapura dhe konkurente në vend dhe jashtë Europës.

Të sigurohen njohuri dhe inovacione për rritje, rritja dhe përmirësimi i investimeve në zhvillim dhe kërkim, stimulimi i inovacioneve, aplikimi i teknologjisë informative - komunikuese (TIK) dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i resurseve.

Të sigurohet numër më i madh dhe më atraktiv i vendeve të punës, tërheqja e një numri sa më të madh të mundshëm të njerëzve në hapësirat e punës nëpërmes modernizimit të sistemit të mbrojtjes sociale, përmirësimi i përshtatjes së punëtorëve dhe sipërmarrjeve dhe fleksibiliteti i tregut dhe punës, investime më të mëdha në kapitalin njerëzor nëpërmes arsimit të përmirësuar dhe nxënie të aftësive.

Është evidente se në Bashkimin European, punësimi llogaritet si njëra ndër shtyllat kryesore për një zhvillim të qëndrueshëm dhe ekonomi të fuqishme. Theks i veçantë i kushtohet arsimimit, i cili në kushtet e sotme paraqet njërën ndër shtyllat më të rëndësishme për lëvizshmërinë e punëtorëve gjatë ndryshimeve turbulente të kërkesave në tregun e punës.

Përfundim

Është evidente se Unioni Evropian synon një përqindje të madhe të të punësuarëve, me çka me automatizëm do të zvogëlohej numri i shfrytëzuesve të çfarëdo ndihme sociale dhe përfitimeve të tjera që i marrin personat e papunë.

Nga ajo që u përmend më lartë, është më se e qartë se fokusi i shtetit, i cili duhet të jetë pjesë e Bashkimit European, nuk ka për qëllim rritjen e ndihmës sociale, respektivisht trajtimin pasiv të papunësisë por, nëpërmes aktivizimit të të gjitha mundësive, duke stimuluar hapjen e vendeve të punës nga njëra anë dhe stimulimi i lëvizshmërisë dhe përshtatjes ndaj tregut të punës të fuqisë punëtore, nga ana tjetër. Theksi i veçantë vendoset mbi nocionet si, arsimi, trajnimi, kompetencat, aftësitë, arsimimi gjatë gjithë jetës, vetëpunësimi.

Vëmendje e veçantë i kushtohet mbajtjes sa më të gjatë në arsimin formal, në bazë të mundësisë deri në marrje të diplomës nga Fakulteti.

Lehtësimi i rrugës deri te vendi i punës, i cili do të përmbushë pritjet e punëtorit dhe do të rritë kënaqësinë e tij.

Prezenca e të gjitha këtyre që u përmenden më sipër, pengon vendin drejt zhvillimit në aspekte të ndryshme dhe marrjen e statusit të vendit kandidat në BE.

Bibliografia

Burgess, P. L. (1994). *Unemployment. Inworld Book Illustrated Information Finder* (CD-ROM Encyclopedia). Chicago, US: World Book.

Fujita, M. Krugman, P. and Venables, A. J. (1999) *The Spatial Economy: Cities, Regions and International Trade*, MIT Press.

Kutscherauer, A., Fachinelli, H., Hučka, M., Skokan, K., Sucháček, J., Tománek, P. and Tuleja, P. (2010) *Regional disparities: Disparities in country regional development - concept, theory, identification and assessment*, WD-5507-1.

Stimson, R., Stough, R. R. and Nijkamp, P. (2011) *Endogenous Regional Development: Perspectives, Measurement and Empirical Investigation*. Cheltenham: Edward Elgar, UK.

Deklaratë:

Unë dr. sc. Agim Beqiri me marrëdhënie pune në kolegjin AAB deklaroj në mënyrë ligjore dhe morale se ky punim nuk është i botuar në asnjë botim apo revistë tjetër.

POZICIONI LIGJOR I NOTERISË DHE ROLI I NOTERIT NË PËRPILIMIN E AKTEVE NOTERIALE

Agron Arsllani *

Ali Aliu**

Abstrakt

Me kërkesë të të gjitha palëve të interesuara, ideali i secilit shtet është që t'u sigurojë mbrojtje juridike cilësore, efikase dhe të barabartë të gjithë atyre palëve që janë të interesuara. Realizimi i qëllimit të caktuar nënkupton se gjykatat dhe organet e tjera shtetërore dhe shërbimet publike duhet të veprojnë në atë mënyrë që do të thotë se do të realizohen të drejtat e qytetarëve, personave juridikë dhe subjekteve të tjera të interesuara në mënyrë ekspeditive dhe ekonomike. Sigurimi i mbrojtjes juridike është arsyeja se pse çdo shtet përpiqet të avancojë sistemin e tij të mbrojtjes juridike dhe në vazhdimësi të zhvillojë dhe prezantojë format më të favorshme të ofrimit të mbrojtjes juridike. Ekzistenca e shërbimit noterial si një shërbim publik është rezultat i kësaj aspirote. Për këto arsye, implementimi i shërbimit noterial në sistemin ligjor të një vendi duhet të konsiderohet si pjesë e një reforme strategjike të sistemit të drejtësisë, ku objektivi kryesor i të cilit është për të ndërtuar një sistem funksional dhe efikas të drejtësisë të bazuar në standarde evropiane të drejtësisë.

Fjalë kyç: *mbrojtja juridike, roli i noterit, palët, kontratat.*

Hyrje

Shërbimi noterial në Republikën e Maqedonisë është organizuar si një shërbim i pavarur publik, në të cilin kryhen veprat e llojit të autorizimeve publike në bazë të ligjit me kërkesë të qytetarëve, organeve shtetërore,

*Mr.sc. Agron Arsllani, doktorant pranë Univerzitetit "University American College" Shkup. E-mail: agron.arsllani@hotmail.com.

**Mr.sc. Ali Aliu, doktorant pranë Univerzitetit "University American College" Shkup. E-mail: alialiu19@yahoo.co.uk.

personave juridikë dhe institucione të tjera të interesuara. Noteri, punët noteriale i kryen në mënyrë të lirë, të pavarur, profesionale dhe të paanshme, të bazuara në Kushtetutë, ligj, traktatet e ratifikuara ndërkombëtare dhe rregulloret e tjera dhe aktet e përgjithshme në bazë të ligjit .

Siç është e njohur gjatë konceptimit të sistemit të shërbimit noterial, ligjvënësi ynë është përcaktuar mbi të ashtuquajturin një lloj Latin të shërbimit noterial (Noter i lirë Latin) lloj i tillë, i cili dominon në shumë vende të botës. Në bazën e konceptit të këtij modeli është paanshmëria dhe pavarësia në kryerjen e shërbimit noterial. Ky lloj i noterialit nënkupton ndarjen dhe pavarësinë e punëve të kryera nga Noteri nga punët të cilat i kryen avokati.

Sfera e punëve dhe kompetencave që janë në kompetencë të noterëve në Republikën e Maqedonisë, në përgjithësi është e rregulluar me Ligjin për Noterinë dhe ligje të tjera. Kur është fjala për përmbajtjen e shërbimit të noterisë është i qartë fakti se ligjvënësit tanë gjatë miratimit të ligjeve të reja ose gjatë ndryshimeve të ligjeve ekzistuese, vazhdimisht i zgjerojnë kompetencat e shërbimit të noterisë, domethënë kryejnë modifikime të caktuara në atë mënyrë që noterët brenda fushës së kompetencës së tyre fitojnë kompetenca të reja. Kur ne flasim për përmbajtjen e shërbimit noterial gjegjësisht kompetencën e Noterit, duhet theksuar se përcaktimi i kompetencës të Noterit është një çështje e natyrës juridike dhe politike si në rrethin e punëve që do ti besohen Noterit në kompetencën e tij natyrore, po ashtu edhe në lidhje me punët, të cilat Noteri do ti kryej, si i besuar i gjykatës ose ndonjë organi tjetër.

Duke pasur parasysh sferën e punëve të cilat sipas rregulloreve pozitive bien në kompetencën e noterisë si një shërbim publik në mënyrë të lehtë mund të konkludohet se shumë nga kompetencat burimore të noterëve janë rezultat i trendit të dejudicizmit kryesisht çështjet e kompetencës së gjykatës Jo-kontestimore. Bëhet fjalë për punë Jo-kontestimore të punëve Jo-kontestimore, të cilat sipas përmbajtjes së mbrojtjes juridike të cilat sigurohen bien në domenin e të ashtuquajturës mbrojtje parandaluese.

Përmbajtja e shërbimit noterial

Funksionet themelore të Noterit rregullohen në Ligjin për Noterët. Kur është fjala për fushën e veprimtarisë që e kryejnë noterët, detyra primare ose funksioni i noterëve konsiston në redaktimin e instrumenteve zyrtare publike për punë juridike dhe të deklaratave (akteve noteriale), në të cilat

themelohen të drejtat. Ky funksion i Noterit në teorinë juridike do ta hasim si një funksion redaktues të verifikimit si dhe verifikim normativ. Përveç funksionit primar, në sferën e veprimtarive të tyre Noterët kryejnë edhe një varg aktiviteteve të tjera. Sipas rregullave juridike, noterët nën kompetencën e tyre gjithashtu kanë këto funksione:

1. Funksionin verifikues-protokollar ose funksionin e verifikimit të proces-verbaleve, të cilat kanë të bëjnë me redaktimin e instrumenteve noteriale për fakte (proces- verbale), në të cilat themelohen të drejtat; funksioni i legalizim-verifikimit i përbërë nga verifikimi zyrtar dhe konfirmimi i instrumenteve private;
2. Funksionin depozitar, i cili ka të bëjë me pranimin e instrumenteve, parave dhe letrave me vlerë për arsye të dorëzimit të tyre në persona të tjerë ose organeve kompetente;
3. Funksionin komisionar, i cili ka të bëjë me kryerjen e punëve të caktuara (ndërmarrjen e veprimeve zyrtare), me kërkesë të gjykatës ose të organeve të tjera publike të parashikuara nga ligji;
4. Funksionin i monitorimit konsultativ, i cili ka të bëjë me këshillim, paralajmërim gjegjësisht kujdes për të gjithë personat që marrin pjesë në përgatitjen e instrumenteve noteriale, funksion i cili është i lidhur direkt me rolin e noterit si një i besuar i paanshëm të palët.

Pavarësisht këtyre veprimeve themelore (punëve), të cilat janë në kompetencë të noterëve, noterët kryejnë disa gjëra ndihmëse ose athezike. Kështu, në të drejtën juridike në Maqedoni noterët kryejnë edhe:

1. Funksionin asekurativ, i cili ka të bëjë me kryerjen e punëve të caktuara, të drejtën e pengut vullnetar dhe të sigurisë fiduciare;
2. Funksioni adjuvant-ekzekutiv që ka të bëjë me lejimin e zbatimit në bazë të një dokumenti autentik të besueshëm.

Deri në miratimin e ligjit të ri për noterët në vitin 2007, noterët në kuadër të kompetencave të tyre kanë kryer edhe funksione të tjera të cilat për nga natyra e tyre i përkasin grupit të punëve athezike. Gjegjësisht, noterët ishin të autorizuar për të përfaqësuar palët në veprat Jo-kontestimore para gjykatave dhe organeve të tjera në qoftëse këto punë ishin të lidhura në mënyrë direkte me instrumentin të cilin Noteri e ka redaktuar. Në këtë rast, Noteri kishte të drejta dhe detyra si avokat. Ky është një funksion i ashtuquajtur atheziko-prokurorial.

Në teorinë juridike ekzistojnë pikëpamje të ndryshme për atë se si është natyra e shërbimit publik noterial. Sipas një mendimi, shërbimi publik

noterial ka një natyrë administrative, ku noterët kryejnë punë të administratës publike. Ky qëndrim bazohet në mendimin se shërbimi publik noterial është një organ ndihmës i administratës shtetërore, ku shërbimi noterial quhet kryerje private e funksionit publik. Sipas një mendimi tjetër, shërbimi publik noterial i takon fushës së gjyqësorit. Në mbështetje të këtij qëndrimi fillon nga kompetenca e pavarësisë dhe paanësisë së shërbimit noterial dhe autorizimet që iu transferuan Noterit nga gjykata¹.

Shërbimi noterial duhet të trajtohet si një shërbim juridiko ligjor sui generis, gjegjësisht një shërbim i veçantë në të cilin paraqiten shenja të veprimtarive publike, të cilat sipas karakterit të tyre janë Jo-kontestimore dhe administrative, domethënë me organizim të lirë dhe privat për të kryer këto veprimtari². Megjithëse shumica e kompetencave të Noterit janë të nxjerra nga juridiksioni gjyqësor, domethënë tek Noteri është transferuar një pjesë e madhe e juridiksionit të gjykatës në fushën e procedimit Jo-kontestimor, shërbimi publik noterial në vete nuk përmban kompetencën e gjykatës për të gjykuar; domethënë, atij nuk mund t'i jepen atributet e një organi gjyqësor në kuptimin e plotë të fjalës. Kjo është kështu për shkak se noterët nuk vendosin me aplikimin e ligjit, por ata vendosin në bazë të pëlqimit të palëve³. Në këtë drejtim, mund të themi se veprimtaria e shërbimit noterial, sipas karakterit të vet është veprimtari normative - redaktuese dhe verifikuese. Noteri, gjatë redaktimit të një akti noterial, nga njëra anë ai paraqitet si një i besueshëm i paanshëm i palëve, i cili i rregullon marrëdhëniet e tyre duke llogaritur zbatimin korrekt të ligjit (e ashtuquajtura aspekt normativ i redaktimit). Nga ana tjetër, me anë të redaktimit të aktit noterial, Noteri e dëshmon në mënyrë autoritative juridike vetë veprën e redaktimit dhe vërtetësinë e përmbajtjes së aktit (domethënë aspektin e verifikimit)⁴.

Kur flasim për karakteristikat kryesore apo për karakteristikat e përgjithshme të shërbimit noterial, së pari duhet të thuhet se shërbimi noterial është shërbim i të ashtuquajturit. mbrojtje juridike parandaluese.

¹M. Trgovčević Prokić, *Ovlašćenja javnog beležnika i organizacija beležništva, treće izmenjeno i dopunjeno izdanje*, 2012 Beograd, f. 131-132

²M. Dika, *Javnobilježnička služba u Republici Hrvatskoj, Pravo i porezi*, 12/2001, Zagreb, f.5.

³M. Dika, *Javnobilježnička služba u Republici Hrvatskoj, Pravo i porezi*, 12/2001, Zagreb, f.5 dhe M. Trgovčević Prokić, *Ovlašćenja javnog beležnika i organizacija beležništva, treće izmenjeno i dopunjeno izdanje*, Beograd 2012, f. 132.

⁴M. Dika, *Javnobilježnička služba u Republici Hrvatskoj, Pravo i porezi* 12/2001, Zagreb, f.5.

Me veprimtarinë e tij, Noteri kontribuon në sigurimin e një sigurie më të madhe juridike nga njëra anë dhe shmangien e mosmarrëveshjeve nga ana tjetër. Funkzioni parandalues i shërbimit publik noterial në masë të madhe e pamundëson shfaqjen e kontesteve, domethënë ai e lehtëson zgjidhjen e tyre nëse ata vijnë tek ata. Natyra e shërbimit noterial morri përmasa në fushën e drejtësisë parandaluese, e cila përsëri, duke marrë parasysh funksionin të cilin duhet ta realizojë, kryesisht Noteri e parandalon angazhimin e panevojshëm të gjykatave në veprimtaritë Jo-kontestimore. Duke patur këtë parasysh, ne mund të themi se shërbimi noterial kur është tashmë në fazën e redaktimit të instrumenteve noteriale dhe përcaktimin e marrëdhënieve ndërmjet palëve e siguron atë nivel të mbrojtjes juridike, të cilin nivel gjykatat mund t'a ofrojnë atëherë në kohën e zgjidhjes së kontesteve të paraqitura. Nga kjo del se Noterin mund ta quajmë gjykatës parandalues. Shërbimi noterial është një shërbim publik që noterët e kryejnë si profesion të pavarur. Ne mund të themi shërbimi noterial është një profesion i lirë me autorizime publike duke marrë parasysh se në një pjesë të shërbimit noterial ka tiparet karakteristike të profesionit të lirë.

Qasja në shërbimin noterial, selinë zyrtare dhe zonën, si dhe vet kryerja e këtij shërbimi kryhet nën kontrollin e shtetit. Për shkak të natyrës publike të shërbimit, konsiderohet se Noteri, në kryerjen e veprimtarisë së tij, vepron si një i besuar i paanshëm i palëve. Noteri e kryen veprimtarinë me kërkesë të palëve, por vepron sipas detyrës zyrtare.⁵ Për shkak të statusit si një i besuar i paanshëm i palëve, Noteri gjithashtu bie nën rregullat e lirit, njëjtë sikur gjykatësi.

Noterët janë bartës të pavarur të shërbimit noterial. Duke pasur parasysh se shërbimi noterial është një shërbim publik në të cilin kryhen punë të llojit të autorizimeve publike, duhet të themi se autorizimet publike sipas natyrës së vet në të vërtetë janë funksione të shtetit, zbatimi i të cilave është besuar të subjekte të ndryshme. Në një segment sovraniteti i shtetit është transferuar edhe te shërbimi noterial si një shërbim publik. Në këtë kontekst, autorizimet publike i japin autorizimin shërbimit noterial sa u takon personave fizikë dhe juridikë dhe subjekteve të tjera për të vepruar me autoritet të shtetit.

⁵Shih neni 3 dhe 5 të ligjit për noteri (*Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.72, shpallur më 12.04.2016*)<http://pravo.org.mk/documentDetail.php?id=8039>

Prandaj, kryerja e autorizimit publik domosdoshmërisht rregullohet plotësisht me ligj, në mënyrë që të shmanget mundësia e abuzimit dhe për të siguruar kryerjen e tyre të përgjegjshme. Një element i rëndësishëm është që kryerja e autorizimeve publike të jetë e kontrolluar nga shteti. Në këtë kuptim, shërbimi noterial si një shërbim publik në të cilin kryhen punët nga lloji i autorizimeve publike të kontrollohet nga shteti, i cili rezervon të drejtën të mbikqyrë ligjshmërinë e punës së subjektit, të cilit i është besuar ushtrimi i autorizimit publik. Shërbimi noterial është një shërbim juridik. Noteri është i detyruar të kryejë veprimin e vet në përputhje me Kushtetutën, ligjet, traktatet e ratifikuara ndërkombëtare, rregulloret e tjera dhe aktet e tjera të bazuara në ligj. Prandaj prej këtu del kërkesa për profesionalizëm maksimal të noterëve dhe kërkesa për njohuri të specializuara të këtyre fushave të ligjit, të cilat i mbulon veprimtaria e shërbimit noterial. Detyra e përgjithshme zyrtare e noterëve kushtëzohet nga statusi i tyre i personave të besimit publik. Noterët veprimtarinë e vet e kryejnë në mënyrë të pavarur (shërbimi noterial si një profesion i lirë) dhe në mënyrë të pavarur ndaj shtetit dhe ndaj palëve (parimi i pavarësisë). Duke e pasur këtë parasysh, noterët në kryerjen e shërbimit të tyre nuk janë përfaqësues të palëve, ata nuk mund të veprojnë si avokatët e palëve, e as shërbimi noterial nuk e ka të lejuar që të deformohet në këtë drejtim. Noterët janë të besuarit e paanshëm të palëve. Në sistemin e llojit Latin të shërbimit noterial, numri i ofruesve të shërbimeve noteriale është i kufizuar.

Parashikimi i dispozitave në ligjet që rregullojnë veprimtarinë e shërbimit noterial në disa sisteme juridike kombëtare në lidhje me kriteret sipas të cilave caktohet numri i noterëve, tregon se numri i noterëve është i kufizuar dhe i kontrolluar nga shteti. Rregulli i caktimit të një numri të kufizuar të noterëve, *numerus clausus*, sot është reflektim i nevojës për të kryer veprimtarinë e Noterit në një mënyrë që përmes numrit të kontrolluar të vendeve noteriale bëhet kontrollimi i volumit të mjaftueshëm të punës që ka një Noter, duke siguruar kështu gjendjen e tij të sigurt financiare, e cila ia garanton pavarësinë e tij. Numri i vendeve noteriale është numri i vlerësuar i nevojshëm, në mënyrë që qytetarët dhe personat e tjerë të interesuar të jenë të shërbyer shpejt, me cilësi dhe në mënyrën profesionale, si dhe në të njëjtën kohë Noterët që të mundin nga puna e tyre të sigurojnë një ekzistencë të sigurt materiale në përputhshmëri me rëndësinë dhe përgjegjësinë e shërbimit që ata e kryejnë. Të gjitha punët që bien nën kompetencën e shërbimit noterial, duke pasur parasysh natyrën dhe karakterin e tyre dhe sidomos duke pasur parasysh pozitën e Noterit si person me autorizime publike, i cili

veprimtarinë e vet e kryen me elementet e sovranitetit shtetëror, por si një profesion i lirë, i cili funksionalisht bie në fushën e jurisprudencës Jo-kontestimore parandaluese përcakton që numri i kërkuar i Noterëve të jetë i kufizuar⁶.

Karakterit dhe natyra ligjore e punëve të përfshira në kompetencat e shërbimit të noterisë

Në përputhje me vendimet pozitive juridike, Noterët në kompetentësinë e tyre kanë një fushë relativisht të gjerë të punës dhe të autorizimeve. Shumica e kompetencave janë kompetencat burimore të shërbimit noterial të rregulluar me Ligjin për noteri. Por Noterët, në kuadër të kompetencave të tyre burimore, kryejnë edhe punë që rregullohen me rregullore të tjera juridike. Një pjesë e kompetencave burimore të Noterit të rregulluara me ligje janë kompetenca konkurruese me gjykatat. Nga ana tjetër, Noteri kryen punë të caktuara që nuk i përkasin kompetencës burimore të tij, por që janë në kompetencën e gjykatave ku Noteri në këtë rast vepron si person i besuar i gjykatës. Në tekstin që vijon do të përpunohen karakteri dhe natyra juridike e punëve që vepron Noteri, gjë që paraprakisht do të analizohen kompetencat burimore të Noterit të rregulluara me Ligjin për noterinë, kompetencat burimore të Noterit të rregulluara me rregullore të tjera juridike që në fund të përpunohet çështja në lidhje me karakterin dhe natyrën juridike të çështjeve, në të cilat Noteri vepron si i besuar i gjykatës.

Redaktimi i akteve noteriale për çështjet juridike dhe deklaratat

Redaktimi i akteve noteriale për çështjet juridike dhe i deklaratave është funksion primar dhe njëkohësisht funksion më i rëndësishëm, të cilin e kryejnë noterët. Procedura për redaktimin e aktit noterial është një procedurë e veçantë e rregulluar me Ligjin për noterinë, e cila ka për qëllim që në punën juridike për të cilën redaktohet akti noterial të vihet në shprehje vullneti i vërtetë i palëve, kurse puna juridike mos të përmbajë dispozita, të cilat janë në kundërshtim me ligjin gjegjësisht mos të përmbajë dispozita, të cilat nuk mund të zbatohen. Ligji për noterinë parashikon që për cilat punë juridike akti noterial është i detyrueshëm.

⁶Shih neni 8 të ligjit për noteri (*Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.72, shpallur më 12.04.2016*)<http://pravo.org.mk/documentDetail.php?id=8039>

Gjatë redaktimit të aktit noterial Noteri duhet të ekzaminojë nëse palët janë të aftë dhe të autorizuar për të ndërmarrë punët. Noteri duhet t'u shpjegojë palëve qëllimin dhe pasojat e ndërmarrjes së çështjes konkrete juridike. Ai është i detyruar të ekzaminojë vullnetin e vërtetë të palëve gjegjësisht të vërtetë vullnetin dhe seriozitetin e tyre të vërtetë për ndërmarrjen e veprimit ligjor, pastaj deklaratat e vullnetit të palëve në mënyrë të plotë, të qartë, të përcaktuar dhe pa hamendje, në mënyrë të shkruar ti redaktojë në letër. Noteri është i obliguar që deklaratën e redaktuar, të shkruar t'ua lexojë palëve, mbledhur dhe pyetje të drejtpërdrejta të konstatojë a korrespondon përmbajtja e veprës noteriale me vullnetin e palëve. Gjithashtu edhe shtojcat ndaj origjinalit të aktit noterial çdo herë lexohen përveç nëse palët heqin dorë nga kjo e drejtë dhe deklarojnë se ata janë të njohur me përmbajtjen e tyre, ku ajo duhet të jetë e saktësuar në aktin noterial.

Meqë Noteri kryen shërbim i cili ka autorizime publike, akti noterial ka karakterin e një instrumenti publik. Në procedurën për redaktim të aktit noterial, Noteri vepron si palë e tretë e pavarur me detyrën e mbrojtjes së barabartë të interesave të të gjithë pjesëmarrësve. Duke pasur parasysh parimet themelore të punës noteriale dhe karakterit të shërbimit noterial të funksionimit, Noteri kryerjen e funksionit normativ verifikues, paraqitet si i besuar i paanshëm i të dyja palëve. Në kryerjen e këtij funksioni veçanërisht në shprehje vjen edhe funksioni konsultativ-monitor, i cili përbëhet në këshillim gjegjësisht mbajtje kujdesi ndaj të gjithë personave që marrin pjesë në redaktimin e Aktit noterial. Obligimi për këshillim gjegjësisht mësimin e palëve rrjedh nga elementet themelore që e përbëjnë shërbimin noterial, kurse ai obligim është sjellje e pavarur dhe e paanshme e Noterit. Në procedurën për redaktimin e një akti noterial rregullohen, marrëdhëniet juridike midis palëve me qëllim që të arrihet mbrojtja juridike parandaluese. Në këtë procedurë, mbrojtja juridike është kryer përpara një personi të paanshëm të tretë, një person i besimit publik, i cili me statusin e një personi me autorizime publike e garanton ligjshmërinë e procedurës së kryer. Mbikëqyrjen mbi ligjshmërinë e punës së noterit mund ta vlerësojë vetëm Gjykata, Ministria kompetente (Ministria e Drejtësisë) dhe Dhoma e Noterisë. Sipas karakterit të vet procedura për redaktimin e aktit noterial është një procedurë Jo-kontestimore, e cila për nga natyra e saj është Jo-kontestuese Vetë natyra e procedurave Jo-kontestimore lejon që mbrojtja e materialeve juridike të konkretizohet në mënyra të ndryshme. Realizimi i mbrojtjes juridike në punë të caktuara juridike që bien në fushë veprimin e çështjeve Jo-kontestimore, duke pasur parasysh natyrën e

punës juridike, nuk paraqet pjesëmarrjen e patjetërsueshme të gjykatës në mënyrë që të sigurojë mbrojtje të veçantë juridike. Kjo është kështu, sepse në disa procedura Jo-kontestimore veprimet e gjykatës nuk kanë karakter gjykimi. Ky është rasti me procedurën për redaktimin e instrumenteve. Në këtë lloj të procedurës Jo-kontestimore, Noteri nuk sjell vendim për aktin kontestimor ligjor. Në këtë lloj të procedurës Noteri vepron si gjykatës preventiv dhe si rrjedhojë në këtë lloj të procedurës, roli i tij është i një natyre parandaluese. Kjo është një procedurë e cila ofron mbrojtje parandaluese juridike, dhe si pasojë, është e kuptueshme se procesi i reduktimit të instrumenteve që janë nën kompetenca të gjykatës kalojnë në kompetencë burimore të Noterëve. Siç është e njohur, futja shërbimit noterial në Republikën e Maqedonisë për redaktimin e instrumenteve, kompetente ishte për këtë gjykata Jo-kontestimore. Procedura për redaktimin e instrumenteve ishte e rregulluar me rregullat e procedurës Jo-kontestimore, më konkretisht me Ligjin për procedurë Jo-kontestimore.

Sipas Ligjit për procedurë Jo-kontestimore të vitit 1979, gjykata në procesin e reduktimit të instrumenteve, redaktonte instrumente kur ajo është e përcaktuar me ligj ose kur është i nevojshëm instrumenti të ketë karakterin e një dokumenti publik. Rregullat që kanë të bëjnë me materien për redaktimin e instrumentit i rregullojnë dy procedura të veçanta: procedura për të redaktuar një testament gjyqësor dhe procedura për të redaktuar instrumente të tjera. Kur është fjala për procedurën e redaktimit të testamentit gjyqësor e njëjta dhe pas implementimit të shërbimit noterial mbeti nën kompetencën e gjykatës Jo-kontestimore me atë që me ligjin që rregullon veprimtarinë e noterisë (së pari Ligji për Punë Noteriale Jo-kontestimore kurse pastaj Ligji për Noterinë) janë të parapara dispozita që lidhen me redaktimin e aktit noterial për deklaratat e vullnetit të fundit. Kjo praktikisht e ka kuptimin se te procedura për redaktimin e testamentit Noterët kanë një kompetencë konkurruese me gjykatat.

Dispozitat e Ligjit për Procedurë Jo-kontestimore të vitit 1979 që kanë të bëjnë me redaktimin e instrumenteve jashtë dispozitave për redaktimin e testamentit gjyqësor nuk vazhdojnë pas sjelljes së (Ligji për Përmbartim të Instrumenteve, Ligji për Punë Noteriale Jo-kontestimore), në qershor të vitit 1998 . Kjo ishte një zgjidhje mjaft e arsyeshme e ligjvënësit, duke pasur parasysh se proceduara e redaktimit të instrumenteve, të cilat nuk janë përfshirë në fushën e procedurës gjyqësore në të cilin Gjykata e kryen funksionin e administrimit të drejtësisë. Si mbështetje e kësaj ky

është edhe qëndrimi i teorisë së procedurës se veprimet e gjykatës në procedurën e redaktimit të instrumenteve paraqesin një zonë kufitare të kryerjes së funksionit gjyqësor. Në këtë procedurë, gjykata nuk e zgjidh çështjen juridike, as nuk merr vendim. Ky aktivitet i gjykatës ka karakterin e funksionit gjyqësor në mënyrë që përmes ndërmjetësimit të gjykatës për redaktimin e instrumenteve sigurohet e drejta materialo juridike e deklaratës së vullnetit të formimit, ndryshimit dhe ndërprerjes së marrëdhënieve të caktuara juridike, kur e kërkojnë atë arsytet e sigurisë juridike⁷. Për këto arsye, procedura për redaktimin e instrumenteve është transferuar në kompetencën e shërbimit noterial.

Solemnizimi (verifikimi instrumenteve private)

Procedura për verifikimin e instrumenteve private ose solemnizimi është procedurë Jo-kontestimore, e cila sipas funksionit dhe qëllimit përfundimtar që duhet të arrihet është e njëjta me procedurën e redaktimit të akteve noteriale. Në vetë procedurën ka shumë pak dallime në krahasim me procedurën për redaktimin e një akti noterial. Kjo procedurë kryhet kur instrumentit privat i duhet dhënë karakterin e një dokumenti publik, kurse solemnizimi i një instrumenti privat sipas veprimit të vet ka të njëjtën vlefshmëri sikur një akt noterial i redaktuar për një punë të caktuar juridike. Pra, gjatë verifikimit të instrumenteve private, Noteri është i detyruar të marrë në konsideratë nëse sipas formës dhe përmbajtjes instrumenti privat i përmban të gjitha elementet e aktit noterial duke pasur parasysh se instrumenti i verifikuar nga Noteri, kur ai është në përputhje me ligjin, ka vlefshmërinë e instrumentit publik⁸.

Dallimi në mes të redaktimit të aktit noterial për punë juridike dhe solemnizimi i instrumentit privat për punë juridike qëndron në atë se në procedurën e parë puna juridike ndodh para Noterit, i cili vetë e redakton instrumentin (aktin noterial) për punën konkrete juridike, ndërsa në procedurën e dytë pjesëmarrësit punën juridike e kanë kryer dhe e kanë redaktuar punën juridike për një punë konkrete juridike.

Edhe në këtë procedurë Noteri vepron si një palë e pavarur e tretë me detyrën që në mënyrë të barabartë ti mbrojë interesat e të dyja palëve. Në këtë rast, Noteri është i detyruar të kujdeset për të gjithë personat që marrin pjesë në procedurën për solemnizim të një instrumenti privat, të

⁷B. Čalija, S. Omanović, *Građansko procesno pravo*, Sarajevo 2000, f. 366.

⁸Shih neni 45 f.5 të ligjit për noteri (*Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.72, shpallur më 12.04.2016*)<http://pravo.org.mk/documentDetail.php?id=8039>

kontrollojë nëse palët janë të aftë dhe të autorizuar për të ndërmarrë gjëra, të shqyrtojë vullnetin e tyre të vërtetë dhe t'ua bëjë me dije në lidhje me pasojat juridike që mund të rrjedhin nga ajo punë që e ndërmarrin. Lidhur me natyrën e procedurës për verifikimin e instrumenteve private dhe me natyrën e saj juridike, vlen e tërë ajo që është thënë më parë në lidhje me procedurën për redaktim të një akti noterial. Kjo ka të bëjë me një procedurë Jo-kontestimore jashtë gjyqësore, e cila ka për detyrë të sigurojë mbrojtje juridike parandaluese për pjesëmarrësit e interesuar. Kjo procedurë, si dhe procedura për redaktimin e instrumenteve, derisa sjelljen e shërbimit noterial e kishte në kompetencën e gjykatave në sferën e kompetencës Jo-kontestimore. E njëjta ishte e rregulluar me Ligjin për procedurë Jo-kontestimore të vitit 1979.

Verifikimi (dëshmia) e fakteve dhe deklaratave

Sipas Ligjit për Noterinë, si kompetencë burimore e Noterëve konsiderohet gjithashtu i ashtuquajtur i verifikimi noterial, domethënë. dëshmimi noterial i fakteve dhe i deklaratave. Me verifikim nga Noteri verifikohen (dëshmohen) punë që Noteri vetë i ka marrë ose deklaratat gojore të pjesëmarrësve të dhëna përpara Noterit, raste në të cilat ishin të pranishëm edhe faktet që janë konstatuar me anë të vëzhgimit të drejtpërdrejtë. Në këtë aspekt, Noterët janë të autorizuar që të verifikojnë kopje, certifikata nga regjistri tregtar, përkthime dhe nënshkrime⁹, të japin vërtetime për kohën kur instrumenti është dorëzuar për qëllim se a është dikush i gjallë, për fakte të tjera nga regjistri, për shpallje të deklaratave dhe shpallje të shpallura¹⁰, me anë të procesit verbal të verifikojnë konkluzionet e kuvendëve dhe seancat e organeve të tjera, shpalljen e deklaratave dhe shpalljen e fakteve të tjera¹¹. Noterët protestuarojnë kambiale dhe çeqe për të cilat gjithashtu redaktojnë proces-verbale të përshtatshme¹². Vërtetimet të cilat i jep Noteri në përputhje me Ligjin për noteri kanë fuqinë e instrumentit publik¹³. Kur është fjala për procedurën për verifikimin e kopjeve, përkthimeve, nënshkrimeve

⁹Shih nenet 60,61,62 dhe 63 të ligjit për noteri (*Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.72, shpallur më*

12.04.2016)<http://pravo.org.mk/documentDetail.php?id=8039>

¹⁰Ibid. 64, 65, 66, 67, 69, 72.

¹¹Ibid. 73, 74, 67.

¹²Ibid. 75.

¹³Ibid. 59

(legalizimin), ekstrakteve nga regjistri tregtar, Noteri paraqitet si një dëshmitar zyrtar. Siç do të hasim në teorinë juridike, konsiderohet se Noteri gjatë kryerjes së verifikimit informon pas shqyrtimit të vet personal të saj¹⁴. Kështu, te verifikimi i kopjes, Noteri vërteton se kopja e instrumentit është identike me instrumentin origjinal, te verifikimi i ekstraktit të nxjerrë nga regjistri tregtar. Noteri verifikon se ekstrakti është plotësisht identik me normën e përputhshme me librin e origjinalit, te verifikimi i përkthimit. Noteri ose e verifikon saktësinë e përkthimit që ka kryer vet ai, ose e kontrollon statusin e përkthyesit gjyqësor, i cili e ka kryer përkthimin që të njëjtin ta verifikojë, te verifikimi i nënshkrimit Noteri e vërteton se në praninë e tij pala personalisht ka nënshkruar instrumentin, ose ka vënë shenjën e dorës ose e ka pranuar nënshkrimin ose shenjën e dorës si të vetin. Ajo që është e rëndësishme të theksohet se kur bëhet fjalë për procedurën e verifikimit të nënshkrimit (legalizimi) është ajo se me verifikimin e nënshkrimit instrumenti nuk e merr karakterin e dokumentit publik. Ai mbetet instrument privat. Procedura e verifikimit me një fjalë mund të thuhet se dëshmimi i autenticitetit të nënshkrimit, identitetin e kopjes së instrumentit, përkthimit dhe dëshmimin e fakteve të tjera të parapara me ligj. Verifikimin të cilin e kryen Noteri është padyshim një çështje që hyn në fushën e materies Jo-kontestimore. Deri në sjelljen e Ligjit për Punë noteriale Jo-kontestimore, procedura për verifikimin e nënshkrimeve, kopjeve dhe dorëshkrimeve i përkiste fushës së veprimtarisë administrative të gjykatave dhe organeve administrative, ku verifikimin e bënin nëpunësit e autorizuar. Sipas Ligjit për verifikimin e nënshkrimeve, dorëshkrimeve dhe kopjeve, verifikimi ishte nën kompetencën e gjykatave dhe organeve administrative. Meqë Ligji për procedurë Jo-kontestimore i vitit 1979 u miratua disa vjet më vonë, ai nuk e ka rregulluar këtë procedurë¹⁵.

Edhe pse nuk janë normalizuar në ligjin procedural, i cili e rregullonte fushën e procedurave Jo-kontestimore nga gjykata, procedurat për verifikimin e nënshkrimeve, kopjeve, dorëshkrimeve dhe përkthimet, konsiderohen si procedura Jo-kontestimore që kanë karakteristika të caktuara, të cilat ndryshojnë thellësisht nga procedurat e tjera Jo-kontestimore, në veçanti në pjesën që te këto procedura gjykata nuk i

¹⁴Taka, M. Trgovčević Prokić, *Ovlašćenja javnog beležnika i organizacija beležništva, treće izmenjeno i dopunjeno izdanje*, Beograd 2012, f. 235.

¹⁵Shih neni 86 f. 1. i ligjit për noteri (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.72, shpallur më 12.04.2016)
<http://pravo.org.mk/documentDetail.php?id=8039>

zgjidh çështjet e as sjell vendime, por në ato, gjykata vetëm se e vërteton (verifikon) vërtetësinë e disa fakteve në bazë të vëzhgimit personal.

Konfirmimi i obligacionit sipas Ligjit mbi obligacionin

Në vitin 2012, me sjelljen e Ligjit mbi obligacionin¹⁶, Noterët fituan një kompetencë të re burimore në fushën e sigurimit të kërkesave. Obligacioni, si një instrument për të siguruar arkëtimin e kërkesave atë e redukton Noteri, përmes sistemit për mbajtjen e regjistrit të obligacioneve, të cilin e mban Regjistri Qendror. Pas reduktimit të obligacionit, Noteri në mënyrë elektronike e nënshkruan dhe e regjistron pastaj e shtyp fletë obligacionin përmes sistemit për evidentimin në Regjistrin e fletë obligacioneve dhe e verifikon në përputhje me Ligjin për noterinë, i cili ka të bëjë me verifikimin e instrumenteve private (solemnizimin).¹⁷

Veprimi i Noterit në procedurën e redaktimit dhe të verifikimit të fletë obligacionit paraqet një punë Jo-kontestimore që bie në fushën e materies jashtë kontestimore. Obligacioni është një instrument i sigurimit vullnetarisht jashtë gjyqësor të kërkesës që do të thotë se ekziston pëlqimi i vullnetit të palëve në lidhje me dhënien e flet obligacionit¹⁸. Për shkak se bëhet fjalë për një procedurë të solemnizimit të një instrumenti në aspektin e karakterit të saj dhe të natyrës juridike vlen ajo që u tha rreth procedurës për verifikimin e instrumenteve private.

Ndryshimet statusore të shoqërive sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare

Disa kompetenca të caktuara, noterët i kanë edhe sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare¹⁹. Edhe pse janë të rregulluara me një ligj të veçantë,

¹⁶Ligji mbi obligacionet („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 59/2012, 12/2014, 201/2014 dhe

145/2015).<http://pravo.org.mk/documentDetail.php?id=4716>

¹⁷Shih neni 4 f.1 dhe 2 të ligjit mbi obligacionet („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 59/2012, 12/2014, 201/2014 dhe

145/2015).<http://pravo.org.mk/documentDetail.php?id=4716>

¹⁸Ibid.

¹⁹Ligji për shoqëritë tregtare („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.28/2004, 84/2005, 25/2007, 87/2008, 42/10, 48/10, 24/11, 166/12, 70/13, 119/13, 120/13, 187/13, 38/14, 41/14 dhe 138/2014).<http://pravo.org.mk/documentDetail.php?id=110>

punët me të cilat vepron Noteri në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare, sipas karakterit të saj dhe natyrës juridike, hyjnë në thelbin e kompetencave burimore të Noterit të rregulluara me Ligjin e noterisë. Këtu bëhet fjalë për funksionin normativ – verifikues i shërbimit noterial në rast të ndryshimeve statusore të shoqërive (bashkimit, lidhja dhe ndarja e shoqërive).

Marrëveshja me anë të së cilës përshtaten kushtet në të cilat do të kryhet, bashkimi, lidhja ose ndarja e shoqërive reduktohet në formë të aktit noterial²⁰.

Nëse do të kryhet ndarja, e me ndarje themeli, ose me shpëputje me themelimin e shoqërive të reja, organi i menaxhimit të shoqërisë, i cili ndahet e sjell planin e ndarjes. Plani i ndarjes, me të gjitha shtojcat e tij redaktohet në formë të aktit noterial²¹.

Meqë në këto raste bëhet fjalë për procedurë të redaktimit të instrumentit në aspektin e karakterit të saj dhe natyrës juridike, vlen e tërë ajo gjë që është thënë në lidhje me procesin e redaktimit të aktit noterial.

Kompetencat e besuara të Noterit

Kur është fjala për funksion komisionar të shërbimit të noterisë, Ligji për noteri përmban rregulla që e normatizojnë mundësinë që noterët të veprojnë si të besuarit e gjykatave dhe të organeve të tjera. Në kryerjen funksioni komisionar, Noterët veprojnë sipas urdhërit të gjykatës, gjegjësisht sipas urdhërit të ndonjë organi tjetër, pra gjatë kryerjes së punës së besuar, Noteri si i besuar, në mënyrë të përshtatshme i zbaton rregullat që e rregullojnë procedurën në të cilën i është besuar kryerja e detyrave të caktuara, në veçanti rregullat për përjashtim, për dorëzim, për kërkimin e ndihmës juridike, të dhënave dhe të gjërave të tjera²².

Shqyrtimi i trashëgimisë

Në një numër të madh të shteteve ku është pranuar lloji Latin i noterisë, Noteri paraqitet si një i besuar i gjykatës në procedurën e shqyrtimit të trashëgimisë. Në sistemin tonë juridik, një mundësi e tillë është krijuar me Ligjin për procedurën Jo-kontestimore në vitin 2008, kur u shkua një hap më tej në procesin e dejudicializacionit kurse Noterëve iu besua

²⁰Ibid.

²¹Ibid.

²²Shih neni 135 të ligjit për noteri (*Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.72, shpallur më 12.04.2016*)<http://pravo.org.mk/documentDetail.php?id=8039>

veprimi në procedurën e shqyrtimit të trashëgimisë. Me Ligjin për Procedurë Jo-kontestimore është dhënë një bazë juridike dhe mundësi juridike që gjykata të mund noterëve t'ua besojë zbatimin e procedurës së trashëgimisë²³. Besimin e lëndëve të trashëgimisë që i lihet nën veprim Noterit si i besuar i gjykatës i jep Kryetari i Gjykatës²⁴. Në këto raste Noteri është i besuar i gjykatës kurse këto punë bien në fushën e punëve të besuara (funksioni komisionar i Noterit). Në procedurën e shqyrtimit të trashëgimisë, si një punë e besuar, Noteri vepron atëherë vetëm nëse nuk ka kontest as ndaj fakteve e as ndaj aplikimit të së drejtës²⁵.

Noterët si të besuar të gjykatës veprojnë sipas rregullave të Ligjit mbi Procedurë Jo-kontestimore. Kur Noteri kryen veprime në procedurën e trashëgimisë, si i besuar i gjykatës është i autorizuar të ndërmarrë të gjitha veprimet në procedurë dhe ti sjellë të gjitha vendimet me përjashtim të atyre me Ligjin mbi Procedurë Jo-kontestimore nëse ndryshe është përcaktuar²⁶. Gjatë zbatimit të procedurës trashëgimore, ftesat dhe instrumentet e tjera, të cilat i redakton Noteri si i besuar i gjykatës, pjesëmarrësve ua dërgon në pajtim me dispozitat për dërgimin e shkresave të rregulluara me Ligjin mbi Procedurën Kontestimore²⁷.

Nëse me Ligjin mbi Procedurën Jo-kontestimore ndryshe nuk është e përcaktuar, për punën e Noterit si i besuar i gjykatës vlejnë rregullat, të cilat kanë të bëjnë me punët e gjykatave. Kur do të paraqiten arsyet për përjashtimin e Noterit në procedurën noteriale të shqyrtimit të trashëgimisë për përjashtimin e Noterit vendos gjykata, e cila ia ka besuar punën atij. Mbikëqyrjen ndaj punës së Noterit, si i besuar e bën gjykata, e cila ia ka besuar punën atij. Procedura për shqyrtimin e trashëgimisë Jo-kontestimore në të cilën caktohen trashëgimtarët e të ndjerit, pasuria e cila përbën trashëgiminë e tij dhe të drejtat e trashëgimisë që iu takojnë trashëgimtarëve, legatarët dhe persona të tjerë. Bëhet fjalë për procedurë

²³Shih nenin 126 të ligjit mbi procedurën kontestimore (*Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.79/2005*)<http://pravo.org.mk/documentDetail.php?id=289>

²⁴Shih nenin 131 të ligjit mbi procedurën jo-kontestimore (*Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.09/2008*)
<http://pravo.org.mk/documentDetail.php?id=793>

²⁵A. Јаневски, Т. ЗороскаКамиловска, *Граѓанскопроцесно право, книгаавтора, вонпарничноправо, Скопје*, 2010, f. 116.

²⁶Shih nenin 126 të ligjit mbi procedurën jo-kontestimore (*Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.09/2008*)
<http://pravo.org.mk/documentDetail.php?id=793>

²⁷Ibid.137

gjyqësore në të cilin sipas natyrës së punës që është duke u vepruar dhe është duke u vendosur, shpesh nuk ka kontest midis trashëgimtarëve, as në aspektin e bazës së thirrjes për trashëgimi, ose në lidhje me pasurinë e cila e përbën masën trashëgimore ose madhësinë e pjesëve trashëgimore që u takojnë trashëgimtarëve, legatarët dhe personave të tjerë. Puna e gjykatës në procedurë Jo-kontestimore në shumicën e rasteve kthehet në konstatimin e fakteve, të cilat nuk janë të kontestueshme as për gjykatën e as për pjesëmarrësit e interesuar²⁸.

Duke pas parasysh, sipas rregullit, karakterin Jo-kontestimor të shqyrtimit të trashëgimisë, krejtësisht është e qartë pse sistemit të noterisë së lirë Latin të shërbimit noterial i është dhënë veprimi në lëndët e shqyrtimit të trashëgimisë. Imperativi në aspektin e besimit të zbatimit të procedurës trashëgimore që iu dha Noterit si i besuar i gjykatës është ai se nuk ka asnjë farë kontesti në mes pjesëmarrësve në procedurë.

Konkluzione

Nga distanca kohore thuajse pas gati dy dekadave të ekzistencës së shërbimit noterial në Republikën e Maqedonisë mund të themi se si një shërbim publik modern që iu soll qytetarëve, organeve shtetërore, personave juridikë dhe subjekteve të tjera të interesuara në mënyrë të suksesshme iu është përgjigjur nevojës për realizimin më të shpejtë, më efikase dhe më e lirë për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave juridike, lehtësimin e zhvillimit të shpejtë të marrëdhënieve juridike; rritjen e sigurisë juridike dhe natyrisht shkarkim- lehtësimin e drejtësisë duke iu shmangur mosmarrëveshjeve në bazë të akteve noteriale dhe duke iu transferuar përgjegjësi të caktuara të noterëve, kryesisht në fushën e procedimeve Jo- kontestimore. Është një fakt i padiskutueshëm se një shërbim noterial mirë i organizuar ua ka mundësuar qytetarëve që të arrijnë realizimin profesional dhe sidomos të shpejtë të të drejtave. Me një fjalë, futja e shërbimit noterial si shërbim publik ka ndikuar pozitivisht në funksionimin e përgjithshëm të sistemit ligjor të Republikës së Maqedonisë. Veçanërisht është e rëndësishme të theksohet se futja e shërbimit publik noterial ka kontribuar në sigurimin e një sigurie më të madhe juridike. Duke pasur parasysh cilësinë e instrumentit noterial, karakterin e tij të një instrumenti publik dhe rolin e Noterit si person i besuar publik, është një fakt i padiskutueshëm se e tërë ajo ka ndikuar

²⁸ А. Јаневски, *Потреба од растростоварување на судовите од неспорни работи*, *Нотариус* сбр. 12, ф.33.

pozitivisht në përmirësimin e të ashtuquajturës kujdesin parandalues në drejtim të parandalimit të kontesteve.

Përveç ngritjes së nivelit të mbrojtjes preventive, Noterët kanë luajtur një rol të rëndësishëm në shkarkimin e gjykatave nga të vepruarit me lëndë në të cilat nuk ka asnjë ndarje të drejtësisë në kuptimin e vërtetë të fjalës, kryesisht në sferën e çështjeve Jo-kontestimore. Megjithatë, trendi i zhvendosjes nuk mbeti vetëm në kornizën e veprimeve Jo-kontestimore. Kishte një shkarkim, lehtësim tjetër të gjykatave në sferën e ekzekutivit dhe pastaj në çështjet që nuk janë kontestuese dhe bien nën regjimin e procesit kontestimor. Në këtë punim fokusi është në analizimin e thellë të përmbajtjes së shërbimit të noterisë, natyra e gjërave që Noteri vepron, rolin e Noterit dhe sjellja e tij në kryerjen e funksioneve, të cilat janë të përfshira në kompetencën e tij.

Bibliografia

- Ligjitmbinoteri, *Gazetazyrtare e Republikës së Maqedonisë*, nr.72, shpallurmë 12.04.2016
<http://pravo.org.mk/documentDetail.php?id=8039>
- M. Trgovčević Prokić,
Ovlašćenjajavnogbeležnikaioorganizacijabeležništva, trećeizmenjenoidopunjenoizdanje, 2012.
- M. Dika, *Javnobilježnička služba u Republici Hrvatskoj*, *Pravo i porezi*, br. 12/2001.
- B. Čalija, S. Omanović, *Građansko procesno pravo*, Sarajevo 2000
- Ligjit mbi obligacionet „Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 59/2012, 12/2014, 201/2014 dhe 145/2015.
<http://pravo.org.mk/documentDetail.php?id=4716>
- Ligjipërshoqëritëtrëtare, „Gazetazyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr.28/2004, 84/2005, 25/2007, 87/2008, 42/10, 48/10, 24/11, 166/12, 70/13, 119/13, 120/13, 187/13, 38/14, 41/14 dhe 138/2014.<http://pravo.org.mk/documentDetail.php?id=110>
- Ligji mbi procedurën kontestimore „Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr.79/2005
<http://pravo.org.mk/documentDetail.php?id=289>
- Ligji mbi procedurën jo-kontestimore „Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr.09/2008
<http://pravo.org.mk/documentDetail.php?id=793>

А. Јаневски,

*Потреба од растовапувања на судовите од неспорни работи,
Нотариус бр. 12*

А. Јаневски, Т. Зороска Камиловска, *Граѓанско процесно право,
книга автор, во парнично право, Скопје, 2010*

PËRGJEGJËSIA E ORTAKËVE/AKSIONARËVE PËR DETYRIMET E SHOQËRISË TREGTARE NË RAST TË KEQPËRDORIMIT TË SUBJEKTIVITETIT JURIDIK TË SHOQËRISË TREGTARE

Ali Aliu*

Agron Arslani**

Abstrakt

Shoqëritë tregtare gëzojnë subjektivitet juridik dhe të njëjtat sikurse edhe personat fizik mund të fitojnë apo të jenë titullarë të një spektri të të drejtave sendore, para së gjithash të të drejtës pronësore, për të cilën arsye ata edhe posedojnë prone, e cila a priori u shërben për realizimin e të drejtave dhe detyrimeve, të cilat i kanë ndaj subjekteve të treta në qarkullimin juridik. Edhe pse ortakët gjegjësisht aksionarët në shoqëritë aksionare disponojnë me të drejta pronësore personale kundrejt shoqërisë (siç është e drejta në dividendë etj.) nuk do të thotë që është i lejuar konfuzioni në mes pasurisë/pronës së shoqërisë dhe pasurisë/pronës së ortakëve/aksionarëve në aspekt të detyrimeve që çdo njëri nga këta subjekte i ka në relacion me subjektet e treta, por parimisht shoqëria disponon me një autonomi pronësore dhe parimisht çdo njëri nga këta subjekte (shoqëria, ortakët/aksionarët) përgjigjet veçmas për detyrimet e veta në qarkullimin juridik.

Nga ky konstelacion i sendërtimit të diferencimit të pronës së shoqërisë nga prona e ortakut/aksionarit, rrjedhin edhe një sërë marrëdhëniesh juridike të shoqërisë dhe ortakëve në aspekt të përgjegjësisë për detyrimet. Si pasojë e këtyre raporteve komplekse dhe të ndërthurura, rezulton edhe ajo që ky distinkcion në mes pronës së shoqërisë nga prona e ortakut/aksionarit prapëseprapë nuk është absolut, kështu që *ex lege* në rast të keqpërdorimit të subjektivitetit juridik të shoqërisë nga ana e ortakut/aksionarit, e njëjta sanksionohet në kuptim që edhe pse secili nga këta subjekte

*Mr.sc. Ali Aliu, doktorant pranë Univerzitetit "University American College" Shkup. E-mail: alialiu19@yahoo.co.uk.

** Mr.sc. Agron Arslani, doktorant pranë Univerzitetit "University American College" Shkup. E-mail: agron.arsllani@hotmail.com.

(shoqëria, ortakët/aksionarët) në parim ka një autonomi pronësore, mund të vijë deri te prishja e këtij subjektiviteti juridik dhe implikimi i përgjegjësisë së ortakut/aksionarit për detyrimet e shoqërisë.

Fjalë kyç: *subjektiviteti juridik, autonomia pronësore, përgjegjësia për detyrimet e shoqërisë.*

Hyrje

Ligji për shoqëritë tregtare i Republikës së Maqedonisë, e ka pranuar konceptin modern për shoqëritë tregtare, sipas të cilit të gjitha shoqërive tregtare, pa asnjë përjashtim, u pranohet subjektiviteti juridik. Shoqëria tregtare në atë cilësi, si edhe personi juridik, mund të jetë titullar i një spektri të gjërë të të drejtave, në mes të cilave në rend të parë rradhitet e drejta pronësore.

Pikërisht për këtë shkak, shoqëria tregtare disponon me pronë, e cila është vetëm e saja dhe të cilën e përbëjnë të gjitha të drejtat e shoqërisë ndaj sendeve, të cilat hyjnë në masën e saj pronësore. Prona e shoqërisë nuk duhet të konfundohet (përzihet) me pronën e cilit do qoftë nga ortakët, gjegjësisht aksionarët. Mund të flitet për një linjë të ndarjes rigoroze të pronës së shoqërisë nga prona e ortakut/aksionarit. Thënë figurativisht, përgjatë asaj linje është sendërtuar “Muri i subjektivitetit juridik” të shoqërisë tregtare, në brendësinë e të cilit është vendosur prona e shoqërisë tregtare si person juridik. Disa, veçanërisht anglosanksonët për këtë përdorin një term më të butë “vello e personit juridik”.¹ Ky mur (vello) i subjektivitetit juridik është pengesë për konfuzionin apo përzierjen e pronës së shoqërisë me pronën e ortakut, gjegjësisht aksionarit dhe anasjelltas. Çdonjëri (shoqëria dhe ortakut/aksionari) ka pronën e vet dhe me atë pronë përgjigjet për detyrimet e veta, veçanërisht për detyrimet që sajohen në marrëdhëniet apo qarkullimin juridik.

Kjo është korniza e përgjithshme në të cilën shtrihet tema e autonomisë së pronës së shoqërisë tregtare kundrejt pronës së çdonjërit nga ortakët, gjegjësisht aksionarët.

Nga kjo autonomi e pronës së shoqërisë dalin një sërë implikimesh në relacion shoqëri- ortak/aksionar prej të cilave më relevante janë këta:

E para, prona e shoqërisë paraqet një lloj fondi garantues për kreditorët e shoqërisë, por këtu menjëherë duhet të nënvizojmë se ajo pronë nuk

¹Милан Недков, Легис, Деловно право бр. 3, година I, Септември 2000, „Правниот субјективитет, имотната автономија и одговорноста за обврските на трговското друштво“, fq.3.

paraqet fond garantues edhe për kreditorët e ortakut/aksionarit. Kreditorët personalë të ortakëve/aksionarëve mund t'i përfshijnë vetëm të drejtat, të cilat i takojnë ortakut/aksionarit kundrejt shoqërisë, si dhe çfarëdo lloj shume që shoqëria ia ka borxh ortakut/aksionarit, më së shpeshti në bazë të së drejtës së dividendës, apo edhe sipas bazave të tjera.

E dyta, nuk mund të ketë kompensim në mes borxhit të shoqërisë dhe borxheve personale të ortakut/aksionarit. Kështu, ortaku/aksionari nuk mund ta kundërshtojë pagesën e borxhit ndaj kreditorit të vetë me arsyetim se edhe ai vetë është borxhli kundrejt shoqërisë së paku në lartësi që është ekuivalente me borxhin e tij. Çdonjëri (shoqëria dhe ortaku/aksionari) duhet ta përmbushë detyrimin që ka ndaj kreditorit të vet; konfuzioni në mes përgjegjësisë për detyrimet në mes shoqërisë dhe ortakut/aksionarit nuk është i lejuar.

E treta, nëse shoqëria tregtare i ndërpret pagesat ndaj kreditorëve, ndaj tij do të zbatohet falimentimi. Kjo procedurë nuk zgjerohet edhe ndaj ortakut/aksionarit përveç nëse është fjala për ortakun, i cili përgjigjet drejtpërdrejt, në mënyrë të pakufizuar dhe solidare për detyrimet e shoqërisë, siç është rasti me ortakun të shoqëria tregtare publike (kolektive), gjegjësisht siç është rasti me komplementarin të shoqëria komandite.

E katërta, ortaku gjegjësisht aksionari nuk është drejtpërdrejt pronar edhe i të mirave të shoqërisë dhe i njëjti nuk ka kurrfarë të drejtash ndaj pronës së shoqërisë. Ai (ortaku/aksionari) është vetëm titullar i të drejtave kundrejt shoqërisë, të quajtura “kontribute/pjesëmarrje” (tek shoqëritë tregtare publike, shoqëritë komandite dhe shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar) ose “aksione” (shoqëri aksionare apo shoqëri komanditore aksionare). Këto të drejta mund të jenë të natyrës pronësore, siç është e drejta në dividendë ose e drejta e pjesëmarrjes në shpërndarjen e pjesës së mbetur nga masa falimentuese apo e likuidimit, si dhe pjesëmarrja në punën e shoqërisë siç është e drejta e qasjes në mbledhjen e ortakëve gjegjësisht qasja të kuvendi i shoqërisë aksionare, e drejta e të qenurit i informuar dhe e drejta e kontrollit mbi administrimin.

Në këtë kontekst, duke u bazuar në parimin e përgjithshëm të ndarjes së pronës së shoqërisë nga prona e ortakut/aksionarit parashtrohet pyetja e raporteve të shoqërisë dhe ortakëve në lidhje me përgjegjësinë mbi detyrimet. Por nuk duhet të jemi në lajthitje, ndarja e pronës së shoqërisë nga prona e ortakut/aksionarit prapëseprapë nuk është absolute. Në praktikë, çdoherë në një mënyrë apo në tjetrën sanksionohet keqpërdorimi i subjektivitetit juridik të shoqërisë nga ana e

ortakut/aksionarit. Në rastet e tilla, ortakut/aksionari, i cili në bazë të ligjit nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë, kyçet në regjimin e përgjegjësisë për detyrimet e shoqërisë.

Përgjegjësia për detyrimet e shoqërisë tregtare

Përgjegjësia e shoqërisë për detyrimet e saja me tërë pasurinë e vet, rezulton nga parimi i autonomisë së pronës së shoqërisë. Gjegjësisht në nenin 27 al. 1 e Ligjit për shoqëritë tregtare² është normuar:

“Shoqëria tregtare përgjigjet për obligimet e veta me gjithë pasurinë e vet”. Ky normim ligjor e shpreh parimin e përgjegjësisë së plotë të shoqërisë për detyrimet e saja. Sipas këtij parimi, shoqëria si person juridik, për detyrimet e saja përgjigjet gjithmonë me tërë pasurinë e vet, sepse bëhet fjalë për detyrimet e saja, e jo për detyrimet e ortakut apo aksionarit.

Parimi i përgjegjësisë së plotë për detyrimet e shoqërisë ka të bëjë me të gjitha format e shoqërisë tregtare, e jo siç duket në shikim të parë se ai i referohet vetë, shoqërive kapitale, sepse shtrohet çështja e trajtimit të barabartë të pronës së shoqërisë kundrejt kërkesave të kreditorëve. Edhe shoqëritë personale, siç cekëm, kanë cilësi të personit juridik, kështu që edhe prona e tyre shërben si fond për përmbushjen e detyrimeve kundrejt kreditorëve të shoqërisë. Parimi bazë i funksionimit të shoqërive tregtare si persona juridik është që ata përgjigjen me tërë pasurinë e tyre për detyrimet që i krijojnë gjatë ushtrimit të punës së tyre. Ai parim zbatohet në mënyrë konsekuente, kështu që shoqëria do të duhet të pushojë nëse kreditorët e saj nuk mund t'i paguajnë kërkesat e tyre, ose nëse me pagesën e kërkesave të tyre esencialisht zvogëlohet prona e shoqërisë apo e njëjta shuhet.

Krahas sistemit të përgjegjësisë së plotë të shoqërisë për detyrimet e saja, në sistemin juridik të Republikës së Maqedonisë, janë rregulluar edhe format e posaçme të përgjegjësisë së ortakëve/aksionarëve për detyrimet e shoqërisë, e cila mund të ketë bazën e vet qoftë në ligj apo në kontratën. Në Ligjin për shoqëritë tregtare janë përcaktuar dy forma të përgjegjësisë garantuese të ortakëve/aksionarëve për detyrimet e shoqërisë:

²Ligji është shpallur në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë” nr. 28 prej 30 prill 2004 vit. Ndryshimet dhe plotësimet e ligjit janë shpallur në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë” nr. 84/2005, 25/2007, 87/2008, 42/10, 48/10, 24/11, 166/12, 70/13, 119/13 и 120/13. <https://www.pravdiko.mk/zakonot-za-trgovskite-drushtva/>.

- a) përgjegjësia e ortakëve të shoqërive personale për detyrimet e shoqërisë dhe
- b) përgjegjësia e ortakëve për detyrimet e shoqërisë në rast të keqpërdorimit të subjektivitetit juridik të shoqërive të kapitalit.

Krahas kësaj, me punë juridike ortak/aksionari mund të marrë përgjegjësi të tjera për detyrimet e shoqërisë, siç është për shembull rasti me garancën dhe pranimin e borxhit.

Përgjegjësia garantuese e ortakut tek shoqëritë personale rezulton nga vetë konstituimi i këtyre formave të shoqërive tregtare. Këto shoqëri nuk kanë kapital themeltar, por vetëm asete të domosdoshme për funksionimin e shoqërisë. Ky privilegj i ortakëve tek shoqëritë personale kompensohet me përgjegjësinë e tyre për detyrimet e shoqërisë. Në pikëpamje të përgjegjësisë për detyrimet e shoqërisë, situata tek shoqëritë personale është tejet specifike, sepse ata fillimisht përgjigjen me pasurinë e tyre për detyrimet e ndërmarra, por krahas tyre në mënyrë subsidiere përgjigjen edhe ortakët. Pra, ortakët nuk përgjigjen në mënyrë solidare me shoqërinë për detyrimet e shoqërisë.

Ligji për shoqëritë tregtare, çështjen e përgjegjësisë e rregullon në mënyrë të posaçme për shoqëritë tregtare publike (kolektive) si dhe për shoqëritë komandite.

Kështu, shoqëria tregtare publike (kolektive) si person juridik përgjigjet me tërë pasurinë e saj për detyrimet e ndërmarra, por krahas saj për detyrimet e saj përgjigjen edhe ortakët e saj.³ Përgjegjësia e ortakut tek shoqëritë tregtare publike (kolektive) në raport me kreditorët është e drejtpërdrejtë, në raport me shoqërinë është subsidiere, në raport me pronën vetanake është e pakufizuar dhe në raport me ortakët e tjerë është solidare. Ligji nis nga premisa që çdo detyrim i shoqërisë tregtare publike është edhe detyrim i çdonjërit nga ortakët e saj. Kundrejt personave të tretë garancioni i ortakëve të shoqërisë tregtare publike nuk mund të zvogëlohet apo të kufizohet. Pra, në këtë rast vjen në shprehje norma imperative ku në nenin 137 alinea 2 e Ligjit për shoqëritë tregtare është normuar që dispozita e kontratës së shoqërisë që është në kundërshtim me dispozitën që për detyrimet e shoqërisë çdo ortak u përgjigjet kreditorëve të shoqërisë tregtare publike drejtpërdrejt me tërë pasurinë e tyre dhe në mënyrë solidare me gjithë ortakët e tjerë ndaj personave të tretë, është nule.

³Shih nenin 110 të Ligjit për shoqëri tregtare.

Nëse ortakut i përmbush detyrimet e shoqërisë, ka të drejtën e subrogacionit ndaj ortakut tjetër sipas parimeve të së drejtës obligative.

Pozitë të njëjtë me ortakun të shoqëria tregtare publike ka edhe komplementari të shoqëria komandite.

Komanditorët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë, veç kur komanditori i udhëheq punët e shoqërisë, apo nëse nuk e ka paguar në tërësi kontributin e vet në shoqëri. Në atë rast komanditori u përgjigjet drejtpërdrejt kreditorëve në lartësi të shumës që nuk është paguar.

Tek shoqëritë kapitale, aksionari dhe ortakut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë. Kreditori i këtyre shoqërive kërkesat e veta mund t'i përmbushë vetëm nga prona e shoqërisë, e nëse nuk mund t'i përmbushë kërkesat e veta nga ajo pronë, atëherë i njëjti nuk mundet të kërkojë që detyrimet të përmbushen nga ortakët gjegjësisht aksionarët e shoqërisë.

Përgjegjësia për detyrimet e shoqërisë duhet të konfundohet me rizikun e investimit të kapitalit tek shoqëria tregtare. Riziku shprehet në rrezikun që ortakut/aksionari t'a humbi atë që e ka investuar në shoqërinë për shkak të ndërmarrjes së pasuksesshme afariste, në të cilët kapitali ka qenë i investuar. Për këtë nuk mund të flitet që ortakut gjegjësisht aksionari përgjigjet për detyrimet e shoqërisë deri në shumën e investuar në shoqëri, sepse me atë shumë ai e mban rrezikun nga suksesi/josuksesi i ndërmarrjes afariste. Përparësia e shoqërive kapitale për ortakun gjegjësisht aksionarin konsiston në atë që ai nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë, por vetëm e mban rrezikun deri në lartësi të shumës/kontributit të investuar në shoqëri, e nëse njëkohësisht themelon më shumë shoqëri, atëherë vjen deri te dispersioni i rrezikut.

“Heqja e vellos” tek shoqëritë tregtare

Në teorinë juridike është i pranuar koncepti që jo çdo formë e mashtrimit apo keqpërdorimit tek shoqëritë tregtare tërheq edhe heqjen e vellos së shoqërisë, kështuqë vetë shfrytëzimi i ndërmarrjes korporative për t'a kufizuar përgjegjësinë nuk është e mjaftueshme që të vërtetohet kërkesa për heqjen e vellos tek shoqëritë tregtare, por duhet të ketë dëshmi të pakontestueshme që keqpërdorimi i ndërmarrjes korporative ka shkaktuar mashtrim tek kreditori, e njëkohësisht edhe dëm. Me fjalë të tjera duhet të vërtetohet që i padituri në njëfarë mënyre ka ndërmarrë veprime të ndaluara, gjegjësisht veprime me të cilat vjen deri te mashtrimi i kreditorit.⁴

⁴ Hystro Prods., Inc. v. MNP Corp., 18 F.3d 1384, 1390 (7th Cir. 1994).

Debati rreth parimit të përgjegjësisë së kufizuar dhe doktrinës së heqjes së vellos tek shoqëritë tregtare do të vazhdojë me mbështetës nga të dy anët edhe pse mund të gjenden edhe pika konvergjente në të cilat teoriticienët do të pajtohen. Si për shembull në sferën bankare dhe të kompanive të sigurimit shumica e teoriticienëve pajtohen që parimi i heqjes së vellos është i papërshtatshëm dhe se përfitimet nga parimi i përgjegjësisë së kufizuar janë aparente.

Edhe në të drejtën tregtare të Republikës së Maqedonisë është futur një Institut modern të së drejtës së shoqërive i njohur si prishja e subjektivitetit juridik të shoqërisë. Krahas kësaj përdoret edhe shprehja “heqja e vellos së personit juridik”. Në terminologjinë juridike të kroacisë përdoret shprehja „proboj pravne osobnosti drustva“, përderisa në terminologjinë juridike të Sllovenisë përdoret shprehja „spregled pravne osobnosti“.⁵ Këtu duhet të theksohet se me njohjen e këtij instituti qëllimi është që të pengohet një keqpërdorim specifik i subjektivitetit juridik të shoqërisë tregtare, që shprehet në atë që ortaku apo aksionari përkatës edhe pse e ka keqpërdorur subjektivitetin juridik të shoqërisë në dëm të kreditorëve, i ikën përgjegjësisë për detyrimet e shoqërisë duke u thirrur në atë që sipas ligjit nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë.⁶

Pra në lidhje me këtë Institut, relevante janë dy momente, nga njëra anë që ortaku/aksionari t’a keqpërdorë pozitën në shoqëri dhe nga ana tjetër që i njëjti sipas ligjit të mos përgjigjet për detyrimet e shoqërisë. Duhet të potencohet se nuk bëhet fjalë për çfarëdo qoftë keqpërdorimi të të drejtave, por vetëm për keqpërdorim me të cilin kreditorit qëllimisht i shkaktohet dëm. Kjo do të thotë që ortakët/aksionarët me zbatimin e Institutit prishje e subjektivitetit juridik të shoqërisë, do të subsumohen nën regjimin e përgjegjësisë garantuese për detyrimet e shoqërisë. Instituti prishja e subjektivitetit juridik të shoqërisë, u dedikohet në rend të parë shoqërive kapitale (shoqëria aksionare, shoqëria me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëria komandite aksionare), edhe pse parimisht zbatimi i tij nuk mund të përjashtohet kur janë në pyetje edhe shoqëritë personale (shoqëria tregtare publike dhe shoqëria komandite).

⁵Милан Недков, Легис, Деловно право бр. 3, година I, Септември 2000, „Правниот субјективитет, имотната автономија и одговорноста за обврските на трговското друштво“, fq. 6.

⁶Shih nenin 27 al.3 e LSHT, ku është paraparë që ortakët te shoqëria me përgjegjësi të kufizuar dhe aksionarët te shoqëritë aksionare si dhe komanditët te shoqëritë komandite dhe shoqëritë komandite me aksione nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë, përveç nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

Pra, është e qartë që ky Institut ka për qëllim evitimin e pasojave negative/të dëmshme nga zbatimi i parimeve bazike të të drejtës së shoqërive: subjektiviteti juridik i shoqërisë dhe autonomia e pronës së saj prej të cilave si pasoja më logjike nga njëra anë dalin përgjegjësia e shoqërisë për detyrimet e saja, dhe nga ana tjetër ndarja e pronës së shoqërisë nga prona e ortakut/aksionarit.⁷ Praktika flet që autonomia pronësore si dhe pasojat prej saj, në funksionimin e përditshëm të shoqërisë gjenerojnë efekte, të cilat jo çdoherë janë në pajtim me parimin e drejtshmërisë. Pra, autonomia pronësore e shoqërisë mund të shkaktojë pasoja të dëmshme në rend të parë me fshehjen e ortakëve/aksionarëve pas shoqërisë si person juridik, me arritjen e qëllimeve të tyre në dëm të kreditorëve dhe me evitimin e gjithë asaj që për ata do të mund të ishte me pasoja negative në marrëdhëniet juridike të shoqërisë me personat e tretë. Për këtë mund të thuhet që me zbatimin e institutit të prishjes së subjektivitetit juridik të shoqërisë vjen deri te korrigjimi i pasojave negative nga zbatimi rigoroz i parimit që shoqëria tregtare si person juridik përgjigjet për detyrimet e veta me tërë pasurinë e saj, por që ortakët/aksionarët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë.

Prishja e subjektivitetit juridik të shoqërisë nuk paraqet substitut të rrugës së rregullt juridike të përmbushjes së kërkesave të kreditorëve nga shoqëritë tregtare. Përkundrazi, ky Institut do të zbatohet vetëm në rastet kur nuk është e mundur që kërkesat e kreditorëve të përmbushen me mjete të rregullta juridike, siç është për shembull padia për kompensimin e dëmit, padia për prishjen e punëve juridike të debitorit etj.

Po ashtu ky Institut nuk është në disponim të administruesit të falimentimit, e as që i njëjti mundet t'i prishë punët juridike që debitori falimentues i ka lidhur me kreditorin nën kushtet e caktuara me ligj. Administruesi i falimentimit mund që në bazë të padisë për prishjen e punëve juridike, të kërkojë kthimin e pronës në masën falimentuese.

Nga kjo që u tha më lart mund të konkludojmë që ky Institut gjen zbatim rigoroz dhe i njëjti nuk mund të përdoret si mjet gjeneral në rastet kur shoqëria si person juridik u ka shkaktuar dëm kreditorëve edhe pse ajo ndoshta mund të jetë bërë në favor të ortakëve. Si parim i përgjithshëm edhe më tej qëndron përgjegjësia e shoqërisë si person juridik për detyrimet e saj me tërë pasurinë e saj.

Zbatimi i këtij Instituti është përjashtim. Është e patjetërsueshme që të ekzistojnë shkaqe, të cilat e suspendojnë parimin e përgjithshëm të mëvetësisë së personit juridik, kështuqë nuk bëhet fjalë më për

⁷Милан Недков, op.cit., fq.6.

funksionimin normal të shoqërisë në pajtim me objektivat me të cilat është lejuar themelimi dhe veprimi i saj, por në shprehje vjen shndërrimi i shoqërisë në mjet për realizimin e qëllimeve kundërligjore nga ana e ortakëve/aksionarëve.

Në fund, të cekim që Instituti prishja e subjektivitetit juridik të shoqërisë është marrë nga e drejta amerikane dhe në Evropë është zhvilluar sidomos nga teoria dhe praktika juridike gjermane. Në të drejtën amerikane ky Institut është i njohur nën shprehjen „lifting or piercing the corporate veil“, ndërsa në të drejtën gjermane është i njohur nën emrin „Haftungsdurchgriff“.⁸

Ky Institut konsiderohet relativisht i ri, sepse në Evropë është formësuar pesëdhjetë vitet e fundit, por me të zgjidhet një problematikë e vjetër dhe specifike siç është pranimi i subjektivitetit juridik të shoqërisë dhe proklamimi i papërgjegjësisë së ortakëve për detyrimet e shoqërisë. Me këtë Institut kreditorët e shoqërisë i realizojnë kërkesat e tyre drejtpërdrejt nga ortakët/aksionarët, edhe pse sipas ligjit ata nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë. Në Evropë ky Institut është formësuar dhe zhvilluar nën ndikimin e parimit të së drejtës amerikane: parimi i drejtshmërisë.

Nga primesat e mësipërme mund të konkludojmë që doktrina e heqjes së vellos së shoqërive tregtare kohëve të fundit është objekt i diskutimit që ka gjeneruar botëkuptime të ndryshme dhe diametralisht të kundërta. Sipas disa teoriticientëve juridikë, të cilët janë kundër kësaj doktrine, të njëjtët e mbështesin parimin e përgjegjësisë së kufizuar të ortakëve/aksionarëve në shoqëritë tregtare, sipas të cilëve prezumimi i përgjegjësisë së kufizuar është “shtyllë” gjegjësisht parim i të drejtës korporative. Të njëjtët konsiderojnë që krahas lehtësimit të zhvillimit ekonomik, parimi i përgjegjësisë së kufizuar e lehtëson dispersionin e investimeve, i redukton gjegjësisht zvogëlon shpenzimet për mbikqyrje, e zmadhon likuiditetin e aksioneve dhe i stimulon menaxherët që të ndërmarrin projekte të dobishme, të cilat përndryshe do të mund të konsideroheshin si tejet të rrezikshme, e stimulon biznesin me atë që rreziku i investitorëve është kufizuar deri në lartësi të pjesës/kontributit të investuar në shoqëri. Sipas kësaj, nëse do t’u lejohej paditësve që lehtësisht ta prishin subjektivitetin juridik apo ta heqin vallon e shoqërive tregtare si dhe ta prishin parimin e përgjegjësisë së kufizuar, atëherë do të evitoheshin këta përfitime, sepse është përgjithësisht i pranuar

⁸Милан Недков, op.cit., fq.7.

botëkuptimi që parimi i përgjegjësisë së kufizuar është element esencial, i cili i tërheq investimet kapitale, të cilat janë të nevojshme që një korporatë të themelohet dhe të zhvillohet.⁹

Nga ana tjetër, ata teoricienët, të cilët e mbështesin parimin e heqjes së vellos, konsiderojnë që parimi i përgjegjësisë së kufizuar në një mënyrë të padrejtë i hedh shpenzimet mbi kreditorët e pafajshëm. Si rezultat i kësaj, menaxhmenti mund të ndërmarrë veprime afariste, të cilat janë të dëmshme për shoqërinë, sepse ato mund të evitojnë rrezikun e këtyre projekteve afariste, duke rezultuar në probleme morale dhe të njëjtat do t'i tejkalonin përfitimet e parimit të përgjegjësisë së kufizuar.¹⁰

Shkaqet për të cilat mund të aktivizohet Instituti prishja e subjektivitetit juridik të shoqërisë

Ligjet bashkëkohore, të cilat kanë të bëjnë me shoqëritë tregtare kanë pranuar që transferimi i kapitalit mund të arrihet më mirë nëpërmjet stimulimit të aksionarëve që të investojnë, por nëpërmjet kufizimit të përgjegjësisë së tyre. Pra, kufizimi i përgjegjësisë është rregull e jo përjashtim, kështuqë në bazë të këtij prezumpcioni janë formuar ndërmarrje të mëdha, e njëkohësisht është investuar edhe kapital i madh. Për shkak të relevancës së kësaj të parimit të përgjegjësisë së kufizuar në sistemin ekonomik edhe juridik, “barra e palës që kërkon ta ulë vëllon tek shoqëritë tregtare është e rëndë”. Gjykatat do ta ulin këtë vëllon tek shoqëritë tregtare vetëm në rrethana përjashtuese, kështuqë pala duhet të vërtetojë që keqpërdorimi i korporatës është i karakterit të rëndë dhe e njëjta është bërë me qëllim që të krijohet mashtrim gjegjësisht dëm dhe padrejtësi ndaj kreditorëve.

Sipas kësaj, barra e provës së paditësit tek marrëdhëniet kontraktuese është shumë më rigorozë, në rastet kur kërkohet ulja apo heqja e velloa tek shoqëritë tregtare, sepse tek marrëdhëniet kontraktuese, paditësi ka patur mundësi që ta zgjedhë subjektin me të cilin ka marrëdhënie afariste, gjegjësisht me vullnet të lirë ka hyrë në marrëdhënie afariste me atë subjekt. Për këtë shkak, në mënyrë që të ulet velloja e korporatës apo që të konstatohet përgjegjësi *alter ego*, është e nevojshme që të vërtetohet që

⁹ Smith, DG 2008, 'Piercing the Corporate Veil in Regulated Industries', *Brigham Young University Law Review*, 2008, 4, pp. 1165-1211, Business Source Complete, EBSCOhost, viewed 5 September 2017 fq.1166.

¹⁰ Ibid.1167.

ka patur elemente të mashtrimit apo keqpërdorimit të korporatës dhe se keqpërdorimi i tillë i korporatës së caktuar ka shkaktuar dëm material.¹¹

Analog me Ligjin mbi shoqëritë afariste sllovene edhe Ligji për shoqëritë tregtare i Republikës së Maqedonisë saktësisht i përcakton shkaqet për të cilat mund të aktivizohet Instituti prishja e subjektivitetit juridik të shoqërisë. Ligji për shoqëritë tregtare i Kroacisë ka vepruar më ndryshe, gjegjësisht ai ka përcaktuar në mënyrë të përgjithshme apo me formulim të përgjithshëm dhe nuk i përcakton taksativisht shkaqet që duhet te ekzistojnë në mënyrë që kreditorët e shoqërisë të mund të kërkojnë përmbushjen e detyrimeve nga ortakët e shoqërisë. Sipas ligjit kroat mbi shoqëritë tregtare, është e mjaftueshme që ortakët ta ketë keqpërdorur pozitën e vet në shoqërinë tregtare dhe rrethanën që sipas ligjit nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë, në mënyrë që ti privohet e drejta të thirret në papërgjegjësi për detyrimet e shoqërisë.

Në Ligjin për shoqëritë tregtare¹² të Republikës së Maqedonisë janë përcaktuar katër shkaqe për të cilat kreditorët e shoqërisë mund të kërkojnë aktivizimin e Institutit prishja e subjektivitetit juridik të shoqërisë.

Gjegjësisht, ortakët e shoqërisë përgjigjen për detyrimet e shoqërisë edhe në rastet nëse:

1. E kanë keqpërdorur shoqërinë tregtare si person juridik që të arrijnë qëllime, të cilat për ta si individë janë të ndaluara
2. E kanë keqpërdorur personin juridik me qëllim që t'u shkaktojnë dëm kreditorëve të vet
3. Në kundërshtim me ligjin kanë disponuar me pronën e personit juridik sikur të ishte pronë e tyre
4. Në favor të vet apo në favor të kujtdo personi tjetër e kanë reduktuar pronën e shoqërisë tregtare, ndërsa e kanë ditur apo është dashur të dinë që shoqëria është insolvente, apo nuk është në gjendje t'i përmbushë detyrimet e saja ndaj personave të tretë.

Duhet të potencohet që ligjvënësi ka konsideruar që shkaqet e lartpërmendura janë të mjaftueshme që të përjashtohet parimi i ndarjes së personit juridik nga ortakët/aksionarët dhe ajo që është më me rëndësi

¹¹ Smith, DG 2008, 'Piercing the Corporate Veil in Regulated Industries', *Brigham Young University Law Review*, 2008, 4, pp. 1165-1211, Business Source Complete, EBSCOhost, viewed 5 September 2017 fq.1171.

¹² Shih nenin 28 të Ligjit për shoqëri tregtare.

që pasojat juridike të veprimeve të caktuara të shtrihen edhe mbi ta - ortakët/aksionarët.

Gjatë konstatimit të shkaqeve për aktivizimin e Institutit të prishjes së subjektivitetit juridik të shoqërisë, ligjvënësi tek ne e ka pranuar teorinë e keqpërdorimit të personit juridik për t'u shkaktuar dëm kreditorëve të shoqërisë. Këta prezumpcione duhet të plotësohen në mënyrë kumulative.

Keqpërdorimi i shoqërisë tregtare si person juridik për arritjen e qëllimeve të cilat për ortakët si individë janë të ndaluara

Shkaku i parë për të cilin mund të aktivizohet Instituti i prishjes së subjektivitetit juridik të shoqërisë, pra është keqpërdorimi i shoqërisë si person juridik për arritjen e qëllimeve të cilat për ortakët si individë janë të ndaluara. Ky keqpërdorim mund të bëhet nga ortakët si persona fizikë, por edhe nga ortakët, të cilët janë persona juridikë.

Në esencë vetë qëllimi nuk është, apo nuk duhet të jetë i ndaluar vetvetiu. Nëse do të ishte ashtu, atëherë nuk do të shtrohej çështja e prishjes së subjektivitetit juridik të shoqërisë, sepse shoqëria si person juridik nuk do të mund as të themelohej nëse qëllimi i themelimit të saj do të ishte i ndaluar. Në sferën e afarizmit ndalesat kanë të bëjnë me kryerjen e veprimtarisë së shoqërisë. Ky do të ishte shembulli i ndalimit të konkurrencës në mes ortakut dhe shoqërisë.

Në këtë kuptim gjithashtu është përcaktuar që ortaku nuk guxon të merret me veprimtari dhe të kryejë punë, të cilat do të ishin në kundërshtim apo të dëmshme për objektivat e shoqërisë. Nuk do të thotë që ky Institut nuk do të mund të aktivizohet edhe nëse tejkalohet kjo kornizë, nëse ortaku/aksionari do të konkurronte nëpërmjet shoqërisë aksionare në të cilën ka ndikim prevalent, me çka do të kishte mundësi reale të vijë deri te konkurrenca ndaj shoqërisë amë. Ky Institut do të mund të gjejë shprehje edhe për shembull nëse personi fizik i cili ka ndalesë për marrjen e kredisë, jashtë shtetit ka themeluar shoqëri tregtare, e cila do të kishte mundësi të marrë kredi, të cilën kredi, themeluesi do t'a përdorte për nevojat e veta. Nëse shoqëria nuk e kthen kredinë, dhënësi i kredisë mund të kërkojë kthimin e kredisë drejtpërdrejt nga themeluesi i shoqërisë.

Keqpërdorimi i personit juridik me qëllim që t'u shkaktohet dëm kreditorëve

Shkaku i dytë ka të bëjë me rastet kur ortakët e keqpërdorin shoqërinë si person juridik me qëllim që t'u shkaktojnë dëm kreditorëve të vet. Duhet të potencohet që keqpërdorimi i subjektivitetit juridik të shoqërisë është bërë në dëm të kreditorëve të ortakëve, e jo në dëm të kreditorëve të shoqërisë. Rast të tillë do të kishim, për shembull, nëse ortakët e një shoqërie ekzistuese vendosin që kapitali themeltar të zvogëlohet dhe shuma e zvogëluar të dispersohet në mes ortakëve, ndërsa këta ortakë me këtë shumë themelojnë shoqëri të re. Shoqëria paraprahe, për shkak të reduktimit të kapitalit themeltar deri në minimum do të zbatojë procedurën e falimentimit, me çka kreditorëve u shkaktohet dëm. Në këtë rast, kërkesë për kompensim të dëmit për shkak të keqpërdorimit të subjektivitetit juridik të shoqërisë, mund të kërkojnë kreditorët drejtpërdrejt nga ortakët si debitorë. Ortakët në këtë rast e kanë shfrytëzuar autonominë e shoqërisë së parë dhe të dytë, në mënyrë që t'u shkaktojnë dëm kreditorëve të vet.

Në këtë rast bëhet fjalë për sjellje të vetëdijshe të ortakëve, ata kanë qëllim ose e dinë që me ndihmën e shoqërisë tregtare si person juridik u shkaktojnë dëm kreditorëve të tyre. Keqpërdorimi në këtë rast do të thotë sjellje negative e ortakëve që kualifikohet si shkelje e ligjit, mirëbesimit, korrektësisë dhe zakoneve të mira afariste. Nëse bëhet fjalë për keqpërdorimin e pozitës në shoqëri, atëherë është fjala për sjellje subjektive: pra me qëllim zgjidhet veprim i ndaluar ose me qëllim praktikohet sjellje që është e ndaluar.

Disponimi me pronën e shoqërisë tregtare në kundërshtim me ligjin sikur me pronë personale

Shkaku i tretë, ka të bëjë me disponimin me pronën e shoqërisë në kundërshtim me ligjin, sikurse me disponuar me pronë personale. Me fjalë të tjera në këtë rast vjen deri te konfuzioni i pronës së shoqërisë. Për përzierjen e pronës së ortakut me pronën e shoqërisë bëhet fjalë atëherë kur për asete të caktuara apo për të gjitha sendet që hyjnë në masën pronësore nuk mund saktësisht të përcaktohet nëse e drejta mbi ta i takon shoqërisë apo ortakut. Është mjaft që si pasojë e kësaj situate të mos mundet të kontrollohet prona e shoqërisë.

Është njohur fakti që ortakët e themelojnë shoqërinë për realizimin e të mirave dhe interesave personale. Por, të mirat dhe interesat, ortakët i realizojnë gjithmonë nëpërmjet organizimit legal të shoqërisë, qoftë si dividend, apo kuota, qoftë si huamarrje në bazë të ligjit, apo në bazë të prestacioneve të kontraktuara të shoqërisë në favor të ortakëve.

Por, ortakët në atë rast duhet të sillen ashtu që shoqëria të jetë e aftë që t'i përmbushë detyrimet e saja ndaj personave të tretë. Për këtë arsye ortakët nuk mund të disponojnë me pronën e shoqërisë si pronë e tyre personale, por me atë pronë mund të disponojnë vetëm në pajtim me ligjin. Tejkalimi i atyre kufijve të përcaktuara me ligj është shkak për përgjegjësinë e ortakëve për detyrimet e shoqërise.

Këta do të ishin rastet, për shembull kur ortaku themelon një apo më shumë shoqëri të tjera me qëllim që të bëjë transfer të mjeteve nga njëra në tjetrën shoqëri. Po ashtu do të konsiderohej se ka keqpërdorim të pronës së shoqërisë edhe nëse do të themelohej shoqëri e re, me qëllim që të dëmtohet kreditori me atë që prona do të transferohej në shoqërinë e sapoformuar.

Reduktimi i pronës së shoqërisë tregtare nga ana e ortakëve

Rasti i katërt dhe i fundit që mund të çojë deri te aktivizimi i Institutit të prishjes së subjektivitetit juridik të shoqërisë ka të bëjë me zvogëlimin, apo reduktimin e pronës së shoqërisë nga ana e ortakëve në favor të vet, apo në favor të kujt do personi tjetër, ndërsa e kanë ditur apo është dashur ta dinë që shoqëria nuk është e aftë t'i përmbushë detyrimet e veta. Ky shkak është përcaktuar nën ndikimin e doktrinës që e ka bazën në praktikën gjyqësore të SHBA-ve. Si parim është pranuar fakti që në rast të vështirësive në përmbushjen e detyrimeve të shoqërisë kundrejt kreditorëve, duhet të vijë në konsideratë interesi i kreditorëve.

Pra, në situata të tilla prona e subjektit juridik konsiderohet si fond për kreditorët, nga i cili përmbushen detyrimet ndaj kreditorëve. Për këtë konsiderohet si e kundërligjshme çdo sjellje, e cila do ta dobësonte pozicionin e kreditorëve dhe do t'a pamundësonte përmbushjen e detyrimeve ndaj tyre. Sistemi ynë juridik nuk i afirmon drejtpërdrejt këto parime, por ato afirmohen në mënyrë të tërthortë nëpërmjet disa dispozitave të Ligji mbi marrëdhëniet detyimore dhe Ligji për falimentim.

Realizimi i shkakut të katërt është i ndërlidhur me disa kushte, të cilat duhet të respektohen në mënyrë rigoroze.

E para, është e nevojshme që me reduktimin e pronës së shoqërisë të përfitojë ortakut apo personi i tretë, i cili, ka përfituar nëpërmjet ortakut i cili ia ka mundur atë. Dobia mund të jetë e ndryshme: përfitimi i vlerave pasurore apo mundësimi i zvogëlimit të pasurisë, që mund të vijë nëpërmjet për shembull të faljes së kthimit të kredisë apo pagesës së intereseve.

E dyta, efekti i sjelljes së ortakut duhet të rezultojë në zvogëlimin e pronës së shoqërisë. Në këtë kuptim kjo sjellje mund të nënkuptojë zvogëlimin efektiv, apo lëshimin e mundësisë për zmadhimin e pronës së shoqërisë.

E treta, duhet të vërtetohet që ortakut e ka ditur apo ka patur obligim ta dijë se me këtë veprim vjen deri te zvogëlimi i pronës së shoqërisë.

Përgjegjësia e ortakut sipas nenit 28 të Ligjit për shoqëritë tregtare është individuale, kështuqë në çdo rast duhet të vërtetohet korniza subjektive: qëllimi, dija/mosdija.

Në fund, ortakët përgjigjen në këtë rast për detyrimet krahas shoqërisë, që do të thotë se vjen në shprehje përgjegjësia solidare.

Përfundim

Nga premisat e mësipërme, mund të konkludojmë që Instituti prishja e subjektivitetit juridik të shoqërisë në sistemin tonë juridik mund të aktivizohet nga ana e kreditorëve nëse kumulativisht plotësohen dy prezumime edhe atë: të ekzistojë keqpërdorim të personit juridik si dhe me këtë t'u shkaktohet dëm kreditorëve të shoqërisë nga ana e ortakëve/aksionarëve.

Ligji për shoqëri tregtare i Republikës së Maqedonisë analog me Ligjin për shoqëri afariste sloven *expressis verbis* i përcakton dhe i numëron shkaqet për të cilat mund të aktivizohet Instituti prishja e subjektivitetit juridik të shoqërisë, për dallim për shembull nga Ligji për shoqëritë tregtare i Kroacisë, i cili nuk i numëron taksativisht shkaqet të cilat duhet të ekzistojnë që të munden kreditorët e shoqërisë të kërkojnë përmbushjen e kërkesave të tyre nga ortakut i shoqërisë, por i njëjti ka dhënë një kornizë të përgjithshme gjegjësisht formulim sipas të cilit mjafton që ortakut ta ketë keqpërdorur pozitën e tij në shoqëri dhe rrethana që ai si i tillë nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë, në mënyrë që të privohet nga mundësia që të thirret në dispozitën ligjore se i njëjti nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë.

Mund të konstatohet që katër shkaqet e sipërpërmendura sipas sistemit tonë juridik janë të mjaftueshme për tu aktivizuar Instituti i prishjes së subjektivitetit juridik të shoqërive tregtare, në atë kuptim që vjen deri te përjashtimi i zbatimi të parimit të ndarjes së personit juridik nga ortakët/aksionarët e saj, gjë që mund të rezultojë që pasojat nga veprimet e caktuara të zgjerohen edhe ndaj tyre (ortaktëve/aksionarëve).

Nga kjo mund të konstatohet që me zbatimin e këtij Instituti ose me “heqjen e vellos së personit juridik” është qëllimi që të pengohet një keqpërdorim specifik i subjektivitetit juridik të shoqërisë tregtare që shprehet në atë që ortaku gjegjësisht aksionari edhe pse e ka keqpërdorur subjektivitetin juridik të shoqërisë në dëm të kreditorëve, i ikën përgjegjësisë për detyrimet e shoqërisë duke u thirrur në atë që sipas ligjit nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë. Me Institutin prishja e subjektivitetit juridik në të drejtën tregtare, që është përjashtim nga parimi i përgjithshëm për mospërgjegjësinë e ortakëve/aksionarëve të shoqëritë e kapitalit për detyrimet e shoqërisë, praktikisht nëse vërtetohet që ortaku/aksionari e ka keqpërdorur pozitën e tij në shoqëri dhe të njëjtës i ka shkaktuar dëm, i njëjti edhe pse parimisht nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë, në atë rast nuk mund të thirret në mospërgjegjësi për detyrimet e shoqërisë.

Ky Institut është me relevancë të veçantë, sepse nga njëra anë e pengon keqpërdorimin e pozitës së ortakëve/aksionarëve në aspekt të pronës së shoqërisë, ndërsa nga ana tjetër u mundëson kreditorëve që në situatë të pamundësisë së përmbushjes së kërkesave të tyre nga ana e shoqërisë tregtare edhe atë për shkak të insolvencës së saj ose për shkak të ndonjë pengese tjetër objektive, atëherë të njëjtit nën kushtet e përcaktuara me ligj, nëpërmjet aktivizimit të këtij Instituti mund të kërkojnë që detyrimet, gjegjësisht raporti juridik që e kanë patur me shoqërinë, të shtrihet edhe ndaj ortakëve/aksionarëve të saj.

Bibliografia

- Cami Anila, The Heritage, nr.3/2011, International University of Struga, *“Disa aspekte mbi Shoqëritë Tregtare”*.
- Gorenc Vilim, *Trgovačko Pravo- Ugovori*, Školska Knjiga, Zagreb, 1993.
- Беличанец Тито et al., *Корпоративно управување*, Скопје, 2014.
- Недков Милан., Легис, Деловно право бр. 3, година I, Септември 2000.

Smith, DG 2008, 'Piercing the Corporate Veil in Regulated Industries', *Brigham Young University Law Review*, 2008, 4, pp. 1165-1211, Business Source Complete, EBSCOhost, viewed 5 September 2017.

Ligji për shoqëri tregtare ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 28 prej 30 prill 2004 vit. Ndryshimet dhe plotësimet e ligjit janë shpallur në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë" numër 84/2005, 25/2007, 87/2008, 42/10, 48/10, 24/11, 166/12, 70/13, 119/13 и 120/13), <https://www.pravdiko.mk/zakonot-za-trgovskite-drushtva/>

EFEKTET E GLOBALIZIMIT NË PROÇESIN E PUNËS

Aljona Laska

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë

Vlorë/Shqipëri

hidrialjona@gmail.com

Abstrakt

Globalizimi është një proces i hershëm, i cili synon të orientojë të gjitha shtetet dhe qytetarët drejt një tregu të përbashkët. Në kushte të tilla, rëndësi e veçantë do t'i kushtohet orientimit të procesit të punës në lidhje me sfidat e globalizimit. Puna është një proces me natyrë të dyfishtë, sa sociale aq edhe ekonomike, ndaj sfidat e globalizimit synojnë të reflektojnë politika të unifikuara në drejtim të formave të reja të punës. Zhvillimi i punës ka efekte të konsiderueshme edhe në mjedis. Aq sa shfaqet miqësor me të, në të njëjtën mënyrë shpesh edhe reflekton pasoja negative në drejtim të tij. Për të pakësuar këto efekte negative procesi i punës po orientohet në drejtim të “Green Jobs”. Nëpërmjet “Green Jobs” mundësohet në mënyrë të njëherëshme krijimi i fondeve të reja të punës dhe një sjellje miqësore në drejtim të mjedisit.

Nëpërmjet këtij punimi synohet që të paraqiten në mënyrë të përmbledhur dimensionet e reja të punës në dritën e globalizimit. Referuar problematikave të evidentuara nga organizata ndërkombëtare e punës, njëkohësisht edhe atyre të pasqyruara në nivel kombëtar, do të ofrohen sygjerime për përshtatjen e procesit të punës me sfidat e reja globale. Metodologjia e zbatuar në këtë punim është ajo e analizës teorike, e që synon projektimin e zgjidhjeve individuale për secilën prej problematikave me të cilat përballet e drejta e punës. Gjykojmë se Shqipëria është një vend, i cili ka reflektuar mbi gabimet e së shkuarës dhe po orientohet graduashit drejt politikave globale të punës.

Fjalë kyç: *Globalizim, puna, e drejtë e punës, “green job”, telepuna.*

Hyrja

Që pas luftës së dytë botërore dhe veçanërisht në fillim të viteve 1970, zhvillimi ekonomik në nivel botëror ka shkuar drejt liberalizimit global dhe varësisë së ndërsjelltë. Këto ndryshime janë reflektuar në të gjitha fushat e prodhimit dhe veçanërisht në atë të prodhimit dhe shërbimeve. Efektet e globalizimit janë të tilla që krijojnë një ndërvarësi të vazhdueshme ndërmjet ekonomive dhe sektorëve të prodhimit.

Globalizimi përfaqëson procesin e integritit të shteteve dhe njerëzve në nivel botëror(Stiglitz:2002). Ky proces me gjithë kompleksitetin e tij thekson nevojën e ngritjes së institucioneve dhe rritjes së aktivitetit të korporatave ndërkombëtare që lëvizin kapitalin, mallrat dhe teknologjinë në nivel global. Struktura kryesore me peshë të rëndësishme në zhvillimin e këtij procesi dhe harmonizimin e procesit të punës në nivel global janë: FMN(Fondi Monetar Ndërkombëtar), Banka Botërore dhe OBT (Organizata Botërore e Tregtisë).

Integrimi ekonomik ndërkombëtar(Sengenberger:2009) është një proces kompleks dhe i gjatë, ai ka nisur që para luftës së parë botërore dhe ka diktuar nevojën e hartimit të rregullave në nivel ndërkombëtar, për të garantuar ekzistencën e një konkurrence të drejtë. Fillimisht shtetet e kishin mjaft të lehtë për të vendosur raporte tregtare me njëri tjetrin, tarifat e tregtimit dhe burokracitë ishin mjaft të pakta duke lehtësuar kështu financimin dhe investimet. Gjendur në këto rrethana ONP që me krijimin e saj në 1919 diktoi nevojën e krijimit të standarteve minimale të mbrojtjes në punë. Efektshmëria e të cilave do të varej në çdo rast nga detyrimi i përbashkët i të gjithë shteteve për t'i respektuar ato.

ONP, si një nga strukturat më të suksesshme në nivel botëror me 185 Konventa në mbrojtje të të drejtave të punëmarrësve, ligjërisht të detyrueshme për shtetet ratifikuese ka krijuar një kornizë të plotë në garantimin e mbrojtjes së punëmarrësve. Qellimi i ONP nuk fokusohet vetëm në ofrimin e standarteve minimale të mbrojtjes, por në krijimin e një raporti bashkëpunimi dhe efience ndërmjet tre aktorëve kryesorë të procesit të punës punëdhënës, punëmarrës dhe shtet. Sfida e globalizimit nuk është një sfidë e re për ONP-në, por vështirësia e saj vjen në porcion rritës sikurse dhe ndërvarësia gjithnjë e më e madhe ndërmjet ekonomive shtetërore. Ndër sfidat e reja janë ato që lidhen me informalizimin e një sërë sektorëve, të cilët klasifikoheshin si sektorë formal të ekonomisë. Nevoja për rritjen e produktivitetit dhe cilësisë, në të njëjtën kohë solli si pasojë zhvillimin e politikave decentralizuese dhe hapjen e sektorit privat të investimit edhe në ata sektorë, të cilët janë konsideruar si sektorë të zhvillimit të ekonomisë shtetërore.

Efektet e globalizimit në procesin e punës dhe punëmarrësit

Ndikimi i globalizimit në procesin e punës dhe në problematikat, të cilat lidhen me të është një nga çështjet më të diskutueshme. Në këtë kuptim ngrihet edhe debati i madh pro dhe kundër globalizimit. Një pjesë e studiuesve anti-globalizim i adresojnë përgjegjësitë e problemeve në punë dhe me punëmarrësit procesit të globalizimit (Jenkins:2004). Sipas tyre vendimarrjet në forume të larta ndërkombëtare, ku njerëzit e thjeshtë nuk përfaqësohen kanë një ndikim thelbësor në jetën e shumë njerëzve në mbarë botën. Me anë të këtij procesi vihet re një marxhinalizim i një pjese të madhe të popullsisë së botës dhe që kontribuon në rritjen e pabarazisë ndërkombëtare. Thellimi i varfërisë dhe diferencimeve me karakter social janë produkt i ndërvarësisë ekonomike midis shteteve dhe që reflektohen në mundësi dhe kushte më të këqija punësimi për njerëzit e thjeshtë. Për autorët mbështetës të procesit të globalizimit, efektet e tij mbi punëmarrësit dhe punën janë të ndryshme. Sipas tyre globalizimi është procesi, i cili do të mundësojë “kufizimin” e varfërisë në nivel botëror. Hapja e ekonomive drejt tregjeve të mëdha të përbashkëta shihet si mënyra për t’i siguruar punëmarrësve kushte të denja punësimi dhe pagesa të kënaqshme. Mbështetës të teorive liberale, e vlerësojnë globalizimin si procesin e integritit të gjerë ekonomik nëpërmjet lëvizjes së mallrave, shërbimeve, kapitalit, teknologjisë dhe punës, të cilat çojnë drejt një rritjeje të qëndrueshme ekonomike.

Procesi i liberalizimit ekonomik¹ dhe politikat e privatizimit² të ndërmarrjeve shtetërore, sollën rritjen e numrit të përgjithshëm të papunësisë. Sistemet e prodhimit janë të fokusuara në dy metoda kryesore, atë copë-normë dhe aftësi- shërbim. Ndërmarrjet shtetërore aplikojnë më së shumti sistemin e parë duke e orientuar procesin e punës drejt finalizimit të sasisë së planifikuar të produktit. Faktorë si mosorganizimi i mirë dhe mos ushtrimi eficient i kontrollit u pasuan nga mosfunksionimi i shumë ndërmarrjeve shtetërore. Në kushte të tilla

¹Reduktimi ose heqja përfundimtare e të gjitha pengesave për transferimin e mallrave, shërbimeve dhe kapitalit nga një vend në tjetrin. Shembull ilustrues është reduktimi i tarifave /taksave mbi produktet bujqësore të importuara(oxforddictionaries)

²Procesi i privatizimi është transferimi i së drejtës së pronësisë nga subjekti shtetëror drejt subjektit privat. Shembujt kryesorë ilustrues janë privatizimi i ndërmarrjeve të menaxhimit të ujit dhe ato të prodhimit të energjisë elektrike(oxforddictionaries)

procesi i privatizimit është i diktuar nga nevoja e rritjes së efijencës dhe produktivitetit të prodhimit, por i pasuar nga një numër i madh ndërprerjesh të marrëdhënieve të punës. Rritja e papunësisë pasohet nga probleme të një natyre të shumëfishtë ekonomike dhe sociale në të njëjtën kohë. Për mjaft individë zgjidhja shkon drejt emigrimit në shtete, ku mundësitë e punësimit dhe niveli i pagave është më i lartë sesa në vendet e tyre.

Zhvillimet shoqërore, teknologjike dhe ekonomike janë reflektuar në mënyrë direkte edhe në natyrën e procesit të punës. Që pas vitit 1980 roli i kompjuterit “makina e zgjuar” është bërë thelbësore për një sërë procesesh në punë, duke mundësuar kalimin nga puna fizike drejt asaj mendore. Revolucioni teknologjik dhe ai informatik më pas siguruan një ndryshim tërësor të proceve të punës duke zëvendësuar punën fizike me atë mendore, e duke rritur ndjeshëm rolin e teknologjisë, i cili i hap rrugën krijimit të marrëdhënieve jotradicionale të punës. Aktualisht marrëdhëniet e punës po zhvendosen drejt formave të reja të punës, të cilat ulin koston dhe ridimensionojnë raportin punëdhënës-punëmarrës.

Aktualisht punëdhënësit po stimulojnë ndërtimin e marrëdhënieve të punës jashtë ambientit të ndërmarrjes si një mjet për të rritur efikasitetin e punës dhe ulur kostot e saj. Me “punë në shtëpi” sipas legjislacionit shqiptar, do të kuptojmë atë proces pune, i cili kryhet nga punëmarrësi në shtëpinë e tij ose në një vend tjetër të përcaktuar në marrëveshje me punëdhënësin, por që është i ndryshëm nga vendi i punës së punëdhënësit (Kodi i Punës, neni 15). Në të njëjtën linjë vjen edhe rekomandimi nr. 184/1996³ i ONP-së. Nuk do të përfshihen në grupin e punëmarrësve të “punës në shtëpi” ata persona, të cilët gëzojnë një shkallë autonomie dhe pavarësie ekonomike të mjaftueshme për t’u konsideruar si punëmarrës të pavarur në bazë të ligjeve kombëtare. Kështu tërësia e personave të cilët ushtrojnë profesione të lira, p.sh. avokatët, ekspertët kontabël, përmbaruesit privatë, ndërmjetësit... etj nuk do të trajtohen si punëmarrës të “punës në shtëpi”. Gjithashtu nuk do të konsiderohet si punëmarrës i “punës në shtëpi” edhe ai punëmarrës, i cili gëzon statusin e zakonshëm të punëmarrësit, por që në mënyrë të herë pas herëshme mund të kryej punën jo në ambientin e ndërmarrjes por në shtëpinë e tij. Ndërsa punëdhënësi për “punën në shtëpi” do të jetë ai person fizik ose juridik, i cili në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose me anë të

³Me pune ne shtepi, do te kuptohet ai process pune qe kryhet ne shtepine e punemarresit ose ne nje vend tjeter te percaktuar ne marreveshje midis paleve, perkundrejt shperblimit dhe qe finalizohet me sendin/ sherbimin e krijuar sipas kerkesave te punedhenesit, pavaresisht se cili eshte pronari I mjeteve te punes.

një ndërmjetësi ofron kryerjen e punës në shtëpi sipas nevojave të aktivitetit të tij tregtar. Në mënyrë që të ofrohen garancitë e nevojshme për mbrojtjen e të drejtave në punë, për këtë kategori, do të duhet që të krijohen instanca shtetërore specifike që të mundësojnë kontrollin e zbatimit të lirive dhe të drejtave në punë. Aktualisht struktura të tilla në Shqipëri nuk ekzistojnë, por Inspektoriati Kombëtar i Punës ushtron kontrolle të vazhdueshme në terren për zbatimin e të drejtave të punëmarrësve në tërësinë e tyre. Sikurse edhe për punëmarrësit dhe punëdhënësit e tjerë, të cilëve u njihet e drejta e organizimit, edhe punëmarrësit e punëdhënësit e “punës në shtëpi” kanë të drejtën e organizimit (rekomandim i ONP nr.184/1996) dhe mundësinë për të qenë aktivë në politikat e punësimit që prekin këtë kategori. Në mungesë të organizimeve të tilla do të duhet që rol aktiv në mbrojtje të të drejtave të kësaj kategorie t’i vishet instancave përkatëse shtetërore. Aktualisht në Shqipëri, mungesa e plotë e strukturave të organizuara shtetërore, të punëdhënësve dhe punëmarrësve të “punës në shtëpi” e bën të pamundur efektivisht aplikimin e kësaj garancie. Për të siguruar informacion të plotë dhe të saktë për zbatuesit e “punës në shtëpi” do të duhet që të mbahen të dhëna të detajura⁴ në lidhje me gjininë e tyre dhe kushtet e ushtrimit të punës. Të gjitha këto do të shërbejnë si bazë për hartimin e politikave konkrete të punësimit për këtë kategori sipas nevojave të evidentuara. Gjithashtu detyrimi për të mbajtur informacion specifik mbi të dhënat e punëmarrësve rëndon edhe mbi punëdhënësit që punësojnë punëmarrës të “punës në shtëpi”. Ky informacion duhet të jetë i saktë, periodik dhe të ruhet në zyrat e punëdhënësve. Detyrimi për përcaktimin e një page minimale vlen edhe për punëmarrësit e “punës në shtëpi”. Konventa e ONP-së referon të drejtën e ligjvënësve kombëtar për të bërë përcaktime specifike në lidhje me nivelin e pagës minimale. Ky nivel page mund të jetë i ndryshëm për këtë kategori punësh duke marrë në konsideratë specifikat e saj, ose mund të aplikohet niveli i përgjithshëm i pagës minimale i përcaktuar në nivel kombëtar. Në rastin e Shqipërisë do të zbatohet niveli i pagës minimale të përcaktuar në VKM nr. 399/2017.

⁴Punemarresit e “punes ne shtepi” do te duhet qe te japin informacion me shkrim perpara autoriteteve shteterore ne lidhje me:

-Emrin dhe adresen e punedhenesit

-masen e shperblimit dhe elementet te cilet do te merren ne konsiderate per perlllogaritjen e tij

-puna specifike qe do te kryhet prej punemarresit.

Gjithashtu masa e pagës për këtë kategori, do të duhet të rregullohet nëpërmjet kontratës kolektive të punës, nëqoftëse kjo formë kontrate nuk aplikohet atëherë do të gjejnë zbatim rregullat e vendosura në marrëveshje midis organizatave të punëmarrësve dhe punëdhënësve. Në raste të ngjashme me ato të shtetit shqiptar ku organizata të punëdhënësve dhe punëmarrësve të “punës në shtëpi” mungojnë, përcaktimi i kriterëve për caktimin e pagës do t’i vishet autoriteteve shtetërore në nivel kombëtar. Në të njëjtat kushte sikurse edhe punëmarrësit e tjerë edhe kjo kategori e punëmarrësve do të përfitojë nga skema e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

- Telepuna

Telepuna përbën një ndër format e reja të punës që është shfaqur vitet e fundit. Që në vitet 1970 kur kompjuteri dhe rrjetet digjitale u përdorën në funksion të punës dhe biznesit, u shfaqën mendimet e para për telepunën. Aftësia e mjeteve të reja teknologjike për të siguruar informacionin në një kohë të shpejtë për distanca të largëta, i bëri ato mjete të pazëvendësueshme në procesin e punës. Kompjuterat, laptopët, smart phones, tabletat, janë të lidhur ngushtësisht me procesin e telepunës. Gjithashtu, puna, profesionet, taksat dhe shërbimet gjithnjë e më shumë po bëhen virtuale dhe rrjedhimisht po shpëputen nga lidhja me vende fikse (zyrat dhe ambientet e punës) dhe po bëhen më fleksibile.

Në kuadër të procesit të globalizimit vihet re se distancat midis ambienteve të punës dhe shtëpisë po rriten konsiderueshëm. Zhvendosja e industrisë dhe ndërmarrjeve të ndryshme në vendet e treta solli edhe nevojën për rritjen e komunikimit në kohë reale midis tyre dhe shoqërive mëmë të vendosura në distancë shumë të largët. Në një realitet të tillë, të ri, lëvizja e punëmarrësve është e pashmangshme, por a munden mjetet teknologjike ta kufizojnë sadopak këtë nevojë? Sigurisht që po. Ndaj edhe përdorimi i tyre reflektohet ndjeshëm në korporatat dhe industritë e mëdha. Gjatë telepunës punëmarrësi kryen punën e tij në shtëpi, ose në një vend tjetër, të përcaktuar në marrëveshje me punëdhënësin, duke përdorur teknologjinë e informacionit, brenda kohës së punës, të përcaktuar nga punëmarrësi, sipas kushteve të rëna dakord midis tyre në kontratën e punës. Do të ishte me interes të rendisim disa nga avantazhet që ajo paraqet, si ekonomizimi në kohë, mundësia për të ruajtur balancat midis jetës profesionale dhe asaj familjare, reduktimi i nevojës së lëvizjes fizike, kursimi i hapësirave të zyrave, krijimi i mundësive të reja të punës, përfshirja brenda saj e punëmarrësve më të aftë, ndikimi në rritjen ekonomike të rajoneve të caktuara.

Një përkufizim i përbashkët i parashtruar në aktet ndërkombëtare është i nevojshëm për të mbuluar një grup të gjerë rastesh të punës në distancë (nga puna individuale në shtëpi me një kompjuter dhe një telefon deri tek decentralizimi brenda ndërmarrjeve të tëra). Termi "telepunë", po kalon nëpër një proces evolutiv, i cili ka zgjeruar kuptimin e saj origjinal të punës elektronike në shtëpi për të përfshirë forma më komplekse. Tani termi telepunë përdoret gjithnjë për t'iu referuar kombinimeve të ndryshme të punës në zyrat qendrore, në faqet e internetit, në qendrat periferike ose punës nga shtëpia. Nga analiza e rreth 50 përkufizimeve të telepunës (Messenger, Vargas Llave, Gschëind, Boehmer, Vermeylen, Eilkins: 2017) është arritur në përfundimin se ajo mbështetet në tri koncepte kryesore: organizimi, vendndodhja dhe teknologjia. Pjesa më e madhe e këtyre përkufizimeve janë bazuar në një kombinim të të paktën dy prej këtyre koncepteve. Sigurisht që në çdo rast realizimi i punës në distancë, por edhe përdorimi i teknologjisë së re nënkuptojnë ndryshime organizative në procesin e punës. Dimensionet e telepunës janë të shumta, ajo mund të realizohet në disa mënyra: telepuna mund të kryhet "on-line" ose "off-line"; ajo mund të organizohet në mënyrë individuale ose kolektive; telepuna mund të përfshijë të gjithë procesin e punës ose një pjesë të punës së kryer nga punëmarrësi; telepuna mund të kryhet nga punëtorët e vetëpunësuar, ose nga punëmarrësit palë në një marrëdhënie të varur pune. Referuar gamës së gjerë të sektorëve, profesioneve dhe vendeve në të cilat telepuna ka gjetur shtrirje, sigurisht që sistemi i pagave dhe kushtet e punës do të jenë të ndryshme. Teknologjia gjithnjë e më shumë po luan një rol të rëndësishëm në procesin e punës, por ky rol nuk duhet mbivlerësuar. Njëkohësisht lind nevoja që të merren në konsideratë tërësia e përfitimeve të realizuara nga punëmarrësit e telepunës. Kjo kategori është përfituese e fleksibilitetit në kohë dhe një autonomie të gjerë në menaxhimin e procesit konkret të punës, ndaj edhe sistemi i pagës dhe përfitimeve të tjera materiale mund të jetë më i vogël. Me qëllim zbatimin e parimit të barazisë në pagë mund të ndodhë që paga e ofruar për punëmarrësit e telepunës të jetë më e vogël se ajo për punëmarrësit, të cilët të njëjtin proces pune e realizojnë në ambientet e punës së punëdhënësit. Një diferencim i tillë mund të vendoset, bazuar në faktin se punëmarrësit e telepunës kanë njëkohësisht përfitime që lidhen me fleksibilitetin dhe autonominë e tyre në realizimin e saj. Niveli i shpërblimit dhe përfitimeve të punëmarrësve të telepunës varet kryesisht mbi statusin e tyre të punësimit dhe profesionin. Në kompanitë e mëdha të prodhimit të paisjeve kompjuterike dhe telekomunikacionit, ku

telepuna është më e zhvilluar, tendenca është që punëmarrësit e telepunës të mbajë statusin e të punësuarve me pagë të njëjtë dhe kushte të barabarta pune sikurse dhe punëmarrësit e tjerë që zhvillojnë punën brenda ndërmarrjes. Si referencë për përcaktimin e pagës mund të përdoren edhe pagat e punëmarrësve të tjerë të të njëjtit profesion në të njëjtin lokalitet (Gahan, Mitchell, Cooney, Steëart, Cooper: 2011). Në raste të caktuara kur aftësi të caktuara të një grupi punëmarrësish të telepunës janë në kërkesë të lartë, punëdhënësit bien dakort për të aplikuar paga më të larta se ato mesatare për të njëjtin profesion. Disa kategori punëmarrësish të telepunës shpesh nuk u njihet mundësia e trajtimit dhe përfitimit sipas këtij statusi, pasi ato vlerësohen si të vetëpunësuar ose kontraktorë të pavarur (kontratë porosie). Sistemi i pagës në këtë rast është ai i pagesës me copë për çdo njësi të prodhuar.

Aplikimi i telepunës për vetë punëdhënësit paraqitet me mjaft interes pasi sjell uljen e kostove për procesin e punës. Punëdhënësit kursejnë shuma të konsiderueshme në hapësirë për zyra, energji elektrike, pajisje, pagesë për kohën e pushimit gjatë procesit të punës dhe për mbikqyrësit që punësoheshin vetëm për të ushtruar kontroll mbi mënyrën e ecurisë së procesit të punës. Punëmarrësit e telepunës nuk janë zakonisht subjekt i një orari të ngurtë të punës, por janë të lirë për të zgjedhur, kur dhe për sa kohë që ata dëshirojnë të punojnë. Ata kanë liri të plotë edhe në përcaktimet e kohës së pushimit. Procesi i punës është i pakufizuar në kohë, ai mund të kryhet si gjatë ditës ashtu edhe gjatë orëve të natës, kjo në varësi të preferencave të punëmarrësit.

Telepuna është shoqëruar edhe me ndryshime në stilin e menaxhimit të saj. Një kompani që vepron me punëmarrës të telepunës ka si detyrë momentalisht gjetjen e zgjidhjeve të reja për: probleme që lidhen me mënyrën e organizimit, me mbikëqyrjen e të gjithë procesit, koordinimin dhe motivimin e fuqisë punëtore të shpërndarë. Sfidat të tjera lidhen me funksionet tradicionale hierarkike dhe me zbatimin e parimit të autoritetit. Në një kompani, e cila vepron vetëm me telepunë, është e vështirë të gjejë zbatim organizimi hierarkik i procesit të punës dhe njëkohësisht shfaqen probleme të tilla si: komunikimi ndërmjet vetë punëmarrësve ashtu edhe midis tyre e punëdhënësit, reagimet ndaj mënyrës së realizimit dhe finalizimit të punës, njëkohësisht i vështirë është edhe garantimi i zbatimit të detyrimit për besnikëri ndaj kompanisë.

Sipas studimeve të realizuara në tregun e telepunës në Mbretërinë e Bashkuar (Craig, Lynk:2006), është arritur në përfundimin se organizimi i punës për punën në distancë duhet të ketë të paktën gjashtë tipare.

Telepuna duhet: të jetë e përshtatshme me nevojat e tregut të punës dhe jo e ngurtë; të realizojë një kosto më të ulët sesa në rastet e realizimit në fabrikë; të rrisë kreativitetin; të sigurojë një angazhim më të lartë të të gjithë individëve dhe të nxisë cilësinë në procesin e prodhimit.

ONP dhe globalizimi

ONP shprehet se potencialet e globalizimit⁵, në aspektin e lindjes dhe rritjes së kapaciteteve prodhuese, janë të pafundme. Megjithatë, këto sisteme nuk janë shfrytëzuar si potencial për shumicën e njerëzve të botës dhe në shumë raste janë keqpërdorur. E parë me sytë e shumicës së njerëzve në mbarë botën, globalizimi nuk ka përmbushur aspiratën e tyre të thjeshtë për një punë më të mirë, për një jetesë dhe një të ardhme më të mirë për fëmijët e tyre. Në vitin 2017⁶, shifrat zyrtare për papunësinë në Shqipëri arritën në masën prej 13.6%. Shifrat jozyrtare do të ishin shumë më të larta. Këto trende, janë kryesisht rezultat i pabarazive të thella dhe të vazhdueshme në punët aktuale të ekonomisë globale. Rezultate të tilla janë jo vetëm në këndvështrimin etik të papranueshme por edhe politikisht pasqyrojnë paqëndrueshmëri. Ato paralajmërojnë për ekzistencën e një krize në legjitimitetin e institucioneve politike, qoftë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Paraqitet si një nevojë urgjente të rishikohen institucionet aktuale të qeverisjes ekonomike globale.

Një efekt të rëndësishëm në ekonominë e shumë shteteve kanë reminitancat. Ato paraqiten veçanërisht të rëndësishme në shtetet në zhvillim (rasti i Shqipërisë). Reminitancat janë rritur në terma absolutë dhe relativë, duke zënë për shumë vende zë kryesor në PBB. Lëvizja e lirë e krahut të punës në kushtet e një ekonomie të madhe globale, por edhe zhvillimi i kanaleve financiare që mundësojnë transferimin e shpejtë dhe të plotë të të ardhurave nga vendi i kryerjes së punës në vendin e rezidencës, kanë ndikuar në rritjen e ndjeshme të lëvizjes së punëmarrësve. Punëtorët migrues janë kryesisht punonjës të sektorit bujqësor të pakualifikuar ose punëtorë në industrinë e ndërtimit dhe shërbimit. Edhe pse ata mund të kenë një ndikim pozitiv në vendet e zhvilluara të tilla si Gjermania, Franca, SHBA, ku fluksi i punëmarrësve të ardhur nga shtetet e tjera është mjaft i lartë dhe ndihmon ndjeshëm zhvillimin e ekonomisë së tyre, për vendet nga të cilat ata emigrojnë,

⁵<http://www.ilo.org/fairglobalization/report/lang--en/index.htm>

⁶<https://tradingeconomics.com/country-list/unemployment-rate>

paraqesin probleme ekonomike dhe sociale. Për vitin 2017 flukset e remitançave përfaqësojnë 8.43% për Australinë, 5.84% për Brazilin, 7.29% për Kanadanë, 6.53% për Francën, 7.20% për Gjermaninë, 6.20% për Italinë, 9.52% për Japoninë, 5.03% për Korenë, 1.75% për Rusinë, 5.45% për Arabinë Saudite, 16.17% për Afrikën e Jugut, 7.29% për Mbretërinë e Bashkuar, 5.80% për SHBA⁷.

ONP shprehet se proceset e punës në kuadër të globalizimit duhet të orientohen në vijimësi drejt “Green Jobs”. Green job ose grupi i punëve të gjelbra përfshin tërësinë e atyre punëve, të cilat janë të denja që të kontribuojnë për të ruajtur mjedisin. Në këtë grup përfshihen punë si ato në sektorët tradicionalë të tilla si, prodhimi dhe ndërtimi, ose edhe forma të reja të tilla si, energjia e rinovueshme dhe prodhimi i energjisë nëpërmjet burimeve të reja.

Puna e gjelbër ndihmon në disa drejtime:

- Prodhimin e energjisë nëpërmjet lëndëve të para të përpunueshme
- Kufizimin e emetimit të gazrave serë
- Kufizimi i ndotjes dhe i plehrave
- Mbrojtjen dhe rivendosin ekosistemet
- Mbështet përshtatjen me efektet e ndryshimit të klimës(ONP:progress report 2014-2015)


Në kuptimin e punës brenda vetë ndërmarrjes, “green job” reflektohet në procesin e prodhimit të mallrave apo shërbimeve, të cilat shkojnë në favor të mjedisit, për shembull krijimi i ndërtesave të gjelbërta apo zhvillimi i një transporti të pastër. Megjithatë, këto rezultate të gjelbërta (sendet dhe shërbimet) nuk janë gjithmonë të bazuara në procese të gjelbërta prodhimi. Prandaj “green job” dallohet për kontributin që ato sjellin në mjedis pasi produkti i punës është gjithmonë me efekte pozitive/mbrojtëse për mjedisin. Për shembull, “green job” mund të reduktojë konsumimin e ujit ose të përmirësojë sistemin e riciklimit.

Megjithatë, në kuadër të “green job” përfshihet edhe rasti ku puna klasifikohet si “green job” mbështetur në procesin e prodhimit edhe pse mallrat apo shërbimet e krijuara jo domosdoshmërisht janë me natyrë mjedisore, psh. rastet e prodhimit të një sendi mbështetur mbi procesin e riciklimit, pra është ky i fundit që e klasifikon një punë të tillë si “green job”. Krijimi i një programi të “green job” nga ONP, vlerësohet si një

⁷https://remittanceprices.worldbank.org/sites/default/files/rpw_report_december2017.pdf

përpjekje pozitive për të vepruar mbi ndryshimin e klimës dhe për të promovuar përdorimin e burimeve ekologjike në procesin e punës. Puna është një gur themeli për politika efektive për ndërtimin e ekonomive të gjelbra dhe arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm. Kjo do të thotë se përpjekjet për të zvogëluar ndikimin negativ në mjedis duhet të sjellë në rezultate sociale dhe në mundësi punësimi për të gjithë.

Procedura e zhvillimit të “green job” pasqyrohet në skemën e mëposhtme



1. Krijimi i idesë për realizimin e “green job” duhet dokumentuar nëpërmjet kryerjes së studimeve globale, rajonale dhe sektoriale, si dhe nëpërmjet hartimit të raporteve dhe udhëzimeve mbi lidhjet që duhet të krijohen mes punës dhe çështjeve të mjedisit.
2. Mbrojtja e idesë (planit) duhet realizuar nëpërmjet ndërtimit të partneriteteve ndërshtetërore por edhe nëpërmjet një angazhimi të vazhdueshëm në dialogje dhe procese kyç të negociatave për rritjen e koherencës së politikës ndërkombëtare. ONP ka kontribuar në mënyrë aktive në Konferencën e Ndryshimeve Klimatike në Paris në dhjetor të vitit 2015
3. Kapacitetet ndërtuese, realizohen duke u siguruar palëve të interesuara mundësi për të mësuar në lidhje me konceptet kryesore të gjelbra, mjetet ekzistuese dhe praktikat më të mira në krijimin e “green job”.

4. Nëpërmjet analizës dhe përcaktimit, synohet të identifikohen sektorët ekonomikë me potenciale të larta për krijimin e vendeve të punës “green job”
5. Projekti pilot
6. Politika e këshillimit synon formulimin dhe zbatimin e politikave efektive kombëtare ose sektoriale që krijojnë vende pune të gjelbra.
7. Shpërndarja e eksperiencës në mënyrë që të tjerët të mund të mësojnë nga praktikat më të mira dhe përvojat e mëparshme.

Konkluzione

Ajo që është e rëndësishme të përcaktohet nëpërmjet këtij punimi është se çfarë mund dhe çfarë do të bëjmë me qëllim që të minimizojmë pasojat negative të procesit të globalizimit në marrëdhënien e punës.

Së pari do të sygjeronim forcimin e organizimit sindikal në nivel kombëtar dhe global. Ky sygjerim paraqitet me një theks të veçantë për shtete të cilat kanë një organizim të dobët sindikal⁸.

Paraqitet si rekomandim nevoja e marrjes së masave për edukimin e punëmarrësve dhe punëdhënësve mbi ndikimin e globalizimit në ekonominë kombëtare dhe pasojat e pritshme të tij. Në këtë kuptim do të sygjerohej ndërtimi i raporteve të partneritetit me OJF, shoqërinë civile dhe organizma me karakter social .

Masat me karakter edukues duhet të nisin që në momentin e formimit në institucionet arsimore, duke ofruar njohuri të përgjithshme mbi procesin e globalizimit, efektet e tij në ekonomi, edukimin dhe orientimin drejt tregjeve ekonomike globale. Fushata sensibilizuese duhet të ndërmerren me qëllim informimin dhe sensibilizimin drejt arsimimit profesional dhe në sektorë, të cilët i përshtaten nevojave të një ekonomie të madhe globale, si kurse të posaçme biznesi, teknologjie, informacioni, tekstili dhe studime industriale.

Do të rekomandohej lobimi në nivele të larta dhe shpesh rritja e presionit ndaj ligjvënësve me qëllim respektimin e konventave dhe rekomandimeve të ONP-së. Paraqitet e nevojshme respektimi efektiv i kriterëve mbi përcaktimin dhe zbatimin efektiv të nivelit të pagës minimale. Gjithashtu duhet të eliminohen praktika të padrejta pagese, si ajo e përcaktimit të pagës mbi bazën e copëve / njësisive të prodhimit, e cila shpesh i lë shteg orëve shtesë të papaguara.

⁸ Ky konkluzion adresohet në mënyrë të vecantë për shtetin Shqiptarë.

Së fundmi do të rekomandonim ndërmarrjen e masave me qëllim sensibilizimin e popullsisë mbi procesin e globalizimit, efektet e tij me karakter social dhe ekonomik. Cilat janë masat me karakter parandalues të cilat duhet të ndërmerren nga të gjithë antarët e shoqërisë me qëllim që globalizimi të përbëjë një proces pozitiv dhe eficient për ekonominë kombëtare dhe sikurse Nestor Kirchner rekomandon “Ne duhet të ndërtojmë një proces globalizimi që funksionon për të gjithëdhe jo vetëm për disa”

Bibliografia

- Globalization and the future of labour laë, edited by John D. R. Craig and S. Michael Lynk, Cambridge University Press, 2006
- Globalization and its Discontents, Joseph E.Stiglitz, june 2002, ISBN 0-393-05124-2
- Labour Laë, Hugh Collins K. D. Eëing Aileen Mccolgan, 2012
- Th e Autonomy of Labour Laë, Edited by Alan Bogg Cathryn Costello ACL Davies and Jeremias Prassl, OXFORD,2015
- European Labour Laë, 2nd edition, Brian Bercusson, Cambridge University Press, 2009
- The Idea of Labour Laë, editors: Guy Davidov & Brian Langille, Oxford University Press, 2011
- Globalization, production,employment and poverty: debates and evidence, Journal of International Development, I.Int.Dev,16,1-12 (2004)
- Ëorking anytime, anyëhere: The effects on the ëorld of ëork, European Foundation for the Improvement of Living and Ëorking Conditions, 2017
- International labour standards in the globalized economy: obstacles and opportunities for achieving progress, Ëerner Sengenberger
- Economic Globalization and Convergence in Labor Market Regulation: An Empirical Assessment, Peter Gahan, Richard Mitchell, Sean Cooney, Andreë Steëart & Brian Cooper
- Universal labor standards and national cultures, Jean-Michel Servais, 2005
- Understanding Change in International Organizations: Globalization and Innovation in the ILO, Laurence R. Helfer, 2006

Conceptualizing transnational labour law, Adelle Blackett and Anne Trebilcock

Green jobs progress report 2014-2015, International Labour Organization
Rekomandimi nr. 184/1996 i ONP-së

Kopi i Punës

Vendimi nr. 399, datë 3.5.2017 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”

<http://www.ilo.org/fairglobalization/report/lang--en/index.htm>

<https://tradingeconomics.com/country-list/unemployment-rate>

https://remittanceprices.worldbank.org/sites/default/files/rpw_report_december2017.pdf

PAVARËSIA E PUSHTETIT GJYQËSOR NË SHQIPËRI

Dr.Arjana Llano*

Dr. Stela Meçaj

Abstrakt

Pavarësia e pushtetit gjyqësor është e garantuar nga Kushtetuta dhe është një parim shumë i rëndësishëm që rrjedh nga parimi i ndarjes së pushteteve. A është e garantuar pavarësia e pushtetit gjyqësor? Pavarësia e pushtetit gjyqësor është shumë e rëndësishme dhe sipas saj gjyqtarët i nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve. Vetë pranimi i parimit të ndarjes së pushteteve, si një nga strumbullarët e organizimit të shtetit demokratik, do të thoshte heqje dorë nga pranimi i epërsisë së një pushteti ndaj të tjerëve. Autonomia dhe pavarësia e gjyqësorit janë siguruar edhe me një varg normash kushtetuese që sanksionojnë statusin e gjyqtarit. Kuptimi i tij mund të përmblihet në çështjen e parimit të parevokueshmërisë, si dhe imunitetin e gjyqtarit. Prirja kushtetuese për të sanksionuar aspektet më të rëndësishme të statusit të gjyqtarit në Kushtetutë ka ardhur në rritje. Pavarësia e gjyqësorit bëhet më e rëndësishme për faktin se ajo përbën një garanci efektive për të drejtat dhe liritë themelore të qytetarit. Zbatimi i parimit të ndarjes së pushteteve do të kërkonte që secili nga pushtetet të kishte monopolet e funksionit përkatës dhe që tri pushtetet të vendoseshin në një shenjë barazie të plotë.

Fjalë kyç: *Pushteti gjyqësor, ndarja e pushteteve, Kushtetuta, Gjykata Kushtetuese, pavarësia e gjyqësorit.*

Hyrje

Që nga fillimi i viteve 90, në epokën e pluralizmit, çështja e pavarësisë së gjykatave u shtrua në një rrafsh të gjerë dhe mbi baza reale. Vetë pranimi i parimit të ndarjes së pushteteve, si një nga strumbullarët e organizimit të shtetit demokratik, do të thoshte heqje dorë nga pranimi i epërsisë së një pushteti ndaj të tjerëve. Kjo, krahas zhdukjes së monopolit politik të një

*Dr. Arjana Llano, Departamenti i Drejtësisë, Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë. E-mail: ariana-llano@live.com.

partie dhe mbikëqyrjes së rreptë të saj edhe mbi gjykata, hapi rrugën për një pavarësi efektive të pushtetit gjyqësor¹. Kushtetuta ka afirmuar një nga parimet më të rëndësishme të pushtetit gjyqësor, ky është parimi i pavarësisë së gjyqësorit. Formulimi kushtetues i pavarësisë së gjyqtarëve do të mbetej thjesht deklarativ nëse nuk do të garantohej nga Kushtetuta. Çështja e pavarësisë së gjyqësorit bëhet më e rëndësishme për faktin se ajo përbën një garanci efektive për të drejtat dhe liritë themelore të qytetarit, të cilat mund të kufizohen edhe nëpërmjet ndërhyrjes së autoriteteve gjyqësore. Ai shoqërohet me një varg të drejtash parime të funksionit gjyqësor, të cilat janë e drejta e çdo subjekti për të pasur një gjykim të drejtë, e drejta për t'u ankuar kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, gjykimi nga një gjyqtar i paanshëm, e drejta e mbrojtjes gjatë gjithë procesit gjyqësor, detyrimi i arsyetimit të vendimeve². Një nga kërkesat aktuale të parimit të ndarjes dhe të balancimit të pushteteve, është nevoja që organet të ushtrojnë funksionet e tyre në fushën e dhënies së drejtësisë. Në bazë të parimit të pavarësisë së gjyqtarëve, askush nuk ka të drejtë të përzihet në punët e gjykatës.³

Parimi i ndarjes së pushteteve

Loku dhe Monteskie dhanë të parët përkufizimin e pushteteve. Funksioni legjislativ që konsiston në formulimin dhe nxjerrjen e ligjeve e që ushtrohet nga parlamenti, të jetë i ndarë nga funksioni ekzekutiv që ka të bëjë me zbatimin e ligjeve dhe që i përket qeverisë, si dhe funksioni gjyqësor që ka për synim të zgjidhë konfliktet e lindura me rastin e zbatimit të ligjeve dhe që u besohen organeve të drejtësisë. Monteskie u nis nga konstatimi i ekzistencës së tre funksioneve shtetërorë, por modeli i sugjeruar nga Monteskie, në vazhden e mendimit të Lokut është pikërisht ndarja e pushteteve në tri elemente për të shmangur përqëndrimin absolut të pushtetit, atë që sot quhet totalitarizëm. Ideja qëndrore e tij ishte se çdo njeri i veshur me pushtet është i prirur ta shpërdorojë, ose të paktën të shkojë deri në kufirin e skajshëm të përdorimit të pushtetit. Monteskie argumentoi se kur pushteti ligjvënës bashkohet me atë ekzekutiv, në të njëjtin person ose në të njëjtin organ, nuk ka liri, sepse mund të shfaqet rreziku që i njëjti monark, ose i njëjti senat të bëjë ligje tiranike për t'i zbatuar po në mënyrë tiranike.

¹ shtetiweb.org/2013/03/12/pavaresia-e-gjyqesorit-strumbullar-i-shtetit-te-se-drejtjes.

² L. Omari, A. Anastasi E Drejta Kushtetuese Tiranë 2017.

³ L. Omari Parime dhe Institucione të së Drejtës Publike, , Tiranë 2004. Fq 107

Pikpamjet e Montesquies gjetën zbatim në fillim të Revolucionit Francez.⁴ Gjykata Kushtetuese, ka interpretuar nenin 145 të Kushtetutës, (“gjyqtarët janë të pavarur dhe i nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve”⁵), ka theksuar se: ...Asnjë pushtet tjetër nuk mund të funksionojë si gjykatë dhe të ushtrojë detyrën e gjyqtarit. Askush nuk mund të ndërhyjë në dhënien e drejtësisë apo në dhënien e vendimit për çështje të caktuara. Sipas Ligjit Themelor, parimi i ndarjes së pushteteve kërkon që organet e shtetit të jenë të specializuara në ushtrimin e njërit prej tre funksioneve: legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, çka e bën të pamundur që i njëjti person të përmbushë kompetenca që burojnë nga funksione të ndryshme, përveç përjashtimeve të parashikuara shprehimisht. Parimi i ndarjes së pushteteve njëkohësisht kërkon që organet e specializuara në ushtrimin e një funksioni të jenë të specializuara. Më së fundmi parimi i ndarjes së pushteteve nënkupton që disa veprime mund t’i kryejnë vetëm titullarët e pushteteve të ndryshme. Kështu vetëm gjyqtari mund të zgjidhë konfliktin që vë përballë dy palë kundërshtare ose të dënojë autorin e një vepre penale. Vetëm organi ligjvënës mund të vendosë norma të qëndrueshme, të domosdoshme për rregullimin e një sektori të veprimtarisë shoqërore. Vetëm organi ekzekutiv mund të zbatojë ligjin në një rast konkret, jashtë çdo konflikti, ose të zhvillojë negociata për një traktat ndërkombëtar ose të emërojë personelin administrativ. Nënshtrimi ndaj të drejtës vlen sot jo vetëm për drejtësinë dhe pushtetin ekzekutiv, por edhe për pushtetin legjislativ. Shteti juridik mbështetet në një varësi rigoroze të organeve ndaj hierarkisë së normave. Nën frymëzimin e normativizimit të Kelzenit, Ligji Themelor sanksionon përparësinë e të drejtës ndërkombëtare ndaj të drejtës së brendëshme.⁶ Parimi i ndarjes së pushteteve është sanksionuar në nenin 7 të Kushtetutës. Sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë, bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor. Gjykata Kushtetuese në vendimin nr.41,2007 vlerëson se, njohja me ligj e të drejtës së ankimit në gjykatat e sistemit gjyqësor për mosshqyrtimin brenda afateve nga organi administrativ nuk përbën cënim të parimit kushtetues të garantimit të pavarësisë së gjykatave. Kontrolli gjyqësor mbi administratën publike bazohet në parimet kushtetuese të balancimit të pushteteve dhe të shtetit të së drejtës dhe është sanksionuar si parim

⁴ L. Omari Parime dhe Institucione të së Drejtës Publike, , Tiranë 2004.

⁶ L. Omari Shteti i së Drejtës ,fq 31Tiranë 2004

procedural edhe në Kodet e Procedurave Administrative e të Kodit të Procedurës Civile, është parashikuar e drejta për të ngritur padi në gjykatë edhe në rastin e mosshqyrtimit të kërkesës nga ana e admiministratës publike brenda afateve ligjore. Në këtë mënyrë ligjvënësi për të garantuar një mbrojtje më të mirë të interesave të kërkuësve për dhënien e statusit të dëshmorit, vendos autoritetin nën kontrollin gjyqësor⁷. Askujt nuk i lejohet të verë në diskutim njohjen dhe vlerën e vendimeve apo të refuzojë zbatimin e tyre, pasi ato kanë marrë formë të prerë⁸. Nga doktrina është ngritur shqetësimi se, dy inspektoriatet që kontrollojnë punën e gjyqtarëve, ai i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe ai i Ministrisë së Drejtësisë, gjatë kryerjes së detyrës së tyre, nuk kufizohen vetëm në mënyrën e performimit nga ana e gjyqtarëve, por shqyrtojnë edhe vendimet gjyqësore, duke u shprehur mbi mënyrën se si gjyqtarët zbatojnë ligjin material dhe atë procedural. Nga statistikat e Këshillit të Lartë Gjyqësor, rezulton se pjesa dërmuese e procedimeve disiplinore dhe e shkarkimit nga detyra, bazohen mbi argumentimin se gjyqtari ka zbatuar gabim ligjin material ose procedural, në dhënien e vendimeve gjyqësore⁹. Po të hedhim një vështrim në sistemin Common Law, mund të thuhet se pavarësia e gjyqtarëve është e siguar nëpërmjet vlerësimit të aftësive profesionale, përparimit kulturor si dhe nga lidhjet social-politike me kolektivitetin¹⁰. Në ndryshim nga ky sistem, sistemet e Evropës janë ndikuar kryesisht nga shembulli burokratik me prejardhje franceze, nga e cila nuk bën përjashtim dhe Kushtetuta shqiptare. A ka mundësi reale Kushtetuta të vendosë e të sigurojë një pushtet gjyqësor efikas e të pavarur? Për të siguar një pushtet gjyqësor të pavarur, një ekuilibër të qëndrueshëm midis të tri pushteteve dhe një paanshmëri reale të instancave gjyqësore, Kushtetuta nuk mjaftohet vetëm me afirmimin formal të pavarësisë së gjyqësorit¹¹. Ajo parashikon në mënyrë të shprehur edhe disa garanci për realizimin dhe aplikimin e kësaj pavarësie. P.sh. vendet e Evropës Lindore që iu nënshtruan reformave institucionale, rendën pas një organi si, Këshilli i Lartë Gjyqësor me shpresën që ky do të zinte vendin e tretë krahas organeve më të larta të legjislativit dhe ekzekutivit, duke

⁷Vendimi I Gjykatës Kushtetuese të RSh nr.41.2007

⁸ Vendim i Gjykatës Kushtetuese të RSh-së, Nr. 11/2004.

⁹ Hoxha A., Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe garantimi i Pavarësisë së pushtetit gjyqësor, kumtesë, botuar në proceedings book, Studime Juridike. Sistemi kushtetues dhe sfidat e tij, Tiranë 2011, f152.

¹⁰ De Vergotini G, vep.cit.fq.282-283.

¹¹ L.omari,A.Anastasi ,E Drejta Kushtetuese, Tiranë 2017,fq354.

balancuar pushtetet. Edhe ndryshimet kushtetuese të vitit 2016 në Shqipëri, kanë krijuar disa garaci të reja për të forcuar pavarësinë e pushtetit gjyqësor. Kështu Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk kryen më hetimin dhe procedimin disiplinor, funksion i cili është ndarë dhe i ka kaluar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Sidoqoftë pavarësisht nga ndryshimet dhe përmirësimet e këtij sistemi, një Këshill i Lartë për gjyqësorin ka rezistuar si një nga garancitë themelore të pushtetit gjyqësor. Ai ka pësuar reformime, por ka ruajtur performancën e tij. P.sh. në ndryshimet kushtetuese të vitit 2016, ky organ ka ndarë kompetencat me institucione të tjera të pavarura kushtetuese, por njëkohësisht është forcuar për sa i përket ushtrimit të kompetencave të qeverisjes së gjyqësorit. Kushtetuta e vitit 1998 u ka siguruar gjyqtarëve një pozitë autonome dhe të pavarur në raport me organet e tjera. Gjyqtarët shpallen të pavarur dhe i nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve. (neni 145¹²). Në këtë mënyrë është bërë i mundur eliminimi i sistemit hierarkik tek gjyqtarët, pasi ata dallohen midis tyre vetëm nga ndryshimi i funksioneve që kryejnë dhe nuk kanë asnjë varësi nga njëri-tjetri. Detyrimi i gjykatave për të arsyetuar vendimet që japin, përfaqëson një nga parimet kryesore të procesit të drejtësisë. Ky parim ka rëndësi kushtetuese dhe sanksionohet drejtpërdrejt në Kushtetutë¹³. Në paragrafin e parë të nenit 142 parashikohet që vendimet duhet të jenë të arsyetuara¹⁴. Vetëm në saj të vendimeve të arsyetuara palët e interesuara kanë mundësi të njohin shkallën e arsyetimit, të përmbushur nga gjyqtari dhe mund të kundërshtojnë vendimet e gjykatës me kundër argumentet e tyre. Detyrimi i gjykatave për të arsyetuar vendimet gjyqësore përbën një garanci të drejtpërdrejtë për realizimin e të drejtave e lirive kushtetuese të qytetarëve. Ai lidhet me parimin e rishikimit të vendimeve të gjykatave të shkallëve më të ulta nga gjykatat e shkallëve më të larta, parim, i cili e bën efektiv të drejtën e ankimit¹⁵. Gjykata duhet të jetë një organ me specializim juridik, në gjendje të bëjë interpretimin dhe zbatimin e drejtë të normave juridike¹⁶. Gjykata Kushtetuese ka theksuar ndër të tjera që vendimi gjyqësor në tërësinë e tij duhet të jetë në një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre:

¹² Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë neni 145

¹³ Po aty, neni 142

¹⁴ Interpretuar me VGJK nr.6\2006 fq 215.

¹⁵ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë neni 43 i ndryshuar me amendamentin 2016, interpretuar me VGJK nr.14/2005,9/2003

¹⁶ L. Omari, Parime dhe Institucione të së Drejtës Publike, Tiranë 2004 fq.112

...Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat dhe ligjet e mendimit të drejtë.¹⁷ Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie apo kontradikcion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshëm për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik... Një arsyetim i saktë i vendimit është një mënyrë e sigurt që gjeneron legjitimitet në sytë e të interesuarve. Ky efekt do të jetë akoma më i madh nëse palët do ta përjetojnë këtë vendim si pasojë normale e një procesi të rregullt në të gjithë komponentët e tij...Vendimi që përmban ose lejon kontradiktën logjike, çënon rëndë dhënien e drejtësisë. Ai nuk mund të jetë i kuptueshëm dhe bindës dhe për pasojë nuk mund të zbatohet në praktikë.¹⁸ Një nga të drejtat themelore kushtetuese, e drejta e mbrojtjes në procesin gjyqësor lidhet drejtpërdrejt me zbatimin e parimit që detyron gjykatat të japin vendime të arsyetuara. Vetë palët në proces ose nëpërmjet avokatëve të tyre, duhet të njohin argumente dhe logjikën e gjyqarit në të gjitha vendimet që ai merr gjatë gjykimit, me qëllim që edhe ata të parashtrojnë argumentat ose kundërgargumentat e tyre me mjetet ligjore që disponojnë. Praktika gjyqësore e ka bërë të qartë se gjykata është e detyruar që në vendimet e saj t'i përgjigjet me arsyetim të gjitha kërkesave që shtron pala në kërkesë-padi, në kërkesën ankimore apo në rekursin përkatës. Ajo nuk mund ti kalojë në heshtje këto kërkesa, madje dhe në rastet kur e rrëzon atë . Në këtë mënyrë ka arsyetuar Gjykata Kushtetuese në një sërë vendimesh të saj¹⁹. Në këtë mënyrë, detyrimi i gjykatës për arsyetimin e vendimeve gjyqësore, shihet i lidhur ngushtë me ushtrimin e të drejtës kushtetuese për një proces të rregullt gjyqësor. Autonomia dhe pavarësia e gjyqësorit janë siguruar edhe me një varg normash kushtetuese që sanksionojnë statusin e gjyqarit. Kuptimi i tij mund të përmblihet në çështjen e parimit të parevokueshmërisë, si

¹⁷Citohet edhe: Engel Ch., *Inconsistency in the Laë: In Search of a Balanced Norm*, MPI Collective Goods Preprint No. 2004/16.

¹⁸ XH.Zaganjori, A.Anastasi E.Methasani Shteti I së Drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë Shtëpia botuese Adelprint 2011

¹⁹ Për këto arsye ka konsideruar antikushtetues vendimin nr.250 dt 25.11.1998 të kolegjit penal të Gjykatës së Lartë .Duke renditur shkaqet që e shpunë në marrjen e vendimit të tillë midis të tjerash.

dhe imunitetin e gjyqtarit. Prirja kushtetuese për të sanksionuar aspektet më të rëndësishme të statusit të gjyqtarit në kushtetutë ka ardhur në rritje. Kushtetuta parashikon aspektet më të rëndësishme që e garantojnë këtë status, gjë që sanksionohet jo vetëm për gjyqtarët e gjykatës së lartë, por edhe për gjyqtarët e të gjitha shkallëve.

Parimi i parevokueshmërisë së gjyqtarëve

Kushtetuta garanton palëvizshmërinë e gjyqtarit nga detyra kur përcakton shprehimisht rastet e largimit të tij nga detyra, si dhe rastet kur paga dhe përfitimet e tjera të gjyqtarit nuk mund të ndryshojnë. Përcaktimi i qartë i organeve të emërtesës së gjyqtarëve, i afateve të qëndrimit në detyrë, i rasteve dhe procedurave të lëvizjes së tyre nga detyra përmes transferimeve apo shkarkimeve, si dhe i garancive për ankimin e tyre ndaj një vendimi që ka prekur kohën e qëndrimit të tyre në detyrë parandalon shkeljen e këtij parimi. Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë dhe gjyqtarët e tjerë nuk mund të lëvizin nga detyra, të shkarkohen e transferohen me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, veç në rastet dhe procedurat që parshikon ligji. Për gjyqtarët e Gjykatës së Lartë parashikohen garanci më të hollësishme nga Kushtetuta. Ata mund të shkarkohen nga detyra vetëm sipas procedurës dhe rasteve të parashikuara nga Kushtetuta. Kushtetuta garanton dhe trajtimin finaciari të gjyqtarëve, pasi paga dhe përfitimet e tyre nuk mund të ulen me përjashtim të rasteve të përcaktuara nga amendamenti kushtetues. Kjo e bën më të sigurt qëndrimin në detyrë të gjyqtarëve, të cilët nuk mund të pësojnë presione për t'u larguar nga detyra.

Kushtetuta e shpall qënien gjyqtar të papajtueshmëm me asnjë veprimtari tjetër politike ose shtetërore, si dhe çdo veprimtari profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës. Kjo është parë si një garanci për të siguruar paanshmërinë dhe asnjësinë e gjyqtarëve. Amendamenti kushtetues i vitit 2016, në ndryshim nga teksti i origjinës së Kushtetutës ka përcaktuar shprehimisht edhe rastet që bëjnë përjashtim nga ky rregull dhe që nga përvoja e zbatimit të kushtetutës u vlerësuan si të nevojshme për t'u parashikuar shprehimisht në Kushtetutë, me qëllim që mos të lihen shkas për abuzime. Pas ndryshimeve të vitit 2012 gjyqtarët gëzonin një imunitet të kufizuar nga procesi penal²⁰. Ndryshimet e reja e hoqën tërësisht. Kjo u hapi rrugë hetimeve dhe kontrolleve ndaj gjyqtarit, si dhe masës së

²⁰Ligji nr.88\2012 dt 18.9.2012

arrestit, pa pasur nevojë për ndonjë autorizim paraprak të organeve kompetente²¹. Sipas amendamentit të ri gjyqtari është përgjegjës në rastet e dhënies qëllimisht të një vendimi si pasojë e një interesi vetiak ose keqbesimi. Gjyqtari mund të procedohet penalisht kur vendimi i paligjshëm është dhënë si rezultat i kryerjes së një krimi të parashikuar nga Kodi Penal, p.sh. korrupsioni pasiv ose për interesa personale duke shkelur parimin e paanshmërisë që lidhet gjithashtu me rastet e veprave penale të shpërdorimit të detyrës. Ndryshimet kushtetuese kanë përcaktuar qartë dhe rastet e përgjegjësisë disiplinore të gjithë gjyqtarëve dhe ata të gjykatës së lartë. Në të gjitha rastet gjyqtari shkarkohet dhe pezullohet nga detyra me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, vendim i cili mund të ankimohet në Gjykatën Kushtetuese. Sidoqoftë në Kushtetutë është vendosur një mekanizëm më efikas për procedimin disiplinor të gjyqtarëve në rastin e shkeljeve të rënda profesionale dhe etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e tij. Për herë të parë, Amendamenti kushtetues 2016, solli një ndarje të funksionit kushtetues të hetimit dhe procedimit disiplinor, nga gjykimi dhe vendosja e masave disiplinore.

Zbatimi i parimit të ndarjes së pushteteve do të kërkonte që secili pushtet të kishte monopolet e funksionit përkatës dhe që tri pushtetet të vendoseshin në një shenjë barazie të plotë, çka në një shkallë më të madhe është realizuar në sistemin presidencial që vepron në SHBA. Në shtetet e tjera kjo pengohet si nga traditat ashtu dhe nga nevoja e bashkërendimit të veprimtarisë të këtyre pushteteve. Ndarja përfaqëson një ekuilibër të pushteteve dhe ideja është ndalimi i nënshtrimit të një pushteti ndaj dy të tjerëve. Gjithashtu duhet përcaktuar vendi që ka pushteti gjyqësor dhe në çfarë masë ai është i pavarur nga pushteti legjislativ dhe ai ekzekutiv. Një aksiomë e pranuar në të gjitha vendet në kontinentin evropian është se, pushteti gjyqësor nuk mund të përzihet në veprimtarinë e legjislativit, sepse gjykatat janë të detyruara të nxjerrin vendime për çështje konkrete dhe jo për probleme të përgjithshme. Kësisoj, si rregull gjyqtari nuk është i lidhur as nga precedentët gjyqësorë, siç ndodh në Britaninë e Madhe dhe në SHBA. Por dhe pushteti ligjvënës nuk duhet të përzihet me pushtetin gjyqësor, qoftë drejtpërsëdrejti duke gjykuar një proces, qoftë tërthorazi. Ideja e mosndërhyrjes së ligjvënësit në konfliktet gjyqësore ka hasur në pengesa kohët e shkuara, në Francë është dashur gjysmë shekulli që kjo ide të sanksionohej, Franca është dalluar për ndërhyrjet e ligjvënësit në punët

²¹L. omari, A. Anastasi, E Drejta Kushtetuese Tiranë 2017, fq 358

gjqësore ²². Dallimi midis pushtetit ligjvënës dhe atij gjyqësor, si dhe ndarja e prerë e kompetencave të tyre, sjell si rrjedhojë dhe ndryshimin midis natyrës së aktit legjislativ dhe atij të vendimit gjyqësor. Sipas Dygisë, akti gjyqësor dallohet nga ai legjislativ për shkak të përmbajtjes .

Konkluzionet

Çështja e pavarësisë së gjyqësorit bëhet më e rëndësishme për faktin se ajo përbën një garanci efektive për të drejtat dhe liritë themelore të qytetarit, të cilat mund të kufizohen edhe nëpërmjet ndërhyrjes së autoriteteve gjyqësore. Ai shoqërohet me një varg të drejtash parime të funksionit gjyqësor, të cilat janë e drejta e çdo subjekti për të pasur një gjykim të drejtë, e drejta për t'u ankuar kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë gjykimi nga një gjyqtar i paanshëm, e drejta e mbrojtjes gjatë gjithë procesit gjyqësor, detyrimi i arsyetimit të vendimeve.

Idenë e parimit të ndarjes së pushteteve e ka hedhur Loku dhe Monteskie. Sipas tyre, funksioni legjislativ që konsiston në formulimin dhe nxjerrjen e ligjeve, e që ushtrohet nga parlamenti, funksioni ekzekutiv që ka të bëjë me zbatimin e ligjeve dhe që i përket qeverisë si dhe funksioni gjyqësor që ka për synim të zgjidhë konfliktet e lindura me rastin e zbatimit të ligjeve dhe që u besohen organeve të drejtësisë.

Zbatimi i parimit të ndarjes së pushteteve, do të kërkonte që secili pushtet të kishte monopole të funksionit përkatës dhe që tri pushtetet të vendoseshin në një shenjë barazie të plotë.

Pavarësia e pushtetit gjyqësor është shumë e rëndësishme dhe sipas saj, gjyqtarët i nënështrohen vetëm kushtetutës dhe ligjeve. Autonomia dhe pavarësia e gjyqësorit janë siguruar edhe me një varg normash kushtetuese që sanksionojnë statusin e gjyqtarit. Kuptimi i tij mund të përmblihet në çështjen e parimit të parevokueshmërisë, si dhe imunitetin e gjyqtarit. Prirja kushtetuese për të sanksionuar aspektet më të rëndësishme të statusit të gjyqtarit në kushtetutë ka ardhur në rritje. Kushtetuta e shpall qënien gjyqtar të papajtueshëm me asnjë veprimtari tjetër politike ose shtetërore, si dhe çdo veprimtari profesionale që ushtrohet kundërt pagesës .Kjo është parë si një garanci për të siguruar paanshmërinë dhe asnjanshinë e gjyqtarëve

²² L.Omari Shtei I së Drejtës ,fq 123Tiranë 2004

Duhet përcaktuar vendi që ka pushteti gjyqësor dhe në ç'masë ai është i pavarur nga pushteti legjislativ dhe ai ekzekutiv. Një aksiomë e pranuar në të gjitha vendet në kontinentin evropian është se pushteti gjyqësor nuk mund të përzihet në veprimtarinë e legjislavit, sepse gjykatat janë të detyruara të nxjerrin vendime për çështje konkrete dhe jo për probleme të përgjithshme. Kësisoj, si rregull gjyqtari nuk është i lidhur as nga precedentët gjyqësorë, siç ndodh në Britaninë e Madhe.

Bibliografia

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ,Ligji Nr.8417 datë 21.10.1998 ndryshuar me ligjin Nr.9675 , datë 13.1.2007, ndryshuar me Ligjin Nr.9904, datë 21.4.2008, ndryshuar me Ligjin 88|2012 datë 18.9.2012, ndryshuar me Ligjin 137\2015 ,datë 17.12.2015, ndryshuar me Ligjin nr.76/2016, datë 22.7.2016)

L.omari,A.Anastasi E Drejta Kushtetuese Tiranë 2017.

L. Omari, Parime dhe Institucione të së Drejtës Publike, , Tiranë 2004.

L.Omari Shteti I së Drejtës ,Tiranë 2004

Hoxha A., Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe garantimi i Pavarësisë së pushtetit gjyqësor, kumtesë, botuar në proceedings book, Studime Juridike. Sistemi kushtetues dhe sfidat e tij, Tiranë 2011

Shteti I së Drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë XH.Zaganjori, A.Anastasi E.Methasani Shtëpia botuese Adelprint 2011

Vendimi I Gjykatës Kushtetuese të RSh nr.41.2007

Vendim i Gjykatës Kushtetuese të RSh-së, Nr. 11/2004.

Vendimin nr.250 dt 25.11.1998 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë shtetiweb.org/2013/03/12/pavaresia-e-gjyqesorit-strumbullar-i-shtetit-te-se-drejtjes/

Deklaratë mbi origjinalitetin e punimit.

Deklaroj se punimi është origjinal dhe nuk ka qenë i botuar më parë dhe nuk është në proces botimi diku tjetër.

MBROJTJA KUNDËR DISKRIMINIMIT NË EVROPË

Dr.Aulona Haxhiraj*

Abstrakt

Parimi sipas së cilës të gjithë qeniet njerëzore kanë të drejta të barabarta dhe duhet të trajtohen njësoj, paraqet bazën dhe kuptimin e të gjithë të drejtave të njeriut që rrjedhin nga dinjiteti i barazisë njerëzore kundrejt çdo individi. Kjo e drejtë natyrore e barazisë, qoftë në të shkuarën ose tani asnjëherë nuk u është ofruar qenieve njerëzore në mënyrë të plotë.

Parimi i mos diskriminimit është një ndër parimet kryesore në çdo sistem të mbrojtjes të të drejtave të njeriut.

Ligji Evropian për mbrojtjen kundër diskriminimit i përbërë nga direktivat e BE-së për mbrojtjen kundër diskriminimit, neni 14 i KEDNJ-së dhe Protokolli Nr. 12 (1) të KEDNJ-së e ndalojnë diskriminimin për një sërë shkaqesh. Mbrojtja kundër diskriminimit ka qenë një ndër çështjet kryesore edhe në jurisprudencën e GJEDNJ-së dhe GJED-së. Kontributi i dhënë prej tyre ka bërë të mundur njohjen më të mirë të parimeve të përgjithshme të cilat janë të rëndësishme për një ekzekutim korrekt në nivel kombëtar dhe një pjesë të normativave Evropiane të lidhura me të drejtat njerëzore si normat mbi mbrojtjen kundër diskriminimit.

Përkufizimi i diskriminimit jepet për herë të parë në Konventën Ndërkombëtare mbi Eliminimin e çdo lloj forme të Diskriminimit Racial sipas së cilës me diskriminim kuptojmë “çdo lloj dallimi, përjashtimi, kufizim ose preferencë që bazohet mbi racë, ngjyrë prejardhje ose origjinën kombëtare etnike që ka për qëllim eliminimin apo të komprometojë njohjen, gëzimin apo ushtrimin, në kushte të barabarta, të të drejtave e lirive themelore të njeriut në fusha politike, ekonomike, shoqërore, e kulturore ose në çdo fushë tjetër të jetës publike”.

Fjalë kyç: *barazi; mos diskriminim; gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut; Gjykata Evropiane e Drejtësisë; direktivë, të drejta themelore.*

* Dr.Aulona Haxhiraj, Universiteti Ismail Qemali, Vlorë.
aulonahaxhiraj@yahoo.com

Diskriminimi dhe format e tij.

Aktet ndërkombëtare dhe kombëtare për mbrojtjen e diskriminimit kanë si qëllim që të garantojë të gjithë individët që të kenë një akses të barabartë në të drejtat dhe detyrimet e tyre. Parimi i mos diskriminimit përcakton se çdo individ duhet të ketë trajtim të njëjtë me çdo individ tjetër në të njëjtat kushte. Legjislacioni për mbrojtjen nga diskriminimit ndalon situatat në të cilat personat ose grupet e personave në të njëjtin situatë marrin një trajtim ndryshe si dhe situatat në të cilat personat ose grupet e personave në situata të ndryshme marrin të njëjtin trajtim”¹.

Diskriminimi shfaqet në dy forma: diskriminimi i drejtpërdrejtë dhe diskriminimi indirekt.

Forma e parë, diskriminimi i drejtpërdrejtë apo direkt është kur për shkak të racës së tij ose të origjinës etnike një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme nga sa mund të jetë, ka qenë ose do të jetë trajtuar në një tjetër situatë të ngjashme². Diskriminimi i drejtpërdrejt bazohet mbi diferencën në trajtimin e një personi, që shoqërohet me një trajtim jo të favorshëm.

Që të kemi diskriminim të drejtpërdrejtë është e nevojshme një lidhje ndërmjet trajtimit më pak të favorshëm dhe objektit të ndalimit të diskriminimit. Kur konsiderohet që është kryer një diskriminim i drejtpërdrejt analizohet nëse trajtimi më pak favorizues ka të bëjë me motivin që nuk është i ndarë nga faktori i veçantë që ka të bëjë me ankimin³.

Si e drejta e BE-së ashtu edhe ajo e KEDNJ-së pranojnë që diskriminimi mund të dali jo vetëm nga trajtimi i ndryshëm i personave që gjenden në një situatë të njëjtë por edhe një trajtim i njëjtë i rezervuar për personat që gjenden në situata të ndryshme. Rasti i mësipërm ka të bëjë me diskriminimin “indirekt”. Kjo formë diskriminimi ka lidhje me efektet që

¹Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut Hoogendijk kundër Vendeve të Ulta (Pranueshmëria), çështja nr. 58641/00, datë 06 janar 2005.

² Diskriminimi i drejtpërdrejtë është i përkufizuar në mënyrë të njëjtë si tek KEDNJ-ja dhe tek Karta e të Drejtave Themelore të BE-së. Po i njëjti përkufizim është dhënë edhe te Neni 2(2) i direktivës së BE-së mbi Barazinë Raciale si dhe Direktiva mbi Barazinë e Trajtimit në Fushën e Punësimit. Gjithashtu, te Direktiva mbi Barazinë Gjinore (ndryshimi, neni 2(1) (a); Direktiva mbi Barazinë Gjinore në bazë të aksesit për të Mirat materiale dhe për Shërbimet, neni 2(a).

³Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, çështja James kundër Këshilit Bashkiak të Eastleigh, Dhoma e Lordëve e Mbretërisë së Bashkuar seanca e 6-të, datë 14 qershor 1990.

prodhon, të cilat janë preceptuar në mënyrë të ndryshme nga personat me karakteristika të ndryshme⁴.

Elementët që e përbëjnë një diskriminim indirekt janë: Një rregull, një kriter ose një praktikë neutrale, që godet në një mënyrë domethënëse më të disfavorshme një grup të përcaktuar nga një “shkak i mbrojtur” të ndalimit të diskriminimit dhe respektimi i personave të tjerë në një situatë të ngjashme⁵.

Diskriminimi indirekt dallohet nga diskriminimi direkt për sa i përket spostimit të vëmendjes të trajtimit në bazë të efekteve të ndryshme. Në pamje të parë rezulton që një grup i mbrojtur goditet në mënyrë jo të njëtrajtëshme negativisht në lidhje me grupet e tjera në situata të njëjta GJED-ja dhe GJEDNJ-ja kërkojnë elementë dhe veprime për të treguar që një pjesë e madhe e veçant e personave të goditur negativisht zëvendësohet nga ky “grup i mbrojtur”⁶.

Subjektet që mbrohen nga parimi i mosdiskriminimit dhe hapsira e aplikimit.

Parashikimi i KEDNJ-së siguron mbrojtjen e çdo personi që i nënshtrohet juridiksionit të shteteve anëtare, pavarësisht nga fakti nëse është ose jo qytetar, brenda apo jashtë territorit kombëtar ku shtrën kontrollin efektiv shteti⁷. Ndërsa mbrojtja e parashikuar nga legjislacioni i Bashkimit Evropian në Kartën e Lirive dhe të Drejtave Themelore dhe Direktivat e BE-së ka një fushëveprimin më të kufizuar.

Parimi i ndalimit të diskriminimit është një parim i cili është parashikuar në legjislacionin komunitar. Fillimisht ndalimi i diskriminimit është përfshirë në të drejtën evropiane si ndalim diskriminimi mbi bazën e prirjeve seksuale, për të mbrojtur personat që përfshihen në komunitetin LGBT. Të gjitha shtetet anëtare të BE-së janë të detyruara që ta adoptojnë

⁴ Direktiva mbi Barazinë e Trajtimit në Fushën e Punësimit, neni 2(2), letra b); Direktiva mbi Barazinë Gjinore (ndryshim), neni 2(2), (b); Direktiva mbi Barazinë Gjinore në fushën e gëzimit së të Mirave materiale dhe Shërbimeve, neni 2, (b).

⁵ Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, çështja D.H kundër Republikës Çeke, datë 13 nëntor 2007. Paragrafi 184.

⁶ Gjykata Evropiane e Drejtësisë, çështja Nimz kundër Qytetit të Lirë dhe Hanseatik të Hamburgut. (Freie Und Hansestadt Hamburg), datë 7 shkurt 1991, vendimi me nr.aplikimi C-184/89.

⁷ Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, çështja GJEDNJ, Loizidou kundër Turqisë, me nr. aplikimi 15318/89, datë 18 dhjetor 1996.

këtë parim dhe të sanksionojnë edhe në legjislacionet kombëtare ndalimin e diskriminimit mbi bazën e prirjeve seksuale.

Ditët e sotme ky parim është përforcuar nga parashikimi që i ka bërë Karta në nenin 21⁸. E theksoj faktin se është forcuar si parim jo vetëm për detyrueshmërinë që ka Karta si pasojë e parashikimeve që ka bërë Traktati i Lisbonës, por edhe për faktin se ndalimi i diskriminimit nuk është më vetëm mbi bazën e orientimit seksual⁹. Aty listohen një sërë “fushash”, cënimi i të cilave është shkelje e parimit dhe si pasojë diskriminim i personit apo personave që i është/janë cënuar një prej këtyre “fushave”.

Neni 21.1 i Kartës përbën një përparim të rëndësishëm në angazhimet e shtuara të BE-së lidhur me problematikën e të drejtave të njeriut. Karta ndalon çdo diskriminim të bazuar mbi çfarëdolloj arsyes si orientimi seksual.

Ndalimi i diskriminimit të bazuar mbi kombësinë sipas BE-së aplikohet vetëm në kontekstin e qarkullimit të lirë të personave dhe është i njohur nga të gjithë qytetarët e Shteteve Anëtare të BE-së. Përveç kësaj direktivat kundër diskriminimit në shumë raste përjashtojnë nga fushëveprimi i tyre qytetarët e vendeve të treta. Një qytetar i vendit të tretë është një qytetar i një shteti që nuk bën pjesë në BE. Nga direktivat

⁸ Në nenin 21 sanksionohet se: Ndalohet çdo lloj diskriminimi për shkaqe të tilla siç janë gjinia, raca, ngjyra, origjina etnike apo sociale, tiparet gjenetike, gjuha, feja apo besimi, mendimet politike apo të llojeve të tjera, përkatësia në një pakicë kombëtare, prona, lindja, aftësia e kufizuar, mosha apo orientimi seksual. Brenda fushës së zbatimit të Traktateve dhe pa cënuar asnjë prej dispozitave të caktuara të tyre, ndalohet çdo diskriminim për shkak të shtetësisë.

⁹ “Orientimi seksual” është një term që shpesh përdoret për të përshkruar tërheqjen romantike, emocionale apo seksuale të një personi ndaj një personi tjetër. Dikush që tërhiqet nga dikush tjetër i të njëjtit seks ka orientim homoseksual dhe mund të quhet ‘gay’ (femra dhe meshkuj), ose lezbike. Individët që tërhiqen nga persona të seksit të kundërt kanë orientim heteroseksual. Orientimi seksual është një proces që thellohet vazhdimisht me kalimin e kohës dhe individët që tërhiqen si nga meshkujt ashtu edhe nga femrat quhen biseksualë. Orientimi seksual është i ndryshëm nga identiteti gjinor, i cili i referohet ndjesive të brendshme që tregojnë se dikush është mashkull apo femër. Orientimi seksual është një koncept relativisht i ri. Në fakt, edhe pse sjelljet brenda të njëjtit seks kanë ekzistuar gjithmonë, ideja e identitetit homoseksual ose e një personi homoseksual është vetëm 100 vjeçare.

Koncepti i orientimit seksual ka të bëjë me shumë më tepër se sa thjesht sjellje seksuale. Përfshin si ndjenja ashtu edhe identitet. Disa individë mund ta identifikojnë veten e tyre si “gay”, lezbike ose biseksualë edhe pa u përfshirë në ndonjë aktivitet seksual. Disa njerëz besojnë se orientimi seksual është i lindur dhe i përcaktuar; mirëpo orientimi seksual zhvillohet përgjatë jetës së dikujt.

kundër diskriminimit përjashtojnë veçanërisht nga fusha e veprimit të tyre diskriminimin e bazuar mbi kombësinë, që është e disiplinuar nga Direktiva mbi Lëvizjen e Lirë¹⁰.

Direktiva mbi Barazinë Raciale edhe Direktiva mbi Barazinë e Punësimit konfirmojnë të dyja që nuk ekziston një e drejtë mbi barazinë e trajtimit për qytetarët e vendeve të treta në lidhje me kushtet e futjes dhe qëndrimit. Direktiva mbi Barazinë në Punësimit konfirmon veç kësaj që nuk krijon një të drejtë për barazinë e trajtimit për qytetarët e vendeve të treta në lidhje me aksesin për punësim ose për kushtet e punës.

Direktiva mbi Barazinë Raciale përjashton veçanërisht çdo lloj trajtimi që vjen nga kushtet juridike të qytetarëve të vendeve të treta. Këto dispozita gjithsesi nuk duket sikur lejojnë Shtetet Anëtare të përjashtojnë totalisht qytetarët e vendeve të treta nga mbrojtja, për sa kohë kanë në konsideratë të drejta që janë të mbrojtura nga direktiva të qytetarëve të vendeve të treta, por jo përsa i përket aksesit në punë. Direktiva mbi Barazinë Gjimore dhe Direktiva e trajtimit të Barabartë Gjimore për aksesin në të Mirat dhe Shërbimet nuk përjashtojnë Qytetarët e Vendeve të Treta nga mbrojtja.

Gjithsesi, Qytetarët e vendeve jo anëtare gëzojnë të drejtën e trajtimit të barabartë në shtetet e parashikuara nga direktiva kundër diskriminimit. Ata marrin statusin për të qëndruar për një periudhë të gjatë në kuptimin e direktivës¹¹ e cila parshikon ndër kërkesat e tjera një periudhë qëndrimi prej 5 vjetësh.

Përveç kësaj në kushte të caktuara Direktiva mbi Ribashkimin Familjar u lejon Qytetarëve të Vendeve të Treta që të qëndrojnë ligjërisht në një shtet anëtar dhe të mund të bashkohen me familjarët e tyre¹². Natyrisht këto norma të legjislacionit të BE-së nuk i ndalojnë Shtetet Anëtare të ndërmarrin dispozita më të favorshme në kuadrin e të drejtës kombëtare. Protokollin nr.12 ndalon diskriminimin në “gëzimin e çdo të drejte të parashikuar nga ligji” pra ka një fushë veprimi më të gjerë të nenit 14 që ka të bëjë vetëm me të drejtat të njohura nga KEDNJ-ja. Komentet mbi

¹⁰ Direktiva 2004/38/CE relative me të drejtën e qytetarëve të Bashkimit dhe të familjarëve të tyre për të lëvizur dhe për të qëndruar lirisht në territorin e Shteteve Anëtare, GU L 158 i dt 30.04.2004, fq.77.

¹¹ Direktiva 2003/109/CE e lidhur me statusin e qytetarëve të vendeve të treta nëse janë rezident për një kohë të gjatë GU L 16 i datës 23.01.2004, fq 44.

¹² Direktiva 2003/86/CE e lidhur me të drejtën e ribashkimit familjar, GU L 251 i datës 03.10.2003, fq.12.

dispozitat e protokollit që ndodhen në relacionin eksplicit të Këshillit Evropian tregojnë që dispozita ka të bëjë me diskriminimin:

- i. “ Në gëzimin e çdo të drejte specifike të njohur nga një person nga e drejta kombëtare;
- ii. Në gëzimin e çdo të drejte të dal nga një detyrim i qartë i një autoriteti publik në mbështetje të së drejtës kombëtare, pra në rastin në të cilin, në kuptimin e të drejtës kombëtare ky autoritet është i detyruar të sillet në një mënyrë të caktuar;
- iii. Nga ana e një autoriteti publik në ushtrimin e forcës diskrete (psh, lidhja ndërmjet subvencioneve të caktuara);
- iv. Përmes veprimeve ose mosveprimeve nga ana e një autoriteti publik (psh, sjellja e funksionarëve të përgjegjshëm në aplikimin e ligjit kur ndërhyr për të pezulluar një protestë)”¹³.

Protokolli edhe pse synon në ruajtjen e simboleve kundër diskriminimit të autoriteteve publike, ka të bëjë dhe këtu raporti ndërmjet privatit që si norëm futet në fushën e normativave kombëtare, “psh, refuzimi arbitër në aksesin e punës, në aksesin në restorante ose në shërbime që privati mund të vëri në dispozicion të publikut, si kujdesi mjekësor ose furnizimi me ujë dhe energji elektrike”¹⁴. Në përgjithësi, protokoli nr.12 ndalon diskriminimin jashtë kontekstit të pastër personal, në rastet në të cilat një person zhvillon një funksion që e lejojnë të marrin vendime në bazë të mënyrës që i ofrohen të mira dhe shërbimet në dispozicion të publikut.

Ndalimi i diskriminimit ka si funksion heqjen nga rendi juridik i akteve të autonomisë private që janë rezultat i një procesi me të meta në formimin e vullnetit dhe me paragjykitime kulturore dhe ideologjike¹⁵.

Në fushën komunitare është konsoliduar përmes Gjykatës së Drejtësisë dhe Kartës parimi i mosdiskriminimit si një implikim i menjëhershëm i parimit të barazisë. Nën profilin e trajtimit të barabartë plotësohen kushtet për të kërkuar nga subjektet shtetërore që ta ushtrojnë pushtetin e tyre në mënyrë të barabartë¹⁶.

¹³ Protokoli nr.12 mbi konventën mbi Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore (STE n.177) relacioni eksplicit, paragrafi 22:
<http://conventions.coe.int/Treaty/en/Reports/Html/177.htm> .

¹⁴ Po aty, paragrafi 28.

¹⁵ Delia la Roca, Eguaglianza e libertà contrattuale nel diritto europeo. Le discriminazioni nei rapporti di consumo. Faqe 120.

¹⁶ François Snyder, The Europeanisation of Law: The Legal Effects of European Integration (Studies in European Law and Integration). Faqe 18.

Shqyrtimi i çështjeve kundër diskriminimit në GJED dhe GJEDNJ.

Zakonisht, gjatë gjykimit në GJED-në referenca që i bëhet neneve koresponduese të Kartë me KEDNJ-në shoqërohet me çështjen përkatëse që është gjykuar në GJEDNJ. Kjo bëhet në mënyrë që të përcaktohet dhe të sqarohet nëse ligji kombëtar vepron në përputhje me të drejtën për mos diskriminim.

Gjatë kohës GJED-ja i është referuar në disa raste GJEDNJ-së. GJED-ja nuk referon te GJEDNJ-ja për çështje analoge, duke përdorur analogjinë, por ajo “frymëzohet” nga GJEDNJ-ja për interpretimin e rasteve që shqyrton. Në mënyrë të veçantë GJED-ja thekson ngjashmëritë në rastet që ajo shqyrton me rastin që referon ta GJEDNJ-ja.

Nëse do të shohim ndryshim midis dy sistemeve pa dyshim që dallimi i parë është ai në lidhje me subjektet dhe mënyrën që ka qytetari për t’iu drejtuar për shkelje të parimit të mosdiskriminimit. Si e drejtë e parashikuar në KEDNJ individ i ka të drejtën që ti drejtohet drejtpërdrejtë GJEDNJ-së. Ndërsa në strukturën e BE-së, në rast se kemi shkelje të parimit, pranë Gjykatës së Drejtësisë çështjen mund të paraqesin vetëm gjyqtarët kombëtar që gjykojnë në gjykatat e brendshme të vendeve anëtare dhe jo qytetarët. Në rast se ka legjislacioni i një prej vendeve anëtare është në kundërshtim me atë të BE-së, është GJED-ja, sipas Traktatit të Lisbonës organi kompetent për zgjidhjen e konfliktit. Kjo ndikon në dialogun midis gjykatave kombëtare dhe atyre komunitare duke zbutur murin midis juridiksioneve dhe duke ndihmuar në përmirësimin e legjislacionit.

Në këtë pikë gjyqtarët e të dy sistemeve do të mund të rindërtojnë më mirë dialogun e nevojshëm ndërmjet gjykatave dhe qarkullimin e jurisprudencës¹⁷, duke ofruar një nivel më të lartë mbrojtjeje të qytetarëve kundër diskriminimit. Raporti midis gjyqtarëve komunitar dhe atyre kombëtar, në sistemin e BE-së, është një raport i ndarjes së kompetencave, ndërsa në sistemin e ndërtuar nga KEDNJ-ja nuk është kjo ndarje.

GJED-ja ka si detyrë interpretimin dhe aplikimin uniform të së drejtës komunitare në vendet anëtare të BE-së. Ndërsa GJEDNJ-ja ka si detyrë mbikëqyrjen e shteteve, që kanë ratifikuar KEDNJ-në, për zbatimin e

¹⁷ Alfonso Celotto, Una nuova ottica dei “controlimiti” nel Trattato costituzionale europeo? Marrë në stin e internetit www.forumcostituzionale.it.

detyrimeve në nivel ndërkombëtar¹⁸. Kjo është një nga aspektet më problematike të sistemit, i cili kufizon efektivitetin e vendimeve të Gjykatës së të Drejtave të Njeriut edhe në ato juridiksione ku KEDNJ-ja zë një vend të rëndësishëm në sistemin e brendshëm juridik¹⁹. KEDNJ-ja përmban një listë të drejtash.

Sa herë që një çështje diskriminimi ka lidhje me një nga fushat që mbulon KEDNJ-ja, GJEDNJ-ja i merr parasysh për shqyrtim ankesat për shkeljen e Nenit 14²⁰. Ky është një ndryshim shumë i rëndësishëm mes ligjit Evropian dhe GJEDNJ-së, meqenëse GJEDNJ-ja siguron mbrojtje nga diskriminimi edhe për disa çështje që nuk parashikohen nga ligjet e BE-së. Edhe pse Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian detyron BE-në të mos ndërhyjë në të drejtat e njeriut gjatë vendimeve dhe masave që vendet anëtare të BE-së të aplikojnë në legjislacionin e tyre (përfshirë edhe ndalimet për shkak të diskriminimit), ajo aplikohet në vendet anëtare vetëm në rastet kur ato aplikojnë ligjin e BE-së. Ky kufizim i aplikimit të Kartës ndodh thjeshtë sepse BE-ja nuk i ka ngritur ende organizmat funksional që do të mund të implementonin ligjin e BE-së në vendet anëtare – pra ligji i BE-së është vënë në zbatim nga vetë administrata e vendit anëtar. Për këtë arsye, në ato fusha aplikimi ku vendet anëtare nuk ia kanë deleguar ende pushtetin organizmave administrative të BE-së, Karta nuk ka asnjë efekt.

Që me hyrjen në fuqi të Direktivave Kundër Diskriminimit, si dhe me shtrirjen e mbrojtjes mbi mallrat dhe shërbimet nëpërmjet sistemit të mirëqenies publike, diferenca mes qëllimit të mbrojtjes së ofruar nga GJEDNJ-ja dhe Direktivat është zvogëluar. Por, pavarësisht përparimeve të dukshme, ende mund të identifikohen disa hapësira të veçanta ligjore, ku GJEDNJ-ja ofron një mbrojtje më të avancuar se ligji i BE-së²¹. Një aspekt tjetër lidhet me mënyrën me të cilën zgjidhen konfliktet ndërmjet ligjeve. Nëse një ligj prek respektimin e jetës familjare në BE aplikohet parimi i zbatimit të drejtpërdrejtë dhe mbizotërimit të praktikës të GJEDNJ-së për çështje të interpretimit. Në rastin e sistemit të KEDNJ-së nuk parashikohet një gjë e tillë, pasi e drejta për një jetë familjare, si pjesë e KEDNJ-së, është bërë pjesë e normave të brendshme të shtetit me ratifikimin nga ky i fundit. Në rast se një gjyqtar ndeshet me një normë e cila bie në kundërshtim me nenin 8 të KEDNJ-së, ai duhet tu japë

¹⁸ Po aty.

¹⁹ Olivier De Schutter, Sébastien van Drooghenbroeck, *Droit international des droits de l'homme: devant le juge National*, Bruksel. Faqe 92

²⁰ Po aty.

²¹ Po aty.

përparësi rregullave në bazë të kriterit kronologjik ose të paraqesë kërkesë për interpretim në Gjykatën Kushtetuese apo Gjykatën e Lartë kombëtare, e cila duhet të jetë në linjën e GJEDNJ-së.

Ndalimi i diskriminimit të çifteve LGBT

GJEDNJ-ja është përpjekur që të vendosë marrëdhëniet e partnerëve homoseksualë në të njëjtin nivel me marrëdhëniet e çifteve të martuar, duke e krahasuar atë me marrëdhënien e dy binjakëve që ndajnë dhomën së bashku²². Për këtë arsye, Diskriminimi mbi baza të orientimit seksual, që lidhet me jetën familjare, e veçanërisht me rastet e adoptimit dhe kujdestarisë, mund të përfshihet në fushëveprimin e mbrojtjes së jetës familjare të përcaktuar në nenin 8, si dhe mund të përbëjë edhe një shkellje shtesë të nenit 14²³. Të gjithë njerëzit, pavarësisht seksit, orientimit seksual apo identitetit gjinor, kanë të drejtën që të gëzojnë mbrojtjen që u ofron legjislacioni mbi të drejtat e njeriut.

Jetesa e përbashkët e një çifti homoseksual, e shoqëruar nga një stabilitet në marrëdhëniet midis tyre konsiderohet si jetë familjare.²⁴ GJEDNJ-ja, me referim të neni 8, i interpretuar duke mbajtur parasysh nenin 14, ka arritur në këtë konkluzion duke iu referuar njohjes që i është bërë jetesës së përbashkët të çifteve heteroseksuale. Jurisprudenca e GJEDNJ-së ka arritur në konkluzionin në disa raste KEDNJ-ja duhet të lexohet në tërësi dhe në këtë kuadër, duke patur në qendër ndalimin e diskriminimit, del konkluzioni se shtetet duhet që të drejtën për martesë të vendosur në nenin 12 të KEDNJ-së ta njohë edhe për çiftet e të njëjtit seks. Kjo njohje duhet të bëhet pasi e kundërta do të thotë mosrespektim i detyrimeve të

²² Cooper, Sarah: "Marriage, Family, Discrimination & Contradiction:", shënimi 64, para. 1759 (referuar rastit Burden kundër Mbretërisë së Bashkuar, ku Gjykata bëri dallimin mes binjakëve që kanë lidhje gjaku, dhe çifteve të martuara nga njëra anë, dhe partnerëve homoseksualë që zgjedhin të jetojnë së bashku).

²³ Pjesë e shkëputur nga Mesazhi i Sekretarit të Përgjithshëm Ban Ki-moon, drejtuar KEDNJ gjatë takimit të Gjenezës me temë: 'Violence and Discrimination based on Sexual Orientation or Gender Identity', mbajtur më 7 Mars 2012.

²⁴ Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në Vendimin Schalk dhe kundër Austrisë, të datës 22 qershor 2014, me nr.aplikimi 30141/04 shprehet se: "... Disa mund të thonë se orientimi seksual dhe identiteti gjinor janë ende çështje sensitive, dhe për mua, kjo është e kuptueshme. Si shumë persona të tjerë të brezit tim, unë nuk u rrita duke folur për këto çështje. Por mësova që të diskutoj dhe ta ngre zërin për ato, sepse bëhet fjalë për jetë njerëzish dhe është detyra jonë, që lind nga Karta e Kombeve të Bashkuara dhe nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, që të mbrojmë të drejtat e cilitdo, kudo ku ata ndodhen."

vendosura nga KEDNJ-ja në nenin 8 dhe 14 të saj, ose e thënë ndryshe prek të drejtën për një jetë familjare dhe u shkakton diskriminim këtyre çifteve. Nga jurisprudenca e GJEDNJ-së shikohet një qëndrueshmëri për mbrojtjen e jetës private e familjare kundrejt diversitetit të çështjeve të paraqitura edhe për shkak të gjinisë²⁵.

Thelbi i detyrimit ligjor të Shteteve, për sa i takon respektimit të drejtave të njeriut për komunitetin LGBT²⁶ përfshin detyrimin për të mbrojtur individët nga dhuna homofobike e trans-fobike. Gjithashtu, ajo synon parandalimin e torturës dhe trajtimit degradues mizor e jonjerëzor, që arrihet nëpërmjet shfuqizimit të ligjeve që përcaktojnë si krimet marrëdhëniet homoseksuale dhe duke ndaluar diskriminimin mbi baza të orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Që të respektohen të drejtat e komunitetit LBGT, atyre duhet tu njihet dhe tu garantohet e drejta dhe liria e lirinë e shprehjes, shoqërimit dhe grumbullimit paqësor për të gjithë individët LGBT.

Gjatë viteve të fundit, shumë shtete kanë bërë përpjekje për të forcuar mbrojtjen e të drejtave për komunitetin LGBT duke aprovuar një sërë ligjesh të reja që dënojnë diskriminimin dhe penalizojnë krimet e urrejtjes homofobike e transfobike, njohin marrëdhëniet e çifteve të njëjtit seks, si dhe lehtësojnë përfitim të dokumenteve ligjore që reflektojnë gjininë që kanë zgjedhur individët që e konsiderojnë veten si trans-gjinorë. Shumë programe trajnimi janë zhvilluar por, mbrojtja e komunitetit LGBT nga diskriminimi dhe respektimi i jetës familjare të tyre nuk kërkon një set të ri të drejtash specifike për ta. Detyrimi ligjor i Shteteve për të garantuar të drejtat e njeriut edhe për komunitetin LGBT është përcaktuar qartë në Konventën Evropiane të Drejtave të Njeriut, e më pas pranuar nga këto shtete gjatë nënshkrimit të marrëveshjeve të ndryshme ndërkombëtare, por është i vështirë zbatimi.

Mungesa e ndalimit të diskriminimit në bazë të orientimit seksual ka qenë e dukshme në të drejtën e BE-së. Në fakt, përveç mos diskriminimit mbi bazën e kombësisë që ka qenë në qendër të lëvizjes së lirë të BE-së, e vetmja formë tjetër diskriminimi që ishte e ndaluar ishte ai në bazë të seksit, e derivuar nga kërkesat e grave për pagesë më të barabartë me burrat për punë të njëjta²⁷.

²⁵ Arta Mandro-Balili, Diskriminimi gjinor, vep.cit., faqe 35

²⁶ Broshurë e UNHR: "Born Free And Equal", vizituar më 22 Qershor 2015 në <http://www.ohchr.org/Documents/Publications/BornFreeAndEqualLowRes.pdf>

²⁷ M. Bell and M. Bonini Baraldi, 'Lesbian, gay, bisexual and transgender families and the Free Movement Directive: Implementation Guidelines' (2008) ILGA Europe.

Deri në fund të viteve '90 asnjë akt i të drejtës primare të BE-së nuk kishte parashikuar norma për mbrojtjen kundër diskriminimit të personave LGBT.

Interesant është fakti se ndalimi absolut i çdo diskriminimi është vendosur menjëherë pas mbrojtës së jetës familjare dhe me kushte të ngjashme me KEDNJ-në²⁸. Sipas Kartës “familja duhet të gëzojë mbrojtje ligjore, ekonomike dhe sociale”²⁹.

Në këtë pikë duhet edhe e drejta për martesë dhe e drejta për të ndërtuar familje duke mos i ngushtuar këto të drejta vetëm mbi çiftet heteroseksuale³⁰. Kjo e drejtë nuk i referohet seksit duke dhënë mundësi të njëjta si për çiftet heteroseksuale dhe për ato LGBT³¹. Pra nuk e ngushton këtë të drejtë në mënyrën sesi kjo është paraqitur tek Neni 12 i KEDNJ-së. Me heqjen e frazës midis një burri dhe një gruaje, Karta shmang argumentin se martesa është një bashkim çiftesh heteroseksuale. Në këtë mënyrë Karta i jep autoritetin BE-së për të ndërmarrë masa të tjera për të mbrojtur familjet LGBT. Pas nënshkrimit të Kartës, KEDNJ-ja i është referuar drejtpërsëdrejti asaj në çështjen Christine Goodwin, duke vëzhguar se instituti i martesës i është nënshtruar ndryshimeve të rëndësishme sociale që prej miratimit të KEDNJ-së. Këto ndryshime shprehen më së miri në Kartën Evropiane të vitit 2007 të Drejtave Themelore të Njeriut, e cila duke pasqyruar këto ndryshime, fillon, jo pa qëllim, me fjalët e Nenit 12 të KEDNJ-së, duke hequr referimin që u bëhet burrave dhe grave³².

Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut dhe ajo e Gjykatës të Drejtësisë të Bashkimit Evropian kanë ecur në drejtimin e trajtimit të barabartë të bashkimeve heteroseksuale me ato të formuara nga çiftet LGBT. Çështjet në këtë drejtim janë të pakta, por ka shumë deklarata dhe qëndrime të institucioneve evropiane që shprehin nevojën e njohjes dhe rregullimit ligjor të raporteve personale të personave LGBT dhe të statusit familjar të tyre. Jurisprudenca e GJED-së vetëm pas vendimit të vitit 2008, në rastin Tadao Maruko kundër

²⁸ Karta e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Bashkimit Evropian, Neni 7.

²⁹ Po aty, Neni 33.1.

³⁰ Po aty, Neni 9.

³¹ Po aty.

³² Christine Goodwin kundër Mbretërisë së Bashkuar, Nr. Aplikimi 28957/95 . Hyrë më 11 Korrik 2015.

*Versorgungsanstalt der deutschen Buhen*³³ ndjek tendencën e zbatimit të parimit të mosdiskriminimit mbi bazën e orientimit seksual, duke patur si qëllim mbrojtjen e jetës familjare të parterëve homoseksual³⁴.

Në këtë vendim GJED-ja është shprehur se nëse legjislacionet kombëtare i konsiderojnë njësoj bashkëshortët dhe partnerët e Regjistruar, këta të fundit nuk duhet të jenë subjekt i trajtimit më pak të favorshëm. Pra, edhe trajtimi i tyre në aspektin ekonomik, shoqëror dhe kulturor duhet të jetë i njëjtë me trajtimin që i ofrohet bashkëshortit. Ky trajtim nuk mund të diskriminoj parterët pavarësisht seksit të tyre. Ashtu si nuk duhet bërë dallimi nëse partneri, për të përfutur të drejtat, është femër apo mashkull, ashtu nuk duhet të bëhet dallimi nëse partneri është heteroseksual apo i përket komunitetit LGBT. Një njohje e tillë të drejtash duhet të aplikohet njësoj për partnerët, pavarësisht nëse partneriteti është i përbërë nga persona të njëjtë seks ose të personave të gjinisë së kundërt, dhe në këtë mënyrë shmanget cënimi i diskriminimit të drejtpërdrejtë në bazë të orientimit seksual³⁵. GJED-ja e vazhdon arsyetimin e saj duke nënvijëzuar faktin se nëse një shtet ndryshon sistemin e vet ligjore në mënyrë që ti lejojë personat e të njëjtë seks për të jetuar së bashku, ky regjim i veçantë, partneriteti, shndërrohet gradualisht në ekuivalente me regjimin që zbatohen për martesën.

Gjithashtu, GJED-ja është shprehur se diskriminimi që buron prej ricaktimit të gjinisë së personit(këtu flitet për personat trangjinor) konsiderohet diskriminim mbi bazat e seksit³⁶. Këtu duhet të ndalemi duke theksuar se diskriminimi seksual vlen vetëm për PT që kanë ndërmend t'i nënshtrohen, janë duke iu nënshtrohet ose i janë nënshtrohet ricaktimit të seksit. Ndërsa në rastet e PT që nuk i janë nënshtrohet apo nuk mund t'i nënshtrohen ricaktimit të seksit për arsye nga më të ndryshmet, sepse nuk e dëshirojnë një gjë të tillë, për arsye shëndetësore, apo sepse këto procedura ju mohohen, nuk konsiderohet diskriminim seksual.

³³ Vendim i GJED-së, çështja *Versorgungsanstalt der deutschen Buhen* kundër gjermanisë, me nr. aplikimi C-267/06. Datë 1 prill 2008.

³⁴ Denise Amram- Angela D'Angelo. La famiglia e il diritto fra diversità nazionali ed iniziative dell'Unione Europea. Faqe 230.

³⁵ Vendim i GJED-së, çështja *Versorgungsanstalt der deutschen Buhen* kundër Gjermanisë, me nr. aplikimi C-267/06. Datë 1 prill 2008.

³⁶ Të Drejtat e Njeriut dhe Identiteti Gjnjor. Botim i Komisionerit për të Drejtat e Njeriut. Marrë në sitin

http://tgeu.org/sites/default/files/Albania_Hammaberg_Issue_Paper.pdf
Hyrë më 10.11.2015.

Janë gjykatat kombëtare të cilat duhet të vlerësojnë faktin nëse këto dy institute janë të njëjta apo jo. Nëse po, nëse janë të njëjta, çdo e drejtë që njihet për personat e martuar duhet të njihet edhe për ata që janë në partnership apo forma të tjera të bashkimeve civile, pavarësisht seksit, në rast të kundërt do të kemi çënimin e parimit të mosdiskriminimit³⁷.

Dallimi në trajtimin bazuar e punonjësve, bazuar në gjendjen martesore të tyre dhe jo shprehimisht në orientimin e tyre seksual, gjithashtu, është diskriminim i drejtpërdrejtë për shkak se vetëm personat e gjinive të ndryshme mund të martohen dhe të punësuarit homoseksuale për këtë arsye nuk janë në gjendje për të përmbushur kushtin e kërkuar³⁸.

Qëndrimet e mbajtura nga GJED-ja, që ndjekin të njëjtën linjë si ajo e mësipërmja, i dhanë një shtysë të rëndësishme ndalimit të diskriminimit në bazë të orientimit seksual, duke përfshirë një dispozitë të re në TFE³⁹. Për më tepër, përsa i përket diskriminimit mbi bazë të orientimit seksual, GJED-ja ka theksuar se nuk është seksi i partnerit i cili përcakton nëse personi përfiton “avantazhet” familjare, por është natyra ligjore e lidhjeve që formohen⁴⁰.

Në hapësirën komunitare dënohet çdo formë e diskriminimit që lidhet me orientimin dhe identitetin seksual, por gjithsesi, të drejtat themelore të komunitetit LGBT në BE akoma nuk respektohen plotësisht⁴¹. Mungon një politikë unike komunitare për mbrojtjen e të drejtave themelore të komunitetit LGBT, pasi e drejta për rregullimin ligjor i takon Komisionit të BE-së dhe mbi të gjitha shteteve anëtare.

Komisioni duhet të përpiqet për sigurimin e respektimit të të drejtave themelore të personave LGBT duke integruar çështjet që lidhen me të drejtat e tyre në të gjithë sektorët si në politikat për zhvillim dhe në propozimet e ardhshme për monitorimin e zbatimit të ligjit të BE-së

Shtetet anëtare kanë si detyrë konsolidimin e kuadrit ligjor ekzistues të BE-së duke punuar në drejtim të zbatimit të Direktivave për trajtim të

³⁷ Po aty.

³⁸ Gjykata Evropiane e Drejtësisë, çështja Jürgen Römer kundër Freie und Hansestadt Hamburg, datë 10 maj 2011. Gjendet në sitin: <http://curia.europa.eu/>

³⁹ Neni 10 TFE parashikon se: "në përcaktimin dhe zbatimin e politikave dhe aktivitetet e saj, Bashkimi do të synojë të luftojë diskriminimin e bazuar në [...] orientimin seksual".

⁴⁰ Gjykata Evropiane e Drejtësisë, çështja Jürgen Römer kundër Freie und Hansestadt Hamburg, datë 10 maj 2011. Gjendet në sitin: <http://curia.europa.eu/>

⁴¹ Konkluzion i dalë nga Rezoluta 2013/2183e Parlamentit Evropian në lidhje me homofobinë dhe orientimin seksual.

barabartë ndërmjet personave pavarësisht fesë apo besimit, paaftësisë, moshës ose orientimit seksual. Të gjitha shtetet anëtare të BE-së janë të detyruar të krijojnë organet kombëtare të barazisë, të cilat janë organe të pavarura që synojnë të nxisin trajtimin e barabartë, hulumtojnë diskriminimin, si dhe të ofrojnë shërbime këshilluese për viktimat. Këto organe janë të detyrueshme në fushën e diskriminimit racor dhe gjinor sipas të drejtës së BE-së, por jo në atë të orientimit seksual⁴².

Konkluzione

Mbrojtja kundër diskriminimit në Evropë është e parashikuar si nga e drejta e Bashkimit ashtu edhe nga KEDNJ-ja. Të dyja sistemet janë në masë të madhe plotësuese. KEDNJ-ja mbron të gjithë individët në territoret e tyre nëpërmjet juridiksionit të 47 shteteve anëtare, ndërsa direktivat e BE-së kundër diskriminimit garantojnë mbrojtjen vetëm të qytetarëve të vendeve anëtare. KEDNJ-ja përmban një list specifike të arsyeve të ndalimit të diskriminimit.

Diskriminimi verifikohet atëhere kur një individ disavantazhohet në një mënyrë mbi bazën e një “sjellje mbrojtëse”. Trajtimi më pak i favorshëm konfirmohet duke pasur një konflikt ndërmjet të ashtu quajturës viktimë dhe të një personi tjetër që nuk ka karakteristika mbrojtëse në situata të ngjashme. Mund të ndodhi që motivi objektiv të ndalimit të diskriminimit nuk përbën arsyen eksplicite që qëndron në bazë të diferencës së trajtimit, duke qenë i mjaftueshëm që kjo arsye e fundit të jetë e shkëputur nga shkaku i mbrojtur.

GJED-ja dhe gjykata kombëtare kanë njohur nocionin e diskriminimit për shkak të shoqërimit, që verifikohet atëhere kur një person pëson një trajtim jo më pak të favorshëm në momentin që shoqërohet me një person tjetër që ka një “karakteristik mbrojtëse”. Dhunimet edhe pse trajtohen të ndara në kuadrin e të drejtës së BE-së, janë një manifestim i veçant i diskriminimit. Për të garantuar të gjithëve barazinë e aksesit në të drejtat e caktuara nga qeveritë, punëdhënësit dhe ata që ofrojnë shërbime mund të thirren që të adoptojnë masa konkrete ose të posaçme për të ndryshuar normat respektive dhe shprehjet për personat që kanë karakteristika të ndryshme.

⁴² Të Drejtat e Njeriut dhe Identiteti Gjinor. Botim i Komisionarit për të Drejtat e Njeriut. Marrë në sitin http://tgeu.org/sites/default/files/Albania_Hammaberg_Issue_Paper.pdf Hyrë më 10.11.2015.

GJED-ja adopton me kujdes fushën e aplikimit dhe të interpretimit në mënyrë të gjerë, vetëm për të garantuar efikasitetin e plotë të drejtave individuale që rrjedhin nga e drejta e BE-së. Përdorimi i KEDNJ-së, është në terma të drejtave themelore të njohura, si në interpretim që u jepet këtyre të drejtave dhe është e përhapur gjerësisht në lidhje me direktivat e BE-së kundër diskriminimit.

lidhje me mosmarrëveshjen që ka.

Diskriminimi ndikon në çdo aspekt të jetës të njerëzve, pasi kjo çon në përjashtimin dhe mëjanimin e çdo personi në jetën e përditëshme. Jurispudencia ka luajtur një rolë jetikë në forcimin dhe mbrojtjen kundër diskriminimit. Rastet e diskriminimit ndihmojnë në zhvillimin dhe mirkuptimin sesi diskriminimi përjetohet dhe sesi efektet e tij të demshëm mund të rregullohen.

Gjithnjë e më shumë, përpjekjet në luftën kundër diskriminimit kanë nxjerë në pah edhe vështirësitë e të provuarit të formave të diskriminimit qoftë diskriminim i drejtëpërdrejtë apo indirekt. Çështjet gjyqësore kanë dhënë një ndihmë jashtëzakonisht të madhe në nxjerjen e rregullave të reja të dëshmive e të krijimit të mjeteve të reja të provave për të provuar diskriminimin.

Diskriminimi në çfarë do llojë rrethane pengon të gjithë njerëzit që të gëzojnë të drejtat dhe liritë e tyre. Diskriminimi racor dhe shkelja e të drejtave të grupeve minoritare mund të them që është një problem shumë serioz për BE-në. Në rast se zbatohen të gjitha traktatet ndërkombëtare përfshirë këtu dhe konventat që kanë lidhje me të drejtat e njeriut parimi i mos diskriminimit do të arrihet të zbatohet në praktikë. Në jetën e përditshme njerëzit trajtohen në mënyra të ndryshme qofshin në punë, në një dyqan ose dhe në një restorant. Mbrojtja kundër diskriminimit duhet parë më tepër si një garanci sociale, por më tepër si një garanci e lartë për të drejtat dhe liritë themelore.

Bibliografia

Alfonso Celotto, Una nuova ottica dei “controlimiti” nel Trattato costituzionale europeo? Marrë në stin e internetit www.forumcostituzionale.it.

Arta Mandro-Balili, Diskriminimi gjinor, vep.cit., faqe 35

Broshurë e UNHR: “Born Free And Equal”, vizituar më 22 Qershor 2015 në <http://www.ohchr.org/Documents/Publications/BornFreeAndEq>

ualLowRes.pdf

Cooper, Sarah: "Marriage, Family, Discrimination & Contradiction.

Delia la Roca, Eguaglianza e libertà contrattuale nel diritto europeo. Le discriminazioni nei rapporti di consumo.

Denise Amram- Angela D'Angelo. La famiglia e il diritto fra diversità nazionali ed iniziative dell'Unione Europea.

Direktiva 2003/109/CE e lidhur me statusin e qytetarëve të vendeve të treta nëse janë rezident për një kohë të gjatë GU L 16 i datës 23.01.2004, fq 44.

Direktiva 2003/86/CE e lidhur me të drejtën e ribashkimit familjar, GU L 251 i datës 03.10.2003.

Direktiva 2004/38/CE relative me të drejtën e qytetarëve të Bashkimit dhe të familjarëve të tyre për të lëvizur dhe për të qëndruar lirish në territorin e Shteteve Anëtare, GU L 158 i dt 30.04.2004, fq.77.

Francëis Snyder, The Europeanisation of Law: The Legal Effects of European Integration (Studies in European Law and Integration).

Grigic, Mataga, Longar Vilfan, The Right to Property under the ECHR, Manuale siu diritti umani n.10.2007 e vlefshme edhe në adresën: www.coehelp.org/mod/resource/view.php?inpopup=true&id=2123.

Gjykata Evropiane e Drejtësisë, çështja Jürgen Römer kundër Freie und Hansestadt Hamburg, datë 10 maj 2011.

Gjykata Evropiane e Drejtësisë, çështja Jürgen Römer kundër Freie und Hansestadt Hamburg, datë 10 maj 2011.

Karta e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Bashkimit Evropian.

M. Bell and M. Bonini Baraldi, 'Lesbian, gay, bisexual and transgender families and the Free Movement Directive: Implementation Guidelines' (2008) ILGA Europe.

Olivier De Schutter, Sébastien van Drooghenbroeck, Droit international des droits de l'homme: devant le juge National, Bruksel. Faqe 92

Protokolli nr.12 mbi konventën mbi Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore (STE n.177) relacioni eksplicid, paragrafi 22 është i disponueshëm në fq: <http://conventions.coe.int/Treaty/en/Reports/Html/177.htm>.

Të Drejtat e Njeriut dhe Identiteti Gjinnor. Botim i Komisionerit për të Drejtat e Njeriut. Marrë në sitin http://tgeu.org/sites/default/files/Albania_Hammaberg_Issue_Paper.pdf Hyrë më 10.11.2015.

Vendim i GJED-së, çështja *Versorgungsanstalt der deutschen Buhen* kundër gjermanisë, me nr. aplikimi C-267/06. Datë 1 prill 2008.

- Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut Hoogendijk kundër Vendeve të Ulta (Pranueshmëria), çështja nr. 58641/00, datë 06 janar 2005.
- Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, çështja Carson kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr.aplikimi 42184/05, datë 16 mars 2010.
- Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, çështja D.H kundër Republikës Çeke, datë 13 nëntor 2007. Paragrafi 184.
- Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, çështja E.B. kundër Francë [GC], nr.aplikimi n.43546/02, datë janar 2008.
- Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, çështja James kundër Këshilit Bashkiak të Eastleigh, Dhoma e Lordëve e Mbretërisë së Bashkuar seanca e 6-të, datë 14 qershor 1990.
- Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, çështja Loizidou kundër Turqisë, me nr. aplikimi 15318/89, datë 18 dhjetor 1996.
- Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, çështja Stec kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr.aplikimi 65731/001 dhe 65900/01, datë 12 prill 2006 dhe .
- Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, çështja Sammerfeld kundër Gjermanisë, nr.aplikimi 31871/96, datë 08.06.2003.
- Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, çështja Weller kundër Hungarisë, nr.aplikimi 44399/05, datë 31 mars 2008.
- Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, çështja Zarb Adami kundër Maltës, nr.aplikimi 17209/02, datë 20 qershor 2006.
- Vendimi i Gjykatës Evropiane e Drejtësisë, çështja Nimz kundër Qytetit të Lirë dhe Hanseatik të Hamburgut. (Freie Und Hansestadt Hamburg), datë 7 shkurt 1991, vendimi me nr.aplikimi C-184/89.

PJESËMARRJA E QYTETARËVE NË PROCESIN VENDIMMARRËS NË NIVEL VENDOR, RASTI I BASHKISË DEVOLL

M.Sc Enida Haxhi (Shishi)*

Abstrakt

Pjesëmarrja qytetare është një proces i rëndësishëm demokratik, nëpërmjet të cilit, qytetarët përfshihen në proceset e vendimmarrjes lokale me qëllim që të bëhen promotorë të iniciativave për çështje që ndikojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi në jetën e tyre, duke i fuqizuar ata dhe duke e bërë marrjen dhe zbatimin e vendimeve më të qëndrueshëm.

Qëllimi i këtij studimi është t'i japë përgjigje në planin teorik dhe praktik pyetjeve kërkimore. Çfarë kuptojmë me pjesëmarrje të qytetarëve në vendimmarrje dhe pse është e rëndësishme ajo? Kush mund të marrë pjesë? Si garantohet pjesëmarrja publike nëpërmjet kuadrit ligjor? Cilët faktorë e kufizojnë të drejtën e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje?

Objektivat e këtij hulumtimi janë:

1. Të vlerësohet përfshirja e publikut në vendimmarrjen e Bashkisë Devoll.

2. Nisur nga perceptimet e qytetarëve të kësaj Bashkie, të analizohen faktorët të cilët mund të rrisin ose ulin shanset e publikut për të marrë pjesë në procesin vendimmarrës në Bashkinë Devoll.

Në Bashkinë Devoll, ky është studimi i parë që realizohet dhe përveçse do t'u vijë në ndihmë banorëve të saj, kam besimin se do të shërbejë si ndihmesë për autoritetet drejtuese të qeverisjes lokale në perspektivë.

Studimi është kryer me pjesëmarrjen e banorëve të Bashkisë Devoll. Për realizimin e studimit është përdorur metoda e anketimit nëpërmjet pyetësorit si dhe kërkimi bibliografik.

Rezultatet e studimit tregojnë se pjesa më e madhe e qytetarëve nuk janë, apo janë pjesërisht të informuar mbi veprimtarinë e Bashkisë. Ata kërkojnë të jenë të angazhuar në proceset vendimmarrëse që i interesojnë dhe të bëhen pjesë e hartimit të

* M.Sc Enida Haxhi(Shishi) , Përgjegjëse e Sektorit Juridik në Bashkinë Devoll, email: enidashishi@yahoo.com

vendimeve dhe politikave. Arrijmë kështu në disa përfundime të dobishme si për autoritetet drejtuese të pushtetit vendor ashtu edhe për qytetarët, të cilët duhet të vlerësojnë me kujdes këtë proces, i cili është në dobinë e tyre të përbashkët.

Fjalë kyç: *Bashkia Devoll, konsultim publik , legjislacion, pjesëmarrja e qytetarëve ne vendimmarrje, qeverisje vendore.*

Hyrje

“...Ne në Amerikë, nuk kemi qeverisje nga shumica.

Ne kemi qeverisje nga shumica që merr pjesë.....”

Thomas Jeferson.

Ish- President i Shteteve të Bashkuara të Amerikës

Vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë, ka si mision, të sigurojë qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve, nëpërmjet nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të komunitetit.¹ Bashkia si njësi bazë e vetëqeverisjes vendore, është adresa e parë për çdo qytetar, i cili kërkon zgjidhjen e llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike, në interes të tij apo komunitetit ku jeton.

Lidhja qytetar- autoritet shtetëror, është padyshim më e afërt në këtë nivel të qeverisjes, sepse është përballja kryesore e qytetarit me autoritetin publik, përgjegjësitë kryesore të së cilit, lidhen me fusha të veprimtarisë, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e komunitetit, duke filluar nga shërbimet publike, infrastruktura, shërbimet sociale, mjedisi, siguria publike, taksat dhe tarifat vendore, lejet e ndërtimit etj.

Duke marrë në konsideratë faktin se qytetarët janë më tepër të njohur me problematikat e njësisë vendore në të cilën jetojnë, ata kanë mundësinë që ti adresojnë problemet dhe pse jo të propozojnë zgjidhje konkrete.

Pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrjen vendore është e drejtperdrejtë dhe përfaqësuese: pjesëmarrja e drejtperdrejtë ushtrohet nëpërmjet të drejtës për t’u zgjedhur dhe për të zgjedhur, referendumit, iniciativave qytetare dhe formave të tjera të parashikuara nga ligji, kurse në pjesëmarrjen përfaqësuese, qytetarët i ushtrojnë të drejtat, jo personalisht, por nëpërmjet përfaqësuesve (Këshilltarëve) të zgjedhur nga ata (në Këshillin Bashkiak).

¹ Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, viti 2015, numri 249, Ligji nr 139/2015, datë 17.12.2015 “ Per vetëqeverisjen vendore”, neni 3.

Pavarësisht pikëpamjeve të autorëve dhe studiuesve të ndryshëm, përqafojmë idenë se pjesëmarrja qytetare shërben si një parakusht për ndërtimin dhe konsolidimin e shtetit demokratik, për nxitjen dhe zhvillimin e një shoqërie civile aktive, të qytetarëve të përgjegjshëm dhe të angazhuar në komunitetet e tyre lokale. Me pjesëmarrjen në krijimin dhe implementimin e vendimeve, qytetarët nga votues joaktiv dhe jo mjaft të interesuar bëhen subjektet aktive politike.

Konsiderata historike mbi dinamikat që ka pësuar e drejta e pjesëmarrjes së qytetarëve në organet vendimmarrëse.

Edrejta e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje është një nga të drejtat më të lashta që e ka zanafillën qysh nga epoka helenike dhe romake, kur filluan të hidhen hapat e parë të organizimit të shtetit.² Ajo zë fill në kohën e vendosjes së “demokracisë athinase”, pikërisht në shek.VII p.e.s kur mbreti Likurg hartoi një Kushtetutë të quajtur “Rhetra”. Në bazë të Rhetrës së Likurgut, e drejta për të dhënë fjalën e fundit do t’i përkiste popullit, i cili do të mbledhej në Kuvendin e Popullit (Apella).³ Në vitet 509- 462 kemi atë që quhet “Demokracia e Klisthenit”. Klistheni mbi bazën e një reforme territoriale e ndau Atikën në 100 qarqe territoriale “dhema”. Në dhemë të gjithë qytetarët ishin të barabartë. Në krye të dhemës qëndronte dhemarku, i zgjedhur nga Kuvendi i popullit (agora), e cila vendoste taksat, shpenzimet, huadhëniet.⁴ Me tej me reformat e Perikliut (462- 411) populli kishte të gjitha pushtetet, kontrollonte gjithçka, vendoste ligjet.⁵ Edhe në Romën e lashtë populli pati një ndikim të madh në qeverisjen e qytetarëve. Kuvendi popullor (comicia Curiata) shpallte luftën, zgjidhte Rex-in (mbretin), votonte ligjet etj. Mjaft autorë modernë mendojnë se Reksi konsultoj me popullin për vendimet që do të merrte.⁶ Organe të ngjashme institucionale që përfaqësojnë popullin i ndeshim edhe në Iliri. Në periudhat e para të

² Kur themi shtet nuk bëhet fjalë për atë mekanizëm që ti përgjigjet këtij koncepti në kuptimin rigoroz të fjalës, por bëhet fjalë për një organizim që kishte tiparet e një mekanizmi shtetëror.

³ Aurela Anastasi, Historia e institucioneve, Ribotim, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, 2004, f. 42.

⁴ (Po aty) , fq .53.

⁵ (Po aty) , fq .56.

⁶ (Po aty) , fq .81.

zhvillimit të organizimit shtetëror, vepronin organe si mbledhja e përgjithshme e popullit dhe kuvendi.

Gjithashtu, burimet bëjnë fjalë për drejtuesin kryesor të aparatit shtetëror lokal që quhej dinasti. Ai ishte autoriteti kryesor i krahinës dhe gëzonte kompetenca të gjera, duke realizuar pushtetin e vet në interes të klasës skllavopronare provinciale dhe në harmoni me drejtimet kryesore të politikës së përgjithëshme të shtetit.⁷ Mbas rënies së demokracisë greke dhe bashkë me të edhe të së drejtave të qytetarëve për të marrë pjesë në vendimet e organeve drejtuese të shtetit, kjo e fundit mund të ketë filluar të rishfaqet në shek XI, në periudhën e rilindjes së qyteteve, veçanërisht në qytetet e Italisë, ku zejtarët dhe artizanët filluan të bashkohen dhe të marrin iniciativa për t'iu përgjigjur interesave të tyre të përbashkëta, duke ndërtuar tregje, duke organizuar punë artizanale etj. Këto organizime që morën edhe karakter politik, sollën krijimin e komunave,⁸ të cilat të konceptuara në mënyrë demokratike, u bënë njëkohësisht shprehje të së drejtës së një komuniteti lokal dhe të vetëqeverisjes vendore.

Komunat popullore e rritën shumë pjesëmarrjen e popullit në jetën publike. Kjo vihet re, për shembull, në Padova, ku Këshilli i madh arriti në 100 mijë anëtarë.⁹

Kryetari i Bashkisë si institucion i përfaqësimit të komunitetit lokal dhe pjesë e sistemit urban të qeverisjes, fillimisht është shfaqur në qytetet e Mesjetës, të cilat kishin një organizim tipik në të gjitha vendet e Europës Perëndimore. Vendosija e tyre mund të jetë kryer në saj të zgjedhjeve të kryera nga komunat dhe kishte funksione të tilla si: kryetari i milicisë komunale, mbajtës i çelsave të portave të qytetit, administrator i thesarit dhe kryetar i të gjitha mbledhjeve.¹⁰

Në periudhën e Mesjetës, afirmohet parimi i përfaqësimit, i cili fillimisht u shfaq në Magna Charta Libertatum e cila u nënshkrua më 12 qershor 1215 në Angli. Që nga ajo kohë, pjesëmarrja e përfaqësuesve të konteve, të qyteteve, në asamblëtë e mëdha filloi të bëhej e përhershme.¹¹ Më tej, të drejtat e qytetarit në lëmin e së drejtës së tij për të marrë pjesë në vendimmarrje, evoluan dhe u sanksionuan në dokumenta historike, që edhe sot qëndrojnë si monumente të padiskutueshme juridike të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Kështu "Bill of Rights" 1969 në

⁷ (Po aty), fq. 81.

⁸ (Po aty), fq. 213.

⁹ (Po aty), fq. 225.

¹⁰ (Po aty), fq. 218.

¹¹ Aurela Anastasi, Historia e institucioneve, Ribotim, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë, 2004, f. 251.

Angli, "Deklarata e të drejtave të njeriut dhe qytetarit" 1789 në Francë, "Kushtetuta e Vajmarit në Gjermani" 1791, afirmuan pushtetin kushtetues, i cili i përkiste popullit.¹² SHBA-të kanë përfshirë elemente të së drejtës së pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje, shekuj më parë. E drejta për peticion, për shembull, ka qenë pjesë e Amendamentit të parë të kushtetutës së SHBA që nga viti 1791.¹³

Megjithatë koncepti i asaj kohe për të drejtën e pjesëmarrjes nuk përputhet me idenë që ne kemi sot për të. Në ditët e sotme, kur roli i organizatave të shoqërisë civile dhe kërkesat e qytetarëve për të qenë tëpërfshirë në proceset vendimmarrëse të autoriteteve shtetërore është në rritje, gjithnjë e më tepër po i kushtohet rëndësi të drejtës së pjesëmarrjes së qytetarëve si nga institucionet shtetërore shqiptare, ashtu edhe nga institucionet ndërkombëtare si: Kombet e Bashkuara, Këshilli i Europës, Bashkimi European etj.

Megjithëse nuk ka një përkufizim rigoroz dhe dogmatik të termit "pjesëmarrje në vendimmarrje", institucione dhe autorë të ndryshëm e përkufizojnë në mënyra të ndryshme, por thelbi mbetet i njëjtë. "Pjesëmarrja qytetare është fuqia qytetare, është rishpërndarja e pushtetit që u mundëson qytetarëve që aktualisht janë të përjashtuar nga proceset politike dhe ekonomike, të përfshihen në të ardhmen. Është strategji sipas së cilës qytetarët që kërkojnë të jenë pjesëmarrës, duhet të dinë sesi ndahen informatat, vendosen qëllimet dhe politikat, alokohen burimet tatimore etj..... Shkurtimisht është mjeti me anë të së cilit qytetarët mund të nxisin reforma të rëndësishme shoqërore që u mundëson atyre të ndajnë përfitimet e një shoqërie të pasur".¹⁴ Pjesëmarrje do të thotë ta organizosh veten për të identifikuar çështje me interes publik dhe të ndikosh në proceset vendimmarrëse të organeve vendimmarrëse vendore nëpërmjet iniciativave qytetare, avokatisë, lobimit dhe mënyrave të tjera me të cilat mund të mobilizohet komuniteti.

¹² Të gjitha klasat që e perbënin popullin, do përfaqësoheshin në Parlament, duke u hedhur kështu bazat për vendosjen e formës parlamentare të qeverisjes.

¹³ World Register of Introduced Marine Species, E aksesueshme ne google ne linkun : <http://www.marinespecies.org/introduced/index.php>

¹⁴ Article Arnstein, Sherry R(1969). A ladder of Citizen Participation Journal of the American Planning Association, 35:4, 2016-224 DOI 10.1080/10944366908977225

Nivelet e pjesëmarrjes.

Në vitin 1969 Sherry Arnstajn (Arnstein) krijoi idenë e “Shkallëve të pjesëmarrjes. Në shkallën e Arnstajnit janë pasqyruar tetë ‘nivele’ të pjesëmarrjes, duke filluar nga kategoria pasive e qytetarëve deri tek qytetarët më aktivë.

Tetë shkallët apo nivelet e pjesëmarrjes sipas Arnstein janë si më poshtë:

- Manipulimi
- Terapia

Manipulimi dhe terapia janë jopjesëmarrëse. Qëllimi i tyre është të “shërohen” ose të “edukohen” pjesëmarrësit.¹⁵ Manipulimi dhe terapia përfaqësojnë nivelet më të ulta të pjesëmarrjes

- Informimi

“Informacion publik” është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik”.¹⁶ Kjo e drejtë i fuqizon qytetarët dhe rrit pozitivisht kontrollin e tyre mbi proceset politike, duke vepruar si parandaluese kundër ushtrimit arbitrar të pushtetit zyrtar.

- Konsultimet

“Konsultim publik” është tërheqja e mendimeve dhe sugjerimeve të palëve të interesuara për përmbajtjen dhe përmirësimin e projektaktit, nga momenti i publikimit të projektaktit deri në miratimin përfundimtar të tij.¹⁷

- Vendosja

Në këtë nivel të pjesëmarrjes, qytetarët këshillojnë ose planifikojnë ad infinitum por autoriteti vendimmarrës ruan të drejtën për të gjykuar legjitimitetin ose realizueshmërinë e këshillave.¹⁸

¹⁵ Malcolm Groves, Regenerating Schools. Leading the transformation of standards and services through community engagement, British Library, 2008, 73.

¹⁶ Malcolm Groves, Regenerating Schools. Leading the transformation of standards and services through community engagement, British Library, 2008, 73.

¹⁷ (Po aty), fq 73

¹⁸ (Po aty), fq 74

- Partneriteti

Në këtë nivel të pjesëmarrjes, planifikimi dhe përgjegjësitë vendimmarrëse ndahen për shembull përmes komisioneve të përbashkëta.¹⁹

- Delegacioni.

Qytetarët i delegojnë të drejtat e tyre, në komisione me kompetencatëdeleguara për të marrë vendime për ta.²⁰ P.sh i tillë është rasti kur qytetarët zgjedhin Këshilltarët si përfaqësues të tyre në Këshillin Bashkiak.

- Kontrolli i qytetarëve

Të paprivilegjuarit ose ata që kanë qënë të papërfshirë në vendimmarrje, merren me të gjitha punët e planifikimit, krijimit të politikave dhe menaxhimit të një programi pa asnjë ndërmjetës midis tyre dhe atyre që kanë dhënë fondin.²¹

Në dokumentet e Këshillit të Europës dhe disa korniza ligjore specifike, përmenden katër nivele të pjesëmarrjes së publikut në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse.²²

- Qasja në informata
- Konsultimi
- Partneriteti
- Dialogu

¹⁹ (Po aty), fq 74

²⁰ (Po aty), fq 74

²¹ ECNL Civil Participation in Decision-Making Processes ,An Overview of Standards and Practices in Council of Europe Member States Strasbourg, May 2016.E aksesueshme ne linkun:<https://rm.coe.int/168068690f>

²² ECNL Civil Participation in Decision-Making Processes ,An Overview of Standards and Practices in Council of Europe Member States Strasbourg, May 2016, 11.E aksesueshme ne linkun:<https://rm.coe.int/168068690f>

Teksti i aksesueshem ne google ne

linkun:https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016805d1979

Pasqyrimi i së drejtës së pjesëmarrjes qytetare në vendimmarjen lokale në kuadrin e brendshëm ligjor dhe atë ndërkombëtar.

Legjislacioni ndërkombëtar.

Çështja e pjesëmarrjes në qeverisjen lokale është trajtuar në disa dokumente ligjore të Këshillit të Europës:

- Rekomandimi Rec (2001) 19.²³

Ky dokument ligjor, thekson 13 parimet bazë të politikës së pjesëmarrjesdemokratike në nivel lokal.Midis të tjerash citohet: “Të bindur se demokracia lokale është një nga themelet e demokracisë në vendet europiane, për pjesëmarrjen e qytetarëve në jetën publike vendore.Duke riafirmuar besimin se demokracia përfaqësuese është pjesë e trashëgimisë së përbashkët të shteteve anëtare;dialogu nëpërmjet qytetarëve dhe përfaqësuesve të zgjedhur lokalëështë thelbësor për (komunitetin) demokracinë lokale, pasi forcon legjitimitetin e institucioneve lokale dhe efektivitetin e tyre” .

- Karta Europiane për Vetëqeverisje Lokale (1988).²⁴

Përmes nënshkrimit të Kartës Europiane, shtetet zotohen të respektojnë parimet bazë, në mes të tjerash, të drejtën e qytetarëve që të marrin pjesë në menaxhimin e çështjeve publike.

- Kodi i praktikës së mirë për pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendimarrjes (2009).²⁵

Ky dokument, përcakton parimet e përgjithshme, udhëzimet, instrumentet dhe mekanizmat për pjesëmarrje të qytetarëve.Megjithëse nuk ka karakter obligues, shërben si një udhërfyese i mirë për qytetarët.

²⁴ Teksti i Kartës Evropiane i aksesueshem ne google ne linkun :<http://conventions.coe.int/Treaty/EN/Treaties/Html/122.htm>

²⁵ Teksti i Kodit të praktikës së mirë i aksesueshem ne google ne linkun:http://www.coe.int/t/ngo/Source/Code_English_final.pdf

- Konventa e Aarhusit.

Konventa e Aarhusit megjithëse e hartuar në lidhje me çështjet mjedisore, është instrumenti i parë ligjor ndërkombëtar, i cili ka njohur në mënyrë eksplicite të drejtën e pjesëmarrjes së publikut.

- Rekomandimet e Maastrichtit.²⁶

Edhe këto rekomandime lidhen me çështjet mjedisore por megjithatë janë mjete të rëndësishme në duart e qytetarëve për të ushtruar të drejtat e tyre mbi pjesëmarrjen në vendimmarrje.

Legjislacioni shqiptar.

Pjesëmarrja efektive e publikut varet nga fakti nëse publiku ka ose jo qasje në informata të sakta dhe gjithëpërfshirëse. Prandaj, ligjet në lidhje me pjesëmarrjen e publikut shpeshmerren me çështjen e të drejtës për të njohur, qasjen e informacionit dhe lirinë e informimit.

- Kushtetuta

Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre. Në nenin 23 të Kushtetutës, është sanksionuar baza dhe garancia kushtetuese e së drejtës së informimit dhe detyrimi i zbatimit të parimit të transparencës në gjithë veprimtarinë shtetërore dhe administrative.”E drejta e informimit është e garantuar. Kushdo ka të drejtë të informohet, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore. Kujtdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive”²⁷ parashikohet në Kushtetutën e R.Sh-së.Gjithashtu Kushtetuta njeh dhe garanton të drejtën për t’u zgjedhur dhe për të zgjedhur, si një nga të drejtat e pjesëmarrjes së qytetarëve“.Çdo shtetas që ka mbushur tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe

²⁶ Udhëzimet e Maahstrihtit janë te aksesueshme ne google ne linkun: <http://www.unece.org/environmental-policy/conventions/public-participation/aarhus-convention/tfëg/envppppdm/ppdm-recs.htm>

²⁷ Botim i Qendres se Publikimeve Zyrtare,2015 , Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ,miratuar me ligjin nr.8417, datë 21.10.1998 të Kuvendit Popullor, Miratuar me referendum më 22.11.1998,neni 23.

ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet”.²⁸ Po kështu, garantohet e drejta e informimit dhe konsultimit: “Kushdo, vetë ose së bashku me të tjerë, mund t’u drejtojë kërkesa, ankesa ose vërejtje organeve publike, të cilat janë të detyruara të përgjigjen në afatet dhe kushtet e caktuara me ligj”.²⁹

- Ligji nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik “.

Ky ligj rregullon procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik të projektligjeve, projektdokumenteve strategjike kombëtare dhe vendore, si dhe politikave me interes të lartë publik.³⁰ Detyrimi për njoftimin dhe konsultimin publik përcaktohet në nenin 6 të këtij ligji ku sanksionohet se: Organet publike janë të detyruara të marrin të gjitha masat e nevojshme, në mënyrë që të krijojnë mundësi për pjesëmarrjen e publikut dhe të të gjitha palëve të interesuara në procesin e njoftimit e të konsultimit publik.³¹

- Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.³²

Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike, të drejtën për të kërkuar informacion pranë organeve publike, detyrimin e këtyre të fundit për të kthyer përgjigjebrenda afateve të caktuara ligjore etj.

- Ligji nr 139/2015 “Per vetëqeverisjen vendore në Republikën e Shqipërisë”.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë bashkitë dhe qarqet. Bashkia është njësi bazë e vetëqeverisjes vendore, e cila përfaqëson një unitet administrativo-territorial dhe bashkësi banorësh.³³

²⁸ Po aty, neni 45

²⁹ Po aty, neni 48

³⁰ Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, Viti: 2014 – Numri: 178, ligj nr 146/2014 date 30.10.2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” neni 2.

³¹ Po aty, neni 6.

³² Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, Viti: 2014 – Numri: 160, ligj nr 119/2014 date 18.09.2014” Për të drejtën e informimit ”.

³³ Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, Viti: 2015 – Numri: 249, ligj nr 139/2015 date 17.12.2015” Per vetëqeverisjen vendore “neni 5.

Tabela nr 1.

Organi përfaqësues i Bashkisë	Organi ekzekutiv i Bashkisë
Këshilli Bashkiak	Kryetari i Bashkisë

Garantimi i të drejtës së pjesëmarrjes së qytetarëve sipas ligjit për vetëqeverisjen vendore.

Ligji 139/2015”Per vetëqeverisjen vendore”, ka si mision të tij edhe nxitjen efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore.³⁴

Gjithashtu ligji sanksionon se njësitë e vetëqeverisjes vendore konsultohen, nëpërmjet shoqatave përfaqësuese të vetëqeverisjes vendore dhe grupeve të tjera të interesit, nëpërmjet të cilave u mundësohet prezantimi i opinioneve, komenteve dhe propozimeve të tyre për politikën dhe legjislacionin që ka ndikim të drejtpërdrejtë në ushtrimin e të drejtave dhe funksioneve të tyre.³⁵

Njësitë e vetëqeverisjes vendore gjithashtu garantojnë për publikun edhe transparencën e veprimtarisë së tyre.³⁶ Nëpërmjet këtij ligji, organet e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara të garantojnë pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është e detyruar të caktojë koordinatorin për njoftimin dhe konsultimin publik, në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për njoftimin dhe konsultimin publik.³⁷

Një nga risitë e këtij ligji, krahasuar me ligjin paraardhës, është edhe sanksionimi i iniciativës qytetare.³⁸ Sipas nenit 20 të ligjit, çdo komunitet, nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar të tij, ose jo më pak se një përqind e banorëve të bashkisë ka të drejtë të paraqesë për

³⁴ Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, Viti: 2015 – Numri: 249, ligj nr 139/2015 datë 17.12.2015” Për vetëqeverisjen vendore “neni 3.

³⁵ (Po aty), neni 12.


³⁶ (Po aty), neni 15.

³⁷ (Po aty), neni 16.

³⁸ (Po aty), neni 20.

vendimmarrje në këshillin bashkiak, iniciativa qytetare për çështje që janë brenda juridiksionit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Mënyra dhe forma e paraqitjes së këtyre iniciativave, procedura e shqyrtimit dhe miratimit të tyre përcaktohet në rregulloren e organizimit dhe funksionimit të këshillit bashkiak. Kur propozimet e ardhura në këshill si iniciativë qytetare, kanë ndikim financiar në buxhetin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, shqyrtohen në këshill, sipas rendit të ditës dhe nuk mund të miratohen pa marrë më parë mendimin e kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Grafiku nr 1



Burimi: Enida Haxhi

Sipas të dhënave që janë nxjerrë nga pyetësorët e zhvilluar, 36% e të anketuarve nuk kishin dijeni se mbledhjet e këshillit bashkiak janë të hapura. 96 % prej tyre nuk e dinin se për vendimet e marra këshilli duhet të konsultohet paraprakisht me qytetarët dhe 94% e tyre nuk e dinin se çfarë është iniciativa qytetare. Nga analiza e rezultateve vihet re një mungesë e theksuar e informacionit që kanë qytetarët për këto instrumenta vendimmarrëse dhe në këtë rast është përgjegjësi e Bashkisë, e cila duhet të ndërhyjë menjëherë për të informuar komunitetin mbi instrumentat që kanë në dispozicion në mënyrë që ata të mos e humbasin mundësinë për t'a përdorur këtë mekanizëm kaq të nevojshëm për të përgjellë zërin e tyre.

Pse është e rëndësishme përfshirja e publikut në qeverisjen vendore ?

Së pari,forcon demokracinë dhe e përmirëson cilësinë e qeverisjes: Përfshirja e qytetarëve në procesin vendimmarrës, është një element i rëndësishëm demokratik.³⁹ Shumë teoricienë pohojnë se pjesëmarrja e qytetarëve në proceset vendimmarrëse sjell efekte pozitive në cilësinë e demokracisë.Siç shprehet edhe Roger A Hart:”Një komb është demokratik deri në masën që qytetarët e saj janë të përfshirë, veçanërisht në nivel kombëtar”.⁴⁰


Megjithëse ekzistojnë edhe pikëpamje të ndryshme të mjaft autorëve dhe studiuesve, e konsiderojmë të drejtë logjikën tokëvilliane se përhapja e zërit të publikut është thelbësore për cilësinë e demokracisë në një vend dhe një pjesëmarrje e lartë qytetare është në dobi të shoqërisë.Russell J Dalton,⁴¹ profesor në Univeristetin e Kalifornisë, nëpërmjet studimit të tij, ka testuar faktin nëse një qytetar aktiv korrespondon me qeverisjen e mirë, ka rezultuar se shtetet me pjesëmarrje më të lartë politike si Kanadaja, Suedia, Norvegjia dhe Zelanda e Re, kanë edhe një qeverisje më të mirë.(Grafiku Nr. 2).

³⁹ Për të qënë të saktë një sistem që të quhet demokratik në kuptimin rigoroz të fjalës , do të duheshin shumë karakteristika të tjera, por në këtë studim termin”demokraci”do ta përdorim për një sistem politik që i garanton të gjithë qytetarëve mundësinë për të qënë në mënyrë të vazhdueshme të përfshirë në proceset politikëbërëse dhe vendimmarëse të qeverisjes lokale.

⁴⁰ Children’s participation.The theory and Practice of Involving Young Citizens in Community Development and Environmental Care.E aksesueshme ne linkun: https://books.google.al/books?hl=en&lr=&id=ncRSAQAAQBAJ&oi=fnd&pg=PP1&dq=R.HART+ABOUT+PARTICIPATION&ots=u5mzkR_iE&sig=xERYsGeQ6YQlbQAMgiRSdbKyLOE&redir_esc=y#v=onepage&q&f=false

⁴¹ Artikulli”The participation gap: Is citizen participation actually good for democracy?”I autorit Russell J Dalton – University of California,i aksesueshem ne adresen e internetit:<http://blogs.lse.ac.uk/euoppblog/2017/08/23/the-participation-gap-is-citizen-participation-actually-good-for-democracy/#Author>

Grafiku 2: Pjesëmarrja e qytetarëve dhe funksionimi i qeverisë.



Burimi: The London School of Economics and Political Science
 Artikulli "The participation gap: Is citizen participation actually good for democracy?" I autorit Russell J Dalton – *University of California*

Së dyti, pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrjen vendore është një urë lidhëse midis qytetarëve dhe institucioneve:

Roli aktiv i qytetarëve në njërën anë dhe transparenca e institucioneve publike në tjetrën, sigurojnë një dialog të hapur, bashkëpunimi dhe partneriteti. Në saj të këtij bashkëpunimi realizohet jo vetëm e drejta e qytetarëve për të marrë pjesë në procese vendimmarrëse, por njëkohësisht përmirësohet llogaridhënia dhe aftësia e autoriteteve vendore për të zgjidhur problemet. Zhvillimi i bashkëpunimit është përgjegjësia dhe sfida e të gjitha palëve pjesëmarrëse në proces, drejt zhvillimit të mëtejshëm të një dialogu sa më të dobishëm midis palëve në proces me qëllim zgjidhjen e problematikave të përbashkëta.

Së treti, Pjesëmarrja, shërben si një mjet për të luftuar korrupsionin:

Siç do ta shohim me poshtë, procesi i pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje, zhvillohet përmes disa faktorëve siç janë: komunikimi, dialogu dhe bashkëpunimi nëpërmjet qytetarëve dhe autoriteteve lokale. Ky komunikim dhe bashkëpunim arrihet nga qytetarët, n.q.s autoritetet lokale i garantojnë atyre të drejtën për t'u informuar mbi proceset vendimmarrëse dhe politikëbërëse. Informimi i vazhdueshëm ul ndjeshëm shanset për korrupsion, ndërkohë që niveli i ulët i korrupsionit sjell shërbime më të mira për qytetarët, rrit besimin e tyre tek autoriteti vendor, pra mundëson një qeverisje më të mirë dhe efektive.

Së katërti, pjesëmarrja rrit komunikimin e drejtpërdrejtë midis qytetarëve dhe vendimmarrësve dhe pasqell kuptimin më të mirë të nevojave.

Pjesëmarrja mundëson një proces të vazhdueshëm komunikimi mes vendimmarrësve dhe komuniteteve, duke u dhënë mundësi vendimmarrësve që të jenë koherentë dhe të njohin nevojat dhe prioritetet e komuniteteve lokale. Këto nevoja dhe prioritetet, vendimmarrësit i mbajnë në konsideratë në planifikimin e fondeve lokale, të cilat i orientojnë aty ku janë nevojat reale të komunitetit. Sipas politologut Robert A. Dahl, që qeveria të vazhdojë të reagojë për një periudhë ndaj parapëlqimeve të qytetarëve, duhet që të gjithë shtetasit madhorë të gëzojnë oportunitete të pacënuara. Të formulojë parapëlqimet e tyre, ti bëjë të njohura për njëri-tjetrin nëpërmjet aksionit individual ose kolektiv dhe të kenë të njëjtën peshë në sjelljen e qeverisë, d.m.th të vlerësohen jashtëqdo diskriminimi për shkak të përmbytjes ose burimit të tyre.⁴²

Së pesti, pjesëmarrja mundëson hartimin më të mirë të politikave publike:

Gjatë procesit të konsultimit publik, qytetarë të ndryshëm kontribuojnë me informacionet dhe ekspertizat e tyre. Pjesëtarët e komunitetit identifikojnë prioritetin/prioritetet dhe i percjellin ato tek autoriteti i pushtetit lokal që mund të jetë Kryetari i Bashkisë ose Këshilli Bashkiak. Gjatë procesit të konsultimit, qytetarët kontribuojnë me ide dhe propozime konkrete. Rrjedhimisht, politikat që bazohen në shumë informacione dhe ekspertiza janë më të mira.

Së gjashti, pjesëmarrja mundëson pranim më të gjerë të politikave nga publiku:

Kur qytetarët kanë marrë pjesë në hartimin e politikave nga autoritetet përkatëse shtetërore,

ata njëherazi kanë diskutuar, kanë dhënë opinionet dhe ekspertizën e tyre dhe rrjedhimisht sipalë të një procesi, kanë të gjithë informacionin e nevojshëm. Për këtë arsye politikat që hartohen nën frymën e bashkëpunimit dhe konsultimit, pranohen më lehtë nga aktorët, sepse ata jo vetëm që i njohin, por kanë shprehur dhe mendimin e tyre për to.

Së shtati, pjesëmarrja rrit besimin publik tek institucionet:

Besimi në institucionet publike është i rëndësishëm për suksesin e shumë politikave publike.

⁴² Robert A. Dahl, Poliarkia, Shtëpia Botuese dhe Shtypshkronja Pegi Tiranë 2005;2.

Mungesa e besimit kompromenton vullnetin e qytetarëve dhe bizneseve për t'iu përgjigjur politikave publike duke penguar në këtë mënyrë zhvillimin e qëndrueshëm.⁴³

Njëri nga instrumentet kryesore për të mundësuar rritjen e besimit publik, është edhe ligji për njoftimin dhe konsultimin publik.

Së teti, pjesëmarrja siguron rritje të transparencës:

Domosdoshmeria e transparencës me publikun duhet parë si një mjet për mirëqeverisje, gjithpërfshirje të grupeve të interesit dhe publikut në vendimmarrje. Kur vendimet janë transparente do të thotë se ato njihen në një masë të gjerë nga publiku. Një komunitet i informuar do të jetë një ndihmesë e madhe për garantimin e aktiviteteteve publike të bashkive.

Transparenca i bën autoritetet lokale më të përgjegjshme. Ato duke qenë përgjegjëse për politikën ekonomike, shërbimet sociale, shëndetin publik, arsimin, infrastrukturën publike etj, janë gjithashtu përgjegjëse për maksimizimin e efekteve dhe kontributeve pozitive që sjellin këto politika, në drejtim të zhvillimit të qëndrueshëm të territorit që ato menaxhojnë.

Së nënti, pjesëmarrja rrit qëndrueshmërinë e aksioneve qytetare, eficientë dhe efikasitetin:

Së dhjeti, pjesëmarrja forcon lidhjet brenda komunitetitetj.

Cilat janë barrierat që e kufizojnë pjesëmarrjen qytetare?

Faktorët që pengojnë realizimin e një procesi të suksesshëm të përfshirjes qytetare në vendimmarrje janë të shumtë dhe të ndërlikur me njëri-tjetrin:

Mungesa e komunikimit dhe dialogut.

E gjithë marrëdhënia njerëzore e shfaqur si marrëdhënie e njerëzve me njëri tjetrin, është në thelb një pafundësi komunikimesh. Gjithçka në fakt është komunikim, shprehet Prof. Dr. Artan Fuga në një nga librat e tij.⁴⁴ Sa më e fortë të jetë lidhja midis dy palëve, aq më i suksesshëm do të jetë procesi vendimarrës në interes të publikut. Pa komunikim nuk ka dialog dhe as bashkëpunim midis palëve. Sa më shumë që të dëgjojmë njëri -

⁴³ Instituti për Dekoraci dhe ndërmjetësim, Sondazh i opinionit Publik, Besimi në qeveri. E aksesueshme në linkun: http://idmalbania.org/p-content/uploads/2016/02/Raporti-i-plote_-sondazhi_besimi-ne-qeveri_2015.pdf faqe 13


⁴⁴ Artan Fuga, Komunikimi në shoqërinë masive, Shtëpia Botuese Papirus, Tiranë, 2014

tjetrin, të përpiqemi ta kuptojmë atë, aq më të lehtë do ta kemi për të zgjidhur problemet e përbashkëta dhe të marim përfitime të ndërsjellta. Rrugët për të vendosur dialog janë të shumta: takimet, ndërmjetësimet etj.

Mungesa e besimit.

Pjesëmarrja kërkon një komunikim të dyanshëm ose të ndërsjelltë mes qytetarëve dhe drejtuesve të pushtetit lokal, por kur këta nuk kanë besim tek njëri-tjetri, ky komunikim nuk arrihet. Njerëzit në përgjithësi nuk mund të bashkohen për të mbështetur synimet e tyre kur nuk kanë besim tek njëri-tjetri. Mosbesimi sjell mungesë solidariteti dhe konsensusi.

Grafiku nr 3



Burimi: Enida Haxhi

Rezultatet e anketimit dëshmojnë se 45% e qytetarëve të anketuar shprehen pozitivisht, pra besojnë se mendimi i shprehur prej tyre gjatë një procesi konsultimesh për një vendimarrje të caktuar, do të merret në konsideratë, kurse 25% e tyre nuk kanë besim se mendimi i tyre do të merrej në konsideratë. N.q.s do t'i shtojmë edhe 30% të qytetarëve që nuk janë të sigurtë, do të marrim një rezultat jo shumë të kënaqshëm. Ajo që vihet re është skepticizmi i qytetarëve për të influencuar në vendimarrje. Ata përgjithësisht shprehen mosbesues ndaj faktit nëse

mendimi i tyre do të influencojnë marrjen e një vendimi nga ana e autoritetit vendor.

Mungesa e bashkëpunimit.

Bashkëpunimi është mjeti me të cilin si qytatarët ashtu edhe autoritetet e qeverisjes vendore mund të realizojnë qëllimet e tyre të përbashkëta për një qeverisje sa më të mirë.

Sipas politologut amerikan Robert A.Dahl,⁴⁵ paaftësia për të bashkëpunuar i zvogëlon gjasat për realizimin me sukses të procesit të përfshirjes qytatare në vendimmarrje. Marrëdhëniet e aktorëve mund të shihen thjesht nën prizmin e bashkëpunimit. Rregulla kryesore këtu është: Jo vetëm mes nesh nuk ka konflikt, por edhe interesat tona janë të njëjta, ose të ndërthurrura deri në atë masë sa mund të fitojmë ose të humbasim së bashku. Sikurse sygjeron A.Dahl, strategjia më e mirë është ajo e bashkëpunimit të plotë dhe shmangies së të gjitha konflikteve të mundshme.


Mungesa e informacionit.

Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet. Autoriteti vendor, pra Bashkia është e detyruar të informojë kërkuesin nëse ka ose jo në zotërim informacionin e kërkuar. Për publikun, marrja e informacionit është e një rëndësie primare pasi pa këtë informacion, ata kursesi nuk mund të realizojnë të drejtën e tyre për të qënë pjesëmarrës aktivë në proceset vendimmarëse dhe politikëbërëse.

Para së gjithash janë autoritetet shtetërore që kanë detyrimin për t'i siguruar publikut aksesin e duhur në informacion dhe t'i përgjigjen pa vonesa kërkesave të tyre.

⁴⁵ Robert A.Dahl, Poliarkia, Shtëpia Botuese dhe Shtypshkronja Pegi Tiranë 2005;153.


Grafiku nr 4.



Burimi: Enida Haxhi

Nga analiza e rezultateve të pyetësorëve, rezulton se përgjithësisht qytetarët e kanë marrë informacionin në kohë dhe në përmbajtjen e kërkuar (grafiku nr 4). Kanali më i përdorur prej tyre për marrjen e informacionit është faja e internetit të Bashkisë. 52% e të anketuarve shprehën se shfrytëzojnë këtë mjet komunikimi. (grafiku nr.5)

Grafiku nr.5



Burimi: Enida Haxhi

Instrumentat që duhet të përdorin qytetarët për të qenë pjesëmarrës.

- Pjesëmarrja në votime:
Të votojnë dhe të zgjidhen në zgjedhjet periodike të pushtetit vendor për kryetar bashkie apo këshill bashkiak.
- Duke marrë pjesë në diskutime publike
- Duke marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak
- Duke u aktivizuar në Komisionin Këshillimor Qytetar Vendor
- Duke qenë aktivë gjatë konsultimeve të buxhetit në atë që njihet si procesi i buxhetimit me pjesëmarrje
- Duke nënshkruar peticione
- Duke drejtuar ankese, kërkesa, letra të zgjedhurve të tyre
- Duke ndërmarrë iniciativa qytetare
- Duke protestuar
- Referendumi.

Si të arrijnë që t'i përdorin këto instrumenta qytetarët?

Që qytetarët të arrijnë t'i përdorin këto instrumenta, së pari autoritetet vendore duhet të luajnë rolin e tyre kryesor në këtë proces, duke ndërmarrë masa organizative që janë në kompetencë të tyre:

Promovimi i pjesëmarrjes qytetare.

Autoritetet vendore do tëduhet të ndërmarrin nisma për tëorganizuar fushata sensibilizuese dhe ndërgjegjësimi nëpërmjet të cilave tëpromovojnë instrumentat vendimmarrëse, që kanë në dispozicion qytetarët e tyre pasi sikurse e trajtuam më sipër, pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje është një proces që sjell përfitime të dyanëshme, mbi të gjitha për autoritetin vendor, pra Bashkinë, e cila duke kuptuar më mirë nevojat e komunitetit e ka më të lehtë planifikimin e shërbimeve apo investimeve publike që do të kryejë.

Informacioni.

Krijimi i mundësive për komunikim dhe zgjerimi i të gjitha kanaleve të komunikimit si web-site i Bashkisë, afishimet në stendat e informimit, media etj nëpërmjet të cilave qytetarët të informohen për çdo vendim që ndikon tek ata. E drejta e qytetarëve për t'u informuar mbi vendimet e autoriteteve vendore buron nga fakti se ata janë tatimpagues dhe kjo duhet të përkthehet në shërbime dhe të mira publike në interes të tyre.


Konsultimi.

Autoritetet vendore e kanë detyrim që buron nga ligji për konsultimin publik dhe ligji për vetëqeverisjen vendore që çdo vendim duhet ta konsultojnë me komunitetin.

Për shembull, komuniteti duhet të ketë dijeni për datat se kur do të zhvillohen mbledhjet e këshillit bashkiak dhe çështjet që do të diskutohen sidomos për ato mbledhje, në të cilat tëmiratohet buxheti, investimet publike etj (çështje me interes të veçantë për ta)


Sikurse e tregojnë dhe rezultatet e këtij hulumtimi, qytetarët janë të interesuar të marrin pjesë në vendimmarrjet e Bashkisë n.q.s informohen për mbledhjet ku diskutohen taksat, buxheti dhe çështje të tjera që i ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e tyre.(grafiku nr 6)

Grafiku nr 6



Burimi:Enida Haxhi

Grafiku nr 7



Burimi:Enida Haxhi

Rezultatet gjithashtu dëshmojnë se vetë qytetarët nuk janë shumë aktivë dhe nuk kanë arritur të marrin përgjegjësitë që u takojnë për mbrojtjen dhe fuqizimin e të drejtës kushtetuese dhe ligjore për pjesëmarrje në proceset vendimmarrëse. Nga të gjithë të anketuarit, askush nuk kishte paraqitur në insitucionin vendimmarrës të Bashkisë (këshilli bashkiak) ndonjë iniciativë qytetare, vetëm 7% e tyre kishin qenë pjesëmarrës së paku një herë në këshillin bashkiak. (grafiku nr 7). Por kjo vjen edhe si rrjedhojë e mungesës së informimit nga ana e Bashkisë. Sipas rezultateve vetëm 6% kishin dijeni se çfarë është iniciativa qytetare dhe po 6% e qytetarëve të pyetur kishin dijeni se këshilli bashkiak duhet të konsultohet me ta, para se të marrë vendime.⁴⁶

⁴⁶ Sipas të dhënave të pasqyruara në grafikun nr 1.

Nga ana tjetër edhe vetë qytetarët duhet të jenë më të angazhuar dhe të mobilizohen nëpërmjet aksioneve qytetare, advokacisë, lobimit etj për t'i imponuar "zërin" e tyre autoriteteve shtetërore vendore.

Përfundime

Mbështetur në analizën e zhvilluar në këtë studim lidhur me gjëndjen aktuale të pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrjen e Bashkisë Devoll, u nxorën përfundimet e mëposhtëme:

1. Qytetarët shprehen se janë të gatshëm për të qenë aktivë dhe të përfshihen në vendimmarrje, nëse Bashkia më parë i ka siguruar atyre akses të plotë në informacion.
2. Studimi tregoi se qytetarët nuk janë mjaftueshëm të informuar për veprimtarinë e Bashkisë. Mungesës së informacionit i bashkangjitet edhe mungesa e besimit sesëancat e keshillimit apo mbledhjet e Këshillit Bashkiak, nuk kanë funksionuar apo nuk janë instrument i garantimit të një vendimmarrjeje demokratike e pjesëmarrëse në Bashkinë Devoll.
3. Qytetarët treguan se arsyeja për të marrë pjesë është e drejtuar nga vetë interesi i tyre. Ata marrin pjesë kur mendojnë se kanë diçka për të humbur apo për të fituar.
4. Qytetarët ishin të gatshëm dhe e vleresonin si pozitiv procesin e përfshirjes së tyre në vendimmarrje.
5. Qytetarët, ishin mosbesues në një masë relativisht të madhe, ndaj faktit nëse mendimi i tyre i shprehur gjatë një seance konsultimi do të merrej ose jo në konsideratë.

Rekomandime

1. Faktorët që pengonin realizimin e një procesi të suksesshëm gjithpërfshirës të publikut në vendimmarrje ishin: mungesa e informacionit, komunikimit dhe besimit etj. Bashkia Devoll duhet të marrë masat e duhura për uljen e barrierave që e kufizojnë procesin e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje.
2. Bashkia Devoll duhet të mbërrijë më lehtë dhe më shpejt tek qytetarët: t'i ofrojë atyre akses të plotë në informacion duke fuqizuar kanalet e informimit publik, në mënyrë që publiku të vihet gjithmonë në dijeni të çdo vendimi të marrë për ta nga kjo Bashki.

3. Bashkia Devoll duhet të prirret që vendimmarrjet e saj t'i bazojë në një proces të gjerë konsultimi publik dhe të përpiqet të fitojë besimin e qytetarëve.
4. Bashkia Devoll duhet të promovojë “pjesëmarrjen në vendimmarrje” duke ndërmarrë nisma të tilla si fushata sensibilizuese, ndërgjegjësimi.
5. Qytetarët duhet të jenë më tepër aktivë dhe të mos hezitojnë të propozojnë ide, nisma të ndryshme, iniciativa qytetare pranë Bashkisë.
6. Bashkia Devoll nga njëra anë dhe qytetarët në tjetrën, duhet të vendosin ura komunikimi, dialogu dhe bashkëpunimi të ndërsjelltë, pasi sa më e fortë të jetë lidhja midis dy palëve, aq më i suksesshëm do të jetë procesi vendimmarrës në interes të të dy palëve.

Bibliografia

- Anastasi, Aurela. Historia e institucioneve, Ribotim, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, 2004, f. 42-251
- Arnstein, Sherry R.A ladder of Citizen Participation, Journal of the American Planning Association, 1969, 35:4, 216-224 DOI 10.1080/10944366908977225
- Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare, 2015, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.8417, datë 21.10.1998 të Kuvendit Popullor, Miratuar me referendum më 22.11.1998.
- Dahl, Robert A. Poliarkia, Shtëpia Botuese dhe Shtypshkronja Pegi, Tiranë 2005;2.
- Dalton, Russell J. The participation gap: Is citizen participation actually good for democracy?, *University of California*, <http://blogs.lse.ac.uk/euoppblog/2017/08/23/the-participation-gap-is-citizen-participation-actually-good-for-democracy/#Author>.
- ECNL, Civil Participation in Decision-Making Processes, An Overview of Standards and Practices in Council of Europe Member States, 2016, <https://rm.coe.int/168068690f>.
- Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, viti 2015, numri 249, ligji nr 139/2015 date 15.12.2015, Per veteqeverisjen vendore.

Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, Viti: 2014 – Numri: 178, ligj nr 146/2014 date 30.10.2014 ,Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik.

Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, Viti: 2014 – Numri: 160, ligj nr 119/2014 date 18.09.2014,Për të drejtën e informimit.

Fuga, Artan. Komunikimi në shoqërinë masive, Shtëpia Botuese Papirus, Tiranë,2014.

Groves, Malcolm. Regenerating Schools.Leadng the transformation of standards and services through community engagement, British Library, 2008,73.

https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016805d1979

Hart, Roger R.Children’s participation.The theory and Practice of Involving Young Citizens in Community Development and Environmental Care, UNICEF, 1997,

https://books.google.al/books?hl=en&lr=&id=ncRSAQAQBAJ&oi=fnd&pg=PP1&dq=R.HART+ABOUT+PARTICIPATION&ots=u5mzkR_iEë&sig=xERYsGeQ6YQlbQAMgiRSdbKyLOE&redir_esc=y#v=onepage&q&f.

Instituti per Dekoraci dhe ndërmjetësim,Sondazh i opinionit Publik, Besimi në qeveri,2015,13

,http://idmalbania.org/ëp-content/uploads/2016/02/Raporti-i-plote_-sondazhi_besimi-ne-qeveri_

Karta Evropiane

, <http://conventions.coe.int/Treaty/EN/Treaties/Html/122.htm>.

Kodi i praktikës së mirë

,http://www.coe.int/t/ngo/Source/Code_English_final.pdf

Udhëzimet e Maahstrihtit , <http://www.unece.org/environmental-policy/conventions/public-participation/aarhus-convention/tfëg/envppppdm/ppdm-recs.htm>

ORPHAN WORKS-ALBANIA AND KOSOVO: TWO DIFFERENT LEGAL FRAMEWORKS

Dr. Ergysa Ikonimi*

Abstract

Albania adopted the new law on author's rights and other neighboring rights in 2016, which abolished the law of 2005. This new law is totally approximated with some EU directives and partially with some others, without including the EU directive on orphan works.

On the other hand Kosovo, which law on authors rights dates back to 2004, had made some amendments and supplements same year Albania adopted the new law, but in contrast these supplements include mainly the way the orphan works are disciplined.

As the orphan works have turned into an economic and social international problem, the Albanian law does not fulfill the obligation to give them a status and to determine the way to use them.

This paper aims to give an overview of the Albanian and Kosovo legislations on orphan works. Through this paper will be analyzed the risks of using the orphan works in Albania. As legal provisions on orphan works are needed the paper will try to determine the best possible solution to be applied in Albania.

Key words: *orphan works, Albanian law, Kosovo law, memory institutions, diligent search*

Introduction

“Orphan works” is probably the best way to call the copyright protected works, which authors are not known or difficult to be located. The situation is *quasi* the opposite of the right of paternity, where in the case of the orphan works there is lack of relevance between the work and its author.

*Dr. Ergysa Ikonimi, Department of Law, Faculty of Human Sciences, “Ismael Qemali” University of Vlora, Albania. e-mail: ergysa83@yahoo.com

There are different causes which bring a work of any genre to be considered “orphan”:

- The simplest case is that the author or the authors of the work are not known: the work was published anonymously or never published, or when the identity of the author could have been once known, but the information was lost over time.¹ So even it is a copyright protected work, there is no rightholder to claim rights over it. If the work is created by two or more co-authors and even if all of them are identified, if they aren’t located after a diligent search, the work receives the status of the orphan work.
- Other times it is also difficult to determine the legitimate heirs which can benefit from author’s rights. So this is another case when the work is considered orphan by the law.
- In some other cases the right holder could have been a legal entity which has ceased to exist.
- Actually the digital world and the widespread use of internet and electronic devices have created a different group of copyrighted works, which because of their informality and the collaborative creation due to the efforts of many users are considered orphan works, such as: blogs, web-pages and wikis.² As a special case of this group can be mentioned the abandonwares, which are computer softwares that are no longer supported by their owners, or sold, like classic old games.

It is quite important to highlight that in the case that the right holders can be located, but there is a dispute among them about the ownership of the work, the situation appears to be”: “two or a number of persons claim rights of ownership of a work”. The precise right holder(s) is not known, but he is located. So the work cannot be considered an orphan one.³

¹Lifshitz-Goldberg, Y. (2010). Orphan Works. WIPO Seminar, p. 3, *retrieved from*:
http://www.wipo.int/edocs/mdocs/sme/en/wipo_smes_ge_10/wipo_smes_ge_10_ref_theme11_02.pdf

²Lifshitz-Goldberg, Y. (2010). Orphan Works. WIPO Seminar, p. 3, *retrieved from*:
http://www.wipo.int/edocs/mdocs/sme/en/wipo_smes_ge_10/wipo_smes_ge_10_ref_theme11_02.pdf

³ According to the Canadian Law, the Copyright Board has no jurisdiction to issue a license if the right holders are unknown, but located, because it primarily

It is not only the technological development to blame for the big number of orphan works, but also there are two major legal factors which have increased artificially the number of them. Probably there is no need to explain more than what copyright is considered to be: the economic foundation for the creative industry and as an important tool for ensuring that the creative sector is rewarded for its work.

But, on behalf of the right benefits for the owners of the works, the extension of their term of protection is enlisted as one of two major factors of increasing the number of orphan works. In the case *Eldred v Ashcroft*⁴ the petitioners argued that about the extension of the copyright term, not for the newly created works, but for those works with the existing copyright terms that should have gone in the public domain, if the extension would not be applied to them.

The other factor is related to Bern Convention principle of formality-free protection, since the creation of the work and its fixation automatically brings copyright protection,⁵ without registration or renewal.⁶ In the case of *Kahle v Gonzales*⁷ the plaintiffs brought suit against government because of the changes made in copyright regime in USA. It was considered a dramatic change the removal of the renewal requirement: from **opt-in** to **opt-out**, which could bring consequences especially in exploiting the works that allegedly had little or no commercial value providing no incentives for their authors, but still remaining under copyright protection. They argued that the opt-in system served as a filter that passed mainly the works without commercial value in the public

has no competence to adjudicate ownership disputes among competing claimants: see De Beer, J. & Bouchard, M. (2009). Canada's "Orphan Works" Regime: Unlocatable Copyright Owners and the Copyright Board. p. 16, retrieved from:

<http://www.cb-cda.gc.ca/about-apropos/2010-11-19-newstudy.pdf>

⁴*Eldred v Ashcroft* (2003). United States Supreme Court, retrieved from: <http://caselaw.findlaw.com/us-supreme-court/537/186.html>

⁵WIPO Publications No. 891. Guide to the Copyright and Related Rights Treaties administered by WIPO and Glossary of Copyright and Related Rights Terms. p. 41, retrieved from:

http://www.wipo.int/edocs/pubdocs/en/copyright/891/wipo_pub_891.pdf

⁶Netanel, W. N. (2008). Copyright's Paradox. Oxford University Press, NY, USA, p. 200

⁷*Kahle v Gonzales* (2007). United States Court of Appeals, Ninth Circuit, retrieved from:

<http://caselaw.findlaw.com/us-9th-circuit/1323375.html>

domain. The new opt-out system would inevitably affect the increase of the average copyright term and at the same time the decrease of the number of works currently entering the public domain. Both the cases the court supported the changes of copyright law.

The increasing number of orphan works, especially during the last two centuries has caused a lot of problems in administration and use of these works. As mentioned before the problems are both economic and social:

First, there are a lot of institutions, often called memory institutions, like: publicly accessible libraries, educational establishments and museums, as well as archives, film or audio heritage institutions and public-service broadcasting organisations, which mission is to preserve the cultural heritage and to promote the spread of knowledge, that are put in serious difficulties in order to fulfill their own function. In this case the real problem lies in the inability to provide *ex ante* the consent of the rightholders of the orphan works necessary for digitization and making them available to the public. The way the digital technology gives memory institutions to safely store that collections, also creates opportunities to give ever greater number of people to benefit from them.⁸

Second, there is always hesitation from researchers or producers to use the orphan works. Even if there is the possibility to be protected under the fair use, they are afraid from the risk for liability for copyright infringement. To avoid judicial costs they choose not to use the orphan works, even these works may have particular values. This means that the orphan work problem may frustrate the further reutilization of them, using their scientifically and culturally valuable content as building blocks for new works.⁹

Third, there is violation of the general interest of the society, as long as the the orphan works can't be available to the public, which lacks the opportunity to know and benefits culturally from them. If these resources cannot be widely available there is no fulfillment of the important social

⁸Statement of best practices in fair use of collections containing orphan works for libraries, archives and other memory institutions (2014). p. 5, *retrieved from*: <http://cmsimpact.org/code/statement-best-practices-fair-use-collections-containing-orphan-works-libraries-archives-memory-institutions/>

⁹Van Gompel, S. &Hugenholtz, P. B. (2010). The orphan works problem: the Copyright conundrum of digitizing large- scale audiovisual archives, and how to solve it. *International Journal of Media and Culture*, Vol. 8 (1), p.2, *retrieved from*: <http://www.tandfonline.com/doi/abs/10.1080/15405700903502361>

interest in facilitating researchers and the broader public's understanding of the knowledge contained in them.¹⁰

In this situation of uncertainty, created by the existence of orphan works, there are different legal solutions provided actually, which try to equilibrate the general interest in using orphan works and the private interest of a possible rightholder, and also to diminish the liability and the costs in administration and using of orphan works.

The Albanian legislation on orphan works

In a very short sentence: *Albania does not have any legal provision on orphan works.*

In Albania during the long years of dictatorship the creative and scientific activity were totally supervised by the state. This important activity had to survive many controls at different levels and often purposely modified before being available to public. Only after the 90s many artists presented their hidden works, prohibited for their contents, especially the erotic ones.

The actual law on author's rights and other neighboring rights is the third law in a row adopted in Albania after the 90s. The adoption of this law was one of the EU- Albania Stabilization and Association Agreement obligations (art. 73), and also was the main objective of the National Strategy on Application of Intellectual Property Rights (2010-2015) as the analytic Report of the European Commission (2010) identified that the previous law was incompatible with some EU Directives.¹¹ Until 2015 Albania had not yet adopted the new law, so the progress reports for Albania of European Commission (2014 and 2015) revealed the little progress regarding intellectual property rights and highlighted the urgent need to adopt the new law.

The Albanian government report on the new draft law explained the purpose of the new law to be: *"the ensuring of a better level of protection for authors, artists and copyright holders in general, ensuring an appropriate environment for guaranteeing and respecting these rights,*

¹⁰Statement of best practices in fair use of collections containing orphan works for libraries, archives and other memory institutions (2014). p. 5, *retrieved from*: <http://cmsimpact.org/code/statement-best-practices-fair-use-collections-containing-orphan-works-libraries-archives-memory-institutions/>

¹¹Ikonomi, E. & Zyberaj, J. (2017). E Drejta e Re e Autorit në Shqipëri dhe të drejtat e lidhura. Botimet Pegi, Tiranë, p. 13

ensuring a full balance between the rights of private rightholders and public interest for information, as well as appropriate business climate”.

The same government report enlisted the EU directives with which the new law would be fully or partially approximated, avoiding the EU directive on orphan works. The report made it clear that the Directive 2012/28 EU is specific, so to be fully approximated with further legal amendments of the law. The relevant explanation on exclusion was justified by the fact that: *“this is a directive which also the countries of the region, where the structure of this law based, have approximated after they have become part of the EU. So, even among the EU member states there are countries which have not made it part of their national laws because of the specifics of its regulatory object and their national context”*.¹²

The new law in Albania, since its adoption, is supplemented with other legal acts mainly concerning the approval of the tariffs for the services offered by DDA (Directory of Authors Rights), the procedures of licensing the AAK (Agencies of Collective Administration) and also the procedures of registering and classification of the works. After *quasi* two years the Albanian legal framework on author’s rights lacks the specific provisions on orphan works.

This situation is of course not favorable in using the orphan works, but I think this is probably “supported” by the lack of awareness, not only of the importance of orphan works, but mostly of the general low level of awareness of the importance of both moral and economic rights of authors. Despite the legal efforts, Albania is not one of the countries where the author rights are highly applied and respected, even though the violation of these rights may constitute criminal offenses, provided by the Penal Code.

The lack of legal provisions on orphan works has not caused a debate after the adoption of the new law, but I think that we need those provisions in order to avoid any risk coming from the (un)proper use of orphan works. If there is a case of using an orphan work and after there is someone claiming author’s rights, the problem not only will be difficultly

¹²According to a survey conducted by ACE (Association Cinéma-théâtres Européennes) in February 2015, eight member states (Cyprus, Portugal, Luxembourg, Poland, Belgium, Romania, Bulgaria and Lithuania) had not transposed yet the Directive 2012/28 EU, surpassing the deadline determined in 29 October 2014, *retrieved from*: <http://project-forward.eu/2015/04/03/ace-survey-on-the-implementation-of-the-orphan-works-directive/>

solved, but all the costs would be faced and covered by the parties involved in it.

The Kosovo legal “solution” on orphan works

Kosovo has preceded Albania on orphan works. The law amendments in 2016 were mainly to offer a proper regulation on orphan works and other issues similar to the European countries as these amendments were approximated with Directive 2012/28 EU and other directives, since the year 2011 marked significant legal changes in EU regarding author's rights.¹³

Actually, the Kosovo law on author's right determines what can be called orphan works, and the institutions and the organizations which have the mission of public interest that can use them. According to the Kosovo law all genres of work can be considered orphan, such as: literary, cinematographic, audiovisual works and phonograms, or other work's parts which are protected and attached to them and constitute integral part of them. This law considers as orphan work not only a full and completed work of any genre (as a whole), but also works and other subject-matters which are embedded or attached or constitute an integral part of them.

The law, according to the specifics of the work, also determines for each category of works the **sources** of the complete search in Kosovo and also allows *“if there are facts that suggest that relevant information on rights holders can be found on other states, the **sources** of information available in these other states should also be consulted”*. The use of these sources, different for each category of work, shows that there is provided for the maximum attention in considering a work as orphan. The search must have these characteristics:

- **Reasonable**-for each kind of work should be consulted the proper sources. The Kosovo law provides for separate sources that can (and should) be used for the search, based on the genre of the orphan work.

¹³Parliamentary Research on Author's rights and Neighbouring Rights (2015). Prishtinë, p. 5, retrieved from: <http://www.amchamksv.org/wp-content/uploads/2016/11/HP-Drejtat-e-Autorit-dhe-t%C3%AB-Drejtat-e-P%C3%ABraf%C3%ABrta.pdf>

- **Complete-** for each work should be used one, some or all the domestic or foreign proper sources if needed.
- **Prior-** the search should be carried out before use. It is logical as copyright demands prior consent of the right holders in order to reproduction, digitization and make available to the public of the work.
- **In good faith**¹⁴- the search should be clear, leaded by the only reason to find the author(s), respecting privacy¹⁵ and without neglecting any information in the hurry to terminate the search.¹⁶
- **Documented-** the organization which realizes the search should keep records on it and submit it to ZDADP (Office for the Rights of Authors and Related Rights) despite the results, which means that the full search leads to the conclusion that a work is to be considered orphan, or the change of status of the orphan work.

There is no determination of the subjects who can conduct a diligent search, so potentially it is possible that the person interested in using an orphan work can do it, or there is to be considered a more “professional” way through specialized agencies that can charge for the work required.

¹⁴The Italian law associates with the “good faith”, the term “professional correctness”, as an added obligation that reinforces the way every professional should behave during the search, based on common practice other than written norms, performing actions accepted by the professional ethics.

In Canada the law does not requires expressively “good faith”, but the applicant’s intentions is considered to affect the quality and the reasonableness of the search. The Copyright Board does not impose formal regulations, but informal standards evaluating the adequacy of the search on a case-by-case basis. There are some relevant factors that matters, like the nature of the applicant, the nature of work and information about its owner, see De Beer, J. & Bouchard, M. (2009). Canada’s “Orphan Works” Regime: Unlocatable Copyright Owners and the Copyright Board. p. 17-18, *retrieved from*: <http://www.cb-cda.gc.ca/about-apropos/2010-11-19-newstudy.pdf>

¹⁵The respect for privacy is quite an ethical and legal problem in the process of the diligent search. The diligent search, although has as final goal the location of the author, should not violate his right to privacy, that perhaps the author has given it priority, rather than being known as the author of the work by drawing the attention of the public. In this perspective, I believe that the co author is not obliged to reveal information for the location of an other co author.

¹⁶The hurry to terminate the search often creates uncertainty about the result. That is why the search should be extended as necessary or as reasonable, by avoiding to wrongly qualify a work as an orphan one.

The status of “orphan work” is not definitive. It will expire if the right holder becomes known or is located.

The provisions state that when there is more than one rights holder, but not all have been identified, or they are identified but not located, the work or the phonogram may be used in accordance with this law if the rights holders identified and located have authorized the organization to make the reproduction and making it available to the public. The organization should inform ZDADP about the way of using the orphan works.

Although the Kosovo regulation of orphan works is quite similar to Directive 2012/28 EU, it doesn't provides specifically in the case that the right holders comes forward and claim their rights. The directive states that there is the obligation to give them retrospectively a fair compensation for the use that has been made of their work. It is quite clear that the beforehand use of the orphan work and other subject-matters it is not seen as a copyright infringement. That's why the EU Directive mentions the term “compensation” than “damage” and also tries to adapt the level of compensation to the use of the work, taking in account the non-commercial nature of the use made by memory institutions. The Directive states also that if a search was not diligent and a work was wrongly given the status of the orphan work, this is to be considered a copyright infringement. Considering the mission of memory institutions the Directive also permits and motivates the public-private partnership agreements.

Finding a solution suitable for Albania

It is very interesting that there are countries which have developed different and efficient systems in administering and using the orphan works.

There have been at least two important attempts in USA (2006 and 2008 Orphan Works bills). Both of them died without advancing. But especially the 2008 Bill introduced very good ideas in using the orphan works. It was required a prior reasonably diligent search from the user. If the author could not be located the user had to file a notice of use with the Register of Copyrights and then might use the work until the author came forward and demands to stop the use of it. The user could pay a reasonable royalty for using the work and also paying back royalties for the previous use if there had been a commercial advantage from it, except

when the work was primarily used for a charitable, religious, scholarly, or educational purpose. Both the diligent search and the negotiation of royalties should be carried out in good faith. That system proposed was simple and in general limited the remedies in a civil action brought for infringement of copyright in an orphan work.¹⁷

In UK there is a different system of using an orphan work. The UK licensing system is an online system that has been designed with users in mind, whether they were applicants or a right holders and the scheme balanced those different priorities.¹⁸ An orphan works license applies for use only in UK. It is non-exclusive and can be for commercial or not commercial use. It can last up to seven years, but is renewable. There is a register to consult about previous applications and licenses, for the term of protection and the exceptions. It is required a diligent search in accordance with IPO published guidance. The costs include the application fee and the license fee. The license fee is calculated the moment the application process is started, in order that the applicant must decide to go ahead or not. The fee depends on how many different works and uses are required to be licensed. Not every application is successful. The scheme works also for the right holder, who can claim the paid license fee or can demand to stop an application for license. The moment the right holder has been identified, no further licenses will be issued.¹⁹

The Nordic countries and also Hungary and Czech Republic have presented a different system which includes the Extended Collective Licenses (ECL). Under this system a Collective Management Organization(CMO) which represent a “substantial” number of right holders of a specific copyrighted works may also grant licenses for works of that category, which are owned by non-members. Even the administration of the orphan works is not a goal of CMOs, this system considers them as one stop shop, as the only part (instead of many right holders) to negotiate with users of orphan works.²⁰ So the users have to

¹⁷Orphan Works Act (2008).*retrieved from:*

<https://www.congress.gov/bill/110th-congress/house-bill/5889>

¹⁸UK IPO (2015). Orphan works: review of the first twelve months, p. 3, *retrieved from:*

https://www.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/487209/orphan-works-annual-report.pdf

¹⁹UK IPO (2018). Copyright: orphan works, *retrieved from:*

<https://www.gov.uk/guidance/copyright-orphan-works#overview>

²⁰International Intellectual Property- A handbook of conterporary research. D. J. Gervais (Ed.), Edward Elgar Publishing, UK, USA.p. 199-201, *retrieved from:*

enter in agreement with the specific CMO. The extended collective licensing does not require that a diligent search for the owner is carried out before the orphan work becomes part of the license. But this system provides assurance to the user against liability for infringement.²¹

The Kosovo law amendments on orphan works are quite similar with EU provisions of Directive 2012/28 EU. It is a smart solution to “shorten the way” to the fully approximation of law with EU directives, even that the integration of Kosovo in EU seems far away.

The Directive 2012/28 EU is thought as a statutory exception or limitation to the right holders for memory institutions, but for restricted (permitted) uses of orphan works. There are states, like Italy,²² which had made amendments to their national laws identic to the Directive, and also have provided for the solution that the memory institutions, in the fulfillment of their missions, have the power to conclude agreements for the use of the orphan works. These agreements must not conflict with the normal exploitation of the work and must not prejudice the interests of the right holders. The moment the right holders are known these agreements have to stop the effects and they have the right to a fair compensation.

Even not pretending to foresee the legal solution that Albania will apply relating to orphan works, it is more likely to harmonize the law with the Directive 2012/28 EU. In order to have a complete regulation relating to an extensive use of the orphan works, it is best that the amendments of law provides for the administration and use of orphan works, not only by memory institutions, but also from scholars, researchers, musicians, producers, etc. The copyright laws aim to balance the opposite directions of the author’s interest and public interest. To achieve this, the intervention in the Albanian law must be serious, well thought, but also simple by avoiding excessive bureaucracy.

<https://books.google.al/books?id=Z4EZBgAAQBAJ&pg=PA199&lpg=PA199&dq=norway+orphan+works&source=bl&ots=Emx1rWY7cn&sig=HWlD3Hj885Bq9PRpB69aO0HCnrE&hl=sq&sa=X&ved=0ahUKEwjWzomJifPYAhXPJIAKHfbIDyMQ6AEIbzAJ#v=onepage&q=norway%20orphan%20works&f=false>

²¹Lueder, T. (2010). The “orphan works” challenge. p.13, *retrieved from*:

<http://fordhamipconference.com/wp-content/uploads/2010/08/TilmanLueder.pdf>

²²Legge 22.04.1941, n. 633 “Protezione del diritto d’autore e di altri diritti connessi al suo esercizio”, aggiornato, *available at*:

https://www.siae.it/sites/default/files/BG_Normativa_LeggeDirittoAutore.pdf

Even so I believe that referring at the examples mentioned above, the nordic practice is not so likely to be applied because in Albania the CMOs are not very used and considered by the authors. The US practice seems a liberal approach. I think that the UK provided solution is clear, very practic and avoids the contact of the user with the potential right holder, so avoiding further liabilities and costs for future ageements in order to conclude over the fair compensation. The UK system has a weak point: the payment of the (non refundable) fee, even though the right holder may never come forward to claim his rights.

Conclusions

There is a problem arising from the existence of orphan works. There is a great potential of intellectual property lying into them which need an adequate solution of using them without copyright infringement. The lack of proper legal regulation could lead to future costly arrangements.

It is quite clear that neglecting or legally ignoring them may create an unpleasant situation, which can possibly can take place in both directions: (1) the orphan work may be considered “the forbidden fruit” that many need to have it, but turn away without getting and using it, or (2) for “the most courageous” the use of it may bring further serious consequences, like a lawsuit for damage. That is why Albanian legislators should not wait more in order to make important amendments regarding the use of orphan works. The Kosovo legal framework on author’s right turns out to be more specific and complete, providing for the use of orphan works.

Probably the moment I am writing about the orphan works, another orphan work has been noted to exist. So dealing with the orphan works is not only a problem of the present. There is real need to provide for the future orphan works, in order to limit the number of them and to reduce further problems. Even though the national laws and also international conventions have a liberal approach on to what is to be considered a work, I think that is best to make the authors aware of the importance of recording their works and offering their data to the administrative bodies which have the obligation of registration of the works. This can made be possible if the national responsible offices promote data collection, offer fast and low costs²³ procedures for registration and motivate the authors to “reinforce” their right of paternity.

²³Actually there are low fees applied in Albania for the registration of the author’s rights. There is the possibility to register one or more of them at the

Bibliography

- De Beer, J. & Bouchard, M. (2009). Canada's "Orphan Works" Regime: Unlocatable Copyright Owners and the Copyright Board, *retrieved from:*
<http://www.cb-cda.gc.ca/about-apropos/2010-11-19-newstudy.pdf>
- Ikonomi, E. & Zyberaj, J. (2017). E Drejta e Autorit në Shqipëri dhe të drejtat e lidhura. Botimet Pegi, Tiranë
- Lifshitz-Goldberg, Y. (2010). Orphan Works. WIPO Seminar, *retrieved from:*
http://www.wipo.int/edocs/mdocs/sme/en/wipo_smes_ge_10/wipo_smes_ge_10_ref_theme11_02.pdf
- Lueder, T. (2010). The "orphan works" challenge, *retrieved from:*
<http://fordhamconference.com/wp-content/uploads/2010/08/TilmanLueder.pdf>
- Netanel, W. N. (2008). Copyright's Paradox. Oxford University Press, NY, USA
- Van Gompel, S. & Hugenholtz, P. B. (2010). The orphan works problem: the Copyright conundrum of digitizing large- scale audiovisual archives, and how to solve it. *International Journal of Media and Culture, Vol. 8 (1)*, *retrieved from:*
<http://www.tandfonline.com/doi/abs/10.1080/15405700903502361>
- International Intellectual Property- A handbook of conterporary research. D. J. Gervais (Ed.), Edward Elgar Publishing, UK, USA, *retrieved from:*
<https://books.google.al/books?id=Z4EZBgAAQBAJ&pg=PA199&lpg=PA199&dq=norway+orphan+works&source=bl&ots=Emx1rWY7cn&sig=HWID3Hj885Bq9PRpB69aO0HCnrE&hl=sq&sa=X&ved=0ahUKEwjWzomJifPYAhXPJIAKHfBIDyMQ6AEIbzaAJ#v=onepage&q=norway%20orphan%20works&f=false>
- Parliamentary Research on Author's rights and Neighbouring Rights (2015). Prishtinë, *retrieved from:*
<http://www.amchamksv.org/wp-content/uploads/2016/11/HP-Drejtat-e-Autorit-dhe-t%C3%AB-Drejtat-e-P%C3%ABraf%C3%ABrta.pdf>
- Statement of best practices in fair use of collections containing orphan works for libraries, archives and other memory institutions (2014), *retrieved from:*

same time, and the cost for one work despite its genre is less than one euro.
Decision of the Council of Ministers no. 33, date 18/01/2017

<http://cmsimpact.org/code/statement-best-practices-fair-use-collections-containing-orphan-works-libraries-archives-memory-institutions/>

WIPO Publications No. 891. Guide to the Copyright and Related Rights Treaties administered by WIPO and Glossary of Copyright and Related Rights Terms, *retrieved from:*

http://www.wipo.int/edocs/pubdocs/en/copyright/891/wipo_pub_891.pdf

UK IPO (2015). Orphan works: review of the first twelve months, *retrieved from:*

https://www.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/487209/orphan-works-annual-report.pdf

UK IPO (2018). Copyright: orphan works, *retrieved from:*

<https://www.gov.uk/guidance/copyright-orphan-works#overview>

<http://project-forward.eu/2015/04/03/ace-survey-on-the-implementation-of-the-orphan-works-directive/>

Directive 2012/28 EU “On certain permitted uses of orphan works”

Albanian Law No 35/2016 “On author’s rights and other neighboring rights”

Decision of the Council of Ministers of Albania no. 33, date 18/01/2017

Kosovo Law No 04/L-065 “On author’s rights and neighboring rights”

Kosovo Law No 05/L-047 “On amending and completing Law No 04/L-065 “On author’s rights and neighboring rights”

Legge 22.04.1941, n. 633 “Protezione del diritto d’autore e di altri diritti connessi al suo esercizio”, aggiornato, *retrieved from:*

https://www.siae.it/sites/default/files/BG_Normativa_LeggeDirittoAutore.pdf

Orphan Works Act (2008). *retrieved from:*

<https://www.congress.gov/bill/110th-congress/house-bill/5889>

Eldred v Ashcroft (2003). United States Supreme Court, *retrieved from:*

<http://caselaw.findlaw.com/us-supreme-court/537/186.html>

Kahle v Gonzales (2007). United States Court of Appeals, Ninth Circuit, *retrieved from:*

<http://caselaw.findlaw.com/us-9th-circuit/1323375.html>

MBROJTJA E DËSHMITARËVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Fatbardha Ismaili*

Abstrakt

Ky studim analizon mbrojtjen e dëshmitarëve në Maqedoni drejtpërsëdrejti përmes Ligjit për Mbrojtje të Dëshmitarëve, duke dhënë një vështrim të përgjithshëm mbi ligjin dhe duke identifikuar sfidat kyç në zbatimin e tij. Më tutje, ky punim shqyrton çfarë është bërë deri më tani në fushën e mbrojtjes së dëshmitarëve në vend dhe në arenën ndërkombëtare, duke shqyrtuar alternativat e mundëshme për përmirësim si dhe ndryshim të kornizës ligjore. Përfundimisht, ky punim analizon dy alternativat kryesore të politikave dhe e rekomandon alternativën më të arsyeshme.

Maqedonia është një vend në tranzicion, sistemi gjyqësor në këtë vend ka pësuar ndryshime rrënjësore për t'a përafruar atë me standardet evropiane. Megjithatë me një ritëm më të ngadaltë, këto ndryshime do të vazhdojnë edhe në të ardhmen e afërt. Një shoqëri në tranzicion është një shoqëri shumë delikate dhe vendet në tranzicion, janë goditur nga krimi i organizuar me të gjitha format e tij. Paralelisht me luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, është thelbësor që të ndërtohet një sistem i fortë gjyqësor me një nivel të lartë integriteti, ku palët të kenë besim se konfliktet e tyre do të zgjidhen në mënyrë të drejtë dhe transparente bazuar në fakte dhe prova të besueshme dhe sidomos në dëshmitë e dëshmitarëve. Për të inkurajuar dhënien e informacionit nga ana e dëshmitarëve, duhen marrë masa gjithashtu që paraqitja e tyre në procesin gjyqësor të jetë sa më e barabartë dhe e sigurtë dhe të mos ndërhyjë në jetën normale të dëshmitarit më shumë se sa është e nevojshme.

Fjalë kyç: *procedura penale, mbrojtja e dëshmitarëve, Ligjit për Mbrojtje të Dëshmitarëve.*

* Doc. dr. Fatbardha Ismaili, Fakulteti Juridik, Universiteti i Tetovës,
fatbardha.ismaili@unite.edu.mk

Hyrje

Krimi i organizuar si një dukuri negative shoqërore me të gjitha manifestimet, kompleksitetin dhe sofistikimin e tij, ka qenë gjithmonë një problem serioz i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikon në zhvillimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve dhe i fundos vlerat themelore të një shoqërie moderne demokratike. Ai si një "kancer" ngadalë dhe në mënyrë sistematike ka hyrë në çdo "qelizë" të shoqërisë duke shkaktuar pasoja të rënda dhe të paparashikueshme në jetën ekonomike, kulturore, juridike, sociale dhe në përgjithësi në çdo sferë duke atakuar themelet e shtyllave mbi të cilat është ndërtuar ose duhet të ndërtohet një shoqëri e shëndetshme.

Paralelisht me luftën kundër krimit, është thelbësor që të ndërtohet një sistem i fortë gjyqësor me një nivel të lartë integriteti, ku palët të kenë besim se konfliktet e tyre do të zgjidhen në mënyrë të drejtë dhe transparente, bazuar në fakte dhe prova të besueshme, dhe sidomos në dëshmitë e dëshmitarëve. Dëshmitarët janë një element i rëndësishëm në proceset gjyqësore dhe për pasojë, edhe për funksionimin e çdo sistemi gjyqësor. Për këtë arsye është e nevojshme të sigurohet sa më shumë të jetë e mundur që dëshmitarët të paraqiten në gjykim dhe të japin dëshmi të sakta dhe të vërteta, kjo do të thotë që të ketë masa për parandalimin e dëmtimit, frikësimit, kanosjes apo ndikimit në forma të tjera të dëshmitarëve.

Në Maqedoni ashtu si edhe në shumë vende të tjera, dalja si dëshmitar është detyrim ligjor. Sidoqoftë nuk është e arsyeshme që dikush të detyrohet të paraqitet si dëshmitar, nëse kjo gjë do të rrezikonte jetën dhe sigurinë e tij. Prandaj detyrimi për t'u paraqitur si dëshmitar duhet të balancohet nga ana tjetër me të drejtën e jetës së dëshmitarit dhe të familjes, siç shprehet në nenet 2 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe me të drejtën e përgjithshme për sigurinë e personit dhe të pronës. Për të inkurajuar dhënien e informacionit nga ana e dëshmitarëve, duhen marrë masa gjithashtu që paraqitja e tyre në procesin gjyqësor të jetë sa më e qetë dhe e sigurtë dhe të mos ndërhyjë në jetën normale të dëshmitarit më shumë se sa është e nevojshme. Dëshmitarët shpeshherë janë pre e kërcënimit dhe dhunës. Dëshmitarët mund të vriten me qëllim që të mos dëshmojnë, gjithashtu mbi ta mund të ushtrohet presion me anë të dhunës apo kërcënimeve ose ata edhe mund të "blihen".

Sistemi i mbrojtjes së dëshmitarëve

Sistemi i mbrojtjes së dëshmitarëve me dispozitat tregon probleme dhe mospërputhje të shumta në aplikim. Duke pasur parasysh se ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve është aplikuar më shumë se një dekadë, dhe në ndërkohë, sistemi i drejtësisë penale ka pësuar ndryshime të mëdha, lind nevoja për rishikimin e dispozitave të caktuara që ai përmban. Autoritetet vendore janë angazhuar për të rregulluar problemet aktuale në zbatimin praktik, si në aspektin e masave të mbrojtjes, forcimi institucional dhe funksionalitetin e organit sipas ligjit ekzistues (Këshilli për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe Departamentit për mbrojtjen e dëshmitarëve) si dhe harmonizimin e tij me dispozitat e tjera nga sfera penale.¹

Gjithashtu, një nga prioritetet në kuptim të këtij ligji është për të zgjidhur çështjen e mbrojtjes së dëshmitarëve në procedurat për ndjekjen e veprave penale të lidhura dhe të cilat dalin nga përmbajtja e përgjimit të paligjshëm të komunikimeve. Dëshmitarët nuk janë të mbrojtur sa duhet me zgjidhjet aktuale legislative dhe se është e nevojshme mbrojtja më e madhe e tyre.²

Nga ndryshimet legislative pritet të zvogëlohet numri i personave që do të njohin identitetin e dëshmitarit të mbrojtur, por gjithashtu se prokuroria speciale mund të mbrojë dëshmitarët e tillë në mënyrë të pavarur nga Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë. Sipas zgjidhjes ekzistuese ligjore, identiteti i këtyre dëshmitarëve prej starti është i njohur për 15 persona, duke përfshirë prokurorin publik republikan dhe drejtorinë e Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve.

Domethënë, që një person i caktuar të bëhet dëshmitar i mbrojtur ose të përfshihet në Programin për dëshmitarët e mbrojtur, propozimi paraqitet nga Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë në bazë të një kërkesë me shkrim të marrë nga prokurori publik kompetent, gjyqtari që merret me rastin ose Ministria e Punëve të Brendshme. Kërkesën që të jetë dëshmitar i mbrojtur mund ta paraqesë edhe vetë dëshmitari, i cili refuzon të dëshmojë publikisht, nga frika e sigurisë së tij dhe për të afërmit e tij. Vendimi, megjithatë sillet nga Këshilli, i cili përbëhet nga pesë anëtarë: një gjykatës nga Gjykata Supreme, një nga zëvendës prokurorët publik, drejtori i Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve, një përfaqësues nga

¹Nacrt strategija za reforma na pravosudniot sektor za periodot 2017-2021 so akciski plan.

²Veličkovič, B, 2016, Zastiteniot svedok vo makedonskoto kazнено pravo, *Pravdiko, Zdruzenie na mladi krivičari na Republika Makedonija*.

Ministria e Brendshme dhe Shefi i Njesisë në Ministrinë e Brendshme. Anëtarët e Këshillit nga ana tjetër kanë zëvendësit e tyre.³

Kjo do të thotë se qysh në fillim, diku pesëmbëdhjetë njerëz e dinë identitetin e dëshmitarit të mbrojtur, prandaj Prokuroria publike speciale insiston të ulin numrin e njerëzve, pasi kjo mund të çonte në shpërndarje të informacionit, gjë që do të kërcënonte sigurinë e dëshmitarëve. Prandaj përmes ndryshimeve prokuroria speciale kërkoi që Këshilli të anashkalohet dhe vendimi mbi atë se kush do të bëhet dëshmitar nën mbrojtje duhet të përcaktohet personalisht nga prokuroria speciale. Ekzistonte frika te dëshmitarët e mbrojtur për shkak të afërsisë dhe marrëdhëniet e individëve me institucionet, përfaqësuesit e të cilëve janë pjesë e Këshillit për mbrojtjen e dëshmitarëve me strukturat politike, të cilët në përputhje me mandatin e prokurorisë speciale janë të përfshirë në hetimin që e udhëheq ky institucion.

Për përgatitjen e ndryshimeve dispozitive janë të udhëzuar nga përvojat e disa vendeve evropiane si Italia, ku prokurori që lufton me mafien ka kompetenca të veçanta për të përcaktuar statusin e një dëshmitari të mbrojtur në lëndët kundër atyre të dyshuar për përfshirje ose bashkëpunimin me mafian.⁴

Masat në dispozicion për mbrojtjen e dëshmitarit janë:⁵ fshehtësia e identitetit; sigurimi i mbrojtjes personale; ndryshimi i vendbanimit, domethënë qëndrimi dhe ndryshimi i identitetit.

Bashkëpunimi institucional dhe ndërkombëtar

Në zbatimin e masave mbrojtëse, si dhe aktivitete të tjera nga fushëveprimi i funksionimit të Departamentit për Mbrojtjen e Dëshmitarëve, shteti, organet dhe institucionet e tjera janë të detyruara ti ofrojnë ndihmë Departamentit. Është e nevojshme për të kryer shkëmbimin e të dhënave në mënyrë që nuk do të rrezikohet siguria e personave të mbrojtur.

³Neni 6 Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve në RM (“Gazeta zyrtare e RM”, nr. 38/05).

⁴Buzarovska- Lazetic, G. 2016, Procesni merki za zashtita na svedoci vo komparativното i domashното pravo, *Zastita na svedocite, sorabotnicite na pravdata i na zrtvite vo domasното i vo meunarodното pravo*. Megjunarodnata organizacija za migracii-IOM i svajcarskata agencija za razvoj i sorabotka-SDC (69-88).

⁵Neni 26 Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve në RM (“Gazeta zyrtare e RM”, nr. 38/05)

Ndër të tjera, Departamenti do të bashkëpunojë me Ministrinë e Punëve të Jashtme ministrinë e drejtësisë, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, Drejtorinë e Doganave, Drejtorinë për pastrimin e parave, Zyrën e Revizionit Shtetëror, kompanitë e sigurimeve dhe subjekte të tjerë.

Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare do të realizohet në mënyrë që mbrojtja e dëshmitarëve - viktimat të trafikimit të qenieve njerëzore në Republikën e Maqedonisë që nuk hyjnë në Programin e Mbrojtjes së Dëshmitarëve, por ata marrin një lloj mbrojtje teknike gjatë hetimit të policisë dhe procesit gjyqësor dhe të cilët sipas saj vazhdojnë të jetojnë në vendin e tyre të origjinës.⁶

Në këtë pjesë, roli i organizatave ndërkombëtare është të ofrojnë shërbime ligjore, psikologjike dhe asistencë sociale për dëshmitarët - viktimat të trafikimit të qenieve njerëzore ose, kur po hidhen në vende të treta ku dëshmitarët - viktimat do vazhdojnë të jetojnë.

Përfundimi

Bazuar në analizën e dokumenteve ndërkombëtare, si dhe në përvojat krahasuese të disa vendeve në rajon dhe më gjerë, mund të konkludohet se disa çështje nuk janë të rregulluara në mënyrë adekuate me LMD. LMD duhet përshtatur për problemet aktuale në zbatimin praktik, si nga aspekti i masave për mbrojtje, forcimi institucional dhe funksionalizimi i organeve të parashikuara me ligjin ekzistues (Këshilli për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Njësia për Mbrojtjen e Dëshmitarëve), si dhe përafrimi i tij me rregulloret e tjera nga sfera penale.

Gjithashtu, një nga prioritetet në lidhje me këtë Ligj është të rregullojë çështjen e mbrojtjes së dëshmitarëve në procedurat për ndjekjen e krimeve të lidhura dhe që rrjedhin nga përmbajtja e përgjimit të paligjshëm të komunikimeve. Sipas zgjidhjes ekzistuese ligjore, vendimi merret nga Këshilli, i cili përbëhet nga pesë anëtarë: një gjykatës nga Gjykata Supreme, një nga zëvendës prokurorët publik, drejtori i Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve, një përfaqësues i Ministrisë së

⁶Fidanovski, L. 2015, Ulogata na MVR za zastita na svedoci vo implementacija na merkite za zastita. *Zastita na svedocite, sorabotnicite na pravdata i na zrtvite vo domasnoto i vo megjunarodnoto pravo*. Megjunarodnata organizacija za migracii-IOM i svajcarskata agencija za razvoj i sorabotka-SDC, fq.50.

Brendshme dhe Shefi i Njesisë në Ministrinë e Brendshme. Anëtarët e Këshillit nga ana tjetër kanë zëvendësit e tyre.

Kjo do të thotë se qysh në fillim, gati dhjetë persona e dinë identitetin e një dëshmitari të mbrojtur, prandaj duhet zvogëluar numrin e personave, pasi kjo mund të çojë në zbulimin e informacionit, gjë që do të kërcënonte sigurinë e dëshmitarëve. Prandaj, për rastet të cilat i udhëheq prokuroria speciale ajo duhet të vendosë se kush do të jetë dëshmitar nën mbrojtje.

Kryesisht zvogëlimi i numrit të personave që do të njohin identitetin e dëshmitarit të mbrojtur, por gjithashtu vendimi i pavarur i prokurorisë speciale, pavarësisht nga Prokuroria Publike republikane, për të mbrojtur dëshmitarët e tillë. Me këtë propozim-ndryshim do të mundësohet implementimi i plotë i parimit të autonomisë së Prokurorisë speciale d.m.th prokuroria speciale duhet të ketë autonomi dhe pavarësi të plotë në ndjekjen e veprave penale të lidhura dhe që rrjedhin nga përmbajtja e përgjimit të paligjshëm të komunikimeve. Që në fillim me keto ndryshime mund të eliminohen pengesat e shumta në punën e Prokurorisë speciale. Për analizë të rëndësishme është një nga masat mbrojtëse të parashikuara në nenin 30 të Ligjit për Mbrojtjen e Dëshmitarëve, ndryshimi i vendbanimit, veçanërisht duke pasur parasysh që Republika e Maqedonisë, ndryshe nga disa vende të tjera, si Amerika ku mund të bëhet zhvendosje në vende qindra milje larg, Maqedonia është një vend i vogël me njohje të ndërsjella, të zhvilluara dhe marrëdhënie familjare. Është e justifikueshme të pyesim nëse mund ta zhvendosim një person të caktuar, i cili është dëshmitar i mbrojtur nga Shkupi, për shembull në Veles ose në ndonjë qytet tjetër në të gjithë Republikën e Maqedonisë, pa rrezikuar fshehtësinë e identitetit të tij? Dhe çka nëse ekziston një rrezik i vërtetë për jetën dhe një nevojë paralele për të shpërndarë njerëz të tjerë nga familja e tij ?!

Në këtë pjesë, është thelbësore të vendoset bashkëpunimi rajonal me autoritetet gjyqësore me vendet fqinje në drejtim të hartimit të strategjive dhe marrëveshjeve dypalëshe për t'u marrë me këtë çështje që do të vendoste bazën për krijimin e të ashtuquajturës. "Shtëpitë e sigurta" në të cilat mund të realizohet dislokimi i dëshmitarëve të mbrojtur dhe zhvendosja e këtyre njerëzve në mes të shteteve pa ndonjë pengesë dhe pa komplikime.

Rregullimi dhe implementimi i suksesshëm i kësaj çështje sjell rritjen e numrit të dëshmitarëve të gatshëm për të dëshmuar, gjykime të suksesshme të kryerësve të krimit, përmirësim i sistemit të drejtësisë, sundim më të fortë të ligjit. Pasi në mbarë botën, mbrojtja e dëshmitarëve

konsiderohet një nga komponentët kyç të sundimit të ligjit dhe e aftësisë së shtetit për të siguruar drejtësi.

Masat e posaçme të mbrojtjes janë: "Ndryshimi i identitetit, ndryshimi i vendbanimit, mbrojtja e përkohshme e identitetit, e të dhënave dhe dokumenteve, masa të veçanta mbrojtëse, fizike dhe teknike, rehabilitimi social, ruajtja, ndryshimi dhe sigurimi i përkohshëm i vendit të punës, dhënia e ndihmës financiare, rikualifikimi profesional, dhënia e këshillave dhe e ndihmës së specializuar ligjore ose mënyra të tjera të caktuara sipas ligjit. Në seancat gjyqësore, dëshmitarët e mbrojtur dhe bashkëpunëtorët e drejtësisë mund të dëgjohen nën një identitet tjetër/të rremë me anë të metodave të posaçme për deformimin e zërit ose me anë të lidhjes audiovizive. Sidoqoftë, përdorimi i dëshmitarëve anonimë duhet të jetë i kufizuar, pasi kjo gjë e mbart në vetvete rrezikun që i pandehuri të mos ketë mundësinë t'i kundërshtojë efektivisht deklaratat e një dëshmitari.

Bibliografia

- Buzarovska -Lazetic,G. 2016, Procesni merki za zashtita na svedoci vo komparativното i domashното pravo, *Zastita na svedocite, sorabotnicite na pravdata i na zrtvite vo domasното i vo megjunarodното pravo*. Megjunarodnata organizacija za migracii-IOM i svajcarskata agencija za razvoj i sorabotka-SDC (69-88).
- Fidanovski, L. 2016, Ulogata na MVR za zastita na svedoci vo implementacija na merkite za zastita. *Zastita na svedocite, sorabotnicite na pravdata i na zrtvite vo domasното i vo meunarodното pravo*. Megjunarodnata organizacija za migracii-IOM i svajcarskata agencija za razvoj i sorabotka-SDC (43-52).
- Kajalxhiev, G. 2016, Zastita na svedocite od aspect na çovekovite prava, *Zastita na svedocite, sorabotnicite na pravdata i na zrtvite vo domasното i vo megjunarodното pravo*. Megjunarodnata organizacija za migracii-IOM i svajcarskata agencija za razvoj i sorabotka-SDC (53-68).
- Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve në RM ("Gazeta zyrtare e RM", nr. 38/05).
- Ligji për prokurorinë publike ("Gazeta zyrtare e RM", nr. 111/08).
- Ligji për prokurorinë speciale ("Gazeta zyrtare e RM", nr. 08- 4352/15).

Nacrt strategija za reforma na pravosudniot sektor za periodot 2017-2021 so akciski plan.

Veličkovič, B, 2016, Zastiteniot svedok vo makedonskoto kazneno pravo, *Pravdiko, Zdruzenie na mladi krivičari na Republika Makedonija.*

GLOBALIZIMI, INOVACIONI DHE KONKURRENCA

Fatime Musliu, PhD student

Sv.Kiril dhe Metodij Universiteti i Shkupit, Republika e Maqedonisë
fatime_musliu@hotmail.com

Abstrakt

Ky material përmban segmentet në vijim: Shpjegimi teorik i globalizimit dhe ndikimi i globalizimit në treg, qëllimi i globalizimit në sfera të ndryshme si, konkurrenca dhe punësimi, roli i globalizimit dhe ndikimi i globalizimit në krijimin e vendeve të punës, konkurrenca dhe bruto produkti vendas. Për më tepër, do të flasim për ndikimin e globalizimit në inovacion dhe rritjen e konkurrencës. Globalizimi, në kuptimin më të shkurtër, paraqet integrimin e gjithçkaje me çdo gjë tjetër. Globalizimi, në një përkufizim më të plotë, është integrimi i tregjeve, ekonomisë dhe teknologjisë, në një mënyrë që minimizon botën nga një shkallë të madhe në një masë të vogël. Globalizimi ka mundësuar që të gjithë njerëzit të jenë më pranë njëri-tjetrit, pavarësisht se ku jetojnë, duke krijuar lidhje më të shpejta dhe më të lira, Globalizimi ka mundësuar që të gjithë njerëzit të jenë më pranë njëri-tjetrit, pavarësisht se ku jetojnë, duke krijuar lidhje më të shpejta dhe më të lira dhe më shumë se kurrë më parë, duke lejuar që bota të arrijë secilin prej nesh në të njëjtën mënyrë.

Globalizimi ka ndryshuar mjedisin konkurrues të kompanive. Ky material synon të kontribuojë në të kuptuarit e ndryshimeve që një kompani mund të përballojë përmes analizimit të ndikimit të drejtuesve dhe efekteve të globalizimit në modelet e konkurrencës së industrisë dhe zinxhirit të vlerave të kompanisë.

Kufijtë e forcave të konkurrencës po veniten, pasi globalizimi ekonomik ka çuar në një dinamikë të re në situatën konkurruese, ku kompanitë dhe aktivitetet e zinxhirëve të vlerave ndryshojnë vend midis forcave dhe ndikimit dhe bashkëveprojnë me njëri-tjetrin në mënyra të reja. Kufijtë e kompanive dhe thelbi i tyre mund dhe po ripërcaktohen. Ndërsa ky potencial evoluon përmes ofrimit të detajuar, transferimit dhe fragmentimit të zinxhirit të vlerave. Presioni i konkurrencës detyron një lëvizje të vazhdueshme dhe rritje në këtë drejtim.

Fjalë kyç: *globalizimi, tregu, konkurrenca, produkti, punësimi.*

Hyrje

Globalizimi është një fenomen i pashmangshëm në historinë e njerëzimit, gjë që e bën botën shumë më të vogël duke rritur shkëmbimin e mallrave, shërbimeve, informacionit, njohurisë dhe kulturës mes dy vendeve. Megjithatë, përkundër përdorimit të gjerë të termit, duket se ende nuk ka një definicion të saktë dhe të pranuar gjerësisht. Kjo është për shkak të faktit se vetë termi përfshin një numër të madh dimensionesh si një dimension ekonomik, politik, socio-kulturor dhe mjedisor - ekologjik. Bhagëati e përshkruan globalizimin si një proces, në të cilin njerëzit janë të unifikuar në një shoqëri, një proces që kombinon forcat ekonomike, politike dhe socio-kulturore me forcat teknologjike.

Në përgjithësi, globalizimi ka dy kuptime:

- a) Si fenomen, nënkupton që çdo herë dhe më shumë rritet ndërvarësia mes vendeve dhe rajoneve të ndryshme në botë, veçanërisht në fushën e tregtisë, financës dhe komunikimit
- b) Si teori e zhvillimit, një nga parimet themelore të saj është se sa më i lartë është niveli i integritetit aq më shumë krijon vend midis rajoneve të ndryshme të botës dhe se ky nivel i integritetit ndikon në kushtet konservatore dhe ekonomike të vendeve¹.

Ndikimi i Globalizimit në Republikën e Maqedonisë


Globalizimi ka vënë në lëvizje një proces të fuqishëm të ndryshimeve, që prek të gjithë. Teknologjia e re, e mbështetur nga politika më të hapura, ka krijuar një botë të ndërlidhur si kurrë më parë. Kjo marrëdhënie ka krijuar ndërvarësi më të madhe në marrëdhëniet ekonomike - tregti, investime, financa dhe organizimin e prodhimit në nivel global, por gjithashtu një ndërveprim social dhe politik midis organizatave dhe individëve në mbarë botën².

Nga hulumtimet e bëra në mes kompanive dhe ekipeve të tyre të menaxhimit, konkludojmë se (42%) globalizimi sjell mundësi dhe kërcënime, 21% është proces pozitiv që ofron mundësi dhe 37% është një proces negativ që sjell vetëm kërcënime.

¹Reyes, G. E., 2001, TEORÍA DE LA GLOBALIZACIÓN: BASES FUNDAMENTALES, University of Pittsburgh, USA, стр. 45,46. достапен на: file:///C:/Users/klient/Downloads/Dialnet-TeoriaDeLaGlobalizacion-5029712.pdf

²Amato, G, Cardoso, R, etc., 2004, "Comisión Mundial sobre la Dimensión Social de la Globalización", Primera edición, ISBN 92-2-315426-X, стр, 10,

Figura 1




Burimi: Sikaleska, A. V. (2016), Journal of Sustainable Development.

Listat e mundësive që sjell globalizimi janë në krye me zgjerimin e tregut (33%), e ndjekur me operacione të përmirësuara (28%), bashkëpunim të avancuar me klientët dhe furnitorët (21%), reduktimet e kostos (14%) si dhe importimin dhe eksportimin më të lehtë të mallrave (4%)³.

³Sikaleska, A. V. (2016), Journal of Sustainable Development, Integrated Business Faculty, Skopje, Republic of Macedonia, Volume 6, Issue 15, p.49.

Figura 2



Burimi: Sikaleska, A. V. (2016), Journal of Sustainable Development.

Inovacioni dhe Konkurenca


Inovacioni, siç përcaktohet nga Manuali i Oslos, konsiston në zbatimin e një produkti të ri ose të përmirësuar dukshëm, i një procesi të ri, një metode të re të marketingut ose një metodë të re organizative në praktikën e biznesit, organizimi i vendeve të punës ose organizimi i marrëdhënieve të jashtme. Për këtë arsye themi se, inovacioni shkon përtej hulumtimit dhe zhvillimit dhe mbulon një gamë të gjerë aktivitetesh, që ndihmojnë firmat më produktive dhe konkurruese. Inovacioni është një nxitës i madh i rritjes ekonomike dhe të ngjashëm, në zhvillimin politik të novacionit, konsiderohet si një nga themelet e strategjisë ekonomike të qeverive⁴.

Inovacioni në biznes arrihet në mënyra të ndryshme, duke i kushtuar shumë vëmendje kërkimit dhe zhvillimit për "risitë revolucionare". Nëse e kuptojmë inovacionin si "aftësi për të ripërcaktuar modelet ekzistuese të biznesit, në mënyrë që ata të gjenerojnë vlera të reja për konsumatorët, dhe të gjenerojë pasuri të re", koncepti do të jetë në lidhje me një model të ri biznesi, duke bërë konkurrencë reale mes modeleve dhe koncepteve

⁴ OECD (2010a), "The OECD Innovation Strategy: Getting a Head Start on Tomorrow", OECD, Paris, ISBN 978-92-64-08347-9(PDF).

më shumë se sa midis produkteve apo kompanive. Inovacioni është domosdoshmëri e çdo organizate moderne dhe pjesë e strategjisë globale të kompanive, për të konceptuar krijimin dhe për të fituar një avantazh konkurrues. Një vizion më i gjerë mund të ndihmojë një vend për të kapur më shumë burime, një vizion që mund të aplikohet në këto fusha të punës⁵:

Tabela1



Për Republikën e Maqedonisë me rëndësi është rritja e vazhdueshme e ekonomisë. Si një alternativë për rritjen e ekonomisë është zhvillimi i konkurrencës në sektorin privat. Pasi që Maqedonia nuk është në gjendje të konkurojë me pagesa me kosto të ulët për një periudhë të gjatë, inovacioni dhe përmirësimi i konkurrencës përmes njohurive është vendimtare. Kjo strategji synon në fillimin e transformimit të vendit në një ekonomi të bazuar në dije – ekonomi, e cila do të jetë në gjendje të konkurojë në tregun ndërkombëtar nëpërmjet punës së kualifikuar dhe inovative të kompanive. Duke pasur parasysh disponueshmërinë e kufizuar të resurseve dhe nevojën për të zhvilluar një masë kritike të burimeve dhe kompetencave për të konkuruar në nivel ndërkombëtar, një strategji e "specializimit të zgjuar" siguron një bazë të shëndoshë për ndërtimin e sistemit kombëtar të inovacionit. Specializimi i zgjuar përfshin inkurajimin e investimeve në programe, që do të plotësojnë asetet produktive të vendit, për të nxitur aftësitë e brendshme në të ardhmen dhe avantazhin krahasues ndërajonal⁶.

⁵Corea Garsia, S.M., Innovación como Estrategia para la Globalización, <http://www.ur.mx/LinkClick.aspx?fileticket=9ME4z296PEA%3D&tabid=2636&mid=11797>.

Duke e pranuar idenë dhe strategjinë e lartpërmendur, duhet të theksohet edhe fakti se, teknologjia e lartë e posedon një pjesë të suksesit, por që nuk domethënë se është vendimtare. Mund të kemi një ekonomi të suksesshme edhe me një teknologji normale, por me rëndësi është që vendi t'i përkushtohet vlerave reale, ndoshta edhe atyre tradicionale dhe të mundohet t'i zhvillojnë duke i drejtuar burimet drejt sektorëve ku zotërimet dhe aftësitë ofrojnë potencialin më të madh për të lëvizur zinxhirin e vlerës, duke lehtësuar kështu specializimin e mençur.


Pra parimi i diskriminimit pozitiv është ndër parimet e rralla që e karakterizojnë Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Ky parim parashihet që një pakice i jepen më shumë të drejta se që në fakt meriton, të cilat nuk u garantohen të tjerëve. Pra në rastin e Kosovës, kjo i është dhënë komunitetit serb për pjesëmarrje në jetën publike dhe në vendimarrje, gjë që ka shkaktuar një pabarazi ndërmjet komunitetit serb dhe komuniteteve të tjera në Kosovë.²⁰

Kohët e fundit në media qarkulloi një lajm se Bullgaria pretendon se në Kosovë jetojnë 50.000 bullgarë. Kështu ka bërë të ditur në një intervistë për Radion Kombëtare Bullgare kryetari i Agjencisë Shtetërore për

¹⁹ Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Rasti Nr. KO130/15. Burimi: http://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/amicus_curiae_brief_ki_shq.pdf vizituar më 28.12.2017.

²⁰ Arsim Bajrami, Zenun Halili, Jusuf Zejneli, Florent Muçaj, *Pozita Kushtetuese dhe Ligjore e Pakicave Kombëtare- Aspekte Krahësuese*, Artini, Prishtinë, 2015. Fq: 140-141.

Bullgarët Jashtë Shtetit, Petër Harallampiev.²¹ Sipas tij pas suksesit historik lidhur me njohjen e minoritetit bullgar në Shqipëri, që ndodhi muaj më parë, në kohë të afërt kjo mund të bëhet fakt edhe në Kosovë, ku supozohet se jetojnë afër 50 mijë pjesëtarë të komunitetit bullgar, duke aloduar në goranët e gorës, pretendime ndaj të cilëve kanë shprehur dhe Serbia dhe Maqedonia.

Komuniteti malazez në Kosovë merr pjesë në Këshillin Konsultativ për Komunitete. Presidenti i Kosovës gjatë vitit të kaluar i ka premtuar këtij komuniteti që do njihen edhe me kushtetutë dhe rrjedhimisht do kenë ulëse në Kuvend.²² Qeveria më 22 mars 2017 miratoi Strategjinë për afirmimin dhe integrimin e komunitetit malazez në Republikën e Kosovës 2016-2021, e cila figuron në listën e qeverisë për dokumentet strategjike valide.²³

Trajtimi kushtetues dhe ligjor i minoriteteve në vendet e rajonit

Edhe në vendet e rajonit ka tendencë të avancimeve ligjore të komuniteteve. Për të mos u larguar shumë nga fokusi kryesor i temës, që ka të bëjë me pozitën e minoriteteve në Kosovë, por sa për ta pasuruar punimin dhe lehtësuar kuptimin e tij kemi marrë disa shembuj krahasues nga vende të rajonit si: Shqipëria, Mali i Zi dhe Maqedonia. Shqipëria në tetor të vitit të kaluar, ka miratuar ligjin për mbrojtjen e pakicave kombëtare (që deri atëherë nuk kishte pasur fare ligj për pakicat), ku në momentet e fundit është shtuar dhe komuniteti bullgar, pas një letre të europarlamentarëve bullgarë, drejtuar Kuvendit të Shqipërisë, e cila nga disa opinione është cilësuar si letër presioni.²⁴ Në kuptimin e këtij ligji, pakicat kombëtare në Republikën e Shqipërisë janë pakicat greke, maqedonase, arumune, rome, egjiptiane, malazeze, boshnjake, serbe dhe

²¹Burimi: <http://www.koha.net/arberi/59267/bullgaria-pretendon-se-ne-kosove-jetojne-50-mije-bullgare/> vizituar më 28.02.2018.

²²Burimi: <http://www.president-ks.gov.net/sq/lajme/presidenti-thaci-priti-perfaqesuesit-e-komunitetit-malazez-ne-kosove> vizituar më 03.01.2018.

²³Qeveria: Zyra e Kryeministrit, Lista e Dokumenteve Strategjike Valide, përditësuar më 4 Maj 2017. Burimi: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Lista_e_dokumenteve_strategjike_valide.pdf vizituar më 23.12.2017.

²⁴Burimi: <http://www.panorama.com.al/letra-e-pe-presioni-shqiperia-shton-bullgaret-dhe-njeh-me-ligj-9-pakica-kombetare/> vizituar më 09.01.2018.

bullgare.²⁵ Kjo shtron dilemën se në të ardhmen Bullgaria do mund në të njëjtën mënyrë të kushtëzojë të ardhmen evropiane të Kosovës, me njohjen e minoritetit bullgar në Kosovë. Në vitin 2014 në Shqipëri ndodhi një reformë e madhe territoriale ku kishte shqetësime nga minoriteti grek, deri në reagim edhe të Greqisë. Mirëpo krijimi i tre bashkive, ajo e Finiqit, e Dropullit dhe e Pustecit, ishte tërësisht për interesa të komuniteteve dhe ruajtjes së tyre, për dallim nga 58 bashki të tjera që u themeluan mbi kriterin e funksionalitetit.

Pra, Shqipëria pjesën më të ndjeshme historikisht e ka me raportet me minoritetin grek në jug, pasi që kjo çështje tejkalon dimensionin e të drejtave të njeriut, duke pasur implikime të përdorimit politik të kësaj çështje nga ana e Athinës zyrtare. Në këtë fillim viti janë zhvilluar bisedime të nivelit të lartë mes dy vendeve, po që nuk kanë qenë deri më tani shumë transparente për publikun. Në dhjetor qeveria shqiptare mori përsipër ndërtimin e varrezave të ushtarëve të vrarë grek gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Viti 2017 shënoi edhe përparim në trajtimin e minoriteteve në Mal të Zi. Pas shumë orvajtjeve, Tuzi me popullatë shumicë shqiptare është shpallur komunë. Edhe ligji i ri për përdorimin e simboleve kombëtare i miratuar vitin e kaluar, avancon përdorimin e simboleve të pakicave, në komunat ku ato përbëjnë 5% të popullsisë.

Në Maqedoni, kuvendi ka miratuar ligjin e ri për gjuhët, me shumë vështirësi së pari për shkak të mosnënshkrimit të presidentit dhe vështirësitë në tejkalimin e 35 mijë amandamenteve të propozuara nga opozita maqedonase. Ligji ende nuk është publikuar në fletoren zyrtare, megjithatë neni 1 i ligjit për përdorimin e gjuhëve thotë se gjuhë zyrtare në gjithë territorin e Maqedonisë dhe në raportet e saja ndërkombëtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik. Ndërsa paragrafi i dytë nga neni i parë parasheh që gjuhë zyrtare të jetë edhe gjuha që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe shkrimi i saj.²⁶ Ky ligj nuk përmend decidivisht gjuhën shqipe, por në mënyrë të qartë është avancim i përdorimit të gjuhës shqipe për shkak që mbi 20% e flasin këtë gjuhë në Maqedoni. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, gjuha shqipe do ketë avancim të përdorimit në nivelin qendror, por pa pasur barazi juridike me gjuhën zyrtare maqedone, që mbetet me kushtetutë gjuha e vetme zyrtare në Maqedoni.

²⁵Ligji Nr. 96/2017 Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë, Neni 3. Burimi: <https://www.parlament.al/wp-content/uploads/2017/04/ligj-nr-96-dt-13-10-2017-1.pdf> vizituar më 12.02.2018.

²⁶Burimi: <http://ina-online.net/ja-ligji-plote-se-si-dhe-ku-eshte-zyrtare-gjuha-shqipe-dokument/> vizituar më 25.02.2018.

Ndërsa disa pjesë diskutabile në lidhje me përdorimin e gjuhës shqipe në valutë dhe ushtri me gjasë do të shkojnë në Komisionin e Venedikut.

Përfundime

Kosova në përgjithësi është rast sui generis në Evropë, sa i përket të drejtave të komuniteteve, të cilat janë të sanksionuara në Kushtetutën e Kosovës dhe aktet e tjera ligjore, por edhe me mekanizmat shumë nivelësh institucional të krijuara enkas për pjesëmarrje dhe integrim të minoriteteve. Nga ky aspekt, Kosova paraqitet si shtet mjaft gjëneroz në garantimin e të drejtave të komuniteteve minoritare. Në anën tjetër që me Pakon e Ahtisarit dhe Kushtetutë është zbatuar parimi i diskriminimit pozitiv, e që me dialogun Kosovë-Serbi vetëm se është thelluar në segmente të ndryshme. Ky parim i diskriminimit pozitiv vlen ekskluzivisht për komunitetin serb, duke krijuar ndjenjë pabarazie në komunitetet e tjera dhe që ka krijuar vështirësi në funksionimin e sistemit politik të Kosovës. Andaj nga krejt këto që u thanë deri këtu, mund të arrijmë në konkludim se trajtimi i pakicave në Kosovë, nuk paraqet modelin më të avancuar funksional që mund të jetë. Kjo ka ndodhur si rezultat i të kaluarës së shoqërisë kosovare, vështirësive në arritjen e subjektivitetit të plotë ndërkombëtar të Kosovës, marrëdhëniet mes etnive të ndryshme në vend, por edhe për shkak të së tashmës së brishtë dhe rezervave se si mund të rrjedhin gjërat më tutje.

Edhe në vendet fqinje në vitin e fundit ka përparim në garantimin e të drejtave të komuniteteve në ato vende. Kjo ka ndodhur si rezultat edhe i presionit ndërkombëtar ndaj këtyre shteteve që tenton t'i avancojë sa më parë në integrimet euroatlantike. Shqipëria në vjeshtën e vitit të kaluar për herë të parë miratoi ligjin për pakicat, që është prej ligjeve model në aspektin e avancimit dhe garantimit të të drejtave minoritare. Mali i Zi me hyrjen në NATO dhe avancimit për integrim në UE, ka shënuar përparimin më të madh që pas pavarësisë së saj në kuadrin ligjor për respektim të të drejtave minoritare. Në Maqedoni, shqiptarët janë në numër të madh, andaj nuk mund të trajtohen si pakicë e thjeshtë. Qeveria e re deri më tani është treguar më e hapur për avancim të pozitës shqiptare dhe minoriteteve të tjera në vend dhe për zbatimin e plotë të Marrëveshjes së Ohrit.

Bibliografia

- Bajrami, Arsim, (2012), *Të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në sistemin kushtetues të Republikës së Kosovës*, në Constitutio, Revistë studimore për çështje juridiko – kushtetuese dhe parlamentare, *Pozita Kushtetuese dhe Ligjore e Pakicave në Regjion*, 2/2012. ISKP, Prishtinë.
- Bajrami, Arsim., Halili, Zenun., Zejneli, Jusuf., Muçaj, Florent., (2015) *Pozita Kushtetuese dhe Ligjore e Pakicave Kombëtare-Aspekte Krahësuese*, Artini, Prishtinë.
- Haziri, Behar, (2017) *Kultura Politike e Kosovës: Kultura Politike dhe Demokracia Konsociative*, Toena, Prishtinë.

Webliografia

- Amandamentimi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës lidhur me Përfundimin e Mbikëqyrjes Ndërkombëtare të Pavarësisë së Kosovës. Burimi: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>
- Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës RastiNr. KO130/15. Burimi: http://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/amicus_curiae_brief_ki_shq.pdf
- <http://ina-online.net/ja-ligji-plote-se-si-dhe-ku-eshte-zyrtare-gjuha-shqipe-dokument/>
- <http://www.koha.net/arberi/59267/bullgaria-pretendon-se-ne-kosove-jetojne-50-mije-bullgare/>
- <http://www.panorama.com.al/letra-e-pe-presioni-shqiperia-shton-bullgaret-dhe-njeh-me-ligj-9-pakica-kombetare/>
- <http://www.president-ksgov.net/sq/lajme/presidenti-thaci-priti-perfaqesuesit-e-komunitetit-malazez-ne-kosove>
- Komisioni Evropian, Raporti i vitit 2016 për Kosovën*, 09.11.2016. Burimi: https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/20161109_kosovo_report_2016_alb.pdf
- Kushtetuta e Kosovës.
- Ligji Nr. 04/L-066 Për Qendrën Historike të Prizrenit. Burimi: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2836>
- Ligji Nr. 04/L-62 Për Fshatin Hoçë e Madhe. Burimi: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2835>

Ligji Nr. 96/2017 Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë. Burimi: <https://www.parlament.al/wp-content/uploads/2017/04/ligj-nr-96-dt-13-10-2017-1.pdf>

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/l-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës. Burimi: <https://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20ndryshimin%20e%20ligjit%20per%20te%20drejtat%20e%20komuniteteve.pdf>

Propozimi Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës. Burimi: <https://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Propozim%20per%20Statusin%20e%20Kosoves.pdf>

Qeveria: Ministria për Komunitete dhe Kthim, Strategjia për Komunitete dhe Kthim 2014-2018. Fq: 15. Burimi: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_per_Komunitete_dhe_Kthim_2014-2018.pdf

Qeveria: Zyra e Kryeministrit, Lista e Dokumenteve Strategjike Valide, përditësuar më 4 Maj 2017. Burimi: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Lista_e_dokumenteve_strategjike_valide.pdf

Rregullore (QRK) - NR. 01/2018 Për Kthimin e Personave të Zhvendosur dhe

Zgjidhje të Qëndrueshme. Burimi: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15942>

Rregullore Nr 07/2012 për Zyrën e Komisionerit për Gjuhët. Burimi: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8364>

Statuti i Këshillit Konsultativ për Komunitete. Burimi: <http://www.ccc-rks.net/images/stories/Dokumente/Ligjet/STATUTI.pdf>

Deklaratë e autorit

Me anë të kësaj deklarate, vërtetoj se unë jam autor i punimit me titull:

“Minoritetet në Kosovë dhe në vendet e rajonit, trajtimi i tyre përkitazi me të drejtat e njeriut dhe përdorimi politik i tyre”.

Ky punim, apo pjesë të tij, nuk janë botuar apo nuk janë në process rishikimi për tu botuar diku tjetër.

Autori

Gjenis Haxhimehmeti

REALIZMI DHE EKUILIBRI I FUQIVE

Hedibe Nesimi (PhD Candidate)

Abstrakt

Qëllimi i këtij punimi është të konfigurojë një nga idetë më simbolike të teorisë politike realiste: nocionin e ekuilibrit të fuqive. Aktorët politikë (individualisht ose kolektivisht) konkurrojnë për kontrollin e disa burimeve. Një burim kyç është fuqia. Ky është një mjet i pashmangshëm për të arritur ndonjë qëllim, të çdo natyre dhe prandaj është pikërisht ajo që e bën atë një nga pasuritë më të çmuara, por akumulimi i fuqisë të disa krijon frikë të tjerët pasi që përderisa i pari rrit fuqinë e tij, fuqia e të tjerëve zvogëlohet.

Në këtë hulumtim është bërë një përpjekje modeste për t'iu përgjigjur disa pyetjeve për ruajtjen e ekuilibrit dhe paqes pasi që paqja është një qëllim i pakapshëm, madje edhe për një shtet të fuqishëm që përpiqet ta sigurojë atë duke përdorur forcën. Lind pyetja: si, atëherë, ka më shumë gjasa të vihet tek ajo? Paqja, për realizmin politik, është një produkt i frikësimit të ndërsjellë, është një përzierje e frikës dhe sigurisë. Paqja është një mirësi e brishtë që përparon nën mbrojtje të balancës së fuqive dhe për shkak se ajo bazohet në korrelacionin e forcave që janë subjekt i rirregullimit të vazhdueshëm, natyra e saj është e brishtë. Pra ekuilibri në të cilin ajo mbështetet është i paqëndrueshëm, lehtë i prishur dhe i pasigurt.

Do të analizohet se si ekuilibri i fuqive për realizmin politik është vetëm një armëpushim tolerant. Në asnjë rast nuk është mungesa e rivalitetit dhe durim i armiqësive të vogla mes pjesëtarëve të bashkësisë politike. Përkundrazi, mosmarrëveshjet vazhdojnë, nën prapësinë e asaj që është tolerante, por kur ky kufi të kapërcehet, mund të ndodhin luftërat për rikonstruksion që mund ta luhasin dhe madje ta shkatërrojnë sistemin e ekuilibrit.

Ky hulumtim synon të sigurojë një histori të shkurtër dhe të përgjithshme për funksionet që i përmbush ekuilibri i forcave, cilat kërkesa janë thelbësore për funksionimin e tij të mirë dhe si ai i nxit aleancat politike. Duke analizuar këto do të shihet se ekuilibri ka në të njëjtën kohë dy objektiva kardinale: të parandalojë, të formohet një fuqi e padiskutueshme qendrore (perandori botërore) dhe ruajtjen e paqes.

Fjalë kyç: *ekuilibri i forcave, aleancat, paqja botërore, realizmi politik.*

Hyrje

Që nga koha e Aristotelit, ka pasur shqetësime për ekuilibrin e pushtetit midis klasave sociale brenda një shoqërie të shëndoshë, kështu që për të pasurit, klasa e mesme ka funksionuar si një element stabilizues në mes të ekstremeve: aristokracisë, e cila ka akumuluar pasuri, dhe masë publike në një pozitë të palakmueshme.

Mes romakëve, ky problem u shpreh edhe në shpërndarjen e fuqisë politike midis organeve të ndryshme që e ushtronin atë.

Duke shkruar për Luftën e Peloponezit, Thukididi shpjegon në hollësi logjikën e funksionimit të tij. Megjithatë, shekujt e tetëmbëdhjetë dhe të nëntëmbëdhjetë konsiderohen si "epoka e artë" e ekuilibrit të pushtetit.¹

Autorët si Rousseau, Hume, Toynbee, Taylor, Butterfield, Laswell dhe Kaplan besojnë se bilanci është vendosur pa vullnetin e shteteve. Përveç kësaj, shpesh ekziston një paralele me sistemin ekonomik laissez-faire dhe "dorën e padukshme" të Adam Smith. Shpjegimi është se "nëse çdo person ndjek instinktet e tij, të gjithë njerëzit do të jenë të suksesshëm dhe nëse çdo shtet ndjek interesin e tij, të gjitha shtetet do të jenë paqësorë dhe të sigurt".²

Në epokën moderne, ideja perëndimore e këtij ekuilibri, - ekuilibri i pushtetit siç e quajnë konstitucionalistët amerikanë mori formë me triumfin e revolucionit amerikan dhe francez të shekullit të tetëmbëdhjetë, në teorinë e ndarjes së pushtetit konceptuar nga Montesquieu dhe sugjeruar nga teoricienë të tjerë, me qëllim që përqëndrimi i autoriteteve publike në të njëjtat duar mos të çojë në despotizëm.

Por, ekuilibri i pushtetit është gjithashtu një parim i vjetër në marrëdhëniet ndërkombëtare, origjina e të cilëve tregojnë kohët më të hershme të ndërveprimit në mes klaneve, fiseve dhe grupeve të tjera primitive që, duke matur forcën ushtarake të fqinjëve të tyre, përpiqeshin të përgatiten dhe të armatosen ushtarakisht për të balancuar forcat dhe për të mbrojtur sigurinë e tyre. Ekuilibri i pushtetit ka qenë dhe vazhdon të jetë sot, një nga pengesat për aktet e agresionit në marrëdhëniet ndërkombëtare. Prandaj, gjatë gjithë historisë, nëpërmjet lëvizjeve të

¹ Maleski, D. *Меѓународната политика и меѓународното право*, Skopje 2000, str. 454

² ibid

armatosura dhe aleancave ushtarake, shtetet janë përpjekur të balancojnë forcën ushtarake si një mjet për të parandaluar konfliktet e armatosura. Përfaqësues i kësaj sjellje ndërkombëtare ishte e ashtuquajtura "paqe e armatosur", që u themelua në Evropë gjatë periudhës së tensionit dhe armiqësisë që i parapriu Luftës së Parë Botërore. Forcat e mëdha të kohës formuan aleanca armiqësore ushtarake: nga njëra anë, Aleanca Trepalëshe e Gjermanisë, Austria-Hungarisë dhe Italisë; dhe, nga ana tjetër, Antanta e themeluar nga Britania e Madhe, Franca dhe Rusia, në mënyrë që të balancojnë forcat. Kjo periudhë e tensionit dhe armiqësisë arriti kulmin në vitin 1914 në Luftën e Parë Botërore.³

Në periudhën para Luftës së Dytë Botërore, e njëjta gjë ndodhi përsëri: gara e çmendur e armëve të Gjermanisë së Hitlerit dhe formimi i aksit Berlin-Romë-Tokio detyruan vendet e Evropës Perëndimore, Bashkimin Sovjetik dhe, në veçanti, Shtetet e Bashkuara të Amerikës për të bërë sasi të mëdha armësh dhe formalizuan një aleancë mbrojtëse për të balancuar forcën luftarake të ushtrisë nazifashiste për të parandaluar një luftë. Përpjekjet ishin të kota. Paranoja e Hitlerit e tërhoqi botën në një luftë të re të madhe. Shtetet e Bashkuara, me armë shumë të kufizuara dhe të pamjaftueshme, hynë në prodhimin masiv të armëve për vete dhe aleatët e saj.⁴

Pas Luftës së Dytë Botërore, filloi një periudhë e armiqësive ideologjike, politike, ekonomike, dhe armiqësore midis Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Sovjetik, e njohur si Lufta e Ftohtë, në të cilën të dyja superfuqitë u përpoq në çdo kohë dhe me të gjitha mjetet për të grumbulluar sasi sa më të madhe të mundshme të objekteve ushtarake nga teknologjia më e mirë, me një efekt të qartë parandalues që pengoi Luftën e Ftohtë të bëhet një luftë e nxehtë. Ishte Periudha e Balancit të Terrorit që zgjati nga viti 1945 deri më 1989.

Rënia e bllokut lindor krijoi një përçarje serioze të konfigurimit të fuqisë në botë. Tërheqja e fuqisë së Rusisë brenda kufijve të saj kombëtarë la vakumet të pushtetit. Shpërndarja e ekuilibrit të vjetër të forcave dhe nevoja për të krijuar një të ri, prodhuan luftëra etnike dhe civile. Gjegjësisht, Bashkimi Sovjetik u shemb në 15 shtete të pavarura, Jugosllavia në 6, luftëra shpërthyen në Slloveni, Kroaci, Bosnje, Gjeorgji, Çeçeni, Azerbajxhan, Taxhikistan ... Karakteri policentrik i ekuilibrit të ri

³ Kissinger, H. *Diplomacia*, CEU, Tirane, 1999, fq.71

⁴ *ibid*

të forcave është duke ndodhur. Përveç Shteteve të Bashkuara dhe BE-së, qendrat relevante të pushtetit janë Rusia dhe Kina, dhe ndoshta India.⁵

Koncepte të përgjithshme

Për të përdorur në mënyrë të duhur shprehjen ekuilibri i fuqive është e nevojshme që të ketë së paku dy lojtarë politikë me madhësi të ngjashme të cilët janë të lidhur dhe gjithashtu luftojnë për të kontrolluar mjete të caktuara që sjellin mosmarrëveshje mes tyre, por shmangin që mosmarrëveshjet e tyre mos të arrijnë prapun e konfrontimit fizik të drejtpërdrejtë dhe sistematik.

Nga pikëpamja praktike, kërkimi dhe ruajtja e ekuilibrit të fuqive për të shmangur luftën ka qenë shqetësim i vazhdueshëm i shtetarëve që e miratojnë pikëpamjen realiste të politikës dhe, nga pikëpamja teorike, është një nga idetë udhëzuese dhe më të identifikuarat me të ashtuquajturën shkollë realiste.⁶

Aktorët politikë (individualisht ose kolektivisht) konkurrojnë për kontrollin e disa burimeve. Një burim kyç është fuqia. Është një mjet i pashmangshëm për të arritur ndonjë qëllim, të çdo lloji, prandaj është pikërisht ajo që e bën atë një nga pasuritë më të çmuara. Është e çmuar, sepse është e dëshirueshme nga ata që nuk e kanë atë dhe e ruajtur me xhelozë nga ata që kanë një pjesë të vogël të saj.

Cila është vlera e saj? Në faktin se është një mjet i domosdoshëm për zgjidhjen e pasigurisë së ekzistencës dhe, kundërshton ndjenjën e frikës dhe pasigurisë që shkakton një gjendje të tillë. Nga kjo pikëpamje, lufta për pushtet është një luftë për mbijetesë dhe, si e tillë, lidhet me jetën dhe vdekjen e qenieve njerëzore specifike, ose, për ta thënë ndryshe, në mënyrën se si njerëzit jetojnë dhe vdesin.

Akumulimi i fuqisë të disa, krijon frikë të tjerët. Për çfarë arsye? Sepse sikur i pari rrit fuqinë e tij, fuqia e këtij të fundit ulet, dhe për këtë arsye siguria e tij, gjegjësisht, dëshira e një aktori politik që të ketë siguri absolute do të thotë pasiguri radikale për të gjithë të tjerët. Prandaj, një siguri e tillë nuk mund të arrihet nëpërmjet një marrëveshjeje konsensuale, për shembull, përmes negociatave, por përmes nënshtrimit kompulsiv të detyruar të njësive të tjera politike.

⁵ Maleski, D, *Меѓународната политика и меѓународното право*, Skopje 2000, str. 458

⁶ Cristián, G. Vera, y Concha, J. M. *La alianza entre Chile y Bolivia entre 1891 y 1899. Una oportunidad para visitar la teoría del equilibrio*, revista Enfoques de ciencia política, número 10, Santiago de Chile, 2009.

Kështu që, kërkimi i sigurisë së plotë përmes nënshtrimit, i inkurajon të nënshtruarit për një rebelim të vazhdueshëm⁷. Kush vrapon pas iluzionit të paqes mileniale, shkatërron atë që dëshiron të arrijë, ndërsa kërkimi për të e largon paradoksalisht atë nga pax et tranquillitas dhe e bën atë të jetojë çdo ditë me spektrin e rebelimeve dhe luftërave pa fund. (Për shembull, sundimtarët gjermanë pasues të Otto von Bismark, duke u përpjekur për të arritur sigurinë e plotë për vendin e tyre, sipas Kissinger, kërcënuan të gjitha kombet e tjera evropiane me një pasiguri të tillë që rezultoi në një koalicion pothuajse automatik kundërbalancues. Adolf Hitler gjithashtu kërkoi siguri për Gjermaninë në vitin 1930, por ishte e pamundur që Gjermania të arrinte nivelin e sigurisë që po synonte, pa u bërë kërcënim për vendet e tjera evropiane.⁸

Nëse paqja është një qëllim i pakapshëm, madje edhe për një aktor të fuqishëm që përpiket ta sigurojë atë duke përdorur forcën, lind pyetja: si, atëherë, është e mundur të arrihet ajo?. Paqja, për realizmin politik, është një produkt i frikësimit të ndërsjellë. Është një përzierje e frikës dhe sigurisë. Paqja është një dashamirësi e brishtë që lulëzon nën mbulesën e ekuilibrit të pushtetit dhe pasi mbështetet në bazë të korrelacionit të forcave që i nënshtrohen rirregullimeve të vazhdueshme, natyra e saj është e brishtë dhe fatale. Por pse ndryshon paqja që rezulton? Sepse ekuilibri në të cilin mbështetet është i paqëndrueshëm, lehtë i prishur dhe i pasigurt.

Në çfarë qëndron elokuenca e ekuilibrit të fuqive? Në atë që aktorët që marrin pjesë në ekuilibër nuk janë krejtësisht të kënaqur me pozicionin që ata kanë. Ata gjithmonë përpiqen për diçka më shumë. Prandaj, secili prej tyre përpiket të përmirësojë pozicionin e tyre relativ në dëm të të tjerëve. Përpjekjet që secila prej tyre bëjnë në këtë drejtim, shihet me mosbesim, ose të paktën me shqetësim nga pjesa tjetër e komunitetit. Strategjitë e orientuara në këtë mënyrë për rritjen e fuqisë - dhe përfitimet që imponon – i ndryshojnë korrelacionin e forcave dhe theksojnë pasigurinë në brendësinë e sistemit të ekuilibruar.⁹

Megjithatë edhe pse duket kontradiktore, është pakënaqësia relative ajo që siguron stabilitetin e sistemit. Pse? Sepse nëse një aktor e gjen veten plotësisht të kënaqur, si pasojë e kënaqësisë së tij, të tjerët do të ndjehen

⁷ Kissinger, H. *A world restored*, 1974, p. 12, 190, 235 y 237

⁸ Kissinger, H. *Diplomacia*, 1999, CEU, Tirane. fq.104

⁹ Oro, R. Luis, *Notas Sobre el equilibrio de poder*, Revista Enfoques, Vol.VIII N° 12, 2010, 53-69 Chile, pp.58

edhe më të prekshëm dhe të pakënaqur. Sepse në një rast të tillë, këto të fundit kanë pak për të humbur dhe shumë për të marrë, ata ndoshta do të luftojnë për të rivendosur shpërndarjen e pushtetit, me shpresën për të përmirësuar pozicionin e tyre relativ. Ky qëllim do t'i inkurajonte ata që të ndryshonin themelet në të cilat mbështetet ekuilibri, dhe pavarësisht suksesit që ata do të kenë në misionin e tyre, ata mund të shkelin rendin dhe kështu do të rritet paqëndrueshmëria e të gjithë sistemit të ekuilibruar.¹⁰

Meqenëse balanca e pushtetit nuk mund të kënaqë plotësisht çdo anëtar të sistemit ndërkombëtar, suksesi i tij qëndron në mbajtjen e shkallës së pakënaqësisë pa arritur nivelin e frustrimit. Nëse ndodh kjo e fundit, ata që janë në një situatë shumë të përkeqësuar do të përpiqen të shkelin rendin ndërkombëtar nëpërmjet dhunës.

Prandaj, ajo që siguron stabilitetin e sistemit është kënaqësia relative e anëtarëve të saj. Kështu, mbijetesa e tij qëndron, paradoksalisht, në ekzistencën e pritjeve pjesërisht të paplotësuara. Por ato duhet të jenë në një sasi më të ulët; në mënyrë që ata të mos vënë në dyshim gjithë rendin ekzistues.

Hans Morgenthau në gazetën e tij me ndikim Politika midis Kombeve, përdor shprehjen ekuilibri i fuqive në katër mënyra domethënëse: 1. Si një politikë e drejtuar në një gjendje të caktuar; 2. Si një gjendje e caktuar; 3. Si përafërsisht shpërndarje e njëjtë e pushtetit; 4. Si çdo shpërndarje e pushtetit¹¹.

Nga këndvështrimi i mësipërm, mund të konkludohet se paqja, për realizmin politik, është thjesht një armëpushim tolerant. Në asnjë rast nuk është mungesa e rivalitetit dhe armiqësisë të vogla mes pjesëtarëve të bashkësisë politike. Në të kundërt, grindjet vazhdojnë dhe vazhdojnë për njëfarë kohe, nën pragun e asaj që është tolerante, por kur ky kufi të kapërcehet, mund të ndodhin luftërat e rindërtimit që mund të shkelin dhe madje të shkatërrojnë sistemin e ekuilibrit.

Funksionet e ekuilibrit të fuqive

Në fakt, një funksion i rëndësishëm i ekuilibrit të pushtetit është parandalimi i dominimit të pamohueshëm të një shteti në skenën ndërkombëtare dhe kështu e pengon atë në vendosjen e vullnetit të tij të njëanshëm ndaj anëtarëve të tjerë të bashkësisë ndërkombëtare. Si të

¹⁰ *ibid*

¹¹ Maleski, D. *Меѓународната политика и меѓународното право*. Skopje 2000, str. 454

parandalohet? Me frikësim të ndërsjellë. Kjo bazohet, në fund të fundit, në barazinë relative të burimeve të pushtetit.¹² Pra, funksioni parësor i ekuilibrit të fuqive është të apelojë në radhë të parë, për mundësinë e krijimit të një perandorie globale dhe, së dyti, të parandalojë një aktor të fuqishëm të ketë shumë pushtet dhe kështu ta pengojë atë të mbizotërojë pa rivalë, siç ndodh - për shembull - në rendin unipolar. Në të dyja rastet, po përpiqet të lehtësohet mundësia që të fuqishmit të mund të nënshtrojnë më të dobët.

Funksioni i dytë i ekuilibrit të pushtetit është të ndihmojë në ruajtjen e rendit të brishtë ndërkombëtar. Ky synim mund të arrihet më lehtë nëse ekuilibri bazohet në një bazë minimale të vlerave të ndara. Kjo zvogëlon efektin e një përplasjeje midis aktorëve në sistem dhe gjithashtu parandalon dëshirën e dëshpëruar për të përmbysur rendin ekzistues duke përdorur forcën. Ky substrat funksionon si burim i legjitimitetit, domethënë, si emulsifikues i marrëdhënieve të pushtetit. Në të kundërtën, fuqia, pa legjitimitet, është gërryese, është e patolerueshme për ata që janë në një situatë të përkeqësuar, të cilët e konsiderojnë atë të papranueshme dhe pikërisht për këtë përpiqen të zhvlerësojnë marrëdhëniet ekzistuese me përdorimin e dhunës.¹³ Prandaj, sistemi është më i qëndrueshëm dhe funksionon më mirë kur anëtarët e tij ndajnë një set bazë vlerash, si një normë reference dhe lejon që sjellje të caktuara të kualifikohen si të pranueshme ose të papranueshme.

Por, në mënyrë specifike, si kontribuon ekuilibri i fuqisë për ruajtjen e rendit? Nëpërmjet të drejtës ndërkombëtare, nëse ajo kontribuon në tejkalimin e dallimeve dhe zgjidhjen e konflikteve. Drejtësia, e kuptuar si përmbushja e asaj që parashikohet nga ligji, është një qëllim që është vështirë të arrihet plotësisht. Megjithatë, është e mundur që t'i afrohem asaj përmes ekuilibrit të fuqive. Ligji i kuptuar si dispozitiv i normave - është një shprehje formale e disa marrëdhënieve të pushtetit që ekzistojnë në një moment të caktuar. Ligji respektohet vetëm gjatë ekuilibrit të pushtetit që e ka krijuar atë. Në fakt, të gjitha manifestimet historike të drejtësisë gjatë gjithë historisë janë arritur me njëfarë ekuilibër të pushtetit.¹⁴ Prandaj, sipas Niebuhr, "asnjëherë nuk ka ekzistuar asnjë plan

¹² Oro, L. Tapia, *¿Qué es la política?*, Editores Revista Enfoques, Santiago, 2003, pp. 11 a 41.

¹³ Oro, L. Tapia. *Notas Sobre el equilibrio de poder*, Revista Enfoques, Vol. VIII N° 12, 2010, 53-69 Chile, p.67

¹⁴ Niebuhr, R. *Ideas políticas*, Editorial Hispano Europea, Barcelona, 1965, pp. 182.

në historinë e administrimit të drejtësisë që nuk e ka pas për bazë balancën e pushtetit".¹⁵

Si rezultat, një nga opsionet më të besueshme për të shmangur nënshtrimin e një subjekti nga tjetri është të stimulojë ekuilibrin e pushtetit, sepse lejon kufizimin e impulseve ekspansive të të fuqishmëve. Gjegjësisht, asnjë kufizim moral nuk mund të jetë i suksesshëm në përpjekjen e tij për të shmangur pabarazitë, nëse nuk ka arritur më parë një ekuilibër të arsyeshëm të forcave.

Por moralistët utopikë që neveriten nga ekuilibri i pushtetit (ose për shkak se ai është i papërsosur ose për shkak se ende ka armiqtësi kaq latente në të) nuk e kuptojnë se drejtësia (në fakt) bazohet në fuqinë e forcave rivale. Është e vërtetë se ata mund të rriten në një konflikt të hapur. Por në qoftë se ekuilibri nuk është i pranishëm, rriten shanset për arritjen e paqes despotike, e arritur me nënshtrimin e vullnetit të të dobët nga më të fortët.¹⁶

Kritikat e utopistëve korrespondojnë me faktet. Por ata nuk paralajmërojnë për përfitimet që sjell ekuilibri i fuqive. Cilat janë përfitimet? Pavarësisht nga mangësitë e saj, ekuilibri i fuqive siguron kushtet për ndërtimin e rregullave që përmbajnë një minimum të drejtësisë dhe ato gjithashtu kanë më shumë gjasa të ruhen.

Pra, rregullat që përparojnë nën drejtimin e ekuilibrit të fuqive funksionojnë si shembuj që zgjidhin mosmarrëveshjet dhe në këtë kuptim ndihmojnë ruajtjen e rendit dhe krijimin e kushteve për punën e institucioneve ndërkombëtare, qofshin ato shtetërore apo politike.

Një funksion tjetër i bilancit të pushtetit - i tretë - është kufizimi i konflikteve. Thënë në një kuptim negativ: ekuilibri i fuqive nuk ka ndërmend të çrrënjosë përfundimisht luftërat, madje edhe krizat, por t'i shmangë sa më shumë që të jetë e mundur. Në fakt, kur ekuilibri i pushtetit funksionon mirë, pengon aftësinë e disa shteteve për të dominuar të tjerët dhe në të njëjtën kohë kufizon mundësinë e konflikteve. Qëllimi i tij nuk është paqja (e definuar si mungesa e rivaliteteve dhe armiqtësive), por rendi dhe stabiliteti. Ekuilibri i fuqive formon një rend ndërkombëtar. Por një rend i tillë nuk nënkupton mungesën e konflikteve. Ata vazhdojnë. Megjithatë, ekuilibri lejon ekzistencën e një bote në të cilën konfliktet mund të zgjidhen në mënyrë paqësore, sepse përderisa ai është në fuqi, hapësira e antagonizmit lëviz nga fusha e betejës në institucionet shumëpalëshe. Si rezultat, ata që

¹⁵*Ibid* pp. 132

¹⁶*Ibid* pp.133 y 185.

marrin vendime përfundimtare janë diplomatët, jo ushtria. Por të parët mund të përmbushin rolin e tyre sipas kushteve të sigurisë të ofruara nga ato të fundit.¹⁷ Ekuilibri i pushtetit përfaqëson një simetri të caktuar midis rezistencës, nga njëra anë, dhe aftësisë për të marrë veprime armiqësore nga ana tjetër.¹⁸

Pra, një nga synimet e bilancit të pushtetit është të zvogëlojë gjasat e luftërave. Megjithatë, për mbështetësit e realizmit, pritjet për eliminimin e të gjitha formave të antagonizmit janë utopike. Prandaj, ekuilibri i pushtetit nuk ka për qëllim të zhdukë konfliktin sepse është joreale, por të kufizojë atë sa më shumë që të jetë e mundur. Por si ta kufizojë? Zgjidhja e propozuar nga realistët është të shfrytëzojë ose të zhdukë disavantazhet e natyrshme në natyrën e njeriut, për të arritur rezultatin më të mirë të mundshëm në një periudhë afatgjatë".¹⁹

Së fundi, mund të identifikojmë funksionin e katërt, i cili është mjaft i pazakontë, që nuk do të thotë në asnjë mënyrë që ai të mos mund të verifikohet në një mënyrë empirike. Kur ekuilibri i fuqive punon në mënyrë optimale, ka mundësi që shtetet e vogla të marrin pjesë në marrëdhëniet ndërkombëtare me një shkallë më të lartë autonomie, siç është rasti, për shembull, me Lëvizjen e të painkuadruarve në vitin 1970, në kontekst të Luftës së Ftohtë, dhe për të kufizuar (por jo për të eliminuar) aftësinë për të shkelur lehtë të drejtat e tyre.²⁰

Nga ana tjetër, në masën që vendet e vogla gjithashtu marrin pjesë në koalicione që përbëjnë ekuilibrin, ata kanë mundësinë të transferojnë përkrahjen nga një shtet në tjetrin dhe konglomeratet e tyre eventuale, që ti trajtojnë me respekt me qëllim që të shmangin braktisjen e tyre. Prandaj, forcat që udhëheqin koalicionin janë të detyruar të marrin politika të moderuara, si brenda komunitetit dhe në raport me aleancën rivale, sepse nuk kanë të sigurt aderimin e pakushtëzuar të shteteve të vogla.²¹

¹⁷ Morgenthau, H and Thompson, K. *Politics among nations: The struggle for power and Peace*, New York, p.198

¹⁸ *Ibid.* p.205

¹⁹ Kissinger, H. *Diplomacia*, CEU, Tirane, 1999, fq. 62

²⁰ Vukadinovic, R. *Marredheniet Nderkombetare Politike*, Kolegji universitar Victory, Prishtine, 2006, fq.239

²¹ Hey, A K. Jesne. *Small world in world politics*. Colorado, 2003

Kushtet për funksionim të mire të ekuilibrit të fuqive

Që ekuilibri i pushtetit të përmbushet, disa nga funksionet e identifikuar në pikën e mëparshme, duhet të plotësohen, të paktën një nga kushtet e mëposhtme: fleksibiliteti i koalicioneve, ekzistenca e një fuqie të tretë që ka statusin e fuqisë së auto-margjinalizuar dhe lidhjet e dobëta midis aleatëve.

Fleksibiliteti i koalicioneve. Çdo komb duhet të ndjehet i lirë të ndryshojë anë nëse rrethanat e reja e justifikojnë atë. Kjo jep elasticitetin e sistemit të ekuilibrit dhe zvogëlon gjasat për të formuar aleanca të forta që inkurajojnë aleatet që të angazhohen në lojëra zero. Dezertimi i një aleati mund të ndihmojë në reduktimin e erërave të luftës, kur tensionet rriten. Një elasticitet i tillë kufizon mundësinë e shpërthimit të konflikteve të dhunshme dhe gjithashtu aftësinë për të thyer vlerat e ndërtimit të paqes si rendi dhe stabiliteti.

Mungesa e qëndrueshmërisë së aleancës ndihmon në ruajtjen e ekuilibrit të përgjithshëm të sistemit, duke zvogëluar kështu mundësinë e fillimit të një konflikti të armatosur që përfshin thuajse të gjitha njësitë politike. Për shembull, plasticiteti i partneriteteve midis Luftërave Napoleonike dhe Luftës së Parë Botërore, gjegjësisht, në periudhën prej vitit 1815 deri 1914, u lejua të bëhet një ndryshim në ekuilibër, duke ndryshuar aleancat. Kjo ka kontribuar në reduktimin e presionit të sistemit dhe mundësinë që konfliktet lokale të mbeten të mbyllura në një hapësirë të kufizuar, duke shmangur mundësinë e fillimit të një lufte botërore.²²

Në rast se formohen aleanca të forta, gjasat e konfrontimit duhet të reduktohen, duhet të ketë një forcë që është jashtë të dyja koalicioneve dhe të parandalojë që asnjë prej tyre të bëhet e pandalshme. Kjo është një forcë neutrale që nuk është pjesë e balancës së pushtetit, por bashkimi i tij në sistem mund të ndryshojë në mënyrë të konsiderueshme ekuilibrin e fuqive. Dhe ajo mund të përmbushë rolin e saj shumë më mirë nëse do kishte fuqi të mjaftueshme për të shpëtuar nga presionet e të dyja koalicioneve dhe gjithashtu të ofronte garanci të qarta për neutralitetin e palëve ndërluftuese. Kjo ndodhi, për shembull, pas marrëveshjes franko-ruse, kur Mbretëria e Bashkuar vazhdoi të vepronte si një kundërpeshë.²³ E njëjta gjë ndodhi edhe me rolin e Kinës që nga viti 1960, kur qëndroi larg Paktit të Varshavës dhe NATO-s.

²² Vukadinovic, R. *Marredheniet Nderkombetare Politike*, Kolegji universitar Victory, Prishtine, 2006, fq.241

²³ Kissinger, H *Diplomacia*, CEU, Tirane, 1999, fq. 177.

Lidhje të dobëta midis partnerëve të koalicionit. Në rast se një aleancë nuk ka një koalicion kundërbalancues, rriten gjasat të ndjehen të inkurajara për të marrë aktivitete armiqësore kundrejt anëtarëve të tjerë të bashkësisë ndërkombëtare. Kështu, për shembull, Shtetet e Bashkuara gjatë administrimit të Xhorxh W. Bush.

Në rastin e aleancave simetrike dhe të forta, pa aftësinë për të ndryshuar lehtësisht anët, siç ndodhi gjatë Luftës së Ftohtë, është mirë për paqen, që kohezioni brenda koalicioneve të jetë i vogël. Për shembull, bashkimi i ashpër i anëtarëve të NATO-s gjatë viteve 1960 ishte një pengesë për Aleancën Perëndimore për të marrë një qëndrim më militant dhe si pasojë më të rrezikshme për paqen. Në anën tjetër, në Paktin e Varshavës, kishte përpjekje për kryengritje në Hungari (1956) dhe në Republikën Çeke (1968), të cilat tregonin çarje ekzistuese në atë bllok.²⁴

Ekulibri i fuqive dhe aleancat

Politika është gjithmonë një aktivitet i të interesuarve, thelbi i të cilës është lufta, marrja e aleatëve dhe ndjekësve vullnetarë.

Fjala interes nuk ka kuptim pezhorativ ose nënkupton ndonjë vlerë, në kuptimin që ajo është diçka morale e keqe ose e mirë. Me fjalën e interesit, Max Weber dëshiron të deklarojë se veprimi politik është racional nëse protagonistët janë të vetëdijshëm për qëllimet që ndjekin, kështu që ata e dinë se cilat janë përfitimet e tyre dhe i kanë të qarta pengesat për realizimin e tyre.²⁵

Kështu, aleancat nuk janë as aksidentale as nga mosinteresi; prandaj, mund të konfirmohet se miqësia politike formohet në bazë të llogaritjeve të të ardhurave reciproke midis atyre aktorëve që me qëllim zgjedhin të bashkëpunojnë për të forcuar realizimin e tyre. Termi miqësia politike është marrë nga Aristoteli. Kjo shprehje ka një kuptim analog, sepse miqësia politike është rrënjësisht e ndryshme nga miqësia natyrore. Ky i fundit bazohet në individualitetin e secilit individ dhe në ekzistencën e dashurisë dhe vlerësimit të ndërsjellë dhe qëllimi i tij është për të mirën e të tjerëve. Sidoqoftë, miqësia politike bazohet në një lloj interesi pragmatik ose utilitar. Prandaj, miqësitë politike janë natyrisht të interesuara, utilitare dhe të ndërmjetme. Kështu, interesi është në zemër të

²⁴ Oro, L. R Tapia *Notas Sobre el equilibrio de poder*, Revista Enfoques, Vol.VIII N° 12, 2010, 53-69 Chile, pp.70

²⁵ Morgenthau, H& Thompson, K. *Politics among nations: The struggle for power and Peace*, New York

aleancave dhe është një nga motivet e veprimit politik, pasi krijon dinamikën e konfliktit dhe bashkëpunimin.²⁶

Cilat janë arsyet që inkurajojnë aktorin politik për të marrë aleatë? Konkurrenca, rivaliteti dhe armiqësia. Politika presupozon ekzistencën e një "armiku". Nëse në botën politike do të kishte vetëm harmoni, nuk do të kishte kuptim kërkimi i aleatëve, sepse të gjithë do të ishin miq dhe të gjithë do të bashkëpunonin në mënyrë spontane. Megjithatë, ne e dimë se nuk është kështu. Dhe pikërisht sepse kjo nuk ndodh në realitet, aktorët përpiqen të gjejnë miq, mbështetës, anëtarë dhe simpatizantë. Prandaj, aleatët kanë për qëllim të mbrojnë veten nga armiqët e përbashkët (në lidhje me këtë, Niebuhr vë në dukje, në një vërejtje, mbase me realizëm të tepruar, se "nuk ka informata për njerëz që kanë krijuar një komunitet të përbashkët të udhëhequr nga dashuria e ndërsjellë, por ka shumë raste të kohezionit të arritur nëpërmjet frikës së një armiku të përbashkët" ²⁷). Historiani grek Thukidid, një analist i marrëdhënieve ndërkombëtare që nga koha e Luftës së Peloponezit, identifikoi motivet që nxitën qytetet që të zgjedhin bashkëpunimin politik. Për këtë tregon se aleancat janë formuar nga ekzistenca e një armiku të përbashkët, qoftë real apo virtual. Me fjalë të tjera, pa ekzistencën e një armiku aktual apo të mundshëm, mundësitë për të formuar një koalicion janë të vogla. Pastaj, ai argumenton se reciprociteti i interesave është ajo që i jep stabilitetit aleancave. Dhe së fundmi, frika dhe nevoja për të rritur sigurinë janë motivet që nxisin qytetet të zgjedhin bashkëpunimin. Për Thukididin, pra, aleancat formohen për "interes ose nevojë".²⁸ Nga ana tjetër, Thukididi thotë se ekuilibri i fuqive i jep stabilitet koalicionit, sepse "frika e ndërsjellë, e cila vjen nga fuqitë e barabarta, është ajo që përbën sigurinë e mbijetesës së aleancës". Gjithashtu, ekuilibri i fuqive midis koalicioneve kontribuon në ruajtjen e paqes, pasi agresorët e mundshëm nuk janë në gjendje të sulmojnë në aspektin e superioritetit, nuk ndjehen të motivuar të ndërmarrin aktivitete armiqësore kundër viktimës së mundshme, nga frika e reagimeve të partnerëve të tyre. Kështu, aleancat kontribuojnë ndjeshëm në demobilizimin e qëllimeve të armikut për agresorët e mundshëm, pra barazia e pushtetit, domethënë ekuilibri i pushtetit midis koalicioneve, çon në paqe.²⁹

²⁶ Oro, L.R. Tapia. *Notas sobre el equilibrio del poder*, Revista Enfoques, Vol. VIII N° 12, 2010, 53-69 Chile, pp. 66

²⁷ Niebuhr, R. *Ideas políticas*, Editorial Hispano Europea, Barcelona, 1965, pp. 313

²⁸ Maleski, D. *Светот на Тукидид и на Макијавели*. Скопје, 2001

²⁹ *Ibid*

Cilat janë karakteristikat e aleancave? Një nga karakteristikat e tyre më të rëndësishme është se ato janë themeluar në përputhje me ekzistencën e interesave të përbashkëta. Këto janë përparësitë reciproke ndërmjet aktorëve që vuajnë nga i njëjti problem, i cili i inkurajon ata për të formuar koalicione. Si rezultat, ato bazohen në mundësinë që palët kontraktuese të marrin shërbime të përbashkëta, përfitime dhe fitime. Por një reciprocitet i tillë nuk është kurrë i përsosur, sepse nuk është e pazakontë të ekzistojë një çekuilibër midis interesit të përbashkët të aleancës dhe interesave individuale të secilit prej anëtarëve. Për shembull, gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë, keqkuptimet në brendësinë e NATO-s midis Shteteve të Bashkuara dhe Francës ishin shkakuar nga vetoja e SHBA për programin atomik francez, kështu që opozita e interesave mes tyre bëri që të rritet frika, në disa momente, se Franca do të largohej nga NATO.³⁰

Prandaj, marrëdhëniet ndërmjet anëtarëve të koalicionit nuk janë gjithmonë harmonike. Aristoteli thotë se ""Në miqësitë e bazuara në fitim, ka ankesa dhe ankesa vazhdimisht" Me të vërtetë ", miqësia utilitare ngurron. Në fakt, secili partner e vlerëson ndryshe kontributin e tij në kauzën e përbashkët dhe përpiqet të mbajë besëlidhjen bazuar në interesat e tij. Prandaj, mund të themi se miqësitë politike janë të frustruara, sepse ato nuk janë të lira nga hidhërimi, keqkuptimi dhe antagonizmi midis bashkëpunëtorëve. Për shembull, në fund të Luftës së Parë Botërore, hija e mosmarrëveshjes ndërmjet aleatëve u ndje në akuzat e ashpra të bëra nga Georges Clemenceau ndaj Woodrow Wilson, si dhe në antagonizmin e dukshëm midis Lloyd George dhe Wilson, gjatë negociatave që çuan në Traktatin e Versajës.³¹

Një veçori tjetër e aleancave është se ato janë të kufizuara në kohë, sepse ato zgjasin për aq kohë sa vazhdojnë interesat e përbashkëta.³² Kur arrihet qëllimi, koalicioni humbet shkakun e ekzistencës dhe aleati i djeshëm shpesh bëhet armik, mutacioni i interesave çon në krijimin e aleancave të reja. Për shembull, Bashkimi Sovjetik nënshkroi një marrëveshje me Gjermaninë naziste, rivalin e saj ideologjik për ndarjen e Polonisë. Pas arritjes së qëllimit, në shtator të vitit 1939, miqësia mes Hitlerit dhe Stalinit u errësua nga mosmarrëveshja dhe, nga 22 qershor 1941, miqtë e

³⁰ Oro, L. R. Tapia. *Notas sobre el equilibrio del poder*, Revista Enfoques, Chile, pp. 62

³¹ Kissinger, H. *Diplomacia* CEU, Tirane. 1999.

³² Kissinger, H. *A world restored* p. 141, 150 y 151

djeshëm u bënë armiq. Në atë kohë BRSS u bë aleat i Anglisë, Francës dhe Shteteve të Bashkuara. Të katër kishin një interes të përbashkët: ta mposhtin Gjermaninë naziste. Pas arritjes së objektivit në maj të vitit 1945, Rusia pushoi së qeni një aleat dhe që nga viti 1947 u bë armik, kërcënim i vdekshëm për ish-partnerët e saj. Gjithashtu, nga fundi i viteve 1940, Gjermania Perëndimore u bë një aleate e mirë e Francës, Anglisë dhe Shteteve të Bashkuara. Prandaj, "interesi kombëtar sipas Aronit mund të kërkohet gjatë disa viteve, një kthim të plotë të aleancave, pas të cilave miqtë do të bëhen armiq dhe armiqtë mund të bëhen miq".³³ Në fakt, shumica e aleancave janë jo të besueshme, të përkohshme dhe të ndërmjetme; në përgjithësi humbasin vitalitetin kur arrijnë qëllimin për të cilin janë themeluar, atëherë bëhen të parëndësishme ose pa kuptim. Një ilustrim është mendimi që Clemente de Metternich shprehu në ditarin e tij në ditën e përrurimit të Kongresit të Vjenës: "Të gjitha angazhimet tona janë përmbyshur, të gjitha qëllimet e mëparshme të Koalicionit jo vetëm që janë arritur por edhe janë tejkaluar. Tani patjetër të sqarojmë edhe një herë kush është qëllimi ynë, sepse ndodh me aleancat si me të gjitha vëllazërimet, se nëse nuk ka ndonjë qëllim specifik, shpërbëhen".³⁴ Pra, aleancat po ndryshojnë kur ndryshojnë rrethanat që justifikojnë ndryshimin e ekzistencës së tyre. Në politikë, armiqtë dhe miqtë nuk janë të përrjetshme dhe të pandryshueshme, as të dhëna njëherë e përgjithmonë. Gjegjësisht, ata po ndryshojnë me kalimin e kohës: miqtë e sotëm mund të jenë armiqtë e së nesërme. Në fund të fundit, një aleat nga pikëpamja e realizmit politik është gjithmonë një armik vëllazëror.

Përfundim

Përderisa fuqia dhe politika janë në duart e shteteve sovrane, do të vendosen marrëdhënie të caktuara të pushtetit midis tyre. Në këtë kuptim, koncepti i ekuilibrit të fuqive është pasojë e rivalitetit dhe konkurrencës midis shteteve për pushtet më të madh, si një kusht për sigurinë e tyre.³⁵ Për përkrahësit e realizmit, puna politike është si një ekuilibër që lëviz midis anarkisë dhe tiranisë, domethënë në mes të lirisë kaotike dhe një rendi thjesht kompulsiv. Ekuilibri i pushtetit përpiket të apelojë për të dy rreziqet, edhe pse jo gjithmonë në mënyrë të suksesshme. Në periudha të caktuara historike, ekuilibri i pushtetit prodhoi paqe dhe stabilitet. Në të

³³ Vukadinovic, R. *Marredheniet Nderkombetare politike*. Prishtine, 2006, fq. 241.

³⁴ Kissinger, H. *A world restored*. Spanish edition 1974, p. 150-151

³⁵ Maleski, D. *Меѓународната политика и меѓународното право*, Skopje 2000, str. 458

tjerat kolaboi në kaos dhe në luftëra. E tillë ishte situata në vitet 1914-1918, kur ekuilibri i forcave përfundoi me luftën e parë botërore.³⁶

Ata që përpiqen për një rend të përsosur, nuk do të hezitojnë ta etiketojnë ekuilibrin e pushtetit si anarkikë dhe, në fakt, në një farë mënyre është. Nga ky këndvështrim, ekuilibri i fuqisë është një rend i papërsosur dhe i brishtë. Prandaj, ata që punojnë në të dhe, janë të vetëdijshëm për veçoritë e tij dhe duan ta mbajnë atë, janë të detyruar të veprojnë me kujdes.

front of the citizens rather than the victim of politics". It seems the two countries share the same opinion on this issue, where in the assertion "I completely agree" 91) and agree 92) similar 68% to 70% and 22% to 24%. In "Female counsellor in smaller municipalities has the least influence on decision making" Tearce municipality has a greater compliance than the other town of Vitia in this comparison, thus 38% with 58% in Tearce. However, even in "Female Counsellors are sufficiently involved in budget representations and other commissions" we have seen an extremely high match of results in Viti and Tearce, with almost 1 to 4% differences. As far as "Women are today a great potential, not only numerical but also professional and intellectual", the highest compatibility of 90% has been witnessed in Viti while in Tearce with 74%. Also in the last structured question, 'the quota in the election is set to increase the number of women in legislation at the request of internationals', high uniformity was achieved in both countries, but in particular in 92% and 74% in Tearce. The opinion remains unchanged with regard to the new legislature elected at the end of 2017, where the responses and opinions are almost identical and somewhere identical and where apart from the political configuration and the female has remained in the same position that the causes should be 'we also look for it in other social circles. However, in Vitia there is a decrease of female counsellors by 4% in 2017, while in Tearce there is a growing percentage of a about 5.30% which is very welcomed considering that Tearce is much smaller Municipality than Vitia municipality.

Hence, we emphasize our interest in considering this data as an opportunity to gain an understanding in political strategies in the future to improve and encourage women everywhere in the Balkans to improve the position of women in society through participation in decision-making and not to remain her status only as a party opposition. We have worked intensively in this paper to approximate thoughts, ideas and widespread opinion on the situation of women in decision-making in these two municipalities. However, this paper should serve other researches of this nature. The results of table statistics and graphs show that respondents really value educative, social and cultural factor based on this research, and we have come to the conclusion that the findings are these together with the main challenges during the research. According to the data, the representation of women in the Municipality of Vitia exceeds the foreseen quota in its entirety, while the participation of women in the municipality of Tearce is satisfactory but does not meet the given quota, so there is still work to be done in this regard. Most of the respondents

were employed in the city but residing in the village. A great deal of respondents think that quality is still missing, and more than 80% think that quality is required. Only 40% of respondents agree completely or agree that women in decision-making are sufficiently involved in budget processes and other important committees. Almost 90% of respondents "fully agree" and "agree" that women should voice their voice and be independent of politics to carry out their duties given by the citizen. It is also a conciliatory opinion that women have the potential and intellect to make money. However, there is also a split between the opinion that women in municipal decision-making have the least influence on governance as well. There is a broad shared opinion regarding the influence of women from their party leaders, the responses were very contrasting in Tetovo and Tearce, where there was a neutral but more confidence in this issue resulted in the Municipality of Viti and less trust in the Municipality of Tearce. In general, the quota quoted in Viti is regarded as an international decision with 92% conformity while in Tearce with only 52% of conformity.

Bibliography

- Sahay, Sushama (1998). "Women and Empowerment". Discovery Publishing House New Delhi
- Dahl. B. Cited in Dahlerup, 'Increasing Women's Political Representation: New Trends in Gender Quotas', op.cit. p.143.
- Anan, Kofi-UN, (16 January, 2004) Online Press-Release, SG/SM/9118 NY
- Goethals R. G and Sorenson G.J. (2006), "*The Quest for a General Theory of Leadership*", Edward Elgar Publishing USA.
- "*Venia e konceptit gjinor në partitë politike në nivel lokal*"; Retrieved from <http://www.osce.org/sq/skopje/16080?download=true>
- http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L073_al.pdf
- <https://kk.rks-gov.net/viti/Kuvendi.aspx> and Komuna e Tearcës - Ligji për barazi gjinore, 2004/2 mund të shkarkohet në http://www.gazetazyrtare.com/egov/index.php?option=com_content&task=view&id=76&Itemid=28&lang=sq

Official Gazette of the Republic of Kosovo / PRISTINA: YEAR V / NO. 87/16 November 2010, Article 8

www.statsvet.su.se/quotas , This paper was presented at the ECRP conference in Marburg, Germany, September 18-21, 2003. University of Bristol, UK, for insightful comments. Retrieved from Lenita Freidenvall The Research Program: Gender Quotas - a Key to Equality? Department of Political Science, Stockholm University Bystydzienksi, Jill M.(1995) Women in Electoral Politics: Lessons from Norway. Published Westport, Conn. : Praeger, c

http://www.qag.org/WEB/deklarata/2011/garantimi_i_perfaqesimit_gjinor_të_barabartë_ne_Reformen_Zgjedhore. Pdf nga Prof. Dr. Aurela Anastasi” Garantimi i Përfaqësimit Gjinnor Të Barabartë ne Reformen Zgjedhore”.

<https://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Law%20on%20amending%20the%20law%20on%20the%20financing%20of%20political%20parties.pdf> ‘Law on Amending and Supplementing the Law no. 03 / L-073 on General Elections in Republic of Kosovo’.

minaslist.org/library-assets/pub-a-10.pdf

<https://kk.rks-gov.net/viti/Kuvendi.aspx>

<http://www.tearce.gov.mk/>

<http://www.tearce.gov.mk/>

STATEMENT

Hereby we declare that our research work is done in accordance with research ethics and we are responsible for the validity and reliability of our work. We guarantee that this research material is only presented at the ICEICH International Conference on 15-16 February 2018 at AAB University and assure you that it has not been published or presented elsewhere!

Respectfully,

Co-authors

Lirie Aliu

Gjylten Ademi

AKTORËT DHE ROLI I PARTNERITETIT PUBLIK-PRIVAT NË MENAXHIMIN E TURIZMIT TË QËNDRUESHËM

Dr(c). Marinela Selmanaj

Dr. Merita Murati

Abstrakt

Turizmi është një aktivitet socio-ekonomik dhe ka evoluar me ritme të shpejta duke u shndërruar në një nga industritë më të mëdha të botës. Jan Van der Straaten thekson në studimin e tij për turizmin e qëndrueshëm se domosdoshmëria ekonomike është forca lëvizëse e zhvillimit të turizmit. Pa turistët, komunitetet lokale e kanë gjithnjë e më të vështirë për të konkuruar në sfera të tjera me qendrat e mëdha metropolitane dhe si rrjedhojë mund edhe të “humbasin”. Në këtë sens, qëndrueshmëria mjedisore është e lidhur pashmangshmërisht me qëndrueshmërinë ekonomike, kulturore, sociale, dhe politike. Raporti “E ardhmja jonë e përbashkët” vë theksin se zhvillimi i qëndrueshëm nuk përfshin vetëm zhvillimin ekonomik, por edhe çështje të barazisë midis individëve apo grupeve në shoqërinë e sotme, por edhe midis brezave të tashëm dhe të ardhshëm (WCED 1987; Bramwell & Lane 1993).

Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm si një mjet strategjik kërkon një proces planifikimi dhe menaxhimi që bashkon një sërë interesash dhe shqetësimesh të aktorëve të turizmit. Prandaj, duke patur parasysh rëndësinë e bashkëpunimit të aktorëve të turizmit në zhvillimin e qëndrueshëm të tij dhe duke konsideruar banorët si aktorët kryesorë, ky studim shqyrton qëndrimet e banorëve ndaj ndikimeve të rolit të aktorëve të turizmit dhe të partneriteteve publike e private në menaxhimin e turizmit.

Iniciativa për të përfshirë komunitetin në zhvillimin e një plani të menaxhimit të turizmit është huazuar nga partneriteti “Sektor Publik – Sektor Privat”.

Fjalë kyç: *Aktorët e turizmit, partneritetet publike - private, turizmi, menaxhimi*

Hyrje

Në dy dekadat e fundit është parë nevoja për shfaqjen e një nocioni të ri në studimet e menaxhimit: nocionin e palëve të interesuara. Studiuesit e menaxhimit kanë hetuar rolin dhe përgjegjësinë e bizneseve dhe aktorëve të tjerë në organizimin e mjedisit që prej viteve 1960, kjo ka çuar në krijimin e teorisë së “Stakeloder” që u shfaq në vitet 1980. Disa studiues të kohëve të fundit kanë argumentuar se elementët e teorisë së “Stakeloder” mund të gjurmohen shumë më herët në menaxhim.

Jamieson (2001) në studimin e tij thekson se *“Gjithmonë do të ketë konflikte në menaxhimin e destinacioneve komunitare. Do të ekzistojë gjithmonë një konflikt në një destinacion ndërmjet arritjes së zhvillimit ekonomik, ruajtjes dhe menaxhimit të ambientit social, kulturor e natyror. Sfida qëndron në ruajtjen e një balance ndërmjet tyre. Kjo detyrë bëhet gjithmonë e më e vështirë duke marrë parasysh numrin e madh të pjesëmarrësve në procesin e marrjes së vendimeve, po kështu faktorët dhe burimet që duhet të merren në konsideratë në çdo destinacion”*.

Shumica e akademikëve të angazhuar në studimin e teorisë së aktorëve e konsiderojnë Freeman (1984) si babai i teorisë së “Stakeloder”. Në punën e tij në vitin 1984 Menaxhimi Strategjik: Një përjasje e “Stakeloder” që Freeman përpiqet të shpjegojë “marrëdhënien e firmës me mjedisin e saj të jashtëm dhe sjelljen e saj brenda këtij mjedisi”. Freeman (1984, fq.46) përcakton si aktor “çdo grup ose individ që mund të ndikojë ose të preket nga arritja e objektivave të një organizate”. Lista e aktorëve të një organizate përfshin pronarët, klientët, konkurrentët, punonjësit, furnizuesit, qeveritë, organizatat e komunitetit lokal, grupet e interesit të veçantë, ambientalistët, mbrojtësit e konsumatorit, mediat, sindikatat, shoqatat tregtare, komuniteti financiar dhe grupet politike.

Ndërgjegjësimi i pranisë së aktorëve të shumtë që ndërveprojnë, ka hapur rrugën për qasje të reja të bazuara në “Stakeholder theories”, me të cilën u është lënë hapësirë marrëdhënieve midis aktorëve të ndryshëm, por me qendër veprimi ndërmarrjen turistike (Savoja 2009), e cila duhet të koordinojë interesat e të gjithëve, duke i besuar përdorimin dhe shfrytëzimin e pronës, duke besuar se është edhe në interes të saj ruajtja e pronës. Është shumë e thjeshtë të përdorësh burimet e të tjerëve dhe me pas ti braktisësh kur aktivi është përkeqësuar, veçanërisht në qoftë se askush nuk kërkon që ju të paguani asgjë.

Objektivat

1. Të identifikojë “aktorët” në turizmin urban dhe të hetojë marrëdhëniet e pushtetit ndërmjet tyre;
2. Të vlerësojë në mënyrë kritike nivelin dhe kufizimet e përfshirjes së aktorëve në zhvillimin e turizmit urban;
3. Për të vlerësuar rëndësinë e rolit të partneritetit publik- privat në turizëm

Metodologjia

Të dhënat për këtë studim u mbledhën nga banorët lokalë, të cilët angazhoheshin në partneritete publike-private në aktivitetet e turizmit. Aktorët dhe turistët u identifikuan si një faktor kyç në zhvillimin e rolit që kishte në turizëm partneriteti publik – privat. Ky studim bazohet kryesisht në të dhënat sekondare, si broshura, pamflete, libra, gazeta, internet, shpallje etj.

Rishikim i literaturës

Në planifikimin turistik, aspekteve ambientale e social - kulturore u kushtohet më pak vëmendje sesa aspekteve ekonomike. Qeveritë kryesisht përqëndrohen në maksimizimin e përfitimeve ekonomike. Gjatë viteve të fundit është rritur vëmendja ndaj qëndrueshmërisë si në aspektin ekonomik ashtu dhe ambiental. Koncepti i turizmit të qëndrueshëm ngre nevojën për një zhvillim më të balancuar të turizmit nga pikëpamja ekonomike, mjedisore dhe kulturore, që do të kërkonte padyshim një integrim të sektorit publik – privat dhe politikave të turizmit në të ardhmen.

Gray(1989) përcakton aktorët në mënyrë të ngjashme me Freemanin. Sipas saj, "Palët e interesuara janë aktorët që kanë interes për një problem apo çështje të përbashkët dhe përfshijnë të gjithë individët, grupet ose organizatat e ndikuara drejtpërdrejt nga veprimet që të tjerët ndërmarrin për të zgjidhur problemin".

Carroll (1989) zhvillon më tej idetë e Freeman, në punën e tij “Biznes dhe Shoqëri”: Etikën dhe Menaxhimi i aktorëve si një përpyetje për të përshkruar marrëdhëniet e bizneseve me grupe të ndryshme si punonjësit, konsumatorët, konkurrentët etj. Carroll ofron disa përkufizime të “Stakeholders”. Një prej tyre sugjeron që një “Stakeholder” është "një individ ose grup që ka një ose më shumë lloje të ndryshme aksionesh në


një biznes". Një tjetër nga përkufizimet e Carroll-it i përngjan përkufizimit të thjeshtuar të Freeman: "Një aktor mund të konsiderohet si çdo individ ose grup që mund të ndikojë ose të preket nga veprimet, vendimet, politikat, praktikat ose qëllimet e organizatës" (Carroll, 1996, fq. 74). Në këndvështrimin e tij, aktorët më të dukshëm të një biznesi janë aksionerët, punonjësit, klientët dhe konkurrentët, megjithëse ai gjithashtu do të argumentonte për domosdoshmërinë e përfshirjes së grupeve të tjera në konceptin e "Stakeholders" si; komuniteti, grupet me interes të veçantë dhe shoqëria ose publiku më i gjerë. Në pikëpamjen e Clarkson (1995), mund të konsiderojmë një person ose një grup si aktorë nëse ata "kanë ose pretendojnë pronësi, të drejta ose interesa në një korporatë dhe aktivitetet e saj, në të kaluarën, të tashmen ose në të ardhmen" (Getz & Timur, 2005, f. 235). Argent (1997, f.442) identifikon pesë grupe kryesore të "Stakeholders" që janë: "investitorë, punonjës, konsumatorë, furnizues dhe komuniteti përkatës". Shilling (2000, fq 225) përmbledh definicionet e ndryshme të "Stakeholders" si një grup, duke përfshirë klientët, punonjësit, menaxherët, aksionerët, kreditorët, furnizuesit, komunitetin "dhe ndonjëherë edhe konkurrentët". Megjithatë, Starik (1993) sfidon autorët e përkufizimeve të shumta të "Stakeholders" duke thënë se ata të gjithë e kufizojnë konceptin tek njerëzit dhe për rrjedhojë përjashtojnë "Stakeholders" e të tjerë të mundshëm, jo njerëzore.

Ai argumenton se mjedisi natyror pranohet si një "Stakeholder", pasi kjo do të lejonte identifikimin dhe planifikimin e ndërveprimeve mjedisore njerëzore-natyrore. Stark na kujton auditimet mjedisore dhe deklaratat e ndikimit si mekanizma, ku qeniet njerëzore përpiqen të menaxhojnë marrëdhëniet e tyre me mjedisin natyror duke përdorur proceset e menaxhimit të aktorëve. Prandaj, nëse qeniet jo njerëzore janë të përfshira në teorinë e "Stakeholder", koncepti duhet të ripërcaktohet që të përfshijë "çdo entitet të vetëm të natyrshëm që ndikon ose ndikohet nga performanca organizative" (Starik, 1993, f.22).

Teoria e "Stakeholders"

Kuptimi i teorisë së "Stakeholders", tani është themeluar mirë në literaturën e menaxhimit. Megjithatë, ka ende debate të konsiderueshme rreth përdorimit të teorisë në menaxhim. Në vitin 1984, Menaxhimi Strategjik i Freemanit: Një përjasje e "Stakeholders", solli teorinë e aktorëve në rrjedhën kryesore të literaturës së menaxhimit. Teoria u shfaq në vitet 1980 gjatë një periudhe të ndryshimit të shpejtë në mjedisin e jashtëm. Freeman (1984) sugjeroi që një teori e re ishte e nevojshme për

të reduktuar pasigurinë në kohën e ndryshimit të shpejtë. Si e tillë, ndryshime të mëdha strategjike në mjedisin e biznesit kërkonin ndryshime konceptuale në mendjet e menaxherëve. Një qasje e mundshme ndaj problemit të trajtimit të mjedisit të jashtëm ishte të rishikonte perspektivën tradicionale input-output të organizatës, ku iu kushtua vëmendje klientëve dhe investitorëve. Kjo çoi në një konceptualizim të ri të firmës si një organizatë që ka marrëdhënie me grupe të jashtme që kanë një pjesë dhe mund të ndikojnë në firmë. Freeman (1984) paraqet modeli i “Stakeholders” si një hartë, në të cilën firma është qendra e një rrotë ku rrezet janë të përbërë nga aktorë të ndryshëm. Kjo pikëpamje është bërë konventa nga e cila ka marrë zhvillim teoria e “Stakeholders”. Në dritën e kësaj, teoria e “Stakeholders” e sheh firmën si një njësi organizative përmes së cilës pjesëmarrësit e shumtë dhe të shumëllojshëm përbushin qëllime të shumëfishta që jo gjithmonë janë krejtësisht të njëjta.



Në modelin e “Stakeholders”, ndërmarrja nuk është një operator i thjeshtë i tregut, por ka rolin e kordinatorit të interesave që të gjithë aktorët e përfshirë kërkojnë të arrijnë. (Bowie, 2002)

Ndërsa shoqëria dhe mjedisi i jashtëm i biznesit janë bërë më komplekse, organizatat janë detyruar të zgjerojnë fokusin e tyre për të përfshirë një grup të gjerë aktorësh (Steadman, et al, 1995). Kështu, sugjerimi i Freeman (1984) ishte se vetëm nëpërmjet marrëdhënieve të thella me dhe midis këtyre palëve të interesuara kompanitë do të parashikojnë, rinovojnë dhe përshtaten me shpejtësi të mjaftueshme për ndryshimet në mjedisin e jashtëm, ato duhet të përpiqen të identifikojnë dhe komunikojnë me grupet përkatëse të interesit, të vendosin natyrën e përgjegjësisë për secilin dhe duhet të jenë të gatshëm për t'u gjykuar nga një gamë më e gjerë e treguesve të performancës që lidhen me

shqetësimet e aktorëve. Freeman (1984, fq.46) përcaktoi një aktor si "çdo grup ose individ që mund të ndikojë ose të preket nga arritja e objektivave të organizatës". Kështu, një grup kualifikohet si një "Stakeholder" nëse ka një interes të ligjshëm në aspektet e aktiviteteve të organizatës dhe kështu, ka ose fuqinë për të ndikuar në performancën e firmës ose ka një rol në performancën e firmës. Fokusi i Freeman-it është se si drejtuesit mund të përdorin teorinë, kornizën, filozofinë dhe proceset e qasjes së "Stakeholders" për të menaxhuar më mirë organizatat e tyre.

Për të zbatuar teorinë e aktorëve, koncepti i parë i Freeman (1984) kërkon që organizata të ketë një vlerësim të plotë të të gjithë personave apo grupeve që kanë interes në planifikimin, proceset, shpërndarjen dhe rezultatet e produktit ose shërbimit. Ky proces i identifikimit dhe klasifikimit të aktorëve ka çuar në zhvillimin e hartës së "Stakeholders". Sipas Freeman, qëllimi i hartës së "Stakeholders" është të identifikojë të gjithë "aktorët kryesorë", domethënë ato kategori të grupeve që mund të ndikojnë në organizatë, si dhe veprimet e tyre të perceptuara. Sipas Sautter & Leisen (1999), nuk ka asnjë nivel të veprimeve që duhet të ketë përparësi në aspektin e interesave të këtyre grupeve të ndryshme. Pa marrë parasysh këtë, aktorët e shumtë do të ushtronin ndikimin e tyre për të plotësuar interesat e tyre, për shembull ekonomisht, politikisht dhe shoqërisht. Kjo nxjerr në pah një pjesë integrale të hartës së aktorëve që vlerëson marrëdhënien e pushtetit/interetit midis grupeve të ndryshme të aktorëve. Kjo përfshin marrjen e vendimeve për dy çështje; sa i interesuar është secili grup i "Stakeholders" që t'i përshtasë pritjet e tij mbi zgjedhjen e strategjive të organizatës dhe nëse ata kanë mjetet për ta bërë këtë. Fuqia e "Stakeholder" lidhet me masën në të cilën ai mund të imponojë vullnetin e tij nëpërmjet shtrëngimit, përmes aksesit në burime materiale ose financiare, ose nëpërmjet presionit normativ (Medeiros de Araujo & Bramwell, 1999). Me fjalë të tjera, "Stakeholders" mund të kenë fuqinë votuese, fuqinë ekonomike, fuqinë politike dhe fuqinë pozicionuese. Në këtë kuptim, është e mundur që disa aktorë të mos kenë fuqi. Për shumicën e organizatave, fuqia shpërndahet në mënyrë të pabarabartë ndërmjet aktorëve të ndryshëm dhe ekziston një tendencë e përgjithshme për organizatat që të adresojnë nevojat dhe interesat e atyre grupeve me më shumë fuqi (Johnson & Scholes, 1999).

“Stakeholders” në literaturën e turizmit

Në literaturën e turizmit ishte prezantimi i idesë së zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm në vitet '80, i cili nxiti kërkime për hetimin e nocionit të “Stakeholders”. Sidoqoftë, ndërgjegjësimi për çështje të ngjashme filloi një dekadë më parë me studimet lidhur me ndikimet e zhvillimit të turizmit në destinacione, ku theksi po zhvendosej gradualisht nga mjedisi në komunitetin pritës. Murphy (1985) i paraprin idetë, të cilat u bënë popullore si masa të qëndrueshme në fillim të viteve 1990, në punën e tij “Turizmi”: “Një Qasje në Komunitet” ai studion aspektin social të qëndrueshmërisë. Ai demonstroi se si komuniteti lokal ndikohet nga turizmi dhe zhvillimi i turizmit, nëse efektet janë pozitive ose negative dhe thekson nevojën për përfshirjen e komunitetit lokal si një mjet për të kontrolluar këto efekte. Prandaj duhet të ofrohen mundësi për të siguruar pjesëmarrjen e gjerë të komunitetit në ngjarjet dhe aktivitetet turistike. Megjithatë Murphy po përqëndrohet në përfshirjen e komunitetit në turizëm dhe zhvillimin e turizmit, ai i përmend qeveritë, bizneset dhe bankat si aktorë kryesorë në planifikimin e turizmit: “Më shumë ekuilibër në procesin e vendimmarrjes kërkohet ndërmjet “aktorëve me fonde” (qeveritë, bizneset e mëdha, bankat) dhe atyre që duhet të jetojnë me rezultatet dhe që pritet të sigurojnë mikpritjen”(Murphy 1985, fq. 153). Në vitet 1990, çështjet e ngritura në literaturën e turizmit i ngjajnë gjithnjë e më shumë çështjeve të ngritura nga akademikët në studimet e menaxhimit.

Studiuesit si Jamal & Getz (1995) dhe Bramwell & Sharman (1999) u përqëndruan në bashkëpunimin si një mjet i nevojshëm në planifikimin e turizmit në komunitet. Theksi u vendos në komunitetin pritës, si aktori më i rëndësishëm dhe në format e bashkëpunimit ndërmjet komunitetit lokal dhe sektorit publik dhe privat.. Bramwell & Sharman (1999) përdorin nocionin e “Stakeholders” pa e definuar atë, megjithatë, ata përcaktojnë atë që ata e shohin si “Stakeholders “ kyç mbi të cilin do të varet bashkëpunimi në zhvillimin e turizmit: “Qeverisja vendore plus organizata të tjera publike që kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në shpërndarjen e burimeve; shoqatat dhe sektorët e industrisë së turizmit si Dhoma e Tregtisë, Konventa dhe Byroja e Vizitorëve dhe Autoriteti Rajonal i Turizmit; organizatat rezidente (grupet e komunitetit); dhe grupet e interesit të veçantë (Bramwell & Sharman 1999, fq. 198). Sautter & Leisen (1999) përpiquan të përshtasin hartën e “Stakeholders” të Freeman në një kontekst turizmi. Në këtë hartë të aktorëve të turizmit, ata

rendisin kategoritë e mëposhtme si aktorët kyç: planifikuesit e turizmit, bizneset lokale, banorët, grupet e aktivistëve, turistët, zinxhirët e biznesit kombëtar, konkurrentët, qeveria dhe punonjësit.

Rëndësia e “Stakeholder Responsibility” është aq e madhe sa kohët e fundit ka pushtuar vëmendjen e të gjithëve. Është fakt mjaft i qartë se reciprociteti dhe ndërvlerësia e të drejtave dhe detyrave të aktorëve janë themeli për krijimin e një mjedisi ku veprimet ekonomike mund të projektohen, zbatohen dhe kontrollohen në bazë të modeleve të sjelljes së të gjithë aktorëve.

Ideja e “Stakeholder Responsibility” është një fushë interesante e menaxhimit të turizmit të qëndrueshëm. Tanimë është e qartë se për menaxhimin e suksesshëm të turizmit të destinacionit turistik nevojitet përdorimi i aseteve të përbashkëta të atij destinacioni. Në fakt, prodhimi, shpërndarja dhe shkëmbimi i aseteve turistike janë të lidhura me ato që quhen si kufijtë socialë të përdorimit të burimeve, për këtë menaxhimi i turizmit përqëndrohet në zhvillimin e modeleve të përdorimit “global” të përgjegjshëm (në kuptimin që kjo përgjegjësi duhet të bjerë mbi të gjithë aktorët e përfshirë).

Koncepti, i “Stakeholder Responsibility” lejon një hap përpara në zhvillimin e një Paradigme etike për turizmin si dhe në hartimin dhe menaxhimin e praktikave të turizmit më të qëndrueshme të bazuar në modelin e “Aktorëve” (Savoja 2007).

Përkufizimi “Zyrtar” i turizmit të qëndrueshëm i referohet aftësisë “Për menaxhimin e burimeve në mënyrë të tillë që mund të plotësohen nevojat ekonomike, sociale dhe estetike duke ruajtur integritetin kulturor, karakteristikat themelore të ekosistemeve, biodiversitetit dhe mënyrën e jetesës së popullatës lokale” (WTO, 2002). Në këtë kuptim turizmi i qëndrueshëm paraqitet si një deklaratë për një angazhim moral (pikërisht atë të qëndrueshmërisë), që gjithsesi nuk i atribuohet asnjë aktori në veçanti, përkundrazi ideja e turizmit përgjegjës në nivel global çon në krijimin e një kornize për të vendosur aktorët dhe sjelljet e tyre brenda saj.

Partneriteti Publik Privat: Motivet dhe faktorët e suksesit të tyre

Turizmi përcaktohet fuqishëm nga rregullimi qeveritar nga njëra anë dhe interesat private shpesh edhe afatshkurtra në anën tjetër. Në këtë pjesë do të përpiqemi të analizojmë përfitimet kryesore dhe problemet e partneriteteve publike private në industrinë e turizmit. Qëllimi është të

nxjerrin parimet e menaxhimit për formimin e Partneriteteve Private-Publik (PPP) në turizëm.

Para diskutimit të aspekteve të veçanta të partneriteteve publike-private në turizëm, po japim disa përkufizime të Partneriteteve Private-Publik (PPP):

- Kompanitë që përbëhen nga asetet private dhe publike (në pronësi të qeverisë) zakonisht janë etiketuar kompani të përziera.
- PPP-të janë forma specifike të bashkëpronësisë dhe bashkëpunimit midis institucioneve publike dhe ndërmarrjeve private që janë formuar për shkak të disa avantazheve sinergjike dhe që ndajnë rreziqet dhe fitimet.
- Zakonisht, fondacioni është një marrëveshje kontraktuale midis sektorit publik dhe organizatave të orientuara nga fitimi.

Pjesa më e madhe e partneriteteve publike-private duhet të gjenden në zhvillimin, financimin, zbatimin dhe menaxhimin e infrastrukturës (Muhm, 1998). Prandaj, shumë shembuj të partneriteteve publike private mund të gjenden në industritë e ndërtimit (p.sh. ndërtimi i autostradës, stacionet e trenave), në industritë e energjisë ku duhet të ndërtohen termocentralet me kosto të lartë ose në fushën e menaxhimit të mbeturinave. Projekte të tjera infrastrukturore në fushën e turizmit janë ngjarje mega sportive si Lojërat Olimpike apo kampionate botërore, parqe kombëtare, CRS kombëtare etj. PPP nuk mund të interpretohen si një formë tjetër e privatizimeve; për sa i përket qeverive në këto projekte, ato zakonisht kanë një ndikim dhe kontroll të lartë mbi pronat dhe proceset e menaxhimit. Format e PPP-ve mund të ndryshojnë shumë: p.sh. shërbimet apo kontratat e menaxhimit ku prona publike mund të menaxhohet nga institucione private ose BOTs (Build, Operate, Transfer), të cilat janë kontrata afatgjata për të ndërtuar dhe drejtuar infrastrukturën publike dhe private. PPP-të shpesh përfaqësojnë zgjidhje të politikave për dështimet e tregut, një koncept i cili në mënyrë efektive mbështetet dhe është i lidhur me një sërë pyetjesh burimore në ekonominë mjedisore. Këtu, pamundësia e tregjeve (ku kërkesa dhe oferta përcaktohen me çmim) për të ofruar mallra specifike mjedisore qoftë në nivelin që shoqëria e konsideron optimale apo nuk e konsideron fare, lind në thelb nga cilësia e mirë e ajrit, tokës dhe burimeve të ujit. Sot, pa partneritete publike-private do të ndodhin efekte serioze negative sociale dhe ekologjike.

- Investimet private shpesh janë vetëm afatshkurtra dhe nuk e konsiderojnë shfrytëzimin e burimeve.
- Nga ana tjetër, qeveritë nuk janë në gjendje të ofrojnë produkte dhe shërbime të turizmit të përditësuar dhe të orientuar drejt konsumatorit.

Motive të tjera për partneritetet publike private në fushën e turizmit janë:

- **Parakushtet për zhvillimin e destinacioneve turistike që shpesh sigurohen nga qeveria:** janë përmirësimi i situatës konkurruese dhe fitimi i përparësisë konkurruese. Rritja e kostos së kontrollit të cilësisë (psh. në rastin e plazheve ose pyjeve) detyron institucionet publike që të jenë në aleancë me ndërmarrjet private që në njërën anë mund të jenë të specializuar në kontrollimin e parimeve të qëndrueshmërisë në destinacionet turistike në rritje, ose në anën tjetër janë aktorë sipërmarrës në turizëm si ndërmarrje hoteliere, të cilët tashmë kanë mekanizmat e brendshëm të kontrollit të cilësisë së të mirave publike. Megjithatë, qëndrueshmëria sociale dhe ekologjike mund të shihet si bazë për krijimin dhe mirëmbajtjen e avantazheve konkurruese ndërkombëtare.
- **Për të kapërcyer problemet financiare:** Të dy ndërmarrjet private dhe institucionet publike mund të përballen me mungesa të mëdha të kapitalit. Avantazhet e bashkëpunimit janë të dukshme pasi ndërmarrjet private mund të përfitojnë nga strategjitë e mbështetura nga qeveria për të ngritur kapital dhe institucionet publike mund të përfitojnë nga menaxhimi profesional në planin e biznesit për zhvillimin e planeve të biznesit.
- **Për të transferuar njohuritë:** Institucionet publike duhet të dinë më shumë rreth motiveve mikroekonomike të tregut dhe sjelljes sipërmarrëse. Pa njohuri për proceset e brendshme të ndërmarrjeve të turizmit, qeveritë vështirë se mund të zhvillojnë strategji efikase dhe efektive për të mbështetur inovacionin. Por PPP-të gjithashtu mund të punojnë si ndërmjetës, pasi ata janë në gjendje të transferojnë njohuritë që mund të jenë zhvilluar nga universitete apo institucione të tjera publike kërkimore. PPP-të që përqëndrohen në transferimin e njohurive ndërmjet partnerëve

publikë- privatë janë marketingu publik- privat dhe institucionet kërkimore të tregut.

- **Për të rritur profesionalizmin dhe produktivitetin:** Operacionet e përbashkëta në përgjithësi mund të çojnë në një rritje të profesionalizmit dhe produktivitetit, sepse rezultatet dhe progresi mund të kontrollohen nga të dy palët e përfshira. PPP-të në sektorin e energjisë të tilla si gazi, energjia elektrike ose menaxhimi i mbeturinave kanë përmirësuar shërbimet dhe cilësinë e tyre dhe janë bërë më shumë organizata të orientuara drejt klientëve.

Zgjedhja e formës ose e kontratës varet nga qëllimet, shuma e investimeve, kushtet e kornizës ekonomike dhe afati kohor i projektit. Mund të përmenden pesë faktorë kritikë të suksesit të PPP (NCPPP, 2004):

Natyra e PPP: Natyra e PPP-së do të ndikojë në mënyrë kritike në suksesin e saj. Një PPP është e suksesshme kur mund të kapërcejë eksternalitetet e tregut (psh. asimetritë e informacionit) dhe kështu të krijojë sa më shumë stimuj që të jetë e mundur për investitorët privatë në mënyrë që ata të bëhen lojtarë të mundshëm dhe të qëndrueshëm afatgjatë të tregut.

Përfshirja e sektorit publik: Një partneritet i suksesshëm mund të rezultojë vetëm nëse ka angazhim nga "lartë". Zyrtarët më të lartë publikë duhet të jenë të përfshirë në mënyrë aktive në mbështetjen e konceptit të PPP-ve dhe të marrin një rol udhëheqës në zhvillimin e çdo partneriteti të dhënë. Një lider politik i mirinformuar mund të luajë një rol kritik në minimizimin e perceptimeve të gabuara në lidhje me vlerën e publikut për një partneritet të zhvilluar në mënyrë efektive.

Madhësia dhe koha: Kontratat PPP janë kontrata afatgjata. Megjithatë, ato duhet të përfshijnë qartë ndryshimet e projektit sipas ciklit jetësor. Kështu, analiza e ciklit jetësor të projektit mund të ndihmojë për të parë kur përfshirjet publike duhet të rriten ose duhet të zvogëlohen. Në përgjithësi, në fillim të ciklit jetësor për shkak të rrezikut të lartë partnerët publikë duhet të jenë më të fortë se në fazat e mëvonshme të ciklit të jetës së projektit. Në PPP- të më të vjetra angazhimi privat është më i madh dhe duhet të zëvendësojë qeverinë dhe kështu, partnerët publikë do të duhet të tërheqin angazhimin e tyre për të rikrijuar stimuj për sipërmarrësit në treg.

Plan biznesi: Partnerët duhet të dinë se çfarë mund të presin nga bashkëpunimi para fillimit të projektit. Një plan i zhvilluar me kujdes (që shpesh bëhet me ndihmën e një eksperti të jashtëm në terren) do të rrisë ndjeshëm probabilitetin e suksesit të partneritetit. Ky plan më së shpeshti do të marrë formën e një kontrate të gjerë dhe të detajuar, duke përshkruar qartë përgjegjësitë e partnerëve publikë dhe privatë.

Komunikimi i aktorëve: Nga një partneritet do të preken më shumë njerëz sesa vetëm zyrtarët publikë dhe partnerët e sektorit privat. Punonjësit e prekur, pjesa e publikut që merr shërbimin, shtypi, sindikatat e punës dhe grupet përkatëse të interesit do të kenë opinionet e tyre rreth një partneriteti dhe vlerës se saj për të gjithë publikun. Është e rëndësishme të komunikojmë hapur dhe sinqerisht me këta aktorë për të minimizuar rezistencën e mundshme për krijimin e një partneriteti.

Partneriteti Publik -Privat në turizëm

Investimet publike i janë nënshtruar një debati të konsiderueshëm gjatë fazës së ndërtimit të turizmit masiv. Arsytet për mosbesimin e investimeve publike janë se sektorët publikë nuk janë gjithmonë në gjendje të interpretojnë dëshirat e konsumatorëve dhe kështu nuk arrijnë të investojnë në tregjet potenciale të ardhshme të larta (Tribe, 1999, fq. 264). Në destinacionet e reja turistike, zhvilluesit e turizmit tashmë përballen me pengesa të rritjes, veçanërisht në fazën e zhvillimit të ciklit jetësor të destinacionit (Agarwal, 1994; Butler, 1980).

Megjithatë investimet në infrastrukturën e destinacionit turistik janë të nevojshme për të siguruar një standard cilësor të turizmit si për turistët ashtu edhe për banorët.


Në fazat e mëvonshme të ciklit jetësor të produktit të destinacionit, PPP-të mund të luajnë një rol jetësor në ruajtjen e mjediseve tashmë të rrënuara dhe vendosjen e produkteve dhe shërbimeve të reja në destinacion. Një përtëritje e destinacionit turistik mund të inkurajohet përmes partneriteteve të forta publike-private, sepse vetëm projektet afatgjata të orientuara në të ardhmen mund të ndikojnë në konkurrueshmërinë e përgjithshme të destinacioneve. Pas marrjes së rrezikut të madh të investimeve në infrastrukturën e turizmit në fillim të ciklit jetësor të destinacionit turistik, PPP-të duhet të evoluojnë si iniciativa gjithnjë e më shumë private, të cilat nxisin rritjen e industrisë. Në një fazë të mëvonshme të ciklit të jetës mekanizmat e tregut sipërmarrës mund të mbulojnë rrezikun dhe mund të iniciojnë dinamikën e tregut. Kështu, natyra dhe koha e PPP-ve përcaktojnë suksesin e PPP-

ve, pasi ato duhet të instalohen vetëm kur tregjet dështojnë. Në industrinë e turizmit gjejmë forma të ndryshme të PPP-ve. Mirëpo, bashkëpunimet e njohura ndërmjet ndërmarrjeve private dhe publike janë shoqatat e marketingut turistik. Sidomos në destinacionet e vegjël dhe të mesëm të turizmit që për shkak të madhësisë së tyre, ata nuk do të jenë në gjendje të rrisin efektet në shkallë të gjerë dhe kështu asimetritë e informacionit ndodhin në varësi të madhësisë së ndërmarrjeve të turizmit. Marketingu dhe studimet e tregut duhet të bashkërendohen në shoqatën e marketingut, e cila në njërin anë mund të komunikojë në nivel ndërkombëtar strategjitë e përbashkëta të marketingut të strukturave të vogla të destinacioneve turistike dhe në anën tjetër të përpunojë të dhënat statistikore të studimit të tregut dhe ta transferojë atë në bordet e turizmit apo grupet e interesit të destinacionit turistik. Një fushë e dytë e PPP-ve në turizëm janë projektet tradicionale infrastrukturore për produktet dhe shërbimet e kohës së lirë dhe kulturës. Mega-objektet e kohës së lirë u bënë gjithnjë e më të rëndësishme që nga vitet '70.

Nëpërmjet këtij bashkëpunimi, aftësitë dhe vlerat e secilit sektor bashkohen për dhënien e shërbimeve dhe krijimin e infrastrukturës turistike të nevojshme.

Pse është i nevojshëm PPP në turizëm ?

- Mungesa e buxhetit dhe njohurive të nevojshme në shumë Bashki/Komuna
- Zbatimi i projekteve të turizmit bëhet me shpejt dhe me cilësi.
- Zhvillimi i infrastrukturës turistike është shumë i shtrenjtë por thelbësor
- Mjedisi konkurrent kërkon investime të reja



Modeli i bazuar tek partneriteti publik – privat (PPP)

1. Bashkëpunimi

Karakteristikat kryesore të tij janë:

- Sektori Publik – Privat bien dakort të punojnë së bashku (zakonisht kontributi i sektorit është më i lartë se 50%)
- Model ideal nëse fillohet nga fillimi një investim.

2. Përdorim

Karakteristikat kryesore të tij janë:

- Sektori publik, përzgjedh një kompani për planifikim, organizim, financim dhe drejtim, njësitë publike përfitojnë një shumë fikse vjetore.
- Përcaktohet një kontratë për menaxhimin e njësisë me detyra dhe detyrime specifike.

3. Ortakëri

Karakteristikat kryesore të tij janë:

- Sektori Publik ndërmerr një pjesëmarrje të barabartë në një projekt të infrastrukturës turistike.
- Investimi shihet si një impuls për zhvillimin e turizmit rajonal
- Sektori Publik, shpesh mbulon kostot e zhvillimit të infrastrukturës turistike.

4. Sponsorizim

Karakteristikat kryesore të tij janë:

- Sektori Privat ndihmon zhvillimin e elementëve të caktuar të destinacionit nëpërmjet sponsorizimeve në vlerë monetare apo materiale.

5. Dhënie me konçension

Karakteristikat kryesore të tij janë:

- Një konçensionar (sektori Privat) i është garantuar e drejta për përdorimin e një objekti ekzistues.
- Objekti qëndron në pronësinë e sektorit publik
- Konçensionari gjeneron të ardhura nëpërmjet shitjes direkte të shërbimeve tek konsumatorët.

6. Bashkëpunim joformal


Karakteristikat kryesore të tij janë:

- Sektori publik ndihmon nëpërmjet trajnimeve në fusha të ndryshme sektorin privat.

Politika e Turizmit e Qeverisë duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë pjesëmarrjes maksimale të sektorit privat në investimet në projektet e turizmit. Partneriteti “Multi-stakeholder” është një element i rëndësishëm i promovimit të turizmit. PPP-të në turizëm luajnë një rol të rëndësishëm në vendet ku zhvillimi i turizmit është në fazat e hershme.

Për zhvillimin e qëndrueshëm të një destinacioni turistik është e nevojshme jo vetëm pjesëmarrja e komunitetit në marrjen e vendimeve, por dhe bashkëpunimi i tij me të gjitha grupet e interesit.

Një model konceptual i bashkëpunimit të Komunitetit – Sektorit Publik – Sektorit Privat paraqitet si në figurën më poshtë:



Model konceptual i bashkëpunimit të komunitetit, sektorit publik dhe atij privat.

PPP-të duhet të jenë gjithmonë transparente për grupet e tjera të interesit dhe aktorët dhe PPP-të duhet gjithmonë të përpiqen të përqëndrojnë përmirësimin e grupeve të popullsisë sociale të pafavorizuara (Gruber, 2003). Kur përdoret bashkëpunimi publik-privat si një mjet në menaxhimin e ndryshimeve për destinacionet turistike, duhet t'i kushtohet shumë vëmendje kohës së partneriteteve, nevojave në ndryshim dhe problemeve të produkteve apo ndërmarrjeve turistike përgjatë ciklit jetësor të produktit. Sidomos në tregjet e strukturuar të turizmit dhe me përmasa më të vogla, institucionet publike duhet të mbështesin sektorin privat për t'i lejuar ata të zhvillojnë avantazhe konkurruese përmes të mësuarit që çon në produkte dhe shërbime të reja sipërmarrëse. Sidoqoftë, partneritetet publiko-private janë duke u zhvilluar dhe nuk duhet të bazohen shumë tek qeveria, pasi ndërmarrjet turistike duhet të vendosen në pozita për të zhvilluar kompetencat unike thelbësore dhe aftësitë inovative për të dalluar veten në treg.

Konkluzione

Zhvillimi turistik i një destinacioni varet në një masë të madhe nga përfshirja dhe roli i aktorëve kryesorë të tij. Aktorët kanë qëndrime të ndryshme në zhvillimin e turizmit, për shkak të interesave dhe ideve të ndryshme rreth koston dhe përfitimeve të turizmit që këta aktorë kanë.

Të gjithë aktorët lokalë të destinacionit duhet të ndajnë detyrën e përbashkët të mbrojtjes dhe ruajtjes së burimeve natyrore dhe kulturore, për të mbështetur ekonominë koherente, si dhe për të siguruar mbrojtjen e saj për brezat e ardhshëm.

Nevojitet roli i sektorit publik si strukturë përgjegjëse për të gjithë procesin e menaxhimit të destinacionit duke filluar nga planifikimi i zhvillimit, menaxhimi i atraksioneve të destinacionit e deri tek monitorimi i përmbushjes së objektivave të përcaktuara.

Rezidentët duhet të jenë pjesë e vendimeve të zhvillimit të turizmit për t'u siguruar që nevojat e tyre janë të përfshira. Për më tepër komunitetet lokale duhet të kenë një zë në çështjet e zhvillimit turistik, për sa kohë që ai ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në cilësinë e jetës së banorëve.

Procesi i menaxhimit të aktorëve mund të jetë një sfidë në drejtim të mbajtjes së një dialogu të vazhdueshëm me grupet e “Stakeholders “ të identifikuar. Rezultatet e hetimit të “Stakeholders “ tregojnë për një program të përshtatshëm të turizmit për tre arsye:

E para, synon të ofrojë shërbime më të mira turistike, si dhe të kontribuojë në krijimin e një shoqërie më të mirë turistike.

E dyta, ajo i përgjigjet çështjeve kyç me zhvillimin e turizmit.

E treta, ajo është e informuar nga pikëpamjet e një sektori të gjerë të aktorëve.

Për ta përfunduar mund të themi se zhvillimi i turizmit ose zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit është për shkak të rritjes së qëndrimit bashkëpunues të sektorit privat dhe atij publik. Kanë kaluar ditët kur sektori privat ishte në mëdyshje në fillimin e përpjekjeve drejt zhvillimit të turizmit. Autoritetet përgjegjëse për planifikimin dhe promovimin e turizmit në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar, kanë filluar të përfshijnë sektorin privat në procesin e vendimmarrjes. Objektivi i përgjithshëm i të dy sektorëve është krijimi i një imazhi pozitiv të vendit si një destinacion i këtij mijëvjeçari.

Bibliografia

Bramwell, (1999).The Best-Laid Plans;Far Eastern Economic Review
Nov 14. Hong Kong.Canada. Winnipeg: University of Manitoba,
Natural Resources Institute, Continuum International Publishing
Group,pp.34 -56

- Carroll (1989). (1998) Mountain Tourism for Local Community Development in and Resource Studies, Kalmbach Publishing Co.pp.130 -143
- Donaldson (1995).Development: A Report on Case Studies in Kinnaur District H.P. and the Badrinath Tourist Zone Dehra Dun: Academy for Mountain Environics, Channel View Publications,pp.91 -101
- Freeman(1984), Development: Case Study Report on the Annapurna and Gorkha Regions of Nepal Kathmandu: International Centre for Integrated Mountain Development, Centre for Environment studies, Sterling Publications pp. 176-189
- Gray (1985), Tourism and Gender: Impact and Implications of Tourism on Nepalese Women.
- Jamieson W. (2001), "Community Tourism Destination Management: Principales and Practices"
- Bowie N. (2002), Business Ethick, Blackwell, Oxford
- Savoja L. (2007), "Turismo sostenibile e Stakeholder Model" Notizie di Politeia, XXIII,n.85-86.
- Leisen (1999),Tourism and Conservation in Bromo Tengger Semeru National Park, East Java. Hull: University of Hull. Mountain-Forum On-Line Library Document. Andrus and Son Publications,pp.189-198
- Muhm (1998), Sagarmatha National Park: The Impact of Tourism in the Himalayas'Himalaya publications,Prince Publishers, pp. 274–281
- Murphy (1985), Down to Earth 'Saying "No" to Golf', Down to Earth 20/21Continuum International Publishing Group, pp. 17–18.
- Robson (1996), 'Tourism in the Himalayas: Seizing the Opportunity' in Hemmati, M.(ed.) Gender and Tourism: Women's Employment and Participation in Tourism, London: Edward Elgar Publishing, pp.57–70
- Starik (1993), Centre for Resource and Environment Studies Mountain Tourism in Nepal: AnOverview. Kathmandu: International Centre for Integrated Mountain Development, Centre for Resource and Environment Studies, Shambhala Publications,pp.29 -86
- Taurer (2003), 'Sa Pa, Vietnam: Capacity Building for Sustainable Tourism and Sa Pa, Vietnam: Ideas for the Future'. Communications to the Internet Conference on Community Based Mountain Tourism sponsored by Mountain Forum, The University of Chicago Press, Vol. 38 (2), pp. 101-149.
- Tribe (1997), Personal communication addressed to Lhakpa on Mountain Forum email list serve, Rutledge Publication vol. 8 (2) pp. 183-213.

WTO (2002), www.world-tourism.org

Williams (1996), 'Culture, Tourism and Local Strategies Towards Development: Case Studies in the Philippines and Vietnam', Research Report, Sterling publishers, Vol. 2 (3), pp.231-276.

SFIDA E BASHKËPUNIMIT RAJONAL TË KOSOVËS NË KUADËR TË PROCESIT TË INTEGRIMIT EVROPIAN

Stela Meçaj*

Abstrakt

Komisioni Evropian i propozoi Bashkimit Evropian në 26 maj të vitit 1999 krijimin e Procesit të Stabilizim-Asociimit, si angazhim afatgjatë i Bashkimit Evropian për të ndihmuar vendet e rajonit në aspektin politik, financiar dhe të burimeve njerëzore gjatë procesit të anëtarësimit. Kosova u bë pjesë e këtij procesi në bazë të rezolutës Nr. 1244, në kuadër të politikës së zgjerimit të Bashkimit Evropian. Stabiliteti në Kosovë është prioritet për sigurinë dhe lëvizjen e lirë në rajon dhe më gjerë. Lëvizja e lirë e qytetarëve, mallrave, shërbimeve, kapitalit dhe fuqisë punëtore, nëpërmjet zhvillimit të infrastrukturës rrugore, energjetike dhe të telekomunikimeve konsiderohen elemente kryesore në zhvillimin ekonomik të një vendi, i cili aspiro anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Vendet e Ballkanit Perëndimor kanë ndërmarrë një sërë iniciativash duke përmirësuar legjislacionin në përputhje me standardet e BE. Ky proces ka ndihmuar në arritjen e stabilitetit në rajon dhe në çuarjen përpara të reformave. Këshilli për Bashkëpunim Rajonal ka një rëndësi shumë të madhe për implementimin e strategjisë 2020, qëllimi i së cilës është promovimi i integritetit të rajonit në BE. Zhvillimi i bashkëpunimit rajonal përbën domosdoshmëri për integrimin evropian të vendeve të Ballkanit Perëndimor, si një mjet për të arritur stabilitetin në aspektin politik dhe ekonomik. Një bashkëpunim intensiv ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor është me rëndësi të madhe për plotësimin e kriterëve për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Ky punim synon të analizojë sfidën e Kosovës për intensifikimin e bashkëpunimit rajonal në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Fjalë kyç: *Procesi i Stabilizim-Asociimit, bashkëpunimi rajonal, integrimi evropian, standarde evropiane.*

*Dr. Stela Meçaj, Departamenti i Drejtësisë, Universiteti “Ismael Qemali” Vlorë.
E-mail: stela.mecaj@yahoo.com.

Hyrje

Procesi i integritit evropian ka nisur pas Luftës së Dytë Botërore në themel të bashkëpunimit rajonal dhe si qëllim primar ka patur zbutjen e armiqësisë mes disa shteteve të sapo dala nga lufta, si Franca, Gjermania dhe Italia. Përveç kësaj, ky integrit ka patur për qëllim krijimin e një bashkëpunimi të mirëfilltë ekonomik midis këtyre shteteve, me qëllim të sigurimit të pavarësisë ekonomike të pjesës së Evropës Perëndimore për të neutralizuar ndikimin e Rusisë, si aleate të forcave triumfuese të Luftës së Dytë Botërore dhe dominimit të sistemit të saj politik dhe ekonomik në këtë pjesë të Evropës.

Ndonëse bashkëpunimi rajonal duket, si një proces politik në themel ka prapavijë ekonomike. Bashkëpunimi rajonal ka për qëllim promovimin dhe ndërtimin e bashkëpunimit të ndërsjelltë të shteteve për të inspiruar procese të reja të zhvillimit ekonomik, politik dhe social, duke u bazuar në praktika të mira, të cilat sjellin dobi të ndryshme për qytetarët. Nga kjo pikëpamje, bashkëpunimi rajonal konsiderohet, si një mënyrë për zgjidhjen e problemeve para së gjithash ekonomike, të cilat janë të pazgjidhura për një vend të caktuar me kapacitetet e veta.

Në vitin 1999 Bashkimi Evropian hapi Procesin e Stabilizim Asociimit (PSA), si kornizën kryesore të politikës së vet, që u hapte shtegun evropian vendeve të Ballkanit Perëndimor (BP). Procesi i Stabilizim-Asociimit ka tre qëllime kryesore: stabilizimin dhe tranzicionin e shpejtë në ekonominë e tregut, promovimin e bashkëpunimit rajonal dhe perspektivën për anëtarësim në BE.¹ Me kohë PSA ka shtuar instrumentet, që e lehtësojnë këtë rrugë në mes tyre dhe Marrëveshjet e Stabilizim Asociimit (MSA): marrëdhënie kontraktuale me BE-në të kushtëzuara nga përbushja e kushteve të caktuara. Këto paraqesin një dimension të ri në marrëdhëniet me Ballkanin Perëndimor, që hap mundësi edhe për një anëtarësim të mundshëm në BE. Perspektiva e anëtarësimit e vendeve të Ballkanit Perëndimor është e qartë². Fillimisht u lançua në takimin e Këshillit Evropian në Feira në qershor të vitit 2000,³ ku vendet e Ballkanit Perëndimor, pjesëmarrëse në PSA u njohën si kandidate potenciale për anëtarësim në BE. Kjo më vonë u rikonfirmua në samitet e Zagrebit (2000) dhe Kopenhagës (2002). Në qershor të vitit 2003, Samiti Bashkimi Evropian-Ballkani Perëndimor i mbajtur në Selanik,

¹Maloku Kosumi, A. dhe Kosumi, F., Sfidat e integritit evropian, <https://telegrafi.com/sfidat-e-integritit>. (Aksesuar më 17.01.2018).

²Konkluzionet e Samiteve në Feira, Zagreb dhe Selanik.

³Rregullorja e Këshillit (EC)No 2666/2000 e datës 5 Dhjetor 2000.

rikonfirmoi mbështetjen e BE-së për një perspektivë evropiane të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Në Samit u miratua “Axhenda e Selanikut për vendet e Ballkanit Perëndimor: drejt integritimit evropian⁴,” që synon fuqizim të mëtejshëm të marrëdhënieve mes BE-së me rajonin, duke përfutur nga përvoja e mëhershme e zgjerimit⁵.

Çdo vend harton plane të veprimit për zbatimin e Partneritetit, që njëkohësisht shërbejnë, si agjendë për matjen e progresit të arritur. Për më tepër, në fuqi është “parimi i regatës”, që do të thotë se secili vend vlerësohet individualisht për përmbushjen e kriterëve të dhëna për anëtarësim⁶. Në qershor të vitit 2004, Këshilli i Ministrave ka adoptuar Partneritetin e parë Evropian me Serbinë dhe Malin e Zi, ku ishte përfshirë edhe Kosova⁷. Në qershor të vitit 2005 Këshilli Evropian rikonfirmoi zotimin për përmbushjen e Agjendës së Selanikut duke theksuar, se progresi drejt anëtarësimit varet nga përpjekjet, që këto vende do të bëjnë për të përmbushur Kriteret e Kopenhagës dhe kushtet në kuadër të PSA⁸.

Në 30 qershor 2006 Këshilli Evropian adoptoi një partneritet të ri, i cili ishte përshtatur për të reflektuar progresin e arritur brenda vitit, si dhe për të përfshirë sfidat dhe prioritetet e reja për Kosovën. Institucioneve të Kosovës dhe të gjitha vendeve të tjera në PSA u është kërkuar të zhvillojnë Plane Veprimi përmes të cilave do të adresohen prioritetet e dhëna në Partneritetet Evropiane. Prioritetet, që kërkojnë vëmendje të posaçme në kuadër të Partneritetit për Kosovën janë: demokracia dhe sundimi i ligjit, bashkëpunimi i plotë me Tribunalin e Hagës, rritja e bashkëpunimit rajonal, përkufizimi i politikave makro-ekonomike dhe rivitalizimi i privatizimit, çështje të tregut të brendshëm dhe tregtisë, politika sektorale, si bujqësia, mjedisi, transporti dhe energjia, si dhe bashkëpunimi në sferën e drejtësisë dhe çështjeve të brendshme.

⁴http://europa.eu.int/comm/external_relations/see/gacthess.htm. (Aksesuar më 20.01.2018).

⁵Konkluzionet e Presidencës - Selanik, 19-20 qershor 2003, <http://ue.eu.int/ue>. (Aksesuar më 12.01.2018).

⁶Kriteret e Kopenhagës dhe kushtet e tjera të BE-së.

⁷Sipas përkufizimit të Rezolutës 1244 të KSKB.

⁸Komunikata e Komisionit “Ballkani Perëndimor në rrugën drejt BE-së: konsolidimi i stabilitetit dhe rritja e prosperitetit,” 20 Janar 2006.

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit dhe problematikat e integritetit evropian

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit është proces i dyanshëm dhe proces rajonal, me të cilin krijohen marrëdhëniet ndërmjet vendeve të Evropës Juglindore dhe BE-së, si dhe në të njëjtën kohë nxitet bashkëpunimi ndërmjet vendeve të rajonit. Mekanizmi Përcjellës i Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim (MPSA) është baza për dialogun e rregullt mes BE-së dhe autoriteteve të Kosovës mbi çështjet e BE-së⁹.

Në tetor 2012, Kosova mori Studimin e Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit midis Bashkimit Evropian dhe Kosovës. Ky studim përmbante rekomandimet afatshkurtra, afatmesme dhe gjithashtu prioritetet, që ndërlidhen me kriteret politike, kriteret ekonomike, administrative, si dhe detyrën, që kanë institucionet rreth përmbushjes së këtyre kriterëve. Sipas Komisionit Evropian, Republika e Kosovës do të ishte e gatshme për të hapur negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit vetëm nëse ndërmerre hapat e parashikuara në rekomandime dhe prioritetet, si: sundimi i ligjit, administrata publike, të drejtat themelore të njeriut, mbrojtja e minoriteteve dhe tregtia.¹⁰

Kosova nënshkroi më 27 tetor të vitit 2015 në Strasburg, Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit me Bashkimin Evropian. Nënshkrimi i këtij dokumenti shënoi edhe vendosjen e parë të marrëdhënieve kontraktuale midis Kosovës dhe BE-së. Marrëveshja për Stabilizim-Asociim kërkon nga një vend, që synon anëtarësimin në BE të sigurojë, se mekanizmat e tij të qeverisjes dhe të shoqërisë civile përmbushin standardet e BE-së. Procesi i nënshkrimit u ngadalësua për shkak të mungesës së konsensusit brenda vetë Bashkimit Evropian, përkatësisht mosnjohjes së Kosovës, si shtet nga pesë vende të BE-së. Megjithatë u ra dakord, që Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit të mos ratifikohej nga parlamentet e secilit shtet anëtar veç e veç, ashtu siç ka qenë praktika me vendet e tjera. Negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit nisën vetëm pasi Kosova u angazhua në bisedime me Serbinë për normalizimin e marrëdhënieve.¹¹

Prania e BE-së në Kosovë që nga paslufta në forma të ndryshme ka bërë, që Kosova të jetë një nga përfituesit më të mëdhenj të ndihmave

⁹Hajrullahu, V.: Gjendja aktuale dhe sfidat kryesore për Kosovën drejt rrugës së anëtarësimit në Bashkimin Evropian. FES-Conference Paper, 2008, fq.8-10.

¹⁰Lyon, A., Prezentimi i Raportit të Fizibilitetit. Projekti i BE për komuna më të fuqishme, Komisioni Evropian në Kosovë, Prishtinë, Tetor 2012.

¹¹<https://kosovapost.net/dy-vjet-nga-nenshkrimi-msa-se-bashkimin-evropian>.(Aksesuarmë 12.01.2018).

financiare dhe asistencës teknike për kokë banori. Që nga viti 1999 deri më 2007, BE-ja ka shpenzuar rreth dy miliard euro për Kosovën dhe që nga 2008 mbi 65 milion çdo vit përmes fondeve të IPA-së.¹² Mbështetje, e cila nuk ka rezultuar efëcente për të rritur zhvillimin ekonomik dhe forcuar sundimin e ligjit, ku Kosova ka probleme serioze në përmeshjen e kriterëve për përaftrim dhe aderim në BE. Disa studiues pohojnë, se politika e kushtëzimit e BE-së nuk ka rezultuar shumë efikase, sepse nuk ka arritur rezultatet e pritura.¹³ Megjithatë, procesi i integritit varet në masë të madhe edhe nga vet niveli i demokracisë së vendeve aspiruese, stabiliteti politik, si dhe nga përkushtimi i qeverive dhe elitave politike për ta çuar përpara këtë proces, pavarësisht interesave partiake e luftës për pushtet.

Rëndësia e bashkëpunimit rajonal, si sfidë integruese për Kosovën

Përmes bashkëpunimit rajonal vendet e përfshira mund të përfitojnë, jo vetëm ekonomikisht, por një gjë e tillë do të forcojë edhe stabilitetin dhe paqen në rajon. Ky bashkëpunim e ndihmon rajonin drejtpërdrejt, që të adresojë në mënyrë më efektive disa nga sfidat, që vështirë se mund të adresohen nga shtetet e rajonit veç e veç. Takimi ndërqeveritar mes Kosovës dhe Shqipërisë, si dhe takimi ministror i gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor ka për qëllim përforcimin e marrëdhënieve bilaterale dhe rajonale, gjë që do të kontribuojë drejt avancimit të përbashkët në Bashkimin Evropian. Marrëdhëniet e mira fqinjësore sjellin dobi edhe në procesin e integritit euro-atlantik. Ky angazhim rajonal i mbështetur nga Komisioni Evropian dhe nga vetë Komisioneri Johannes Hahn është një vazhdimësi dhe rrjedhojë e procesit të nisur në Berlin. Prosesi i globalizimit dhe bashkëpunimi rajonal kanë ndihmuar njëri-tjetrin. Globalizimi në masë të madhe e ka intensifikuar nevojën për bashkëpunim rajonal të shteteve anë e mbanë botës dhe ky bashkëpunim konsiderohet, si mundësi për ndërtim të raporteve të mira në fushën e ekonomisë dhe biznesit, si dhe ka në fokus edhe zgjidhjen e problemeve të zhvillimit rajonal, bashkëpunimit ekonomik, hulumtimit të resurseve natyrore, mundësisit të lëvizjes së lirë të njerëzve dhe të mallrave, kapitalit, fuqisë punëtore mes dy apo më tepër vendeve.

¹²Fagan, A.: Europe's Balkan Dilemma. Paths to Civil Society or State-Building? I.B.Tauris, London 2010, fq.161.

¹³Po aty, fq. 190.

Marrëdhëniet e mira fqinjësore janë kërkesa formale të procesit të integritetit evropian dhe kjo është e përcaktuar qartë në Procesin e Stabilizim Asociimit, që BE e aplikon në rastin e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Nga ana tjetër, prioritet mbetet bashkëpunimi rajonal në fushën ekonomike në mënyrë që tregjet e vogla të rajonit të Ballkanit Perëndimor të integrohen dhe përgatiten duke u reformuar mjaftueshëm për të qenë në gjendje për t'u përballur me presionin e konkurrencës në tregun e përbashkët të BE-së. Disa nga gjërat, për të cilat mund të bëhet më shumë nga të gjitha shtetet e rajonit janë ulja e shpenzimeve në transport, përmirësimi i shërbimeve doganore, njohja e ndërsjelltë e kualifikimeve profesionale, harmonizmi i standardeve të sigurisë, cilësisë etj. Të gjitha këto mund të jetësohen vetëm me një bashkëpunim rajonal të mirëfilltë, gjithëpërfshirës dhe të barabartë. Kosova, po arrin që kohë pas kohe të bëhet fokus dhe fuqi shtytëse e këtyre proceseve.¹⁴

Kosova, si shtet i ri, që pretendon të hyjë në Bashkimin Evropian, kryesisht përballet me probleme të njëjta si të gjithë fqinjët e saj, por në anën tjetër në masë të madhe përballet me problemin politik, posaçërisht në raport me Serbinë, ku kjo e fundit refuzon të pranojë de jure shtetësinë e Kosovës. Marrëveshja e parë e parimeve, që rregullon normalizimin e raporteve mes Beogradit dhe Prishtinës e arritur në Bruksel, si dhe vazhdimi i bisedimeve janë sinjal i parë në drejtim të krijimit të një stabiliteti politik për Kosovën. Problemi mes Kosovës dhe Serbisë në rrafshin e bashkëpunimit rajonal është paraqitur në kuadër të Marrëveshjes për Tregti të Lirë në Evropën Qëndrore (CEFTA), e cila njëherazi është instrument i parahyrjes në BE.

Bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet me Shqipërinë dhe Serbinë

Përsa i përket marrëdhënieve dypalëshe Shqipëri-Kosovë, në vitin 2013 u themelua partneriteti strategjik me fushë të gjerë veprimi dhe zbatimi përmes mekanizmit të mbledhjeve të përbashkëta të qeverive. Takimet e rregullta ndërqeveritare kanë konkretizuar bashkëpunimin dypalësh, si dhe kanë lehtësuar pjesëmarrjen në projekte të ndërlidhjes infrastrukture, energjitike, njehsimit të politikave dhe tregjeve në funksion të shndërrimit të rajonit tonë nga një hapësirë e fragmentizuar dhe e pabarabartë në një rajon të vërtetë nga pikëpamja ekonomike dhe politike. Tashmë ka filluar nga puna, Sekretariati i Përbashkët Shqipëri-

¹⁴<http://www.mei-ks.net/sq/lajmet/jave-e-bashkepunimit-rajonal-dhe-e-integritetit-evropian-ne-kosove>, (Aksesuarmë 19.02.2018).

Kosovë, do të shërbejë, si koordinues dhe bashkërendues i ecurisë së projekteve të përbashkëta¹⁵. Gjithashtu janë ndërmarrë hapa për heqjen e barrierave në shkëmbimet tregtare, për lehtësimin e qarkullimit të mallrave, shtimin e pikave kalimtare kufitare, në mënyrë që të nxiten marrëdhëniet në të gjitha fushat. Së shpejti, pritet vënia në funksion e një pike doganore të Kosovës në Portin e Durrësit, që do krijojë lehtësira të mëtejshme në qarkullimin e mallrave. Shqipëria dhe Kosova kanë intensifikuar bashkëpunimin në shërbimet konsullore. Kjo rrit ndjeshëm efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve ndaj shtetasve.¹⁶

Bisedimet politike midis Prishtinës dhe Beogradit të ndërmjetësuara nga BE-ja nisën në tetor të vitit 2012 me qëllim normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet këtyre dy shteteve. Kjo periudhë, e cila karakterizohet me një dialog të intensifikuar mes Kosovës dhe Serbisë rezultoi në arritjen e disa marrëveshjeve. Shumica e këtyre marrëveshjeve nuk janë zbatuar ende, posaçërisht “marrëveshja për fusnotën”, e cila kishte për qëllim të hiqte pengesat, me të cilat përballej Kosova në anëtarësimin dhe përfaqësimin e saj në nismat rajonale. Serbia pranoi që Kosova të përfaqësohej dhe të anëtarësohej në organizatat rajonale, si palë më vete pa UNMIK-un apo palët e tjera ndërkombëtare të pranishme në nisma të tilla në emër të Kosovës. Kosova, në anën tjetër pranoi, që emri i saj zyrtar të ndryshohej nga “Republika e Kosovës” në “Kosova*” me një yllth, që e nënkupton fusnotën, e cila thotë se “Ky emërtim nuk ndikon në qëndrimin për statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe me mendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës”.¹⁷

Këto kompromise ishin pjesë e përpjekjeve të të dyja palëve për ta përsheptuar perspektivën e tyre në proceset integruese të BE-së. Kosova, po ashtu shpresonte se duke e pranuar “marrëveshjen e fusnotës”, pozita e pesë anëtarëve të BE-së, të cilat nuk e kanë njohur Kosovën, do të ndryshonte.¹⁸ “Marrëveshja për fusnotën” pritej të sillte një dinamikë të re të bashkëpunimit rajonal, në mënyrë që Kosova të bëhej pjesë e nismave

¹⁵Intervista për gazetën “Koha Ditore” - Kosovë, 21.02.2017. (Aksesuar më 21.01.2018).

¹⁶Po aty.

¹⁷Anëtarësimi dhe përfaqësimi i Kosovës në nismat rajonale të sigurisë, 2014, fq. 12.

¹⁸Initiative, Foreign Policy. Kosovo: New Reality of Regional Cooperation. Sarajevo: Friedrich Ebert Stiftung, 2013, fq. 10.

rajonale të sigurisë, të grupeve punuese dhe të strukturave të tjera, që janë ndërtuar gjatë dekadave të fundit për të rritur bashkëpunimin ndërmjet shteteve të Ballkanit. Por, periudha pas marrëveshjes paraqet një realitet, i cili tregon se Kosova e ka përmirësuar pak përfaqësimin e saj, sidomos në nivel rajonal. Marrëveshja nuk arriti t'i përmbushte pritshmëritë fillestare. Në anën tjetër, marrëveshja i solli Kosovës disa përfitime, siç ishte anëtarësimi i saj në Këshillin për Bashkëpunim Rajonal (KBR). Në tetor të vitit 2013, Kosova iu bashkua strukturës së KBR-së, një organizatë rajonale që përbëhet nga 46 shtete, organizata të ndryshme dhe prej institucioneve financiare ndërkombëtare. Pjesëmarrja e Kosovës në KBR është konsideruar një arritje shumë e rëndësishme në kuadër të përfshirjes rajonale.¹⁹ Duke patur parasysh faktin, që KBR-ja përfaqëson një prej organizatave kryesore ombrellë të bashkëpunimit rajonal në Evropën Juglindore,²⁰ institucionet e Kosovës e panë këtë anëtarësim, si mundësi drejt procesit të para-anëtarësimit në BE dhe të bashkëpunimit rajonal në fushën e sigurisë.²¹ Megjithatë, përkundër pritjeve të arsyeshme, anëtarësimi nuk rezultoi në përfshirjen aktive të Kosovës në rrjetin dhe projektet e KBR-së. Pas një viti të anëtarësimit, Kosova nuk u përfshi në 14 nismat, që janë pjesë e KBR-së. Kjo tregon, se vendi nuk arriti të përfitonte nga një varg projektesh dhe aktiviteteve në fushën e sigurisë.²²

Konkluzione

Zhvillimi ekonomik dhe vullneti politik janë të ndërlidhura ngushtë dhe do të nxisin, jo vetëm bashkëpunim më të ngushtë rajonal, por do të sjellin gjithashtu paqe dhe stabilitet afatgjatë në rajon. Përmirësimi i infrastrukturës është një nga mjetet kryesore për të lidhur rajonin duke sjellë vendet dhe qytetarët e saj më pranë njëri-tjetrit. Pajtimi dhe gjithëpërfshirja janë hapat e nevojshëm për të përmbushur integrimin rajonal, si hapin e parë drejt integritit evropian. Përmbushja e këtij parimi i kontribuon rritjes ekonomike.

Dialogu Kosovë-Serbi, si një nga çështjet më të rëndësishme të marrëdhënieve rajonale duhet të intensifikohet. Procesi i anëtarësimit të Kosovës në nismat dhe organizatat rajonale, po sfidohet prej dy elementeve të fuqishme: e para ka të bëjë me mungesën e njohjeve dhe

¹⁹ Kosovo Progress Report 2013. Brussels: EU Commission, 2013, fq. 20.

²⁰ Strategy Work and Programme 2011-2013. Sarajevo: RCC, 2010, fq. 12-15.

²¹ Remikovic, D. and Karadaku, L., Regional Co-operation Council membership will be a boost for Kosovo. 2013. June 2014.

²² AnëtarësimidhepërfaqësimiiKosovësnënismatrajoaletësigurisë, 2014, fq. 13.

pozitën e dobët diplomatike të Kosovës; e dyta ka të bëjë me rezistencën e fortë të Serbisë dhe vendeve të tjera, të cilat nuk e kanë njohur Kosovën, duke e lënë jashtë proceseve të rëndësishme të nivelit rajonal. Pamundësia, që të bëhet anëtare me të drejta të plota në nismat rajonale i paraqesin Kosovës sfida të tjera, si: vendit po i mohohet mundësia, që ta pozicionojë veten si palë e barabartë aktive në rajon. Kosova po parandalohet, që të përfitojë prej veprimeve dhe aktiviteteve të përbashkëta në fushën e sundimit të ligjit, drejtësisë, sigurisë dhe institucionet e Kosovës po pengohen, që të përfitojnë nga programet e përbashkëta të trajnimeve apo praktikave, që mësohen përmes aktiviteteve të përbashkëta ndërmjet vendeve të rajonit.

Bibliografia

- A. Fagan: Europe's Balkan Dilemma. Paths to Civil Society or State-Building? I.B.Tauris, London 2010.
- A. Lyon, Prezentimi i Raportit të Fizibilitetit. Projekti i BE për komuna më të fuqishme, Komisioni Evropian në Kosovë, Prishtinë, Tetor 2012.
- D. Remikovic and L. Karadaku. Regional Co-operation Council membership will be a boost for Kosovo. 2013. June 2014.
- V. Hajrullahu:
Gjendja aktuale dhe sfidat kryesore për Kosovë ndrejtrrugësë anëtarësimit në Bashkimin Evropian. FES-Conference Paper, Prill 2008.
- Initiative, Foreign Policy. Kosovo: New Reality of Regional Cooperation. Sarajevo: Friedrich Ebert Stiftung, 2013.
- Kosovo Progress Report 2013. Brussels: EU Commission, 2013.
- Strategy Work and Programme 2011-2013. Sarajevo: RCC, 2010.
- Anëtarësimi dhe përfaqësimi i Kosovës në nismat rajonale të sigurisë, 2014.
- Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.
- Komunikata e Komisionit “Ballkani Perëndimor në rrugë ndrejtr BE-së: konsolidimi i stabilitetit dhe rritja e prosperitetit,” 20 Janar 2006.
- Rregullorja e Këshillit (EC) No 2666/2000 e datës 5 Dhjetor 2000.
- Intervista për gazetën “Koha Ditore” - Kosovë, 21.02.2017.
- <http://europa.eu.int/>.
- <http://ue.eu.int/ue>.
- <https://kosovapost.net/>.

<http://www.mei-ks.net/sq/lajmet/jave-e-bashkepunimit-rajonal-dhe-e-integritet-evropian-ne-kosove>.

<https://telegrafi.com/sfidat-e-integritet>.

Deklaratë e autorësisë

Unë, Stela Meçaj deklaroj, që ky punim nuk ka qenë i botuar më parë dhe nuk është në proces botimi diku tjetër.

ROLI I ADMINISTRATËS SË TREGUT TË PUNËS NË ZHVILLIMIN EKONOMIK, RASTI I KOSOVËS

Dr. Ylber Aliu

Kolegji AAB

ylber.aliu@universitetiaab.com.

Abstrakt

Objektivi kryesor i të gjitha shteteve është rritja e zhvillimit ekonomik. Shtetet e varfëra kërkojnë të kenë zhvillimin ekonomik. Shtetet në proces të industrializimit synojnë rritjen e nivelit të zhvillimit ekonomik. Ndërsa shtetet e pasura synojnë maksimizimin e zhvillimit ekonomik si parakushtin kryesor për ruajtjen e standardit të jetës dhe mirëqenies së lartë sociale që e kanë. Por, a ka ndonjë rol administrata e tregut të punës në zhvillimin ekonomik të një vendi dhe cili është ky rol? Rezultat i hulumtimit është identifikimi i rolit të administratës së tregut të punës në zhvillimin ekonomik të një vendi. Metodologjia e punimit përbëhet nga një shumicë e metodave të ndryshme për mbledhjen e të dhënave si dhe për analizimin e tyre. Konkluzioni i punimit është se, administrata e tregut të punës ka një rol kyç në zhvillimin ekonomik të një vendi duke udhëhequr procesin e sistemit të të papunëve dhe punëkërkuesve në ndërmarrje dhe biznese si dhe duke ndërmjetësuar të papunët dhe punëkërkuesit në gjetjen e punëve të përshtatshme për ta.

Fjalë kyç: zhvillim, ekonomi, administratë, treg i punës, Kosovë.

Hyrje

Administrata e tregut të punës ka një rol kyç në zhvillimin ekonomik të vendit.

Administrata e tregut të punës e cila përbëhet nga rrjeti publik i shërbimeve të punësimit dhe të aftësimit profesional si dhe nga rrjeti i ofruesve jo publikë të shërbimeve të punësimit është në funksion të zhvillimit ekonomik në dy mënyra. E para, duke ju ndihmuar punëdhënësve të gjejnë punëtorët e nevojshëm për zhvillimin e aktivitetit të tyre biznesor. Për suksesin biznesor të një ndërmarrje është kruciale fuqia punëtore, e cila ka njohuritë, aftësitë dhe shkathtësitë të cilat i kërkon tregu i punës. Duke u nisur nga fakti se tregu i punës është

dinamik duke ndryshuar kërkesat e tregut të punës, administrata e tregut të punës duhet të ndjekë trendin e ndryshimeve duke ofruar shërbime, këshillime dhe aftësim profesional të përshtatshëm. E dyta, duke ndërmjetësuar në formë të përshtatshme të papunët dhe punëkërkuesit në ndërmarrje dhe biznese. Administrata e tregut të punës duhet të informojë, orientojë dhe këshillojë të papunët dhe punëkërkuesit, se cilat janë vendet e punës ku ata ose ato janë të dobishme për veten dhe shoqërinë.

Hipoteza kryesore e këtij punimi është se, '*Administrata e tregut të punës ka një rol kyç në zhvillimin ekonomik të një vendi*'. Kjo hipotezë përbëhet nga dy variabla: variabla e varur dhe variabla e pavarur. Variabla e varur është: *zhvillimi ekonomik i vendit*. Kjo variabël, pra zhvillimi ekonomik i vendit varet edhe nga disa variabla të tjera, të cilat nuk janë operacionalizuar në këtë studim, duke u fokusuar vetëm në rolin e sistemit adekuat të fuqisë punëtore. Ndërsa, variabla e pavarur e punimit është: *administrata e tregut të punës*. Hipoteza e punimit është se: *roli i administratës së tregut të punës, si variabël e pavarur, ka një ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik të një vendi, si variabël e varur*.

Pyetja kryesore kërkimore e punimit, e derivuar nga hipoteza, është: *Cili është roli i administratës së tregut të punës në zhvillimin ekonomik të një vendi?*

Për nevoja të argumentimit praktik të hipotezës do të përdorim rastin e Kosovës. Duke shfrytëzuar të dhëna empirike dhe kuantitative nga data baza e administratës së tregut të punës në Kosovë. Mirëpo të dhënat e nxjerra nga analiza e administratës së tregut të punës në Kosovë, besojmë se, janë të vlefshme edhe për shtetet e tjera.

Metodologjia e punimit është e ndryshme. Të dhënat e punimit janë marrë nga literatura akademike që elaboron rolin e administratës së tregut të punës në funksion të zhvillimit ekonomik. Ndërsa, të dhënat praktike janë marrë nga baza e të dhënave të administratës së tregut të punës në Kosovë. Përpunimi logjik i materialit të mbledhur paraprkasht është bërë përmes metodës së analizës, sintezës si dhe krahasimit.

Korniza teorike dhe ligjore

Konventa e Shërbimit Publik të Punësimit e Organizatës Ndërkombëtare të Punës e vitit: 1948, me nr 88, përkufizon rolin dhe shërbimin e administratës së tregut të punës. Kjo Konventë përcakton se: "Roli themelor i shërbimit publik të punësimit do të jetë që të sigurojë, në

bashkëpunim me organe të tjera publike dhe private, organizimin më të mirë të mundshëm të tregut të punësimit si pjesë përbërëse e programit nacional për arritjen dhe mbajtjen e punësimit të plotë si dhe për zhvillimin dhe shfrytëzimin e resurseve produktive"¹.

Ndërsa autorët e tjerë e vënë theksin te roli organizues dhe lehtësues i administratës së tregut të punës në tregun e punës. Sipas këtyre autorëve, "Theksi kryesor i këtij neni është se SHPP është qendër e organizimit më të mirë të mundshëm të tregut të punësimit, jo vetëm si ofrues i drejtpërdrejt i shërbimeve të punësimit dhe informatave të tregut të punës, por edhe si partner, lehtësues dhe katalizator në arritjen e punësimit të plotë dhe në zhvillimin e resurseve produktive"².

Përpos literaturës dhe konventave ndërkombëtare roli dhe mandati i administratës së tregut të punës rregullohet edhe me legjislacionin përkatës në fuqi. Ligji i Punës përcakton se, "Për zbatimin e politikave aktive dhe pasive të punësimit në Republikën e Kosovës, në kuadër të MPMS-së themelohen Shërbimet Publike të Punësimit"³. Ligji i Punës lejon edhe organizimin dhe funksionimin e administratës private të tregut të punës. Kështu, "Përveç shërbimeve publike të punësimit, personat fizikë dhe juridikë për punët e ndërmjetësimit në punësim mund të themelojnë edhe Agjencinë Private të Punësimit"⁴.

Ligji për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës përcakton se, "Agjencia e Punësimit e Kosovës është ofrues publik i shërbimeve në tregun e punës, që ka për qëllim administrimin e tregut të punës dhe zbatimin e politikave të punësimit dhe aftësimit profesional"⁵. Ligji

¹ Konventa e Shërbimit Publik të Punësimit e miratuar nga Organizata Ndërkombëtare e Punës me nr 88 e vitit 1948.

² Thuy PHAN, et.al, *Shërbimi Publik i Punësimit në tregun e ndryshueshëm të punës*, mbështetur nga Organizata Ndërkombëtare e Punës, Prishtinë, 2001. Ibid. F-53.

³ Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Ligji Nr 03 / L – 212 i Punës*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr 90, dhjetor, 2010, Prishtinë. F-29.

⁴ Ibid. Në këtë punim ne nuk do të analizojmë administratën private të tregut të punës dhe rolin e saj në zhvillimin ekonomik. Fokusi jonë është në rolin e administratës publike në zhvillimin ekonomik të vendit. Megjithatë është e rëndësishme të potencohet se në shtetet e zhvilluara ekonomikisht, ofruesit jo publik të shërbimeve të punësimit kanë një rol të theksuar në aktivitetin ekonomik të vendit.

⁵ Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Ligji Nr 04 / L – 205 për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr 01, janar, 2014, Prishtinë. F-1.

gjithashtu përcakton se, “Shfrytëzuesit e shërbimeve të punësimit janë personat e papunë, punëkërkuarit, punëdhënësit, të punësuarit dhe shtetasit e huaj, të cilët kanë për qëllim punësimin në Kosovë”⁶.

Mandati i Zyrtarëve të Punësimit është ofrimi i shërbimeve publike të punësimit për të papunët, punëkërkuarit si dhe për punëdhënësit. Shërbimet e punësimit, të cilat ofrohen nga Zyrtari e Punësimit, janë si vijon: regjistrimi i të papunëve, ndërmjetësimi në punësim, hulumtimi i tregut të punës, shpallja e vendeve të lira të punës, këshillim për punësim, këshillim për orientim në karrierë, këshillim për intervistë për punë, etj. Zyrtari e Punësimit ofrojnë edhe shërbime përmes platformës online. Shërbimet kryesore të cilat ofrohen përmes platformës online për punëdhënësit janë si vijon:

1. Krijimin dhe menaxhimin e profilit të Punëdhënësit
2. Shpalljen e vendeve të lira të punës
3. Njoftimet për kandidatët e përshtatshëm, sipas shpalljes së vendit të lirë të punës
4. Shpalljen e ofrimit të trajnimit
5. Përcjelljen e aplikimeve për vendet e lira të punës
6. Kërkimin e kandidatëve të përshtatshëm në relacion me vendet e lira të punës”⁷.

Përpos Zyrtarëve të Punësimit, pjesë e administratës së tregut të punës në Kosovë janë edhe Qendrat e Aftësisimit Profesional. Rrjeti i Qendrave të Aftësisimit Profesional funksionon në kuadër të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, që është institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Pra, konventat ndërkombëtare të miratuara nga Organizata Ndërkombëtare e Punës, si dhe në legjislacionin përkatës që rregullon fushë veprimtarinë e Zyrtarëve të Punësimit në Kosovë, roli i administratës së tregut të punës është rol kyç në sistemimin adekuat të fuqisë punëtore tek punëdhënësit në funksion të nxitjes së zhvillimit ekonomik si dhe rritjes së punësueshmërisë. Kontakti i përditshëm i administratës së tregut të punës (Zyrtarëve të Punësimit dhe Qendrave të Aftësisimit Profesional) me të papunë, punëkërkuar si dhe punëdhënës u jep mundësinë të njohin më mirë se kush do tjetër ofertën dhe kërkesën në tregun e punës, të dinë se cilat janë dinamikat kryesore të tregut të punës, si dhe të japin këshilla, udhëzime dhe informacione për harmonizim adekuat të ofertës dhe

⁶ Ibid.

⁷ Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Ligji Nr 05 / L – 077 për Regjistrimin dhe Ofrimin e Shërbimeve për të Papunët, Punëkërkuarit dhe Punëdhënësit*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr 26, korrik, 2016, Prishtinë. F-6.

kërkesës. Asnjë institucion tjetër më mirë se administrata e tregut të punës nuk mund të realizojë një qëllim të tillë.

Të gjeturat praktike

Më poshtë do të prezentojmë në formë tabelare të gjeturat praktike lidhur me rolin e administratës së tregut të punës në Kosovë në ofrimin e shërbimeve të ndryshme të punësimit për punëdhënësit, të papunët dhe punëkërkesit. Të dhënat janë të ndara në tri tabela kryesore.

E para, janë të dhënat lidhur me vendet e lira të punës të identifikuar nga administrata e tregut të punës për vitin 2017. Hulumtimi i vendeve të lira të punës dhe regjistrimi i këtyre vendeve në sistemin elektronik të vendeve të lira të punës që mbahet nga Zyrat e Punësimit është njëri prej aktiviteteve kryesore të këtyre zyrave.

Tabela 1: Vendet e lira të punës të identifikuar nga administrata e tregut të punës sipas aktivitetit ekonomik 2017

Aktiviteti ekonomik	Totali
BUJQËSIA, GJUETIA, DHE SILVIKULTURA	863
PESHKIMI	0
INDUSTRIA NXERRËSE	11
INDUSTRIA PËRPUNUESE	1505
PRODHIMI, SHPËRNDARJA E ENERGJISË	116
NDËRTIMI	652
TREGTIA, RIPARIMI I AUTOMOBILAVE DHE ARTIKUJVE SHTËPIAKË	1162
HOTELE DHE RESTORANTE	474
TRANSPORTI DHE TELEKOMUNIKACIONI	183
AKTIVITETI FINANCIAR	51
PASURITË E PATUNDSHME, DHËNIA ME QIRA DHE SHËRBIME PËR NDËRMARRJET	72

ADMINISTRIMI PUBLIK	212
ARSIMI	265
SHËNDETI DHE VEPRIMTARITË SOCIALE	44
SHËRBIME KOLEKTIVE, SOCIALE DHE PERSONALE	478
SHËRBIME SHTËPIAKE	43
AKTIVITETE TË ORGANIZATAVE NDËRKOMBËTARE	0
Të tjera	1471
Total	7602

Burimi: Sistemi i Informatave në Tregun e Punës janar - tetor.

E dyta, ndërmjetësimet në punësim të rregullt. Ndërmjetësimet në punësim të rregullt është aktiviteti tjetër i Zyrave të Punësimit. Pra, aty ku ka pajtueshmëri mes punëdhënësit dhe të papunëve ose punëkërkuesve, Zyrat e Punësimit e realizojnë ndërmjetësimin në punësim të rregullt.

Tabela 2: Ndërmjetësimet në punësim të rregullt nga administrata e tregut të punës sipas aktivitetit ekonomik për vitin 2017

Aktiviteti ekonomik	Totali	Femër	Mashkull
BUJQËSIA, GJUETIA, DHE SILVIKULTURA	104	31	73
PESHKIMI	0	0	0
INDUSTRIA NXERRËSE	7	1	6
INDUSTRIA PËRPUNUESE	566	200	366
PRODHIMI, SHPËRNDARJA E ENERGJISË	13	2	11
NDËRTIMI	196	10	186
TREGTIA, RIPARIMI I AUTOMOBILAVE DHE ARTIKUJVE SHTËPIAKË	502	280	222
HOTELE DHE RESTORANTE	199	69	130
TRANSPORTI DHE TELEKOMUNIKACIONI	47	15	32
AKTIVITETI FINANCIAR	19	13	6

PASURITË E PATUNDSHME, DHËNIA ME QIRA DHE SHËRBIME PËR NDËRMARRJET	52	13	39
ADMINISTRIMI PUBLIK	18	9	9
ARSIMI	26	23	3
SHËNDETI DHE VEPRIMTARITË SOCIALE	11	9	2
SHËRBIME KOLEKTIVE, SOCIALE DHE PERSONALE	159	68	91
SHËRBIME SHTËPIAKE	17	9	8
AKTIVITETE TË ORGANIZATAVE NDËRKOMBËTARE	0	0	0
Të tjera	477	162	315
Total	2413	914	1499

Burimi: Sistemi i Informatave në Tregun e Punës janar - tetor.

E treta, institucionet punëdhënëse, të cilat bashkëpunojnë me Zyrat e Punësimit. Këtu kemi përfshirë numrin dhe llojin e institucioneve punëdhënëse, të cilat në momentin kur kanë pasur nevojë për fuqi punëtore u janë drejtuar Zyrave të Punësimit për të kërkuar shërbime nga këto zyra.

Tabela 3: Lloji i institucioneve që bashkëpunojnë me administratën e tregut të punës

Emri	Totali
Organizatë jo qeveritare	117
Person Fizik	549
	2
QAP - Qendra e Aftësimi Profesional	66
QTTJ – Qendra të tjera trajnuese jopublike	207
Kompani	15427
Institucionet Publike	831
Total	17199

Burimi: Sistemi i Informatave në Tregun e Punës.

Tabela 4: Stafi i Zyrove të Punësimit në Kosovë krahasuar me Austrinë, Serbinë, Slloveninë, Shqipërinë

Vendet	Stafi total i ShPP-së	Totali i Këshilltarëve	Totali i punëkërkuësve të regjistruar	Totali i të papunëve të regjistruar për një anëtar stafi të ShPP-së	Numri total i të papunëve të regjistruar për një këshilltar të ShPP-së
Austria	4865	4105	246702	51	60
Sllovenia	1071	482	110021	103	228
Serbia	1781	823	761486	428	925
Shqipëria	364	N. A.	143000	393	N. A.
Kosova	201	91	98601	491	1006

Burimi: Tabela është marrë nga studimi i realizuar me përkrahjen e projektit, EYE, me autor: Koro, L. (2013) Rishikimi Sistematik i Shërbimit Publik të Punësimit (ShPP) në Kosovë, Departamenti i Punës dhe Punësimit, shtator, Prishtinë. Prishtinë: EYE.

Gjithashtu input të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendit japin edhe Qendrat e Aftësimit Profesional duke ofruar trajnime dhe ritrajnime falas për të papunët e pakualifikuar ose ata, të cilët duan të ndërrojnë profesion apo duke trajnuar e ritrajnuar punonjësit e bizneseve dhe ndërmarrjeve të ndryshme. Qendrat e Aftësimit Profesional ofrojnë trajnime në 30 profile të zgjedhura nga tregu i punës. QAP-at ofrojnë po ashtu njohjen e mësimit paraprak që është një politikë tjetër aktive e tregut të punës. Në vitin (periudhën janar – dhjetor) 2017, QAP-at kanë trajnuar dhe ritrajnuar 4987 të papunë dhe punëkërkuës. Ndërsa në periudhën janar – dhjetor të vitit 2016 QAP-at kanë trajnuar 6818 të papunë dhe punëkërkuës.

Pra, hulumtimi i vendeve të lira të punës, ndërmjetësimi në punësim të rregullt, bashkëpunimi me punëdhënësit, aftësimi dhe riaftësimi profesional, nuk janë aktivitetet e vetme të Zyrove të Punësimit, sepse këto zyra kryejnë edhe aktivitete të tjera; mirëpo këto aktivitete janë kryesore sa i përket sistemimit të fuqisë punëtore.

Analiza e të gjeturave

Duke gjykuar nga ajo çfarë u tha më lart ne konkludojmë se, administrata e tregut të punës ka një rol kyç në zhvillimin ekonomik të një vendi duke udhëhequr procesin e sistemimit të të papunëve dhe punëkërkuësve në ndërmarrje dhe biznese si dhe duke ndërmjetësuar të papunët dhe punëkërkuësit në gjetjen e punëve të përshtatshme për ta.

Në rastin e Kosovës administrata e tregut të punës ka pasur një rol kyç në vitin 2017 duke udhëhequr dhe organizuar procesin e hulumtimit të vendeve të lira të punës, ndërmjetësimet në punësim të rregullt si dhe duke ofruar shërbime të ndryshme të punësimit për punëdhënësit e të gjitha llojeve. Administrata e tregut të punës, gjegjësisht Zyrat e Punësimit kanë arritur të identifikojnë dhe regjistrojnë 7602 vende të lira të punës gjatë vitit 2017. Përmes identifikimit dhe regjistrimit të vendeve të lira të punës në sistemin elektronik, Zyrat e Punësimit u kanë ofruar mundësinë të papunëve dhe punëkërkuësve të aplikojnë për punë dhe eventualisht nëse ka pajtueshmëri mes punëdhënësit dhe të papunit apo punëkërkuësit të punësohet. Aktiviteti ekonomik që ka prodhuar më së shumti vende të lira është industria përpunuese me gjithësej 1505 vende të lira pune, mandej vjen tregtia dhe kështu me rradhë. Me shërbimin e identifikimit dhe zbulimit të vendeve të reja të punës, Zyrat e Punësimit i japin një dinamikë të fuqishme tregut të punës dhe rritjes së punësimit. Vendet e lira të punës janë identifikuar nga Këshilltarët e punësimit, duke i vizituar direkt ndërmarrjet dhe bizneset ose kur ndërmarrjet dhe bizneset i kanë deklaruar vendet e lira te Zyrat e Punësimit.

Administrata e tregut të punës, gjegjësisht Zyrat e Punësimit në periudhën janar – tetor të vitit 2017, kanë arritur të ndërmjetësojnë në punësim të rregullt 2413 të papunë dhe punëkërkuës. Pavarësisht se identifikimi i vendeve të lira të punës ka qenë më i madh në këtë periudhë kohore, numri i ndërmjetësimeve në punësim të rregullt është më i vogël, sepse nuk ka pasur harmonizim mes ofertës dhe kërkesës në tregun e punës, përkatësisht mes kushteve dhe kriterëve, të cilat janë kërkuar nga punëdhënësit me aftësitë, njohuritë apo shkathtësitë e të papunëve dhe punëkërkuësve. Përmes shërbimit të ndërmjetësimit në punësim të rregullt, Zyrat e Punësimit u ndihmojnë punëdhënësit të gjejnë punëtorë të përshtatshëm për zhvillimin e aktiviteteve të tyre biznesore, por në të njëjtën kohë u ofrojnë mundësi të papunëve dhe punëkërkuësve të gjejnë punë. Pra, është fjala për një shërbim me vlerë të madhe si për punëdhënësit ashtu edhe për të papunët dhe punëkërkuësit. Nga të dhënat

e prezantuara, ne kuptojmë se, gjatë vitit 2017 veprimtaria ekonomike që ka të bëjë me industrinë përpunuese, ka punësuar më së shumti të papunë dhe punëkërkues, mandej është tregtia si dhe shërbimet (hotele dhe restorante). Po ashtu edhe në aspektin gjinor, femrat janë më së shumti të punësuar në veprimtarinë e industrisë përpunuese si dhe tregtisë.

Administrata e tregut të punës, gjegjësisht Zyrat e Punësimit në periudhën janar - tetor të vitit 2017, kanë ofruar shërbime të ndryshme të punësimit për të gjitha kategoritë e punëdhënësve. Nga të dhënat e prezantuara ne kuptojmë se 15427 kompani kanë marrë shërbime të punësimit nga Zyrat e Punësimit. Mandej, kanë ofruar shërbime të ndryshme punësimi për institucionet publike, ofruesit jo publikë të shërbimeve të trajnimit, personat fizikë në cilësinë e punëdhënësve, etj. Këto të dhëna argumentojnë më së miri se Zyrat e Punësimit kanë qenë një krah i fortë i punëdhënësve në zhvillimin e aktiviteteve të tyre biznesore sa i përket shërbimeve të punësimit. Është e domosdoshme që Zyrat e Punësimit të zgjerojnë gamën e shërbimeve të punësimit, të cilat i ofrojnë për punëdhënësit, të modernizojnë ofrimin e këtyre shërbimeve, duke ofruar shërbime edhe përmes platformave elektronike, duke ju mundësuar punëdhënësve pa shpërburje nga puna të kenë qasje në databazën e të papunëve dhe punëkërkuesve me qëllim që të gjejnë profilet e punëtorëve për të cilën kanë nevojë.

Në tabelën nr 4 ne kemi prezantuar të gjeturat tabelare në formë krahasuese për sa i përket Zyrate të Punësimit në Kosovë duke i krahasuar me Zyrat e Punësimit në dy shtete rajonale: Serbia dhe Shqipëria, si dhe me dy shtete të cilat janë anëtarë të Bashkimit Evropian: Sllovenia dhe Austria. Dhe nga të dhënat e prezantuara ne shohim se, Kosova ka numrin më të vogël të Këshilltarëve të punësimit për të papunë dhe punëkërkues në krahasim me shtetet krahasuese. Bie fjala, në Kosovë një Këshilltari të punësimit i duhet të ofrojë shërbime për mbi 1000 të papunë dhe punëkërkues, përderisa në Austri një Këshilltar punësimi ofron shërbime për 60 të papunë ose punëkërkues, në krahasim me Slloveninë ku raporti është 1 me 228. Numri i madh i të papunëve dhe punëkërkuesve për të cilët duhet të kujdeset një Këshilltar punësimi ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e ofrimit të shërbimeve, sepse kujdesi dhe cilësia e shërbimeve është shumë më kualitative kur numri është më i vogël, për dallim prej rasteve kur numri është më i madh dhe cilësia e shërbimeve është shumë më e ulët.

Konkluzioni

Administrata e tregut të punës (Zyrat e Punësimit dhe Qendrat e Aftësimit Profesional) kanë një rol kyç në zhvillimin ekonomik të një vendi. Ky rol përbëhet nga shërbimet, të cilat i ofrojnë Zyrat e Punësimit dhe Qendrat e Aftësimit Profesional dhe të cilat konsistojnë në: hulumtimin e tregut të punës përmes identifikimit të vendeve të lira të punës, ndërmjetësimet në punësim të rregull si dhe aftësimi dhe riaftësimi profesional i të papunëve dhe punëkërkuesve. Andaj, është e domosdoshme që kjo administratë të ketë një përkrahje më të madhe nga institucionet shtetërore me qëllim të zgjerimit në ofrimin e shërbimeve si dhe rritjen e cilësisë së këtyre shërbimeve. Ashtu sikurse e kemi potencuar edhe në hyrje të punimit, zhvillimi ekonomik është një variabël studimor i cila varet edhe prej faktorëve të tjerë në shoqëri, mirëpo në kuadër të punimit ne jemi fokusuar vetëm tek roli i administratës së tregut të punës në zhvillimin ekonomik.

Bibliografia

- Ylber Aliu, *Roli i politikave të punësimit dhe aftësimit profesional në Kosovë*, disertacion i doktoraturës, Prishtinë, 2016. Linku: <https://drive.google.com/file/d/0Bw7PMj1MQMklcmJDVURKOEJkQ0U/view>.
- Konventa e Shërbimit Publik të Punësimit e miratuar nga Organizata Ndërkombëtare e Punës me nr 88 e vitit 1948.
- Thuy PHAN, et.al, *Shërbimi Publik i Punësimit në tregun e ndryshueshëm të punës*, mbështetur nga Organizata Ndërkombëtare e Punës, Prishtinë, 2001.
- Dell’Aringa, Carlo, et. Al, *Strategic Choices in Reforming Public Service Employment*. Great Britain: Palgrave. 2001.
- Bach, Stephen, et. al, *Public Service Employment Relations in Europe, transformation, modernization or inertia?*, London and NewWork: Routledge. 1999.
- Singh Madhu, *Meeting basic learning needs in the informal sector*. USA: Institute for Education, 2005.
- Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Ligji Nr 03 / L – 212 i Punës*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr 90, dhjetor, 2010, Prishtinë.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Ligji Nr 04 / L – 205 për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr 01, janar, 2014, Prishtinë.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Ligji Nr 05 / L – 077 për Regjistrimin dhe Ofrimin e Shërbimeve për të Papunët, Punëkërkuesit dhe Punëdhënesit*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr 26, korrik, 2016, Prishtinë.

Të dhënat e marra nga Sistemi i Informatave në Tregun e Punës (SIMP) te pjesa e të gjeturave praktike të prezantuara në formë tabelare.

Katalogimi në botim – **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

33/34”2018”(063)

Book of proceedings / organizuar nga
Kolegji AAB. – Prishtinë : Kolegji AAB, 2018. – 302 f.
: ilustr. ; 24 cm.

ISBN 978-9951-494-80-9

ISBN 978-9951-494-80-9



9 789951 494809